



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 100

Tiranë – E mërkurë, 6 korrik 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 52/2022, datë 9.6.2022	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin shtesë për projektin “Përmirësimi i sistemit të shëndetësisë”..... 12557
Dekret i Presidentit nr. 13751, datë 30.6.2022	Për shpallje ligji..... 12562
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 460, datë 29.6.2022	Për miratimin e Strategjisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit, 2021–2027..... 12563
Vendim i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 2, datë 31.5.2022	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 92, datë 17.3.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor..... 12659
Urdhër i kryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 311, datë 29.6.2022	Për shfuqizim të urdhrit nr. 2, datë 21.1.2021 “Për delegim kompetencash”..... 12681
	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar “Sekret shtetëror” në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave..... 12681
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 116, datë 24.5.2022	Mbi licencimin e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Blue 1”, me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 mw..... 12682
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 117, datë 24.5.2022	Mbi njohjen e licencës për furnizimin me energji elektrike, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës, për subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k. 12683

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 118, datë 24.5.2022	Mbi njohjen e licencës për tregtimin e energjisë elektrike, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës, për subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k. (<i>Fuente Dynamics</i>).....	12685
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 119, datë 24.5.2022	Mbi kërkesën e shoqërisë “Irarba Energji” sh.p.k. për transferimin e asetëve të paluajtshme në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a.....	12686
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 120, datë 24.5.2022	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Gostima 1”, me kapacitet të instaluar 3047 kw, “Gostima 2”, me kapacitet të instaluar 5586 kw, “Gostima 3”, me kapacitet të instaluar 5335 kw, “Gostima 4”, me kapacitet të instaluar 7396 kw, “Gostima 5”, me kapacitet të instaluar 10321 kw, “Gostima 5/1”, me kapacitet të instaluar 450 kw, dhe “Gostima 6”, me kapacitet të instaluar 16819 kw, me kapacitet total të instaluar 48 864 kw.....	12687
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 121, datë 24.5.2022	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	12690
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 122, datë 24.5.2022	Mbi shtyrjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me rinovimin e licencës së shoqërisë “Kurum International” sh.a., me nr. 372, seria F12/17, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 20.7.2012, i ndryshuar.....	12691
	Korrigjim gabimi material në urdhrin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 115, datë 6.6.2022, “Për miratimin e rregullores për kërkesat, përmbajtjen e regjistrit dhe procedurat e regjistrimit, çregjistrimit ose ndryshimit të të dhënave në regjistrin e avionëve civil të Republikës së Shqipërisë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 93, datë 20.6.2022.....	12692



LIGJ
Nr. 52/2022

HUAJA NUMËR 9306-AL

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM PËR FINANCIMIN
SHITESË PËR PROJEKTIN
“PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË
SHËNDETËSISË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin shtesë për projektin “Përmirësimi i sistemit të shëndetësisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar më datë 9.6.2022.

Shpallur me dekreten nr. 13751, datë 30.6.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

MARRËVESHJE HUAJE
(Financim shtesë për Projektin e Përmirësimit të Sistemit të Shëndetësisë)
**NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

Marrëveshje sipas datës së nënshkrimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë (“Huamarrësi”) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka”),

DUKE PASUR PARASYSH SE

A. sipas Marrëveshjes Fillestare të Financimit, Banka ka rënë dakord t’i jepte Huamarrësit një hua në shumën prej tridhjetë e dy milionë e njëqind mijë euro (32,100,000) “Financimi fillestar”, për të ndihmuar në financimin e aktiviteteve të lidhura me projektin e përshkruar në Marrëveshjen e Financimit për Projektin e Përmirësimit të Sistemit Shëndetësor (“Projekti fillestar”) ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës, të datës 24 mars 2015, të ndryshuar (Huaja nr. 8466-AL) (Marrëveshja Fillestare e Financimit); dhe

B. Huamarrësi i ka kërkuar Bankës të ofrojë ndihmë financiare shtesë në mbështetje të aktiviteteve që lidhen me Projektin Fillestar dhe të përshkruara në skedulin 1 të kësaj Marrëveshjeje (“Projekti”) duke dhënë hua në një shumë të barasvlershme me 25,000,000 euro (njëzet e pesë milionë euro) (“Financimi shtesë”).

C. Banka ka rënë dakord, ndër të tjera, në bazë të sa më sipër, t’i japë Huamarrësit një ndihmë të tillë shtesë sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

Huamarrësi dhe Banka bien dakord si më poshtë:

Neni I
Kushtet e përgjithshme; përkufizimet

1.01 Kushtet e përgjithshme (siç përcaktohen në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) zbatohen dhe janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Me përjashtim të rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe, termat me shkronjë të madhe të përdorura në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u janë dhënë në kushtet e përgjithshme ose në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.



Neni II Huaja

2.01 Banka pranon t'i japë hua Huamarrësit shumë prej 25,000,000 euro (njëzet e pesë milionë euro), siç kjo shumë mund të konvertohet herë pas here nëpërmjet një konvertimi valutor ("Huaja") për të ndihmuar në financimin e projektit të përshkruar në skedulin 1 të kësaj Marrëveshjeje ("Projekti") (përveç pjesëve 1 (a) (ii), (iii) dhe (v) të Projektit).

2.02 Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat e Huas në përputhje me seksionin III të skedulit 2, të kësaj Marrëveshjeje.

2.03 Tarifa fillestare është një e katërta e një për qind (0,25%) të shumës së Huas.

2.04 Shuma e angazhimit financiar është një e katërta e një për qind (0,25%) në vit mbi balancën e patërhequr të Huas.

2.05 Norma e interesit është norma e referencës plus shtrirje e ndryshueshme ose norma që mund të zbatohet pas një konvertimi; sipas seksionit 3.02 (e) të kushteve të përgjithshme.

2.06 Datat e pagesës janë data 1 e muajit prill dhe tetor të çdo viti.

2.07 Shuma principal e Huas do të shlyhet në përputhje me skedulin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni III Projekti

3.01 Huamarrësi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të Projektit. Për këtë qëllim, Huamarrësi do të realizojë projektin nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në përputhje me dispozitat e nenit V të kushteve të përgjithshme dhe skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni IV Bërja efektive; përfundimi

4.01 Afati i bërjes efektive është data 90 (nëntëdhjetë) ditë pas datës së nënshkrimit.

Neni V Përfaqësuesi; adresat

5.01 Përfaqësuesi i Huamarrësit është ministri i saj përgjegjës për financat.

5.02 Për qëllime të seksionit 10.01 të kushteve të përgjithshme: a) Adresa e Huamarrësit është:
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Shqipëri dhe
Adresa elektronike e Huamarrësit është:
E-mail: sekretariamin@financa.gov.al

5.03 Për qëllime të seksionit 10.01 të kushteve të përgjithshme: a) Adresa e Bankës është:
International Bank for Reconstruction and Development
1818 Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America; dhe
Adresa elektronike e Bankës është:
Faksimile: 1-202-477-6391
E-mail: esalinas@worldbank.org
RËNË DAKORD që nga data e nënshkrimit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: _____

Përfaqësuesi i Autorizuar

Emri: DELINA IBRAHIMAJ

Titulli: MINISTËR I FINANCIVE DHE
EKONOMISË

Data: 29.4.2022

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Përfaqësuesi i Autorizuar

Emri: EMANUEL SAVINAS MUNOZ

Titulli: MENAXHER SHITETI

Data: 5.4.2022

SKEDULI 1 PËRSHKRIMI I PROJEKTTIT

Objekti i Projektit është të kontribuojë në modernizimin e shërbimeve të përzgjedhura spitalore publike dhe të mbështesë rindërtimin e objekteve të përzgjedhura mjekësore të dëmtuara nga tërmeti i vitit 2019.

Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1. Përmirësimi i menaxhimit dhe infrastrukturës spitalore

a) Forcimi i kapaciteteve të menaxhimit të sektorit të spitaleve publike, duke përfshirë:



i. Përditësimin e masterplanit ekzistues të spitaleve dhe rishikimin e kuadrit rregullator ligjor dhe administrativ të spitaleve për përmirësimin e menaxhimit spitalor të shërbimeve dhe rekomandimeve spitalore, nëse është e zbatueshme, një përmirësim të kuadrit të lartpërmendur për ndërtimin e kapaciteteve të ekipeve të menaxhimit spitalor, si Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, HIF dhe agjenci të tjera për mbikëqyrjen shëndetësore për planifikimin e shërbimeve, shpërndarjen e burimeve, reformat e pagesave dhe monitorimin e zbatimit dhe kontraktimin;

ii. kryerjen e një vlerësimi të menaxhimit aktual të *Qendrës Spitalore Universitare* dhe rekomandimi të përmirësimeve përkatëse;

iii. përditësimin e udhëzimeve klinike dhe protokolleve për sëmundjet kronike prioritare;

iv. zbatimin e mekanizmave për angazhimin e qytetarëve për të rritur përgjegjshmërinë dhe transparencën në ofrimin e shërbimeve spitalore;

v. krijimin e Llogarive Kombëtare të Shëndetit për të mbështetur punën analitike buxhetore në sektorin e shëndetësisë;

vi. zhvillimin dhe zbatimin e aktiviteteve komunikuese për informimin e publikut mbi reformat në spitale; dhe

vii. hartimin e një strategjie gjinore dhe mbështetjen e aktiviteteve ndërgjegjësuere që fokusohen në trajtimin e kancerit të gjirit.

b) Infrastruktura mbështetëse e shërbimeve spitalore

i. duke iniciuar, të paktën në një nga rajonet e Huamarrësit, zbatimin e masterplanit të rishikuar spitalor, për të ofruar një fushë të re shërbimesh në objektet rajonale dhe bashkiake;

ii. rehabilitimin dhe/ose përmirësimin e infrastrukturës dhe pajisjeve mjekësore të spitaleve të përzgjedhura; dhe

iii. hartimin e një strategjie për mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore në sektorin e shëndetit publik dhe trajnimin e personelit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, spitale dhe agjenci publike.

Pjesa 2. Përmirësimi i menaxhimit të informacionit shëndetësor/*e-Health* për shërbimet spitalore

i. krijimi i mjedisit mundësues për përmirësimin e saktësisë dhe afateve kohore të informacionit klinik, financiar dhe administrativ brenda dhe ndërmjet spitaleve rajonale, duke përfshirë

zhvillimin e një masterplanit dhe marrëveshjeve institucionale për aktivitetet e shëndetit elektronik (*e-Health*), konsolidimin e standardizimit dhe regjistrave themelorë, dhe përmirësimin e infrastrukturës për sistemet e informacionit të kujdesit shëndetësor; dhe

ii. zbatimi i sistemeve specifike të informacionit për të mbështetur spitalet (sistemi i informacionit spitalor në spitalet e përzgjedhura rajonale dhe mjetet për të mbështetur pagesat e paketave të shërbimit spitalor në HIF.

Pjesa 3. Monitorimi, vlerësimi dhe menaxhimi i Projektit

Ofrimi i mbështetjes për NJKP-në për zbatimin e aktiviteteve të Projektit, duke përfshirë: i) kryerjen e menaxhimit, monitorimit dhe aktiviteteve vlerësuese; ii) kryerjen e sondazheve dhe studimeve në lidhje me projektin; dhe iii) zbatimin e një strategjie komunikimi dhe fushate për reformat në shëndetësi.

SKEDULI 2

EKZEKUTIMI I PROJEKTTIT

Seksioni 1

Masa zbatimi

A. Masa institucionale

1. Huamarrësi:

a) nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e përgjithshëm të Projektit; dhe

b) nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, do të mbajë gjatë zbatimit të Projektit një NJKP me personelin kryesor, duke përfshirë një menaxher Projekti, një specialist të menaxhimit financiar, një specialist prokurimi, një specialist të teknologjisë së informacionit, një specialist monitorimi dhe vlerësimi, një specialist mjedisor dhe social dhe një specialist të inxhinierisë së ndërtimit, të gjithë me kualifikime dhe me përvojën dhe termat e referencës të pranueshme nga Banka.

B. Masa zbatimi

1. Manuali i veprimeve të Projektit

a) Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas datës së bërjes efektive, Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, do të përditësojë dhe më pas do të mirëmbajë dhe



zbatojë Projektin në përputhje me dispozitat e Manualit të Operacioneve të Projektit në formë dhe thelb të pranueshme për Bankën, të cilat do të përfshijnë ndër të tjera: a) rolet dhe përgjegjësitë e secilës prej agjencive ose subjekteve të përfshira në zbatimin e Projektit; b) kërkesat e personelit për Projektin; c) skedulën e parashikuar të zbatimit; c) procedurat për aksesimin, disbursimin dhe llogaritjen e fondeve në kuadër të Projektit; d) treguesit që do të përdoren në monitorimin dhe vlerësimin e Projektit; e) procedurat për monitorimin, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e Projektit, duke përfshirë formatin dhe përmbajtjen e raporteve të Projektit; dhe f) procedurat e prokurimit dhe menaxhimit financiar siç mund të ndryshohen herë pas here me miratimin paraprak me shkrim të Bankës.

b) Përveç rasteve kur Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bankës, mund të bjerë dakord ndryshe me shkrim, Huamarrësi nuk do të shfuqizojë, ndryshojë, pezullojë, heqë dorë ose nuk do të zbatojë ndryshe Manualin e Veprimeve të Projektit ose ndonjë dispozitë të tij. Në rast të ndonjë mospërputhjeje ndërmjet dispozitave të Manualit të Veprimeve të Projektit dhe dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, dispozita e kësaj Marrëveshjeje do të ketë përparësi.

C. Masat mbrojtëse

1. Në realizimin e pjesës 1 (b) të Projektit, Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:

i. do të kryejë pjesën e sipërpërmendur të Projektit në përputhje me Kuadrin e Menaxhimit Mjedisor dhe Social në një mënyrë të pranueshme për Bankën; dhe

ii. t'i ofrojë Bankës për miratimin e saj paraprak, çdo rishikim të propozuar në lidhje me Kuadrin e

Menaxhimit Mjedisor dhe Social, dhe më pas të prezantojë këto rishikime në Kuadrin e Menaxhimit Mjedisor dhe Social, siç është rënë dakord me Bankën.

2. Në rast konflikti ndërmjet Kuadrit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social dhe dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi.

3. Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, do të sigurojë që termat e referencës së çdo konsulence në lidhje me Projektin do të jenë të pranueshme për Bankën pas shqyrtimit të saj dhe për këtë qëllim këto terma reference do të përfshijnë siç duhet kërkesat e Politikave Mbrojtëse të Bankës që ishin në fuqi, siç zbatohet për informacionet e përcjella përmes një asistence të tillë teknike.

Seksioni II. Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i Projektit

Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, do t'i dorëzojë Bankës çdo raport projekti jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik, duke mbuluar tremujorin kalendarik.

Seksioni III. Tërheqja e të ardhurave nga Huaja

A. Të përgjithshme

Pa kufizim dhe sipas dispozitave të nenit II të kushteve të përgjithshme dhe në përputhje me letrën e informacionit të disbursimit financiar, Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat e Huas për: a) financimin e shpenzimeve të pranueshme; dhe b) të paguajë: i) tarifën fillestare; dhe ii) çdo normë interesi apo normë interesi primi; në shumën e alokuar dhe nëse është e zbatueshme, deri në përqindjen e përcaktuar ndaj çdo kategorie sipas tabelës së mëposhtme:

Kategoria	Shuma e Huas së dhënë (e shprehur në euro)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen
1. Punimet, mallrat dhe shërbimet jokonsulente për Projektin (përveç pjesëve 1 (a) (ii), (iii) dhe (v) të Projektit.	22,377,500	100%
2. Shërbimet e konsulencës, trajnimi dhe kostot operative për Projektin (përveç pjesëve 1 (a) (ii), (iii) dhe (v) të Projektit.	2,560,000	100%
3. Fatura fillestare	62,500	Shuma e pagueshme në përputhje me seksionin 2,03 të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me seksionin 2,07 (b) të kushteve të përgjithshme
4. Norma e interesit ose norma e interesit të primit		Shuma detyrim në përputhje me seksionin 4,05 (c) të kushteve të përgjithshme
SHUMA TOTALE	25,000,000	



B. Kushtet e tërheqjes; periudha e tërheqjes

1. Pavarësisht nga dispozitat e pjesës A më sipër, nuk do të bëhet asnjë tërheqje për pagesat e kryera përpara datës së nënshkrimit.

2. Data e mbylljes është data 31 dhjetor 2024.

SKEDULI 3

SKEDULI I SHLYERJES SË AMORTIZIMIT SIPAS ANGAZHIMIT

Tabela e mëposhtme përcakton datat e pagesës së principalit të Huas dhe përqindjen e shumës totale të principalit të Huas që paguhet për secilën datë të pagesës së principalit (“Pagesa me këste”).

Data e pagesës së principalit	Pagesa me këste
Çdo 1 prill dhe 1 tetor Duke filluar nga data 1 tetor 2025 deri më 1 prill 2033	5, 88%
Më 1 tetor 2033	5, 92%

SHTOJCË

Seksioni I. Përkufizime

1. “Udhëzimet kundër korrupsionit” nënkupton se për qëllimet e paragrafit 6 të shtojcës së kushteve të përgjithshme, “Udhëzimet për parandalimin dhe luftimin e mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga huat e IBRD-së dhe huat dhe grantet e IDA-s” të datës 15 tetor 2006 dhe të rishikuar në janar 2011 dhe që nga 1 korriku 2016.

2. Politikat mbrojtëse të Bankës nënkuptojnë politikat dhe procedurat operacionale të Bankës, të përcaktuara në manualin operacional të Bankës dhe të identifikuar si OP/BP 4.01, 4.04, 4.09, 4.10, 4.11, 4.12, 4.36, 4.37, 7.5 7.60 siç ky manual është botuar në www.WorldBank.org/opmanual.

3. “Kategori” nënkupton një kategori të përcaktuar në tabelën e seksionit III.A të shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

4. “Kuatridi i menaxhimit mjedisor dhe social” ose “ESMF-KMMS” nënkupton skedulin e Huamarrësit për pjesën 1 (b) të Projektit, të periudhës nëntor 2020 dhe të përditësuar dhe të publikuar më 18 shkurt 2021 në formë dhe thelb të pranueshme për Bankën, duke përfshirë një listë kontrolli për zbutjen e ndikimeve të mundshme mjedisore, duke dhënë detaje të masave për të menaxhuar rreziqet e mundshme mjedisore dhe për të zbutur, reduktuar dhe/ose kompensuar ndikimet e pafavorshme mjedisore, së bashku me monitorimin dhe raportimin e mjaftueshëm institucional të aftë për të garantuar zbatimin e duhur dhe komente të rregullta mbi pajtueshmërinë me kushtet e tij, siç ky skedul mund të ndryshohet

dhe/ose plotësohet herë pas here me miratim paraprak me shkrim të Bankës.

5. “Zyrat kryesore të regjistrimit” nënkupton objektet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të krijuara për të mbështetur Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në ruajtjen e dokumenteve kyçe për objektet shëndetësore, personelin dhe pajisjet biomjekësore, të pajisura me teknologji dhe softuer, në mënyrë që të mundësojnë institucionet shëndetësore publike të shpërndajnë këto dokumente kyçe.

6. “Kushtet e përgjithshme” nënkupton “Kushtet e përgjithshme të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e IBRD-së, financimin e investimeve të Projektit” të datës 14 dhjetor 2018 (rishikuar më 1 gusht 2020, 21 dhjetor 2020 dhe 1 prill 2021).

7. “Sistemi i informacionit të menaxhimit të spitalit” ose “HMIS” nënkupton sistemin e informacionit të Huamarrësit të krijuar për të mbështetur menaxhimin e funksioneve kryesore në spitale.

8. “Masterplani i spitalit” ose “HMP” nënkupton planin kombëtar të Huamarrësit të datës 31 tetor 2020 për racionalizimin e spitaleve publike, të ndryshuar deri në këtë datë.

9. “MSHMS” nënkupton Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Huamarrësit ose pasuesin e tij ligjor.

10. “Llogaritë Kombëtare të Shëndetit” ose “NHA” nënkupton grupin e treguesve të harmonizuar, të integruar dhe të krahasueshëm të Huamarrësit mbi të dhënat e shpenzimeve vjetore



shëndetësore nga njësitë shëndetësore publike dhe private.

11. “Shpenzime operative” nënkupton shpenzimet e arsyeshme që rrjedhin nga Projekti dhe që përbëhen nga shpenzimet për mirëmbajtjen e pajisjeve, qiranë e zyrave, dietat për nëpunësit civilë, shpërblimet dhe kostot e udhëtimit të personelit të NJKP-së (duke përjashtuar pagat dhe kostot e udhëtimit të nëpunësve civilë të Qeverisë), blerjen e orendive të zyrës, furnizimeve, kostot e komunikimit, reklamat dhe kostot e karburantit për vizitat në terren.

12. Marrëveshje Fillestare Financimi” nënkupton marrëveshjen e financimit për një Projekt të Përmirësimit të Sistemit Shëndetësor ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës, datë 24 mars 2015 (Huaja nr. 8466-AL), e ndryshuar.

13. “Projekt fillestar” nënkupton projektin e përshkruar në Marrëveshjen Fillestare të Financimit, të ndryshuar.

14. “Rregullore e prokurimit” nënkupton për qëllimet e paragrafit 87 të shtojcës së kushteve të përgjithshme, rregulloret e prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit IPF që i përket periudhës korrik 2016 dhe periudhës nëntor 2020.

15. “Njësi e Koordinimit të Projektit” ose NJKP nënkupton një njësi të përmendur në seksionin 1.A.1 (b) të shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

16. “Manual i Funksionimit të Projektit” nënkupton manualin e miratuar nga Huamarrësi në dhjetor 2015, të përditësuar për qëllimet e Marrëveshjes Fillestare të Financimit dhe që do të përditësohet sipas kushteve të seksionit 1.B 1 (a) të tabelës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

17. “Qendër Spitalore Universitare” nënkupton spitalin kombëtar të Huamarrësit, të krijuar dhe që funksionon në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 352, datë 1993 ose pasuesin e tij ligjor.

18. “Spitale të zgjedhura” nënkupton Spitalin e Krujës, Kirurgjia Kardio-Angiologjike (te Qendra Spitalore “Nënë Tereza” – QSUT), Spitalin e Përgjithshëm Pediatrik (te Qendra Spitalore “Nënë Tereza” – QSUT), Departamentin e Djegieve dhe Kirurgjisë Plastike (te Qendra Spitalore “Nënë Tereza” – QSUT), Spitalin e Laçit, Departamentin Psikiatrik (te Qendra Spitalore “Nënë Tereza” – QSUT), Spitalin e Lezhës dhe spitale shtesë

rajonale dhe bashkiake, siç parashikohet më tej në Manualin e Operacioneve të Projektit.

19. “Datë nënshkrimi” nënkupton datën e mëvonshme nga dy datat në të cilat Huamarrësi dhe Banka nënshkruan këtë marrëveshje dhe një përkufizim i tillë zbatohet për të gjitha referencat për “datën e Marrëveshjes së Huas” në kushtet e përgjithshme.

20. “Trajnim” nënkupton kostot e arsyeshme që lidhen me trajnimet, seminarët dhe pjesëmarrjen në ture studimore të personelit të përfshirë në aktivitetet e Projektit, kostot e lartpërmendura që përbëhen nga udhëtimi dhe shpenzimet për trajnim, pjesëmarrje në seminare dhe ture studimore, kostot që lidhen me ofrimin e shërbimeve të trajnerëve, marrja me qira e objekteve dhe faciliteteve të trajnimit, përgatitja dhe riprodhimi i materialeve të trajnimit dhe seminareve, dhe kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me kurset e trajnimit, seminarët ose përgatitjen e turit studimor (por duke përjashtuar kostot e shërbimeve të konsulencës).

DEKRET

Nr. 13751, datë 30.6.2022

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 52/2022, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin shtesë, për projektin ‘Përmirësimi i sistemit të shëndetësisë’”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

**VENDIM****Nr. 460, datë 29.6.2022****PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË
BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE
PESHKIMIT, 2021–2027**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021–2027, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

**STRATEGJIA E BUJQËSISË,
ZHVILLIMIT RURAL DHE PESHKIMIT,
2021–2027
TIRANË, MAJ 2022**

Tabela e përmbajtjes

1. Pjesa I: Konteksti strategjik

1.1 Qëllimi i strategjisë

1.2 Metodologjia

1.3 Përmbushja e vizionit/objektivave të Strategjisë për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin

1.4 Objektivat e Qeverisë Shqiptare në programin e periudhës 2021–2025 dhe kontributi i SBZHRP 2021–2027 në përmbushjen e tyre

1.5 Ndërlidhja me objektivat për zhvillim të qëndrueshëm dhe agjenda 2030

1.6 Barazia gjinore, të drejtat e pakicave dhe grupet e cënueshme

1.7 Ndërlidhja me kuadrin e politikave përkatëse të BE-së, në kuadër të procesit të integritetit evropian

2. Kuadri ligjor, institucional dhe arritjet kryesore

2.1 Kuadri ligjor

2.2 Dokumentet strategjike

2.3 Arritjet dhe mësimet

2.4 Fuqizimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore

3. Pjesa II: Vizioni, politikat, objektivat e përgjithshëm dhe objektivat specifikë

3.1 Situata e përgjithshme në bujqësi dhe zonat rurale

Politikat dhe objektivat e përgjithshëm

Politika 1: Zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë dhe i zonave rurale

Politika 2: Zhvillimi i qëndrueshëm i peshkimit dhe i ekonomisë blu

Politika 3: Zhvillimi i kapaciteteve administrative dhe institucionale, bashkëpunimi i aktorëve, inovacioni dhe digjitalizimi

3.2 Situata në lidhje me politikat respektive

3.2.1 Politika 1: Objektivi i përgjithshëm 1: Promovimi i prodhimit të qëndrueshëm dhe i cilësisë së ushqimit nëpërmjet zhvillimit të një sektori konkurrues dhe inovativ agroushqimor

3.2.1.1 Politika 1: Objektivi specifik 1: Rritja e qëndrueshmërisë dhe e reziliencës/elasticitetit të fermave

3.2.1.2 Politika 1: Objektivi specifik 2: Rritja e konkurrueshmërisë dhe e orientimit drejt tregut të sektorit agroushqimor

3.2.1.3 Politika 1: Objektivi specifik 3: Përmirësimi i reagimit ndaj kërkesave të konsumatorëve për ushqim të sigurt, me vlera të larta ushqyese dhe të qëndrueshëm

Identifikimi i ndërhyrjeve sipas nevojave për mbështetje në kuadër të politikës 1, objektivit të përgjithshëm 1

3.2.2 Politika 1: Objektivi i përgjithshëm 2: Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe veprimeve lidhur me klimën

3.2.2.1 Politika 1: Objektivi specifik 4: Kontributi në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe në energjinë e rinovueshme

3.2.2.2 Politika 1: Objektivi specifik 5: Nxitja e menaxhimit të qëndrueshëm dhe të efektshëm të burimeve natyrore

3.2.2.3 Politika 1: Objektivi specifik 6: Mbrojtja e biodiversitetit, rritja e shërbimeve të ekosistemit dhe ruajtja e habitateve dhe peizazhit



Identifikimi i ndërhyrjeve sipas nevojave në kuadër të politikës 1, objektivit të përgjithshëm 2

3.2.3 Politika 1: Objektivi i përgjithshëm 3: Forcimi i strukturës sociale-ekonomike të zonave rurale

3.2.3.1 Politika 1: Objektivi specifik 7: Forcimi i punësimit rural dhe i zhvillimit të biznesit

3.2.3.2 Politika 3: Objektivi specifik 8: Forcimi i formimit të kapitalit social për iniciativat e zhvillimit lokal gjithëpërfshirës

Identifikimi i ndërhyrjeve, sipas nevojave në kuadër të politikës 1, objektivit të përgjithshëm 3 46

3.2.4 Politika 2: Objektivi i përgjithshëm 4: Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm të peshkimit detar dhe të ujërave të brendshme

3.2.4.1 Politika 2: Objektivi specifik 9: Forcimi i akuakulturës dhe i tregjeve konkurruese dhe të qëndrueshme, si dhe i komuniteteve bregdetare të qëndrueshme

3.2.4.2 Politika 2: Objektivi specifik 10: Nxitja e peshkimit të qëndrueshëm dhe ruajtja e burimeve biologjike detare

Identifikimi i ndërhyrjeve, sipas nevojave, në kuadër të politikës 2, objektivit të përgjithshëm 4

Politika 3: Objektivat ndërsektoriale

3.2.5 Politika 3: Objektivi ndërsektorial 1: Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative drejt përafrimit me *acquis* të BE-së

3.2.6 Politika 3: Objektivi ndërsektorial 2: Transferimi i njohurive dhe i inovacionit

4 Pjesa III: Strategjia dhe instrumentet e ndërhyrjes

4.1 Strategjia e ndërhyrjes në kuadër të SBZHRP-së 2021–2027

4.2 Përshkrimi i instrumenteve dhe i masave të ndërhyrjes së planifikuar, në kuadër të SBZHRP 2021–2027

5 Përshkrimi i sistemit të monitorimit dhe të vlerësimit

6. Anekset

6.1 Korniza logjike e SBZHRP-së me objektivat dhe treguesit (ndikimi, rezultati dhe *output*-i) për 2022–2027, e buxhetuar për periudhën 2022–2024

6.2 Plani i veprimit i MBZHR 2022–2024 për përgatitjen dhe zbatimin e ndërhyrjeve

Lista e tabelave

Tabela 3-1: Toka bujqësore sipas përdorimit (2019/2020)

Tabela 3-2: Sipërfaqet e kultivuara në Ha (2015–2020)

Tabela 3-3: Struktura e fermës në sektorin e prodhimit bimor (2019)

Tabela 3-4: Bilanci tregtar në bujqësi (2015–2020, Shqipëria me të gjitha vendet)

Tabela 3-5: Vështtrim i përgjithshëm – Mundësitë dhe kërcënimet

Tabela 3-6: Emetimet e GS-së nga bujqësia 2014–2018 (pa emetimet nga përdorimi i tokës dhe ndryshimi i përdorimit të tokës)

Tabela 3-7: Mundësi – Kërcënime – Objektivi i përgjithshëm 2

Tabela 3-8: Mundësitë dhe kërcënimet – Objektivi i përgjithshëm 3

Tabela 3-9: Shpërndarja e OMP-ve në Shqipëri viti 2020

Tabela 3-10: Mundësitë dhe kërcënimet – Objektivi i përgjithshëm 4

Tabela 6-1: Korniza logjike në lidhje me objektivin dhe treguesit për 2024–2027 dhe buxhetin për 2022–2024

Tabela 6 2 Plani i Veprimit i MBZHR-së për periudhën 2022–2024

Lista e figurave

Figura 2 1: Klasifikimi rural i rajoneve në Shqipëri (tipologjia urbane-rurale e BE-së, rajonet e nivelit NUTS 3)

Figura 3 1: Ndryshimi i parashikuar i temperaturave mujore për Shqipërinë në vitin 2020–2039

Figura 3 1: Punësimi në sektorin e peshkimit

Figura 3 2: Aktorët e SINJB-së në Shqipëri



Shkurtime

AGJVBP	Agienda e gjelbër për vendet e Ballkanit Perëndimor
AFP	Arsimimi dhe formimi profesional
AM IPARD	Autoriteti menaxhues – Instrumenti për asistencë para aderimit për zhvillim rural
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
AT	Asistencë teknike
BE	Bashkimi Evropian
BB	Banka Botërore
BBP	Bioekonomia e bazuar në pyje
CEFTA	Marrëveshje e Tregtisë së Lirë për Evropën Qendrore
DP	Drejtoria e Përgjithshme
FAO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë
GIZ	Ajencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
GS	Gazet serrë
GVV	Grupet vendore të veprimit (në kuadër të qasjes LEADER)
HACCP	Analiza e rrezikut dhe pikat kritike të kontrollit
INSTAT	Instituti i statistikave
IPA	Instrumenti për asistencë para aderimit
IPARD	Instrumenti për asistencë para aderimit për zhvillim rural
KMBM	Kushte të Mira bujqësore dhe mjedisore
KNMPTA	Komisioni ndërkombëtar për mbrojtjen e peshkut ton të Atlantikut
KPNK	Kontributi i përcaktuar në nivel kombëtar
KKEPUBA	Komisioni Këshillimor Evropian për Peshkimin në Ujëra të Brendshme dhe Akuakulturë
KOPUB	Konfederata e Organizatave të Peshkimit në Ujëra të Brendshme
KPPM	Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun
LEADER	Qasja e zhvillimit të rajoneve me drejtim/vendimarrje të komunitetit (<i>Liaison Entre Actions de Développement de l'Economie Rurale</i>)
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
NjGj	Njësi Gjedhi (1 lope = 1 NJGJ)
OBUE	Operatorët e Biznesit Ushqimor
OMP	Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit
ONP (ILO)	Organizata Ndërkombëtare e Punës
OJF	Organizatë jofitimprurëse
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
OP	Organizata e Prodhuesve
OPU	Organizatat e Përdoruesve të Ujit
OTP (CMO)	Organizimi i Tregut të Përbashkët
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PEI	Plani Ekonomik dhe i Investimeve (për Ballkanin Perëndimor)
PKIE	Plani Kombëtar për Integrim Evropian
PMBM	Praktikat e Mira Bujqësore dhe të Mjedisit
PMB	Produktet e Mbrojtjes së Bimëve
EOM	Emërtim Origjine i Mbrojtur
PPB	Politika e Përbashkët Bujqësore (BE)
PPP	Politika e Përbashkët e Peshkimit (BE)
PPPP	Peshkimi i Paligjshëm, i Paraportuar dhe i Parregulluar
PSHV	Peshkim në Shkallë të Vogël
PZHRQ	Projekti i Zhvillimit të Qëndrueshëm Rural i zbatuar nga GIZ-i në Shqipëri (GIZ–SRD)
QSH	Qeveria e Shqipërisë
QTTB	Qendrat të Transferimit të Teknologjive Bujqësore
RAM	Rezistencë Antimikrobiale
FADN	Rrjeti i të Dhënave të Llogarive në Ferma
RrKZHR	Rrjeti Kombëtar për Zhvillimin Rural
RUB	Rezervuarët Ujorë Bujqësorë
SBERAJ	Strategjia e BE-së për Rajonin Adriatik-Jonian
SBSH	Sipërfaqja Bujqësore e Shfrytëzuar
SBZHRP	Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe i Peshkimit
SIAK	Sistemi i Integruar i Administrimit dhe i Kontrollit
SIPT (LPIS)	Sistemi i Identifikimit të Parcelave të Tokës



SIP-SI	Sistemi i Integruar i Planifikimit – Sistem Informacionit
SNJIB	Sistemi i Njohurive dhe Inovacionit në Bujqësi
SMA	Sistemi i Monitorimit të Anijeve
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SZHL	Strategjitë e Zhvillimit Lokal
SHBB	Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor
SHKF	Shërbimi Këshillimor i Fermave
SHKEB	Shërbimi Kombëtar i Ekstensionit Bujqësor
SHOP	Shoqata e Organizatave të Prodhuesve
TI	Teknologjia e Informacionit
TGJM	Tregues Gjeografik i Mbrojtur
UBT	Universiteti Bujqësor i Tiranës
VSHB	Vlerë e Shtuar Bruto
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZPA	Zona e Përcaktuar për Akuakulturë

1. Pjesa I: Konteksti strategjik

1.1 Qëllimi i strategjisë

Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021–2027 (SBZHRP 2021–2027) është dokumenti politik i qeverisë shqiptare, i cili synon të përcaktojë objektivat, të krijojë kuadrin e nevojshëm institucional, të politikave dhe të instrumenteve që mundësojnë arritjen e këtyre objektiveve për zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë, zonave rurale dhe peshkimit, si dhe përmbushjen e angazhimeve, në kuadër të procesit të përafrimit të Shqipërisë në BE.

Ky dokument u hartua në mbështetje të synimeve të Qeverisë Shqiptare për të përcaktuar kuadrin strategjik për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit agroushqimor në shtatë vjetët, 2021–2027, për përmbushjen e nevojave reale të aktorëve dhe grupeve të interesit, për të përballuar sfidat afatmesme dhe afatgjata lidhur me sigurimin e ushqimit, rritjes së të ardhurave, efektet e ndryshimit të klimës, ruajtjen e biodiversitetit, për të zhvilluar dhe bërë më konkurruese ekonomitë familjare në zonat rurale, bazuar në politika që mbështesin përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, përdorimin eficient të inputeve bujqësore dhe peshkimit, si dhe njohurive bujqësore dhe inovacionit.

Kuadri i përcaktuar në këtë strategji ofron një bazë solide, jo vetëm për realizimin e objektiveve të parashikuara për periudhën 2021–2027, por edhe për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit agroushqimor në përmbushje të vizionit “Bujqësia 2030”.

1.2 Metodologjia

SBZHRP 2021–2027 nga njëra anë pasqyron arritjet e deritanishme në zhvillimin dhe

modernizimin e Bujqësisë, Zonave Rurale dhe Peshkimit, konsolidimin e mëtejshëm të këtyre sektorëve dhe, gjithashtu, orientohet në zbatimin e prioriteteve të Qeverisë së Shqipërisë në bujqësi, zhvillimin rural dhe peshkim për periudhën 2021–2025.

Më tej, SBZHRP-ja i vendos arritjet e deritanishme në kuadrin e përpjekjeve të sektorit të bujqësisë, zonave rurale dhe peshkimit në Shqipëri në koherencë me procesin e përafrimit me BE, siç përcaktohet në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE 2021–2023). Ky dokument është i orientuar drejt objektiveve të Politikës së Përbashkët Bujqësore të BE-së (PPB) dhe Politikës së Përbashkët të Peshkimit të BE-së (PPP).

Procesi i hartimit të kësaj strategjie u drejtua nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nëpërmjet Grupit Ndërinstitucional të Punës, i cili u ngrit me urdhrin nr. 63, datë 5.2.2021, të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Mbështetja kryesore teknike për hartimin e strategjisë është ofruar nga Projekti GIZ-SRD “Zhvillimi i Qëndrueshëm i Zonave Rurale në Shqipëri”, financuar nga Qeveria Gjermane dhe zbatuar nga *GFA Consulting Group*, Hamburg/Gjermani.

Krahas asistencës teknike të ekspertëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë, nga takimet apo tryezat e punës me aktorë të sektorit privat apo përfaqësues të organizatave, aktive në këta sektorë janë marrë në konsideratë qëndrime dhe propozime të vlefshme.

Ndihmë të veçantë kanë dhënë edhe ekspertë të Universitetit Bujqësor të Tiranës, por edhe Organizatave Ndërkombëtare, si UNDP, FAO etj.



Hartimi i SBZHRP-së është bërë duke u bazuar në grumbullimin dhe analizimin e të dhënave dhe evidentimin e nevojave dhe potencialeve për zhvillim bazuar në analizat SWOT, të realizuara nëpërmjet nëntë studimeve të pavarura sektoriale, si edhe në analizën e dokumenteve dhe politikave të tjera përkatëse të hartuara nga Qeveria Shqiptare. Të dhënat e analizuara përfshijnë periudhën 2015–2020 dhe reflektojnë edhe ndikimin e pandemisë së COVID-19 nga viti 2020 e në vazhdim.

1.3 Përbushja e vizionit/objektivave të Strategjisë për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin

Kuadri strategjik që ofron ky dokument, SBZHRP 2021–2027 bazohet në orientimin e arritjet e konfirmuara pozitive të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015–2020, si dhe në vizionin e draftit SKZHI III 2020–2025.

Në mënyrë specifike SKZHI II (2015–2020), parashikon në shtyllën 4: Sigurimin e rritjes ekonomike, nëpërmjet ndërlikohjes, përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe zhvillimit të territorit, dhe ka objektiva strategjike, si më poshtë:

1. Nxitja e prodhimit të qëndrueshëm ushqimor dhe cilësisë përmes zhvillimit të një sektori agroushqimor konkurrues dhe novator që është në gjendje t'i bëjë ballë trysnive nga konkurrenca;

2. Përbushja e standardeve dhe kërkesave të tregut të BE-së, deri në vitin 2020 nëpërmjet:

a) rritjes vjetore të prodhimit të shtuar të krahut të punës në bujqësi, për njësi vjetore pune (NJVP)/punonjësit me kohë të plotë;

b) garantimit që fermat dhe operatorët e regjistruar të agropërpunimit të jenë në përputhje të plotë me standardet e BE-së (aplikimi i standardeve për fermat dhe operatorët e regjistruar të agropërpunimit, sipas normave të BE-së);

c) rritjes së madhësisë mesatare të fermave dhe rritjes së madhësisë mesatare të fermave tregtare;

ç) përmirësimit të organizimit të zinxhirit të vlerave me anë të krijimit të shoqatave dhe grupeve të prodhuesve dhe llojeve të ngjashme bashkëpunimi midis fermerëve;

d) përmirësimit të raportit eksport-import;

dh) sigurimit të menaxhimit të përgjithshëm të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe bujqësore përmes zhvillimit të GVV-ve kombëtare, që marrin

në konsideratë specifikat e peizazhit, tokës bujqësore dhe klimës në Shqipëri.

3. Sigurimi i menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe ndërmarrja e veprimeve klimatike, nëpërmjet:

a) një menaxhimi më të mirë të pyjeve dhe ujërave dhe aplikimit të metodave të prodhimit bujqësor, duke mbrojtur mjedisin dhe zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike;

b) rritjes së numrit të fermave organike të certifikuara; dhe

c) rritjes së numrit të fermave që kanë të ardhura jobujqësore.

4. Balancimi i zhvillimit territorial në zonat rurale përmes promovimit të diversifikimit të veprimtarive ekonomike, krijimit të vendeve të punës, përfshirjes sociale dhe përmirësimit të kushteve të jetesës, nëpërmjet:

a) krijimit të vendeve të reja të punës në aktivitetet e agropërpunimit;

b) ngritjes së mikrondërmarrjeve të reja, bashkë me krijimin e vendeve të reja të punës në zonat rurale përmes diversifikimit të aktiviteteve që gjenerojnë të ardhura;

c) krijimit të vendeve të reja të punës në aktivitete jobujqësore dhe shërbime të tjera;

ç) rritjes së numrit të fermerëve me të ardhura jo nga fermat;

d) promovimit të vetëpunësimit dhe aktiviteteve sipërmarrëse tek emigrantët e rikthyer në zonat rurale dhe formalizimi i aktiviteteve të tyre.

5. Vijimësia e zhvillimit të sektorit dhe sigurimi i menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve peshkore të ujërave detare dhe të brendshme nëpërmjet:

a) përpilimit të një plani shumëvjeçar për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve të gjalla të ujërave detare dhe atyre të brendshme;

b) krijimit të një sistemi efikas për mbledhjen e të dhënave mbi flotën e peshkimit, sasinë e peshkimit, statusin biologjik të popullatave në ujërat dhe akuakulturën shqiptare;

c) ndërtimit të një porti peshkimi në Durrës, bashkë me tregjet e peshkut për tregtinë me shumicë;

ç) instalimit të infrastrukturës së nevojshme për riparimin e mjeteve të peshkimit në të katërta portet (Shëngjin, Durrës dhe Vlorë, Sarandë);

d) forcimit të kapaciteteve njerëzore dhe atyre të infrastrukturës për kontrollin e veprimtarive të peshkimit dhe akuakulturës (si p.sh.: pajisjet,



instrumente të logjistikës për komunikimin e të dhënave në rolin e inspektoratit brenda strukturës të ngritur për monitorimin dhe mbikëqyrjen e peshkimit dhe akuakulturës);

dh) bashkëpunimit më të madh me organet rajonale dhe ndërkombëtare të peshkimit dhe akuakulturës (pjesëmarrës në aktivitete dhe grupet e ngritura të punës); dhe

e) menaxhimit dhe mbrojtjes së burimeve të peshkimit në përputhje me Politikën e Përbashkët për Peshkimin të BE-së.

6. Përmirësimi i statistikave të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit dhe përafrimit të tyre me FADN;

7. Menaxhim efektiv i fondeve publike për bujqësinë dhe zhvillimin rural, përmes draftimit të ligjeve dhe rregulloreve që lidhen me menaxhimin e fondeve, monitorimin periodik dhe publikimin e raporteve të fondeve të përdorura dhe listave të përfituesve.

1.4 Objektivat e Qeverisë Shqiptare në programin e periudhës 2021–2025 dhe kontributi i SBZHRP 2021–2027 në përmbushjen e tyre

Kuadri strategjik i SBZHRP 2021–2027 dhe ndërhyrjet e programuara në këtë dokument i shërbejnë përmbushjes së vizionit, objektivave dhe prioriteteve të Qeverisë Shqiptare për bujqësinë, zhvillimin rural dhe peshkimin, janë parashtruar në programin e saj 2021–2025, si më poshtë:

Zhvillimi bujqësor dhe rural nëpërmjet:

- Përmirësimi në vazhdimësi të cilësisë së jetës në zonat rurale dhe diversifikimi i hapësirave dhe i mundësive për aktivitete ekonomike.

- Promovimit të eliminimit të dallimeve në standardet e jetesës ndërmjet zonave rurale dhe atyre urbane, përmes investimeve të vazhdueshme në infrastrukturën publike rurale në shërbim të aktiviteteve ekonomike të aktorëve në bujqësi, si p.sh. nëpërmjet investimeve në ujësjellës dhe në kanalizime, furnizim me energji elektrike, shëndetësi dhe arsim, infrastrukturë rrugore dhe përmirësim të teknologjisë dhe të njohurive mbi teknologjitë e avancuar të prodhimit dhe të mbështetjes për ndërveprim më të madh ekonomik dhe social ndërmjet aktorëve.

Rritja e eksportit të produkteve bujqësore dhe të peshkimit dhe rritja e vlerës së shtuar në vend nëpërmjet:

- Orientimit të investimeve në zgjerimin e zinxhirit të vlerës në përpunimin bujqësor;

- Lehtësimit të blerjes së makinerive dhe të pajisjeve për përpunimin bujqësor, duke ofruar amortizimin e përshpejtuar me dyfishin e normës për ndërmarjet ekzistuese;

- Përmirësimi të aksesit në tregjet e reja ndërkombëtare nëpërmjet informacionit dhe lehtësimit të marrëveshjeve tregtare;

- Përmirësimi të standardeve të produkteve bujqësore nëpërmjet mbështetjes të prodhimit organik, dhe futjes të standardeve të cilat lehtësojnë eksportet si GLOBALG.A.P. etj.

Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit rural dhe agroturizmit nëpërmjet:

- Mbështetjes për diversifikimin e aktiviteteve ekonomike në zonat rurale;

- Mekanizmave të mbështetjes për të rritur numrin e bizneseve të agroturizmit dhe të bujtinave;

- Masave nxitëse për emigrantët, të rinjtë dhe për përfshirjen e shtuar të pjesëmarrjes të grave në këtë sektor.

Rritja e mbështetjes për bujqësinë, blegtorinë dhe zhvillimin rural nëpërmjet:

- Mbështetjes të drejtpërdrejtë për fermerët me 70 milionë €, nëpërmjet programeve të naftës për traktorët dhe skemave të tjera kombëtare të mbështetjes.

- Mbështetjes me 146 milionë € nëpërmjet programit IPARD III (financim kombëtar dhe nga BE-ja).

TVSH zero për:

- Makineritë bujqësore, të importit dhe vendësk
- 27 zëra doganorë në bordin e anijeve të peshkimit;

- Rrjetat, anijet, pajisjet elektronike, frigoriferë, motorë detarë etj., mjetet e lundrimit për peshkim në bordin a anijeve të konsideruara si pajisje në bord;

- Blerjen e naftës për anijet e peshkimit me 0 akcizë, 0 taksë për karburant dhe 0 taksë për karbon;

- Tarifa zero (0) për regjistrimin dhe vaksinimin e detyrueshëm të kafshëve.

1.5 Ndërlidhja me objektivat për zhvillim të qëndrueshëm dhe Agjenda 2030

Objektivat e SBZHRP-së me ndërhyrjet e tyre specifike kontribuojnë në arritjen e **objektivave të mëposhtëm të Zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ)** të Agjendës së OKB 2030:



- **OZHQ 2**, për të arritur sigurimin e ushqimit dhe të ushqyerjes të përmirësuar dhe për të promovuar një bujqësi të qëndrueshme duke përfshirë peshkimin;

- **OZHQ 5**, barazia gjinore është një temë horizontale në strategji;

- **OZHQ 12**, për të siguruar modele të qëndrueshme të konsumit dhe të prodhimit në sektorin agroushqimor dhe të peshkimit;

- **OZHQ 13**, për të nxitur veprime për të luftuar ndryshimin e klimës dhe ndikimet e saj;

- **OZHQ 14**, për të ruajtur dhe përdorur në mënyrë të qëndrueshme Detin Mesdhe dhe burimet detare për zhvillim të qëndrueshëm;

- **OZHQ 15**, për të mbrojtur, rivendosur dhe promovuar përdorimin e qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore me vëmendje të veçantë për të frenuar dhe përmbyllur fenomenin e degradimit të tokës dhe humbjen e biodiversitetit;

- **OZHQ 17**, për të rritur partneritetin global, për të forcuar strukturat e bashkëpunimit për zhvillim të qëndrueshëm në shkëmbimin e njohurive, ekspertizës, inovacioneve dhe burimeve financiare.

1.6 Barazia gjinore, të drejtat e pakicave dhe grupet e cënueshme

- Elementet e barazisë gjinore, si edhe të drejtave të njeriut në kontekstin e grupeve të marxhinalizuara në kontekstin strategjik janë të reflektuara në dokument në atë mënyrë që mundësojnë monitorimin e tyre, në lidhje me përputhshmërinë dhe realizimin e tyre nëpërmjet Grupeve të Integruara të Menaxhimit të Politikave (GIMP), të koordinuara nga Zyra e Kryeministrit (ZK).

- SBZHRP 2021–2027 është, gjithashtu, në përputhje me udhërrëfyesin e BE-së për “Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave, 2021–2025”, në lidhje me të drejtat ekonomike dhe sociale dhe fuqizimin e vajzave dhe grave, dhe duke përfshirë rolin e grave dhe vajzave në tranzicionin e gjelbër dhe transformimin digjital në sektorët që mbulon kjo strategji.

- Direktiva e riformuluar e BE-së (2006/54/KE) për Mundësitë e Barabarta dhe Trajtimin e Barabartë të grave dhe të burrave në punësim dhe profesion është marrë në konsideratë nga administrata publike shqiptare.

- Në të gjitha fazat e hartimit të kësaj Strategjie, por edhe të zbatimit të saj përmbahen elemente që

fuqizojnë pjesëmarrjen e grave dhe të burrave, në mënyrë të balancuar. Strategjia synon t’u japë grave mundësi të barabarta dhe reale në aksesin dhe përfitimin e fondeve publike. Veprime avantazhuese, si p.sh. pikë më të larta për grandet IPARD III dhe mundësi të barabarta për akses në pagesat e drejtpërdrejta, do të vazhdojnë të zbatohen.

- Ndërhyrjet synojnë të respektojnë plotësisht të drejtat e të gjithë individëve, duke përfshirë të rinjtë dhe minoritetet dhe grupet e marxhinalizuara.

- Aksesin në informacion, në kontekstin e zbatimit të Strategjisë, do të sigurohet pa marrë parasysh gjininë apo përkatësinë etnike.

1.7 Ndërlidhja me kuadrin e politikave përkatëse të BE-së, në kuadër të procesit të integritimit evropian

Politika e përgjithshme e Shqipërisë është e orientuar drejt **anëtarësimit në BE**. Në qershor të vitit 2014, Shqipërisë iu akordua statusi i vendit kandidat. Në qershor të vitit 2018, Këshilli Evropian përcaktoi rrugën drejt hapjes së negociatave të anëtarësimit në BE dhe në 25 mars të vitit 2020, vendosi të hapë negociatat e anëtarësimit me Republikën e Shqipërisë, duke marrë parasysh progresin e arritur mbi reformat dhe përmbushjen e kushteve të përcaktuara në unanimitet nga Këshilli i qershorit 2018. Në kontekstin e përafrimit gradual me *acquis* të BE-së, në përgjithësi edhe me Politikën e Përbashkët Bujqësorë (PPB) dhe Politikën e Përbashkët të Peshkimit të BE-së (PPP) iu është kushtuar një vëmendje e konsiderueshme përafrimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të bujqësisë, zhvillimit rural dhe peshkimit, për shkak të rëndësisë së tyre ekonomike dhe sociale dhe ku janë të punësuar dhe jetojnë rreth 40% e popullsisë në Shqipëri.

Për të përballuar sfidat aktuale, por edhe ato të pritshme në të ardhmen e afërt apo afatmesme në sektorët e bujqësisë, zhvillimit rural dhe të peshkimit, ato globale por edhe ato në kuadër të procesit të përafrimit në BE, politikat dhe objektivat e parashtruar në SNBZHRP 2021–2027 janë bazuar në Planin Kombëtar për Integritimin Evropian dhe përkatësisht te kërkesat dhe objektivat e parashtruar në kapitujt e negociimit 11 (Bujqësia dhe Zhvillimi Rural), 12 (Siguria Ushqimore, Veterinaria dhe Mbrojtja e Bimëve) dhe 13 (Peshkimi).



Draftkorniza negociatore e muajit korrik të vitit 2020 përcaktoi direktivat dhe parimet për negociatat e anëtarësimit me një metodologji të re për Shqipërinë si vend kandidat. Korniza nuk është nënshkruar ende. Ajo integron metodologjinë e rishikuar të zgjerimit, merr parasysh kuadrin ligjor e strategjik të BE-së (EU-*acquis*), gjithashtu edhe PPB-në e BE-së e pas vitit 2020 dhe pasqyron, siç duhet arritjet dhe situatën specifike të Shqipërisë.

Në hartimin e dokumentit janë konsideruar edhe në rekomandimet e raportprogresit të vitit 2021 të BE-së për Shqipërinë, si më poshtë:

Në lidhje me kapitullin 11: Bujqësia dhe Zhvillimi Rural

- Krijimi i regjistrit të fermave, përmirësimi i regjistrit të kafshëve të gjalla dhe miratimi i një plan për të ngritur Rrjetin e të Dhënave Ekonomike të Fermave (FADN) për të ofruar të dhëna të vlefshme (garantuara) për politikëbërjen;

- Ngritja dhe garantimi i kapaciteteve administrative të nevojshme për të përgatitur dhe zbatuar nëntë masat e programi IPARD III (2021–2027), duke garantuar kushtet për akreditimin e tij nga BE-ja;

- Plotësimi i kuadrin ligjor për vreshtarinë dhe verën, për skemat e cilësisë dhe për prodhimin organik: të garantojë kapacitetet institucionale dhe administrative për zbatimin e tyre.

- Rritjen në vazhdimësi të buxheti kombëtar për bujqësinë, zhvillimin rural dhe peshkimin, duke e bërë mbështetjen financiare kombëtare të bashkërenduar me mbështetjen nëpërmjet IPARD-së;

- Përfundimin e reformës së shërbimit këshillimor bujqësor, duke e integruar atë në sistemin e integruar të njohurive dhe të inovacionit, të përputhur plotësisht me sistemin AKIS, të zbatuar në kuadër të zbatimit të PPP në vendet anëtare të BE-së.

Në lidhje me kapitullin 12 – Siguria ushqimore, politika për sigurinë ushqimore, veterinarinë dhe ajo fitosanitare, në veçanti:

- Do të përfundojë reforma për ristrukturimin e shërbimit veterinar, për ta bërë këtë shërbim plotësisht operacional;

- Ngritja e kapaciteteve efektive për mbikëqyrjen dhe kontrollin e sëmundjeve kryesore infektive përfshirë sëmundjen e tërbimit (*rabies*);

- Vazhdimi në mënyrë eficiente i programit të vaksinimit kundër tërbimit 2020–2022;

- Përgatitja e kuadrit ligjor përkatës, që rregullon kontrollet zyrtare, në lidhje me sigurinë ushqimore, shëndetin e kafshëve dhe të bimëve në të njëjtën linjë me parashtrimet e kuadrit ligjor të BE-së (EU *acquis*), në kuadrin e një politike kombëtare të konsoliduar.

Në lidhje me përgatitjet për negocimin e kapitujve 11, 12, 13, në kuadër të procesit të anëtarësimit evropian, SNBZHRP 2021–2027, shtrorton bazat dhe vendos kuadrin për reformat që nevojiten për përshtatjen e hartimit të dokumenteve të politikave kombëtare të bujqësisë, zhvillimit rural dhe të peshkimit me metodologjinë e hartimit, si edhe me objektivat e planeve strategjike të zbatimit të PPB 2021–2027 të vendeve anëtare të BE-së, në të cilët përcaktohen instrumentet dhe metodologjia e arritjes së këtyre objektivave të përcaktuar në PPB të reformuar të BE-së (2022–2027) dhe adaptimin e nëntë objektivave të saj në politika kombëtare. Një shtyllë e dytë ku bazohet SBZHRP 2021–2027 janë edhe objektivat e Politikës së Përbashkët Evropiane të Peshkimit (CFP).

Për më tepër SBZHRP 2021–2027 integron edhe: i. masat e përcaktuara në shtyllën V të Agjendës së Gjellbër të Vendeve të Ballkanit Perëndimor (11/2020); ii. reflekton prioritetet e Planit Ekonomik dhe Investimeve të BE-së (EIP) për Ballkanin Perëndimor; iii. prioritetet e Strategjisë së BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit (EUSAIR); iv. kontribuon në gjashtë objektiva strategjike (SDG) të Agjendës 2030 të OKB-së; dhe v. të angazhimeve dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare të nënshkruara nga Qeveria e Shqipërisë.

Pika të tjera referimi të **SBZHRP-së në kontekstin e procesit të anëtarësimit në BE** janë:

- **Përcaktimet e PPB-së të BE-së të pas vitit 2020** për përpunimin e planeve strategjike, me qasjen e re të saj të orientuar drejt rezultateve dhe të strukturuar rreth nëntë objektivave specifike dhe të një objektivi horizontal, të cilët sigurojnë orientimin e kuadrit strategjik dhe metodologjinë e SBZHRP-së.

- **Agjenda e Gjellbër për vendet e Ballkanit Perëndimor** (AGJBP) (Deklarata e Sofjes, 11/2020) pasqyron **angazhimet e Marrëveshjes së Gjellbër të BE-së**, me Strategjinë e BE-së “Nga ferma në tavolinë” (05/2020), për një sektor të



qëndrueshëm agroushqimor dhe Strategjinë e BE-së për Biodiversitetin 2030 (05/2020) për mbrojtjen dhe rikuperimin e natyrës. SBZHRP-ja është më ambicioze në drejtim të mjedisit, duke marrë parasysh kontekstin e fazës përgatitore të Shqipërisë për hapjen e negociatave me BE-në, në mënyrë që të kontribuojë në mënyrë progresive në angazhimet e Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor. Si rezultat, masat mbështetëse të lidhura me mjedisin, klimën dhe biodiversitetin do të jenë të pranueshme për të përfutur intensitet më të lartë të ndihmës. Në mënyrë të ngjashme, sektori i peshkimit pritet të kontribuojë në zhvillimin e ekonomisë blu dhe të mbështesë objektivat e BE-së lidhur me klimën.

- **Plani Ekonomik dhe i Investimeve (PEI)** për Ballkanin Perëndimor (i miratuar më 6/10/2020), i cili përcakton si prioritet për ndihmën e BE-së transformimin e qëndrueshëm të sistemeve agroushqimore dhe zhvillimin rural. Peshkimi është identifikuar ndërsektorët kyç për prodhimin primar të ushqimit, me një potencial të madh për zhvillim të mëtejshëm të qëndrueshëm ekonomik dhe për t'i bërë komunitetet rurale më tërheqëse.

- **Strategjia e BE-së për Rajonin Adriatik dhe Jonian** e pas vitit 2020 (EUSAIR) përfshin objektivat mbi habitatet tokësore transnacionale dhe biodiversitetin dhe ofertën e diversifikuar turistike, si pjesë e synimit të politikës për zhvillimin rural, synim që pasqyrohet në SBZHRP 2021–2027, ndërsa objektivi i politikës së peshkimit në SBZHRP është në përputhje me promovimin e qëndrueshmërisë, diversifikimit dhe konkurrencës në sektorët e peshkimit dhe të akuakulturës. Pikat kryesore të EUSAIR 2021–2027 përfshijnë veprime për të përmirësuar nivelet e aftësive dhe të ekspertizës për fuqinë punëtore në sektorin detar dhe ekonominë blu.

2. Kuadri ligjor, institucional dhe arritjet kryesore

2.1 Kuadri ligjor

Aktet ligjore kryesore në fuqi, që rregullojnë veprimtarinë e sektorit të bujqësisë, zhvillimit rural dhe peshkimit janë, si më poshtë:

1. Ligji nr. 9817/2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”;
2. Ligji nr. 9863 datë 28.1.2008, “Për ushqimin”;
3. Ligji nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”;

4. Ligji nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”;

5. Ligji nr. 87/2013, “Për kategorizimin e prodhimit, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërsisë së ullirit”;

6. Ligji nr. 10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”;

7. Ligji nr. 8691, datë 16.11.2000, “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”;

8. Ligji nr. 17/2020, “Për produktet plehëruese”;

9. Ligji nr. 106/2016, “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”;

10. Ligji nr. 64/2012, “Për peshkimin”;

11. Ligji nr. 103/2016, “Për akuakulturën”;

12. Ligji nr. 8752/2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”;

13. Ligji nr. 8312/1998, “Për tokat bujqësore të pandara”;

14. Ligji nr. 9244/2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”;

15. Ligji nr. 8318/1998, “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”;

16. Ligji nr. 24/2017, “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”;

17. Ligji nr. 8/2019, “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”;

18. Ligji nr. 38/2012, “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”;

19. Ligji nr. 8702/2000, “Për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve dhe të fermave blegtorale”;

20. Ligji nr. 9441/2005, “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi”;

21. Ligji nr. 9525/2005, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e vitit 1979, “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të madhe”;

22. Ligji nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit dhe mjedisit”;

23. Ligji nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”;

24. Ligji nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”;

25. Ligji nr. 10277/2010, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Roterdamit, ‘Mbi procedurën e njohimit të



pëlqimit paraparak për disa kimikate dhe produkte të rrezikshme për mbrojtjen e bimëve në tregtinë ndërmkombëtare”;

26. Ligji nr. 9263/2010, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Stokholmit, ‘Për ndotësit organike të qëndrueshëm”.

2.2 Dokumentet strategjike

SBZHRP 2021–2027 konsolidon qëllimet e politikave dhe arritjet e reformave të realizuara, bazuar në dokumentet strategjike të ndërlidhura, në veçanti:

- Strategjinë Ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (SNBZHR 2014–2020; VKM nr. 709/29.10.2014);

- Strategjinë Kombëtare të Peshkimit 2016–2021 (VKM nr. 701/12.10.2016);

- Strategjinë Kombëtare për Ujitjen dhe Kullimin 2019–2021 (VKM nr. 345/22.5.2019) për infrastrukturën bujqësore;

- Strategjinë Kombëtare për Konsolidimin e Tokës (VKM nr. 700/12.10.2016);

- Politikat Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit 2016–2020 (VKM nr. 31/20.1.2016);

- Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019–2023 (VKM nr. 413/19.6.2019), në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit agrorural;

- VKM-në nr. 595, datë 10.9.2014, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Cilësinë Ajrit të Mjedisit”;

- VKM-në nr. 412, datë 19.6.2019, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit”;

- VKM-në nr. 162, datë 19.2.2020, “Për rregullat e hollësishme për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve të pakësimit të shkarkimeve në ajër”;

- VKM-në nr. 872, datë 19.12.2021, “Për miratimin e planit kombëtar të energjisë dhe klimës”;

- VKM-në nr. 568, datë 6.10.2021, “Për miratimin e Kontributit Kombëtar të Përcaktuar”;

- Parimet horizontale që lidhen me strategjitë kombëtare, si për Barazinë Gjinore, Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, Reformën e Administratës Publike dhe kundër Korrupsionit.

2.3 Arritjet dhe mësimet

Sektori i bujqësisë, zhvillimit rural dhe peshkimit përgjatë viteve të fundit ka pësuar transformime të rëndësishme dhe ka njohur një rritje progresive, referuar kjo treguesve të prodhimit, të ardhurave dhe të punësimit të familjeve rurale. Po kështu, janë përmirësuar ndjeshëm edhe standardet e sigurisë ushqimore për konsumatorët.

Referuar të dhënave statistikore, për periudhën 2017–2020, bujqësia është orientuar drejt produkteve me avantazhe konkurruese dhe krahasuese, të cilat sigurojnë edhe të ardhura më të mëdha për njësi sipërfaqeje dhe që kanë potencial për eksport.

Në këto vite janë mbështetur dhe stimuluar ndryshimet në strukturën e mbjelljeve të produkteve bujqësore, në funksion të rritjes së prodhimtarisë, zbatimit të standardeve të larta dhe plotësimin e kërkesave të tregjeve të brendshme dhe atij ndërkombëtar. Ndryshimet më të mëdha në strukturën e mbjelljeve kanë ndodhur kryesisht në zinxhirët e vlerës të perimeve, pemëve frutore, ullinjve, agrumeve, bimëve mjekësore dhe aromاتيke, luleshtrydheve etj., jo vetëm për plotësimin e nevojave të tregut të brendshëm, por duke rritur në mënyrë të konsiderueshme edhe volumet e eksporteve.

Veçanërisht, pozitive ka qenë rritja e sipërfaqes dhe e prodhimit të perimeve në serra dhe në tunele plastike. Vetëm sipërfaqja e serrave është rritur me rreth 22%. Pjesa më e madhe e këtij prodhimi ka destinacion eksportin në shumë vende të rajonit dhe më gjerë.

Sektori i prodhimit blegtoral, me gjithë vështirësitë që paraqet puna për blegtorët ka qëndrueshmëri në prodhimin e qumështit, si nga gjedhi edhe të imtat, por edhe të mishit për furnizimin e tregut të brendshëm. Nevojat për qumësht plotësohen thuajse plotësisht nga prodhimi vendës.

Fermerët blegtorë po arrijnë çmime më të larta për lëndën e parë nga tregu vendës dhe industria përpunuese. Sektori i shpendëve, prodhimi i vezëve dhe i mishit, përfaqësohet nga stabilimente moderne, të cilat kanë një performancë të mirë.



Rritja e eksporteve të produkteve bujqësore dhe të peshkimit

Eksportet nga bujqësia në vitin 2020 krahasuar me vitin 2017 janë rritur me 33.3%; peshkimi është rritur me 31.8%, ndërsa agroindustria me 23.7%.

Eksportet, në total nga bujqësia, blegtoia, peshkimi dhe agroindustria në vitin 2020 u rritën me 27.5%, krahasuar me vitin 2017, ndërsa krahasuar me vitin 2013 janë rritur me 168.7%.

Si rrjedhojë, raporti i eksporteve kundrejt importit ka njohur një përmirësim të vazhdueshëm dhe të ndjeshëm në favor të eksporteve. Kështu, ky raport, në fund të vitit 2020 arriti në 1:2.95 nga 1:5.92 që ishte në vitin 2013.

Rritja e numrit të pikave të grumbullimit të produkteve

Në shkallë vendi funksionojnë rreth 224 pika grumbullimi (172 pika të grumbullimit të frutave dhe perimeve, 42 pika grumbullimi për bimët mjekësore dhe aromatike, si dhe 10 pika të tjera me destinacione të ndryshme). Nga 224 pika grumbullimi në total 60 pika grumbullimi kryejnë aktivitet në qarkun Fier, 10 në Vlorë, 15 në Gjirokastrë, 49 në Korçë, 11 në Elbasan, 15 në Berat, 12 në Tiranë, 19 në Durrës, 12 në Dibër, dhe nga 7 subjekte në qarqet Shkodër, Lezhë dhe Kukës. Nga 172 pika të grumbullimit të frutave dhe të perimeve 70 prej tyre garantojnë magazinimin në dhoma frigoriferike. Këto të fundit janë të lokalizuara kryesisht në qarqet e Korçës, Dibrës dhe Fierit.

Pikat e grumbullimit bashkëpunojnë me rreth 35 mijë fermerë. Ato janë të shpërndara në të gjithë territorin ku zhvillohet bujqësi intensive dhe që kryesisht synojnë eksportin e produkteve agroushqimore.

Rritja e vazhdueshme e mbështetjes me financime për investime për fermerët dhe agropërpunuesit dhe për sipërmarrësit në zonat rurale për diversifikim të aktivitetit ekonomik

MBZHR-ja, gjatë viteve të fundit, në sajë të politikave që u përgjigjen nevojave të fermerëve, agropërpunuesve dhe sipërmarrësve në zonat rurale, të krijimit të strukturave të nevojshme dhe instalimit të instrumenteve të përshtatshme ka rritur ndjeshëm investimet në bujqësi, zhvillim rural dhe në peshkim, duke i përdorur me efikasitet maksimal burimet financiare në dispozicion.

Burimet financiare të përdorura vijnë, si nga buxheti i shtetit, ashtu edhe nga financimet e BE-së dhe të donatorëve të ndryshëm, si dhe nga sistemi bankar, si BERZH-së, KfW, por edhe projektet bilaterale.

Nga buxheti kombëtar, nëpërmjet skemës kombëtare bujqësia, zhvillimi rural dhe peshkimi është mbështetur në periudhën 2017–2020, me një fond prej rreth 3.8 miliardë lekësh. Shifra të cilat kanë pësuar rritje të konsiderueshme për vitin 2021 dhe 2022. Në të njëjtën periudhë, numri i fermerëve të prekur nga këto skema është rritur disa herë. Këto skema kanë shërbyer, si për rritjen e prodhimit bujqësor e blegtoral, të mjaltit nga bletët, si nëpërmjet pagesave për krerë, gjedh apo të imta apo koshere, ashtu edhe për rritjen e sipërfaqeve të mbjella me kultura, me vlerë të lartë dhe me potencial për eksport, për rritjen e sipërfaqeve të serrave, por edhe për pajisjen më të mirë të flotës së peshkimit për ta bërë atë me eficiente. Që prej vitit 2021 ka filluar implementimi i skemës së mbështetjes të fermerëve me naftë pa akcizë, taksë karboni dhe taksë qarkullimi, për punimet e mekanizuara në bujqësi. Vetëm nëpërmjet kësaj skeme, më 2021-shin kanë përfituar rreth 20 mijë fermerë.

MBZHR-ja, duke filluar nga viti 2017, ka arritur të ndërtojë institucione eficiente, të marrë akreditimin nga BE-ja (DG-AGRI), si për institucionet e AZHBR-së, ashtu edhe të autoritetit menaxhues së bashku me programin IPARD II të hartuar nga MBZHR-ja, duke krijuar të gjitha kushtet e kërkuara nga BE (DG-AGRI), për të përthithë me shumë sukses, duke u konsideruar kështu si një rast pozitiv midis vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor, për efikasitetin e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së, që mundësohet në zbatim të programit IPARD II. Livrimi i fondeve, në kuadër të këtij programi, pasi u krijua baza e nevojshme institucionale dhe infrastrukturore ka filluar në vitin 2019, me një financim total prej 94 milionë eurosh (nga të cilat 71 milionë financim i Bashkimit Evropian dhe 23 milionë euro nga qeveria shqiptare) ka siguruar mbështetje për fermat e mëdha dhe agrobiznesin. Në kuadër të programit IPARD II janë mbështetur investime, në kuadër të tri masave, si vijon:

1. Investime në ferma, me qëllim modernizimin e prodhimit, rritjen e produktivitetit dhe arritjen e standardeve të BE-së;



2. Investime në agropërpunimin dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe të peshkimit;

3. Investime për diversifikimin e aktiviteteve ekonomike në zonat rurale, për të shfrytëzuar me mirë atraktivitetin që ato ofrojnë për turizmin rural dhe agroturizmin, si edhe aktiviteteve të artizanatit, në mbështetje të ekonomisë, punësimit dhe të ardhurave, duke u bërë një faktor nxitës për të tërhequr aktorët ekonomikë dhe, veçanërisht të rinjtë të qëndrojnë dhe të shfrytëzojnë burimet natyrore dhe ekonomike të zonave malore.

Në fund të vitit 2020, ashtu siç ishte planifikuar, i tërë fondi i vënë në dispozicion është livruar plotësisht në dobi të aktorëve ekonomikë në bujqësi, zhvillim rural dhe peshkim, gjë që dëshmon edhe për dinamikën pozitive të këtyre sektorëve.

Që nga viti 2021, MBZHR-ja po punon intensivisht nëpërmjet institucioneve të saj, si AZHBR dhe AM, që të hartojë dhe të mundësojë akreditimin dhe zbatimin e programit IPARD III 2022–2027, i cili do të mundësojë investimin në total të 145 milionë eurove, nga të cilat 75% nga buxheti i vënë në dispozicion nga BE-ja dhe 25% nga buxheti kombëtar. Në këtë program janë përfshirë nëntë masa mbështetëse, duke zgjeruar kështu, si gamën e fushave të mbështetjes, ashtu edhe bazën dhe numrin e përfituesve të mundshëm. Nga nëntë masat e përfshira në program, pesë prej tyre janë të reja, ndërsa katër prej tyre janë ato të cilat janë zbatuar në kuadër të IPARD II dhe për të cilat është grumbulluar eksperiencia e nevojshme dhe janë nxjerrë mësimet për zbatimin e shpejtë dhe eficient të tyre.

Krahas mbështetjes financiare, nëpërmjet skemave kombëtare dhe ato të IPARD-së, MBZHR-së me mbështetjen e Qeverisë Shqiptare ka mbështetur sektorin e bujqësisë edhe nëpërmjet instrumentit të lehtësimit të aksesit në financim nga bankat për fermerët dhe agrobiznesin, nëpërmjet **Fondit Kombëtar të Garancisë të Kredive për Bujqësinë të ofruar nga BERZH-i, në bashkëfinancim me Qeverinë Shqiptare. Ky fond** shërben si një instrument mbështetës financiar për nxitjen e investimeve private në bujqësi, sidomos të investimeve të IPARD-së, të cilat kërkojnë një financim paraprak nga përfituesit. Kontributi i Qeverisë Shqiptare prej 36 milionë eurosh, ka shërbyer për mbulimin e riskut të

kredive të këqija nga institucionet financiare pjesëmarrëse, duke synuar gjenerimin e 180 milionë eurove, në vlerë kredie për sektorin bujqësor dhe zhvillimin rural në vend. Krahas fondit të garancisë të instaluar nga Qeveria Shqiptare dhe BERZH-i është arritur të përthithen edhe fondet të vëna në dispozicion nga BE dhe Banka Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KfW), nëpërmjet të cilave është ofruar një fond i dytë i garantimit të kredive për këta sektorë.

Një mbështetje e rëndësishme për sektorët bujqësor, të zhvillimit rural dhe të peshkimit kanë qenë edhe incentivat fiskale të financuara nga Qeveria Shqiptare, si vijon:

1. Heqja/reduktimi i TVSH-së për inputet bujqësore, që përfshijnë plehrat kimike, pesticidet, farërat dhe fidanët;

2. Heqja e TVSH-së për makinat bujqësore, si në import ashtu dhe brenda vendit;

3. Heqja e pragut të xhiros për efekt rimbursimi të TVSH-së dhe reduktimin e tatim-fitimit në 5% për “Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor, që operojnë në fushën e bujqësisë”;

4. Paketa e agroturizmit, për subjektet e certifikuar si agroturizëm:

- 6% TVSH;

- 5% Tatim-fitimi;

- 0% Taksë ndikimi në infrastrukturë.

Në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës mbështetëse në funksion të sektorëve të bujqësisë, zhvillimit rural dhe peshkimit zhvillime pozitive ka pasur në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja, duke financuar rreth 13,6 miliardë lekë.

Në ujitje: Sipërfaqja e ujitshme, me infrastrukturë të rehabilituar dhe të përmirësuar, është shtuar me rreth 40 000 ha nga 205 000 ha në fund të 2016 në rreth 255 000 ha në 2020, duke impaktuar kryesisht zonat me bujqësi intensive të vendit. Janë rehabilituar 14 diga të rezervuarëve për ujitje për rritjen e sigurisë së tyre dhe garantimin e burimit ujqor.

Në kullim: nëpërmjet pastrimit të kanaleve kullues me flotën e ekskavatorëve është përmirësuar kullimi në rreth 230 000 ha nga 280 000 ha të sipërfaqes totale të tokës bujqësore, që kullohen aktualisht.

Në mbrojtjen nga përmytja: Janë rehabilituar dhe ndërtuar rreth 60 km argjinatura mbrojtëse në



lumenjtë kryesorë të vendit, duke rritur ndjeshëm sigurinë e mbrojtjes nga përmbytja në zonat problematike.

Diversifikimi i aktiviteteve ekonomike në zonat rurale:

Një dimension tjetër shumë i rëndësishëm i politikave për zhvillimin bujqësor dhe rural është edhe diversifikimi i aktiviteteve ekonomike në zonat rurale, nëpërmjet mbështetjes për investime në agroturizëm, turizmit rural (bujtinat), ngritjen e inkubatorëve të prodhimit dhe produktet tradicionale, si dhe projekte infrastrukturore në zonat rurale.

Në fushën e sigurisë ushqimore ka një përmirësim të ndjeshëm të standardeve të prodhimit dhe të kontrollit, dhe të gjurmueshmërisë përgjatë të gjithë zinxhirit ushqimor. Siguria që i ofrohet konsumatorit shqiptar nëpërmjet ushqimit është rritur ndjeshëm. Në këtë kuadër, rrjeti i laboratorëve të sigurisë ushqimore është përafruar më tepër me standardet e BE-së dhe është rritur numri i analizave dhe i laboratorëve të akredituar.

Sektori i peshkimit është një nga sektorët ekonomikë më vitalë, me rritjen më të shpejtë dhe me perspektiva shumë të mira zhvillimi. Prodhimet tona të peshkimit janë të një cilësie shumë të lartë dhe konkurrojnë denjësisht në tregjet më të mira ndërkombëtare, duke zënë gjithmonë e më shumë vend në tregjet e huaja. Eksportet e prodhimeve peshkore janë rritur me rreth 3 herë në krahasim me vitin 2013, ndërsa investimet në industrinë përpunuese kapin vlerën e më shumë se 40 milionë €. Synimi i MBZHBR-së është të rrisë vlerën e shtuar të produkteve, duke rritur nivelin e përpunimit të produkteve të peshkimit në vend.

2.4 Fuqizimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore

Ndërkohë që është bërë progres në këtë drejtim, sipas analizave të bëra dhe sfidave që kanë përpara këta sektorë, duke filluar nga fermerët dhe në nivelin e MBZHHR-së, janë të nevojshme përpjekje të shtuara për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, përmirësimin e infrastrukturës për transferimin e njohurive dhe futjen në shkallë më të gjerë të inovacionit dhe të digitalizimit.

Për të përballuar sfida, si: ekonomia e gjelbër, mirëruajtja e biodiversitetit, efektet e ndryshimit të klimës me pasoja mbi prodhimin bujqësor, të cilat afektojnë fermerët dhe aktorët ekonomikë në zonat

rurale, si dhe në sektorin e peshkimit, parashikohet të ndërmerren reforma institucionale dhe strukturore, që tashmë kanë filluar dhe do të fuqizohen më tej, nëpërmjet masave të planifikuara në këtë strategji për rritjen e kapaciteteve, të bashkëpunimit, shpërndarjen efikase të njohurive dhe inovacionit, duke fuqizuar përdorimin e mjeteve dhe të instrumenteve digjitale.

Në këtë aspekt, angazhimi i studentëve të ekselencës është një kontribut me përfitim të dyfishtë, si për institucionet, por edhe për vetë të rinjtë e punësuar. Për më tepër, është forcuar më shumë bashkëpunimi me Universitetin Bujqësor, por edhe me modelet pilot të bizneseve nga sektori privat.

3. Pjesa II: Vizioni, politikat, objektivat e përgjithshëm dhe objektivat specifikë

Vizioni i Strategjisë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021–2027

- Të mundësojë që zonat rurale dhe sektorët e bujqësisë, agroindustrisë dhe peshkimit, në Shqipëri të zhvillohen në mënyrë të qëndrueshme, të efektshme, bazuar në inovacion dhe në digitalizim, që të përballojnë më mirë presionet e tregut kombëtar dhe ndërkombëtar, si edhe sfidat që lidhen me ndryshimet klimatike, biodiversitetin, dhe ekonominë e gjelbër, nëpërmjet menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë të jetës së banorëve dhe rritur atraktivitetin ndaj zonave rurale.

- Adresimi i sfidave kryesore ekonomike, mjedisore dhe sociale, si edhe ato të tregjeve ndërkombëtare për të përmirësuar mundësitë për zhvillimin e bujqësisë, peshkimit dhe biznesit në zonat rurale, duke iu kushtuar vëmendje të veçantë barazisë gjinore dhe tërheqjes së fermerëve dhe sipërmarrësve të rinj, për të përmbushur prioritetet e politikave të sektorit dhe për të përballuar sfidat e procesit të përafrimit dhe të anëtarësimit në BE-së.

- Këta sektorë ekonomikë të zhvillohen dhe të operojnë, në përputhje me prioritetet e përgjithshme të politikave kombëtare në këtë sektor dhe me ambiciet e procesit të anëtarësimit në BE.

Misioni i SBZHHRP 2021–2027 është shumëdimensional dhe shumëfunksionësh. Funkcioni kryesor është siguri i ushqimit. Sektori agroushqimor dhe peshkimi zënë një peshë të

rëndësishme në ekonominë e vendit dhe kontributi në PBB në vitin 2020 ishte rreth 19.3%.

Ndërkohë, strategjia synon mbështetjen, zhvillimin dhe fuqizimin e mëtejshëm të një numri funksionesh të tjera me rëndësi të veçantë për shoqërinë dhe grupet e ndryshme konsumatore të produkteve jashtë prodhimit bujqësor, që përkthehen nga ana tjetër në kontribut ekonomik dhe në atë për uljen e varfërisë, si p.sh.;

- Kontributi në sektorin e bujqësisë nëpërmjet garantimit të një ushqimi të sigurt dhe me vlera të larta ushqyese për konsumatorët, duke kontribuar në shëndetin e popullsisë dhe indirekt në aftësinë në punë;

- Kontributi në zhvillimin e turizmit rural dhe të kulturës dhe në agroturizmin, nëpërmjet ndikimit pozitiv në peizazh, mirëmbajtjen e sipërfaqeve livadhore, të kullotave etj.;


- Kontributi/funksioni në biodiversitet dhe në mjedis, duke ulur ndikimin e praktikave të dëmshme në prodhim bujqësor, blegtoral dhe peshkimit, nëpërmjet reduktimit të përdorimit të PMB-ve, të antibiotikëve apo të trajtimit me standarde të larta të mbetjeve nga aktiviteti ekonomik i sektorit.

3.1 Situata e përgjithshme në bujqësi dhe zonat rurale

Sipërfaqja e përgjithshme e territorit të Shqipërisë është 28,748 km². Pyjet konsiderohen si një ndër burimet kryesore natyrore, që mbulojnë 41.6% të sipërfaqes së përgjithshme, rreth 24% është tokë bujqësore dhe 16% kullota dhe livadhe të përhershme. Shqipëria është, gjithashtu, e pasur me burime ujore me një vijë bregdetare prej 476 km, ku zhvillohen aktivitetet e peshkimit. Peshkimi në ujërat e brendshme mbështetet në 10,600 ha të ndarë në tetë laguna bregdetare dhe në më shumë se 100 liqene natyrore me një sipërfaqe totale prej 1,210 km². Vendi ynë është i njohur për diversitetin e tij të lartë të ekosistemeve dhe habitateve të pasura me biodiversitet. Territori i vendit është mjaft i larmishëm dhe përfshin ekosistemet detare, zonat bregdetare, liqenet, lumenjtë, shkurret me gjelbërim të përhershëm dhe gjethegjërë, pyjet gjethegjërë, pyjet me pisha, kullotat dhe livadhet alpine dhe nënalpine, si dhe ekosistemet malore të larta.

Organizimi administrativo-territorial e ndan Shqipërinë në 12 qarqe dhe 61 bashki. Sipas tipologjisë urbane-rurale të BE-së, klasifikohen tri kategori (niveli NUTS 3 = rajone): rajone kryesisht urbane, rajone të ndërmjetme rurale dhe rajone kryesisht rurale¹. Sipas këtij klasifikimi, rajoni me mbizotërim urban është Tirana, rajone të ndërmjetme rurale janë: Durrësi, Shkodra dhe Korça; dhe rajone kryesisht rurale: janë Berati, Dibra, Elbasani, Fieri, Gjirokastra, Kukësi, Lezha dhe Vlora.

Figura 3-1: Klasifikimi rural i rajoneve në Shqipëri (Tipologjia urbane-rurale e BE-së, rajonet e nivelit NUTS 3)



Burimi: INSTAT (2014)

Shqipëria ka një **popullsi totale** prej 2,845,955 banorësh (1 janar 2020, INSTAT 2020), nga të cilët 1,429,088 janë gra. Dendësia e popullsisë është 100 banorë për km².

Popullsia rurale llogaritet në 964,791 banorë (2019). Përqindja e popullsisë rurale ka rënë vazhdimisht nga 42,57% në vitin 2015 në 38,89% në vitin 2019, e shkaktuar nga **migrimi jashtë** dhe përgjithësisht nivelet më të ulëta të lindjeve. Emigrantët tërhiqen kryesisht nga zonat urbane, pasi shkalla e urbanizimit është në rritje pavarësisht nga një rënie e përgjithshme e popullsisë. Sipas parashikimeve, popullsia shqiptare do të ulet me 100,000 njerëz në rreth 2.75 milionë në vitin 2031 krahasuar me vitin 2020.

¹ Rajone kryesisht urbane, rajone të nivelit NUTS 3, ku të paktën 80% e popullsisë jeton në grumbullime urbane; rajonet e ndërmjetme, rajonet e nivelit NUTS 3, ku më shumë se 50%, por më pak se 80% e popullsisë jeton në grumbullime urbane; rajone kryesisht rurale, rajone të nivelit NUTS 3, ku të paktën 50% e popullsisë jeton në qelizat e rrjetit rural.



Disponueshmëria dhe cilësia e **infrastrukturës rurale dhe e shërbimeve** bazë janë në proces zhvillimi në zonat rurale, por mbetet sfidues veçanërisht në zonat e thella dhe malore: me gjithë vëmendjen e rritur, akoma mbeten për t'u përmirësuar furnizimi i qëndrueshëm me energji elektrike, sistemet e administrimit të ujërave të zeza dhe të kanalizimeve, grumbullimi i mbetjeve, rrjeti rrugor rajonal dhe rural ose konektiviteti digjital (brez i gjerë).

Zhvillimi ekonomik në zonat rurale karakterizohet nga një mbizotërim i sektorit ekonomik nga bujqësia. Sektori bujqësor përjeton rritje të qëndrueshme, me formim vjetor të kapitalit fiks bruto (FBKF) prej rreth 53.7 milionë eurosh dhe rritje të produktivitetit vjetor (VSHB për njësi të fuqisë punëtore në bujqësi) prej 5,680 eurosh në vitin 2020. Kontributi i bujqësisë në totalin e vlerës së shtuar bruto të ekonomisë (VSHB) është rreth 22% ndaj VSHB-së kombëtare.

Në vitin 2019, 36.4% e **forcës totale të fuqisë punëtore** ishte në bujqësi, pylltari dhe peshkim me një rënie totale prej mbi 10% gjatë dekadës së fundit, për shkak të migrimit dhe të rritjes së produktivitetit. **Shkalla zyrtare e papunësisë** në zonat rurale konsiderohet më e ulët se në zonat urbane. **Paga mesatare mujore bruto në bujqësi**, pylltari dhe peshkim tenton që të arrijë mesataren kombëtare ishte 33,359 lekë në vitin 2020.

Prodhimi bujqësor dominohet nga fermat e vogla dhe fermat familjare. 85% e fermave klasifikohen si të vogla. Në periudhën 2020–2022, edhe falë integritetit të një pjese të rëndësishme të fermerëve në skemat kombëtare të mbështetjes, ku mbështetja ndaj naftës ka pasur një rrol thelbësor, numri i fermerëve të pajisur me NIPT fermeri është rritur ndjeshëm. Kështu, në vitin 2021 dhe në muajt e parë të vitit 2022, janë pajisur me NIPT fermeri dyfishi i fermerëve që kanë marrë NIPT fermeri për periudhën 2017–2020. Madhësia mesatare e pandryshuar prej 1.2 ha, e kombinuar me fragmentimin dhe të drejtën e paqartë të pronës janë sfidat kryesore për rritjen dhe konkurrencën e sektorit të bujqësisë. Megjithatë, pronarët e vegjël luajnë rol kritik për sigurimin e ushqimit të popullsisë shqiptare, si dhe për uljen e varfërisë në zonat rurale, por janë të integruar në mënyrë të pamjaftueshme në zinxhirët e shkurtër të furnizimit. Vështirësitë strukturore të trashëguara të

fermave, po mbështeten nga politika publike, të cilat synojnë bashkimin e fermerëve në procesin e tregtimit të produkteve bujqësore.

Agropërpunimi është rritur ndjeshëm gjatë 10 viteve të fundit duke arritur në 24.4% të xhiros totale të bujqësisë. Tendencat janë shumë pozitive, të cilat tregojnë se sektori ka potencial të lartë për zhvillim dhe krijimin e vendeve të punës. Xhiroja e sektorit është pothuajse dyfishuar, ndërkohë që punësimi është rritur me rreth 20%, mbështetur nga rritja e kërkesës së brendshme për produkte të përpunuara dhe rritja e eksportit të produkteve me origjinë bimore, ndërkohë që mundësimi i eksportit të produkteve me origjinë shtazore është në proces realizimi me disa prej vendeve të rajonit, por edhe në të ardhmen me vendet e Bashkimit Evropian, pas përfundimit të procesit të reformave të rëndësishme të ndërmarra në fushën e sigurisë ushqimore në të cilat është angazhuar sektori.

Erozioni, degradimi i tokës, si pasojë e terrenit të vështirë kodrinor dhe malor dhe humbja e tokës bujqësore për përdorime, për qëllime të tjera, mbeten sfida të vazhdueshme. Tendencat e ndryshimeve klimatike të parashikuara për Shqipërinë, tregojnë rritje të temperaturës mujore prej 1–2°C gjatë verës, ndryshueshmëri të reshjeve dhe shtim të ngjarjeve ekstreme të motit, duke përbërë një tjetër sfidë për prodhimin bujqësor, furnizimin me ujë, sigurimin e ushqimit dhe rritjen ekonomike për shumicën e popullsisë rurale.

Zonat rurale në Shqipëri kanë një **potencial të lartë për turizmin e qëndrueshëm të bazuar në natyrë**, por i cili po vlerësohet dhe lidhet me sektorët e tjerë të ekonomisë lokale, si bujqësia. Sektori i turizmit, i cili ofron punësim tërheqës për të rinjtë dhe gratë, është një **forcë shtytëse e rimëkëmbjes ekonomike, sidomos** pas përfundimit të pandemisë COVID-19, bazuar në strategjinë “e rindërtimit” me fokus në rritjen e standardizimit dhe certifikimit për t'i shërbyer pritshmërive më të larta të turistëve. Zhvillimi i sektorit po nxjerr në pah nevojën për të punësuar të kualifikuar në sektor. Sektori shihet si një prej motorëve të zhvillimit të zonave rurale, duke lidhur kështu në të njëjtën pikë prodhimin, përpunimin, shërbimet ndaj produktit. Pritet të ketë kërkesa në rritje të banorëve për aktivitete rekreative dhe rritje të vlerësimit të tyre për zonat rurale.



Prodhimi total primar nga peshkimi është rritur në mënyrë të konsiderueshme në vitet e fundit, ku akuakultura detare dhe peshkimi kanë kontribuar në mënyrë të ndjeshme në rritjen e sektorit, ndërsa ujërat e brendshme dhe lagunat bregdetare kanë pasur një kontribut më të kufizuar. Peshkimi detar zë më shumë se 52% të sasisë së kapur dhe 61% të vlerës, ndërsa ujërat bregdetare dhe ato të brendshme përbëjnë 21% të sasisë së kapur, por vetëm 13% të vlerës (2019). Peshkimi artizanal është një faktor i rëndësishëm ekonomik për komunitetet bregdetare, por një pjesë e madhe e sasisë së kapur mbetet e paregjistruar.

Punësimi me kohë të plotë në peshkim dhe akuakulturë vlerësohet në 9,279 persona, me një numër të konsiderueshëm grash të punësuar në industrinë përpunuese dhe shërbimet ndihmëse (viti 2020). Eksportet e peshkut dhe të prodhimeve të detit janë trefishuar në shtatë vjetët e fundit, duke arritur 104 milionë euro në vitin 2020. Industria e përpunimit të peshkut është e fokusuar në eksportimin drejt tregut të BE-së. Industria përpunuese e produkteve peshkore shfrytëzon jo më shumë se 39% të kapaciteteve ekzistuese dhe kjo i jep mundësi të vazhdueshme sektorit për t'u zhvilluar edhe në të ardhmen. Akuakultura është bërë më e rëndësishme, duke përbërë 27% të sasisë totale dhe 26% të vlerës, veçanërisht për produktet e peshkut të kultivuar në det. Tashmë, tendenca dominohet nga shtimi i pjesës së kultivuar krahasuar me atë të zënë në det. Megjithatë, importi i produkteve të akuakulturës detare është i nevojshëm për të plotësuar kërkesën e brendshme, në rritjen e të cilës ka kontribuar edhe zhvillimi i turizmit.

Burimet bregdetare dhe detare janë pasuri ekonomike me një vlerë të lartë, potenciali i plotë i të cilave parashikohet që të eksplorohet në mënyrë më të plotë në Shqipëri. Zhvillimi i mëtejshëm i ekonomisë blu do të mundësohet nga transferimi dhe përthithja e kërimit shkencor dhe inovacionit, investimet në biznese të reja detare dhe në bioekonomi, duke përfshirë modelet e qëndrueshme të turizmit, të cilat do të krijojnë vende pune dhe në të njëjtën kohë të rrisin zhvillimin e drejtuar në nivel lokal me rëndësi të lartë sociale-ekonomike dhe kulturore për komunitetet bregdetare.

Transformimi i shpejtë i prodhimit bujqësor dhe peshkimit, i nevojshëm për të ndërtuar sisteme

të qëndrueshme ushqimore, kërkon fermerë, peshkatarë dhe operatorë përpunues ekonomikisht të qëndrueshëm dhe të aftë që të përballin sfidat.

Politikat dhe objektivat e përgjithshëm

SBZHRP 2021–2027 përmban tri fusha politikash, katër objektiva të përgjithshëm dhe dy objektiva ndërsektorialë, si vijon:

Politika 1: Zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë dhe i zonave rurale

Politika 1 përmban tre objektiva të përgjithshëm, si vijon:

1. Promovimi i prodhimit të qëndrueshëm dhe të cilësisë së ushqimit nëpërmjet zhvillimit të një sektori konkurrues dhe inovativ agroushqimor: Përmirësimi i efektshmërisë dhe prodhimit të qëndrueshëm në fermë, rritja e orientimit drejt tregut të sektorit të agropërpunimit ushqimor, harmonizimi në mënyrë progresive i tij me standardet e BE-së, gjë që do të japë një përgjigje më të mirë ndaj kërkesave të konsumatorëve për ushqim të sigurt, me vlera ushqyese dhe të qëndrueshëm.

2. Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe marrja e masave për zbutjen e efekteve negative, si pasojë e ndryshimeve klimatike: Kontribut i shtuar për kujdesin ndaj mjedisit, përshtatjen dhe zbutjen e efekteve të klimës, mbrojtjen e biodiversitetit dhe të peizazhit.

3. Forcimi i strukturës social-ekonomike të zonave rurale: Promovimi i zhvillimit lokal nëpërmjet përmirësimit të mundësive të punësimit dhe të zhvillimit të biznesit brenda dhe jashtë fermës bujqësore, si dhe përmes iniciativave për zhvillim të territorit të udhëhequra nga komuniteti.

Politika 2: Zhvillimi i qëndrueshëm i peshkimit dhe ekonomisë blu

Politika 2 përmban një objektiv të përgjithshëm si vijon

1. Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm detar dhe të ujërave të brendshme: Forcimi i akuakulturës dhe i tregjeve konkurruese dhe të qëndrueshme, si dhe komuniteteve bregdetare me ekonomi të suksesshme, duke përfshirë ekonominë blu të qëndrueshme, si edhe nxitja e peshkimit të qëndrueshëm dhe mirëruajtja e burimeve biologjike.

Politika 3: Zhvillimi kapaciteteve administrative dhe institucionale, bashkëpunimi i aktorëve, inovacioni dhe digjitalizimi



Politika III përmban dy objektiva ndër-sektorialë, si vijon:

1. **Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative** për përafrimin me *acquis communautaire* të BE-së në klasterin dhe kapitujt përkatës;

2. **Transferimi i njohurive dhe i inovacionit** në bujqësi dhe në zonat rurale, si dhe nxitja e përvetësimit dhe e vënies së tyre në zbatim.

Më tej, SBZHRP 2021–2027 synon forcimin e politikave të koordinimit dhe të komunikimit dhe forcimin e mekanizmave të performancës dhe të menaxhimit të rrezikut, së bashku me mekanizmin përkatës të monitorimit dhe të vlerësimit, që është hartuar në përputhje me urdhrin përkatës të Kryeministrit.

3.2 Situata në lidhje me politikat respektive

3.2.1 Politika 1: Objektivi i përgjithshëm 1: Promovimi i prodhimit të qëndrueshëm dhe i cilësisë së ushqimit nëpërmjet zhvillimit të një sektori konkurrues dhe inovativ agroushqimor

Transformimi me ritme më të shpejta i prodhimit bujqësor, që është i nevojshëm për të ndërtuar sisteme të qëndrueshme ushqimore kërkon një sektor bujqësor ekonomikisht performues dhe të qëndrueshëm, si edhe një sektor konkurrues të agropërpunimit. Sfidat kryesore ekonomike dhe shoqërore që trajtohen në kuadër të objektivit të përgjithshëm 1 janë, si për të përmirësuar mundësitë e aktivitetit në bujqësi, ashtu edhe për të gjeneruar mundësi të reja, si dhe për të konsoliduar tregjet ekzistuese dhe eksploruar tregje të reja, brenda dhe jashtë vendit për sektorin agroushqimor. Me synimin e rritjes së eksporteve, do të promovohet veçanërisht rritja e konkurrueshmërisë, duke përmirësuar nivelin e mekanizmit të fermave, duke rritur sipërfaqet e serrave, të pemëve frutore intensive, ullishtave dhe bimëve mjekësore dhe aromatike, diversifikimi i produkteve bujqësore të kultivuara dhe shtimi i sipërfaqeve, të cilat kanë vlerë më të lartë të shtuar për operatorët e sektorit dhe ose kalojnë nëpërmjet përpunimit, si dhe nëpërmjet shtimit të blegtorisë së imët dhe rritjes së rendimentit për krerë në lopët e qumështit.

Çështjet kryesore për t'u trajtuar:

- Mbështetja e një procesi të përshtatshëm të konsolidimit të fermës në terma ekonomikë dhe strukturorë;

- Mbështetja e të ardhurave të fermave familjare të vogla dhe të mesme dhe të atyre që ndodhen në zona me kufizime natyrore nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit midis operatorëve në faza të ndryshme të prodhimit, tregtimit apo përpunimit. Nevoja për mbështetje të qëndrueshmërisë së fermave kërkohet në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, e nxitur kryesisht nga ndryshimet e vazhdueshme të tregjeve ndërkombëtare dhe procesi i stabilizimit të tregjeve të reja për produktet shqiptare, si dhe nga rritja e ngjarjeve të motit ekstrem të nxitura nga klima. Këta faktorë justifikojnë nevojën për skemat e përshtatshme të mbështetjes së të ardhurave, veçanërisht për fermerët më të vegjël, të cilët duan të tregtojnë duke u bashkuar me operatorë të tjerë, ata ekonomikisht të qëndrueshëm;

- Tërheqja e fermerëve të rinj në biznesin bujqësor dhe rural dhe lehtësimi i ngritjes rishtazi dhe zhvillimit të biznesit të tyre (*start-up*) për një rinovim të gjeneratës së fermerëve në sektorin e bujqësisë;

- Përmirësimi i efektshmërisë dhe i qëndrueshmërisë së prodhimit në fermë, i cili do të sigurojë përgjigje më të mirë ndaj kërkesave të konsumatorëve për ushqim të sigurt, me vlera ushqyese dhe të qëndrueshëm;

- Rritja e kapacitetit të fermerëve për të krijuar dhe për të zotëruar një pjesë më të madhe të vlerës së shtuar në zinxhirin e furnizimit ushqimor;

- Qëndrueshmëri ekonomike e rritur e sektorit agroushqimor, që varet nga arritjet e sektorit për të investuar në siguri ushqimore dhe qëndrueshmëri të përdorimit të burimeve;

- Përafrimi në mënyrë progresive i fermave të qëndrueshme dhe i bizneseve të përpunimit agroushqimor apo i tregtimit me standardet e BE-së, për të siguruar produkte ushqimore të sigurta dhe për të rritur konkurrencën e tyre kombëtare dhe ndërkombëtare (ritje të eksportit);

- Nxitja e inovacionit dhe e një niveli të lartë të trajnimit dhe të investimeve në bujqësi dhe në përpunimin ushqimor;

- Stimulimi i aksesit në financa për zhvillimin e biznesit.

3.2.1.1 Politika 1: Objektivi specifik 1: Rritja e qëndrueshmërisë dhe e reziliencës/ elasticitetit të fermave

Situata specifike në lidhje me politikën 1 dhe objektivat e saj



Struktura e fermës

Sipas INSTAT (2020), sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore të shfrytëzuar (TBSH) në Shqipëri, përfshirë edhe livadhet dhe kullotat është 986,600 ha.

Sipërfaqja e tokës bujqësore të pashfrytëzuar llogaritet në rreth 100,000 ha, e cila përfaqësohet kryesisht nga kategoria e tokave të pandara, aktualisht në administrim të bashkive.

Tabela 3-1: Toka bujqësore sipas përdorimit (2019/2020)

Emërtimi	Sipërfaqja e TBSH		
	2019	2020	
	Total (ha)	Total (ha)	Total (%)
E kultivuar (përfshirë drithërat, perimet, bimët mjekësore dhe foragjere)	417,000	421,607	42.7%
Livadhe dhe kullota të përhershme	478,081	478,081	48.5%
Kulturat e përhershme total (pëmë frutore, ullinj, agrume, vreshta)	85,838	86,912	8.8%

Burimi: INSTAT dhe të dhënat e përmbledhura të MBZHR-së

Shumica e fermave janë të përziera dhe karakterizohen nga parcela të vogla dhe të fragmentuara.

Tabela 3-2 më poshtë paraqet sipërfaqet e kultivuara në periudhën 2015–2020. Në pothuaj të gjitha grup-kulturat ka pasur një rritje të sipërfaqeve dhe të prodhimit, me përjashtim të drithërave, të cilat kanë një dinamikë e cila drejtohet nga niveli i ulët i përfitimit për ha, si pasojë e strukturave të copëzuara. Bimët e arave, ato në ambiente të mbrojtura dhe pemët frutore kanë një rritje të rëndësishme krahasuar me vitin 2015. Tendencat pozitive që vërehen në rritjen e sipërfaqes, sidomos në: mollë, agrume, ullinj, perime dhe, veçanërisht, perimet në serra tregojnë se **orientimi i bujqësisë drejt tregut, nëpërmjet investimeve të vazhdueshme në kultura dhe sisteme prodhimi shumëkonkurrues, është tashmë një realitet i bujqësisë shqiptare.**

Tabela 3-2: Sipërfaqet e kultivuara në ha (2015–2020)

Kulturat (000 ha)	Viti						Ndryshimi 2015 - 2020
	2015	2016	2017	2018	2019	2020	
Totali i kulturave të kultivuara, nga të cilat:	13.100	419.000	424.200	420.300	417.000	421.600	2.06%
Drithërat	142.600	148.000	145.700	140.100	132.200	131.311	-7.91%
Foragjere	207.300	208.600	215.700	217.400	220.100	225.024	8.55%
Perime dhe pjepër	31.100	31.200	31.900	31.700	33.000	33.502	7.7%
Perimet në serra	1.244	1.406	1.540	1.650	1.734	1.798	44.5%
Pemishtet (000 pemë)	Viti						Ndryshimi 2015 - 2020
	2015	2016	2017	2018	2019	2020	
Pemë frutore	12.405	12.594	13.130	13.393	13.822	14.038	13.2%
Pemë ulliri	9.225	9.608	9.786	10.008	10.288	10.532	14.2%
Pemë agrume	1.282	1.354	1.394	1.454	1.521	1.589	23.9%
Vreshta (ha)	10.438	10.533	10.695	10.787	10.842	12.002	15.0%

Burimi: Vjetari i Statistikave në Bujqësi (2020)

Sistemet e vogla të prodhimit (tabela 3-3) përfaqësojnë një nga kufizimet kryesore për rritjen e mëtejshme të qëndrueshmërisë ekonomike-financiare të fermave. Gjithashtu, madhësia e kufizuar e fermës ka prodhuar instrumente të politikës publike, të cilat synojnë të lehtësojnë fermerët në procesin e aplikimit të tyre në pagesat direkte, në inpute më të lira, në kredi etj., nëpërmjet orientimit të tyre drejt bashkëpunimit në faza të ndryshme të prodhimit dhe/ose të shitjes.

Tabela 3-3: Struktura e fermës në sektorin e prodhimit bimor (2019)²

Madhësia e fermës (ha)	Pjesa e fermave sipas madhësisë së fermës							
	Tokë arë	Perimet e fushës	Serrat	* Pemishtet	Fermt e ullirit	* Fermt e agrumeve	Vreshtat	
0 – 0.10	45%	66.66%	60.34%	-	88.5%	-	92.94%	
0 – 20		22.26%	29.66%	77.07%		75.19%		
0.20 – 0.50				17.91%		16.35%		5.46%
0.50 – 1.00				5.02		6.20%		
1.00 – 2.00	41%	9.40%		9%	6.20%	1.17%		
Më e madhe se 2.00	14%	1.68%			5.02	2.5%	2.26%	0.43%

Qëndrueshmëria e fermës

Pragu i qëndrueshmërisë ekonomike të fermës duhet parë si dinamik, në varësi të çmimeve të tregut, kostos së jetesës dhe faktorëve të tjerë, që mundësojnë vazhdimin e aktivitetit ekonomik në zonat rurale. Studimet sektoriale të përgatitura në vitin 2021³ tregojnë si madhësi minimale për qëndrueshmërinë ekonomike të fermës njësinë prej 0.20 ha në rastin e serrave, 0.5 ha për fermt e agrumeve, 0.90 ha për vreshtat, 1 ha për perimet në fushë dhe pemëtoret dhe 2 ha për fermt e ullirit. Megjithatë, një qëndrueshmëri e shëndoshë ekonomike mund të arrihet vetëm në pragje më të larta, pasi fitimi nga fermt të tilla të vogla mund të mos mbulojë nevojat financiare të familjes, dhe në kushtet kur aksesit në rritjen e nivelit të sipërfaqes është i kufizuar, rritja e qëndrueshmërisë mund të prodhohet nga bashkëpunimi midis fermerëve apo dinamizmi i tregut të qiradhënies së tokës.

Analiza e luhatjes së prodhimit të kulturave gjatë viteve 2015–2020 (tabela 3-4) në përgjithësi është e ndërlidhur mirë me sipërfaqet e kultivuara dhe tregon një orientim drejt kulturave më të tregtueshme, si p.sh. perimet (gjithashtu, me një rritje të produktivitetit), bimët aromatike-mjekësore etj.

Bujqësia shqiptare po tregon shenja të rëndësishme të hapjes së saj ndaj tregjeve duke u drejtuar nga kulturat për të cilat ekziston një avantazh i qartë krahasues me produktet në tregjet ndërkombëtare. Ulja e prodhimit të disa kulturave specifike, efektiviteti i të cilave lidhet me sisteme prodhimi me sipërfaqeve të mëdha (disa lloje drithërash apo bimësh industriale) tregon një ndryshim pozitiv të sektorit, i cili është tashmë i vetëdijshëm për pikat e tij të forta, si edhe limitet.

Tabela 3-4: Prodhimi i kulturave (000 ton, 2015–2020)

Përshkrimi	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Ndryshimi 2015–2020
Drithërat	695.598	701.578	696.681	0	1.65%		
Gruri	275.075	271.940	238.238	1	15.12%		
Mieri	380.578	381.801	388.088	1	5.03%		
Thakra	30.27	27.23	26.32	6.67%			
Elbi	70.90	90.97	79.12	6.80%			
Terohëra	30.532	34.134	33.135	6.16%			
Perime në fushë të hapur	1.039	1.29	1.53	0.69	2.59	2.57	15.80%
Perime nga serrat	109.270	170.987	107.407	109.175	15.16%		
Patate	215.038	219.251	250.251	8	7.04%		
Fasule të bardha	28.024	824.724	524.825	8	7.85%		
Duhani	212.18	114.17	114.11	36.36%			
Luledielli	210.20	114.08	110.11	35.90%			
Soja	0.5	0.7	0.5	0.7	0.4	20.00%	
Bimët medicinale	10.810	612.812	512.914	4	33.34%		
Foragjere	6.006	146.888	050.715	170	19.51%		

Burimi: Vjetari Statistikor në Bujqësi (2020)

² Aggregated data of MARD (2020), INSTAT (2020) and MARD (2021): Sector studies on fruits and vegetables, olives and äine; established by AGT International/DSA in the frame of the GIZ-SRD Project, May 2021.

³ MBZHR (2021): 9 Studime sektoriale të hartuara nga AGT International/DSA, në kuadër të Projektit GIZ-SRD, maj 2021.



Ecuria e periudhës 2015–2020 tregon një rritje të konsiderueshme të kulturave, të cilat kanë një vlerë të shtuar shumë të lartë, gjë që në bashkëpunim me koniunkturën pozitive të çmimeve të produkteve bujqësore në tregje do të rrisë si produktivitetin e punëtorit në bujqësi, ashtu edhe atraktivitetin e këtij sektori për punëtorë të rinj.

Blegtoria në Shqipëri është një sektor dinamik, i cili ka përpara vetes sfida të rëndësishme.

Sektori blegtoral po kalon në fazën e rritjes dhe të përqendrimit të prodhimit në njësi, të cilat mbarështojnë një numër më të lartë të krerëve, duke siguruar kështu një rritje të nivelit të sigurisë ushqimore për produktet shtazore.

Sistemet blegtorale janë një fazë tranzicioni, në të cilin formalizimi i një pjese të rëndësishme të prodhimit blegtoral nëpërmjet firmave të përpunimit apo thertoreve të licencuara, ka ngritur pikëpyetje për të ardhmen blegtorale të një grupi fermerësh, të cilët bazonin aktivitetin e tyre në një tufë blegtorale të ulët. Pjesa më e rëndësishme e këtyre blegtorëve po drejtojnë të ardhmen e tyre nga tufa më të mëdha, të cilat sigurojnë qëndrueshmërinë ekonomike të fermës, duke u nxitur edhe nga instrumentet e mbështetjes publike, e cila për arsye më se logjike, mbështet ferma të cilat kanë tufë blegtorale me qëndrueshmëri dhe siguri ushqimore më të lartë. Viti 2021 dhe veçanërisht 2022, duket se do të mundësojnë këtë tranzicion i cili do të ketë efektet e tij të matshme në periudhën në vijim.

Në rastin e fermave që mbarështojnë dele dhe dhi (shumica e fermave janë të përziera), ferma mesatare zotëron 37.4 dele qumështi (pëlleja) dhe/ose 28.8 dhi qumështi (pëlleja). Ndërsa 78.9% e fermave me dele zotërojnë nga 5 deri në 50 dele, fermat e dhive në të njëjtën madhësi janë 84%. (Studimi i sektorit të qumështit, 2021). Pragu i qëndrueshmërisë ekonomike vlerësohet në 120–130 dele ose dhi. Politikat publike synojnë që të ofrojnë instrumentet për arritjen e këtyre niveleve të tufave. **Mbarështimi ekstensiv i deleve dhe i dhive është një traditë e lidhur me kulturën edhe terrenin shqiptar, që aktualisht duhet të bëhet më atraktiv për të rinjtë.** Objektivat publike për mbështetjen e tufave të mëdha, të cilat janë edhe ekonomikisht më të qëndrueshme si edhe lehtësimin e barrës së profesionit të bariut

synojnë pikërisht rivitalizimin e këtij sektori në zonat rurale.

Për sa i përket fermave tradicionale të derrave, tendenca është pozitive, duke vënë në dukje rritjen e ndjeshme të numrit të dosave. Duket se mbarështimi i derrit edhe nga fermerët e vegjël ka sjellë një rritje të të ardhurave të tyre dhe ka diversifikuar aktivitetet në fermë, megjithatë, në të ardhmen stabilizimi i tregut do të prodhojë një ndryshim të strukturës së prodhimit, duke tentuar njësitë me prodhim të përqendruar.

Sektori i zogjve të shpendëve për prodhim mishi ka pasur një rritje të vazhdueshme dhe mbështetet në një sistem në të cilat sasia më e madhe e zogjve të pulave për mish prodhohen në 24 ferma moderne të prodhimit të mishit. Ndërsa 99.8% e fermave mbarështojnë më pak se 1000 zogi pule për mish, si pjesë e aktivitetit tradicional të prodhimit blegtoral brenda fermës. Ky sistem blegtoral duket se siguron një qëndrueshmëri ekonomike për fermat të cilat zhvillojnë një grup aktivitetesh bujqësore dhe blegtorale komplementarë me njëri-tjetrin.⁴ Sigurisht që ky sistem binar i prodhimit kërkon një rritje të sigurisë ushqimore në nivel ferme, gjë që duhet të mundësohet nga numri i rritur i veterinerëve të shërbimit veterinar në terren. Episodi i gripit të shpendëve në fillim të vitit 2022, i cili preku sektorin në stabilimentet e prodhimit të vezëve identifikoi rrugët për përmirësimin e nivelit të sigurisë në këto stabilimente, si edhe rriti efikasitetin e autoriteteve për të vepruar në raste të ngjarjeve të tilla.

Madhësia minimale e një ferme ekonomikisht të qëndrueshme në blegtori, sipas numrit të krerëve, është si më poshtë: 10 lopë qumështi, 130 të imëta (dele/dhi), 15 viça për mish (15 krerë për një cikël x 2 cikle në vit), 20 dosa ose 20,000 zogi pule për mish për një cikël (5 cikle në vit). Këta tregues ekonomikë rrisin akoma më shumë nevojën për zbatimin e instrumenteve publike, që kanë si objektiv jo vetëm stabilizimin e të ardhurave të fermës, por edhe qëndrueshmërinë ekonomike të saj nëpërmjet rritjes së madhësisë fizike apo rritjes së sigurisë ushqimore të siguruar në nivel ferme.

⁴ MBZHR (2021): Studimi i sektorit të mishit, i përgatitur nga AGT International/DSA, në kuadër të Projektit GIZ-SRD, maj 2021.



Bletaria konsiderohet fitimprurëse; me një treg të sigurt dhe pritet që sektori të vazhdojë të zhvillohet. Përtej rritjes së vazhdueshme të prodhimit të mjaltit, mbështetja e vazhdueshme nga ana e politikave publike ka krijuar një stabilitet që do të prodhojë një rritje të qëndrueshme në afatin e shkurtër dhe të mesëm.⁵

Meqenëse të ardhurat e fermave, ndër të tjera, janë të lidhura drejtpërdrejt edhe me madhësinë e fermës, rrjedhimisht madhësitë minimale të një ferme ekonomike të qëndrueshme është e rëndësishme të vijnë të jenë një kriter që duhet të merret në konsideratë në procesin e hartimit të politikave mbështetëse në të ardhshmen, duke u bazuar edhe në përvojën e deritanishme me skemat e mbështetëse kombëtare, por edhe ato të zbatuara në kuadër të IPARD II. Nevoja për të konsoliduar prodhimin nga njëra anë dhe për ndërtuar skema, të cilat përshijnë një numër sa më të madh fermerësh, duhet të bëjë të mundur që edhe në të ardhmen masat direkte të mbështeten në forcimin e bashkëpunimit midis operatorëve ekonomikë.

Pragjet minimale të sipërpërmendura për qëndrueshmërinë ekonomike të fermës (si për sektorin e prodhimit bimor ashtu edhe për atë blegtoral) janë llogaritur në studimet sektoriale të përgatitura në vitin 2021 për Shqipërinë duke marrë në konsideratë pagën minimale për 2 persona (e barasvlershme me 500 euro në muaj). Duke marrë në konsideratë perspektivën e viteve 2021–2027 dhe duke pranuar se madhësia mesatare e familjes në Shqipëri është 3.8 persona, **reziku i migrimit mbetet shumë i lartë** ndaj është e rëndësishme që të zhvillohet niveli i diversifikimit të aktiviteteve në nivel ferme si mundësi për forcimin e qëndrueshmërisë së njësisë prodhuese.

Numri i fermave të regjistruara (me numër identifikimi tatimor/NIPT) ishte më shumë se 62,000 në vitin 2021 (17,7% e rreth 350,000 fermave në Shqipëri), një rritje prej më shumë se 72% e krahasuar me vitin 2018, duke treguar se fermerët janë shumë të interesuar për tregun dhe mbështetjen financiare dhe se përpjekjet e qeverisë për formalizimin e sektorëve po shpërblehen. Vetëm në dy muajt e parë të vitit 2022, janë pajisur

me NIPT fermeri rreth 20 000 fermerë, të cilët e kanë çuar numrin e fermerëve të pajisur me NIPT në rreth 83 000 fermerë.

Çështjet e pronësisë së tokës (kryesisht të lidhura regjistrimin e titujve të pronësisë dhe pajisjen me certifikatë pronësie) njihen si një pengesë e rëndësishme në procesin e konsolidimit të fermave, që ndikon në arritjen e qëndrueshmërisë ekonomike të tyre.

Kuadri ligjor për pronësinë e tokës është i barabartë nga pikëpamja e barazisë gjinore.

Midis faktorëve që duhet të përmirësohen për të rritur nivelin e qëndrueshmërisë ekonomike të fermave janë: i. njohuri më të avancuara bujqësore; ii. aksesin në teknologji / pajisje/makineri të reja dhe rritja e aksesit në kreditim (si për prodhimin dhe për investimet); iii. kapaciteti i magazinimit në nivel ferme; iv. strukturat e bashkëpunimit etj.

Bujqësia precize dhe digjitalizimi: ekzistojnë raste të suksesshme të përdorimit të bujqësisë precize dhe të digjitalizimit. Duhet të theksojmë se digjitalizimi i bujqësisë është njëri prej objektivave të qeverisë shqiptare. Kjo shoqërohet me rritje të nivelit të shërbimeve, të cilat u ofrohen fermerëve nëpërmjet platformave digjitale, por edhe rritja e nivelit të kontrollit dhe e sigurisë së informacionit për sigurinë ushqimore të bimëve, kafshëve dhe konsumatorit final. Të gjitha këto elemente e bëjnë digjitalizimin e bujqësisë një element të rëndësishëm për të ardhmen e sektorit.

Qëndrueshmëria/elasticiteti (reziliencia) e fermës

Qëndrueshmëria e fermës për të përballuar faktorët kufizues/dëmtues

Qëndrueshmëria/reziliencia absolute e të gjithë fermave në Shqipëri nuk është realiste për shkak të strukturës aktuale bujqësore. Ndryshimet strukturore pritët të ndikojnë në uljen e numrit të përgjithshëm të fermave. Megjithatë, fermat e vogla janë, gjithashtu, të lidhura me traditën, ruajtjen e peizazhit dhe mbrojtjen e mjedisit, veçanërisht p.sh. nëpërmjet kullotjes ekstensive. Për këtë arsye, këto aktivitete blegtorale janë mbështetur nga politika publike nëpërmjet masave mbështetëse për blegtorët apo fermerët e vegjël, që vendosin të bashkëpunojnë në një prej proceseve të prodhimit, tregtimit apo përpunimit të produkteve. Edhe varietetet e bimëve apo racat lokale të kafshëve janë pjesë e kësaj qëndrueshmërie.

⁵ MBZHR (2021): Studimi i diversifikimit, i përgatitur nga AGT International/DISA, në kuadër të projektit GIZ-SRD, maj 2021.



Në rastin e një bujqësie të bazuar në struktura prodhuese më të mëdha dhe më intensive, aftësimi dhe rritja e qëndrueshmërisë së fermës kalon nëpërmjet përdorimit të praktikave moderne bujqësore, me fokus miradministrimin e ujit dhe mbrojtjen e tokës.

Veç sa me lart qëndrueshmëria ekonomike dhe financiare e fermave mund të mbështetet vetëm me **skema më të forta sigurimesh**. Aktualisht, tregu i produkteve të sigurimit është i ri dhe ofertat nuk janë të përhapura në gjerësi dhe nuk janë lehtësisht të aksesueshme për fermerët. Zhvillimi i një tregu të sigurimeve të produkteve bujqësore për disa prej kushteve ekstreme të motit, do të përbëjë një zhvillim pozitiv, i cili do të përkrahet së pari nga fermerët që prodhojnë për treg për t'u përhapur edhe në llojet e tjera të fermerëve. Nxitja publike e institucioneve të sigurimit për të mundësuar zhvillimin e produkteve të sigurimit dhe lidhjen e tyre me fermerët, mbetet një hap i domosdoshëm.

3.2.1.2 Politika 1. Objektivi specifik 2: Rritja e konkurrueshmërisë dhe orientimit drejt tregut të sektorit agrorshqimor

Sektori i bujqësisë

Forca e punës është një faktor kyç për produktivitetin. Të dhënat e ILOSTAT-it për vitin 2019⁶ tregojnë se bujqësia angazhon 460,600 *njësi vjetore pune* (NJVP), që do të thotë 36.4% nga fuqia totale e punës janë të punësuar në bujqësi⁷.

Aktualisht, **kostoja e fuqisë punëtore në Shqipëri është 10 herë më e ulët se mesatarja e BE-së**⁸. Kështu, kostot e fuqisë punëtore mund të konsiderohen të lira. **Produktiviteti i fuqisë punëtore në sektorin e bujqësisë ka ardhur në rritje të vazhdueshme**, duke llogaritur 5,680 euro për çdo person që punonte në bujqësi në vitin 2020. **Bujqësia po humbet gradualisht fuqinë punëtore**, si pasojë e rritjes së nivelit të mekanizimit në sektor, që e bën të panevojshëm numrin e lartë të punëtorëve, veçanërisht në kushtet e fermave të specializuara. Siç tregohet në anketat e INSTAT-it (p.sh. anketa tremujore e forcës së punës të kryer nga INSTAT-i për

tremujorin e tretë 2020 krahasuar me tremujorin e tretë 2019), se norma vjetore e rritjes së punësimit në bujqësi ishte me minus -3.7 %, vlerë kjo më e ulët në krahasim me të gjithë sektorët e tjerë ekonomikë.

Niveli i mekanizimit ka pësuar një rritje të rëndësishme me 9,655 traktorë me rrota, 5,715 minitraktorë, 4,036 makina mbjellëse dhe 697 autokombajna⁹ ose një traktor për 122 ha tokë bujqësore dhe një autokombajnë për 431 ha kultura. Ka disa kufizime në përpjekjet për të rritur numrin e makinerive të reja: parcelat e fragmentuara dhe madhësitë e fermave të vogla. Sigurisht që, makineritë e reja sjellin sfida të reja, siç është nevoja për trajnime të specializuara dhe shërbime mekanike. Ndaj nevoja e trajnimit mbetet një prioritet i sektorit të bujqësisë.

Fermat familjare në zinxhirin e prodhimit të dhive-deleve janë pjesë e një zhvillimi pozitiv të rëndësishëm, që është bërë vitet e fundit, veçanërisht pas vendosjes së fokusit te thertoret e formalizuara dhe mbylljes së “pikave të therjes” të paligjshme. Sigurisht që theksi duhet të vihet në rritjen e aksesit të fermerëve në këto pika shërbimesh për të forcuar sigurinë ushqimore të produkteve.

Eksporti i kafshëve të gjalla është i mundur për disa vende të rajonit pjesë e iniciativës *Open Balkan*. Përmirësimi dhe zbatimi rigoroz i legjislacionit për ushqimin e kafshëve, gjurmueshmërinë e nënprodukteve të kafshëve (të mishit dhe qumështit) dhe në programet e kontrollit të sëmundjeve të kafshëve (plani i monitorimit të sëmundjeve të kafshëve dhe nënprodukteve/vlerësimi i rrezikut për fermat dhe operatorët e biznesit), do të zgjerojë tregun e eksportit të produkteve shtazore dhe të kafshëve të gjalla edhe në BE.

Sistemet e ujitjes Shqipëria është e pasur me burime ujore dhe sektori i bujqësisë është shumë i varur nga ujitja gjatë verës nga ujërat e lumenjve dhe Rezervuarët Ujorë Bujqësorë (RUB), pasi vetëm 20% e totalit të reshjeve bien gjatë verës. Niveli i investimeve në rrjetin e ujitjes dhe kullimit në vitet e fundit ka qenë në rritje të vazhdueshme, duke rritur nivelin e sipërfaqes të ujitshme në 70% të sipërfaqes totale potencialisht të ujitshme (ose rreth 360,000 ha). Rehabilitimi ka përfshirë

⁶ <https://ilostat.ilo.org/data/country-profiles/>

⁷ Skeda e të dhënave statistikore të tregtisë të produkteve bujqësore ushqimore, Komisioni Evropian - https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/food-farming-fisheries/farming/documents/agrifood-albania_en.pdf

⁸ MBZHR 2021: Draft IPARD III, maj 2021.

⁹ Libri Statistikor INSTAT, 2019.



rezervuarët, kanalet ujitës, strukturat e kontrollit të ujit, pompat etj. Sipërfaqja ujitëse ka nevojë për rehabilitime dhe për mirëmbajtje të vazhdueshme, të cilat financohen kryesisht nga qeveria qendrore dhe pjesërisht nga qeverisja vendore. Sipërfaqja **me infrastrukturë kulluese** është 280,000 ha, ku 205,000 ha kullohen nga rrjedha e gravitetit dhe 75,000 ha kullohen nga stacionet e pompimit.

Aksesi në huat për investime ose prodhim mbetet i kufizuar. Aktualisht ekzistojnë disa masa të qeverisë në bashkëpunim me bankat e nivelit të dytë dhe donatorët ndërkombëtarë (BERZH, KfW) si edhe nëpërmjet kredisë sovraane, të cilat synojnë rritjen e aksesit të fermerëve në kredi, si edhe uljen e kostove të kreditimit për sektorin.

Efikasiteti më i lartë në përdorimin e plehrave dhe të PMB-ve do të kërkojë jo vetëm makineri, por edhe analiza, testime të tokës dhe trajnimet përkatëse. MBZHR-ja ka miratuar aplikimin e librit të fermerit, i cili synon të evidentojë përdorimin e PMB-ve të në fermë me qëllim rritjen e efikasitetit të përdorimit të tyre dhe uljen e ndikimit të bujqësisë në mjedis.

Konkurrueshmëria ka të bëjë, gjithashtu, me ofrimin e produkteve me cilësi të lartë. Ekziston një procedurë e mirë organizuar për të kontrolluar materialin mbjellës në të gjithë fazat e tij. Në vitet e fundit janë bërë përpjekje të rëndësishme për të rritur kapacitetet e magazinimit (me pajisje seleksionimi dhe paketimi) dhe, veçanërisht, magazinat me ftohje (që mundësojnë eksportin me çmime më të larta në tregun e BE-së). Zonat kryesore të prodhimit janë pajisur me këto struktura. Qeveria shqiptare, parashikoi ndërtimin e platformave të tregtimit të produkteve bujqësore, të cilat synojnë jo vetëm tregtimin e produkteve bujqësore në kushte optimale, por në të njëjtën kohë të ulin nivelin e vartësisë të fermerëve nga tregtarët e shumicës apo grumbulluesit dhe të rrisin forcën e tyre në zinxhirin e vlerës.

Përmirësimi i pozicionit të fermerëve në zinxhirin e vlerës

Pavarësisht mbizotërimit të fermave bujqësore me madhësi të vogël, organizatat e prodhuesve nuk janë akoma të suksesshme në Shqipëri. Ndërkohë që vazhdon ende një ngurrim i qëndrueshëm e i fortë për shoqërizim, janë krijuar disa kooperativa të stimuluar nga disa projekte (me mbështetjen e donatorëve), por edhe nga interesi i tyre, dhe arritën që bashkërisht në mënyrë efektive të blinin

inputet ose të arrinin certifikimin e kërkuar për shitjen e produkteve të tyre te grumbulluesit.

Bashkëpunimi midis fermerëve është një prej instrumenteve më të rëndësishme për të rritur fuqinë e fermerëve në të gjitha fazat e prodhimit.

Fermerët shqiptarë kanë akoma pak fuqi negociuese. Çmimet e inputeve janë rrallë të negociueshme dhe, duke mos qenë pjesë e ndonjë organizate bujqësore, formimi i çmimeve është kryesisht atribut i grumbulluesve, shitësve me shumicë dhe i përpunuesve vendës. Marrëveshjet e zinxhirit të furnizimit ndërmjet blerësve dhe fermerëve/kontratave të furnizimit nënshkruhen rrallë.

Sektorët me orientim eksportin, si prodhimi i perimeve në serra, janë më të prirur për t'u ngritur/bashkuar në organizata prodhuese, ndërsa për sektorin e blegtorisë kjo mbetet sfida më e madhe.

Ndërsa kooperativat janë më të ndërlukuara për sa i përket menaxhimit të brendshëm (kjo kërkon një zotërim dhe përdorim të përbashkët të aseteve), grupet e prodhuesve me fokus në tregtimin e përbashkët të prodhimit (dhe blerjen e inputeve) janë më të zbatueshme dhe më të përshtatshme për fazën aktuale të bujqësisë shqiptare. Aktualisht, **po punohet për përafrimin e kuadrit ligjor drejt *acquis* të BE-së për Organizatat e Prodhuesve (OP) (grupet e prodhuesve) dhe Shoqatat e Grupeve të Prodhuesve (SHGP)**, si edhe masat mbështetëse adekuate në kuadër të IPARD-së.

Skemat e prodhimit bujqësor bazuar në **kontrata** përdoren më shpesh në prodhimin e frutave, perimeve dhe bulmetit, gjithashtu, edhe për fermerët më të vegjël, pasi ekziston një rrjet në rritje i qendrave të grumbullimit dhe të magazinimit. Meqenëse shumica e grumbulluesve janë të organizuar në bazë rajoni, ata mbajnë marrëdhënie kontraktuale me fermerët nga rajoni i tyre dhe mbështesin zinxhirët e shkurtër të furnizimit.

Zhvillimet në industrinë agroushqimore

Industria agroushqimore është një nga sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare, duke shfaqur një rritje vjetore të vlerës së prodhimit. **Vlera e prodhimit** u rrit me një ritëm më të lartë (më shumë se 2 herë) sesa numri i të punësuarve në periudhën midis viteve 2015 dhe 2020 (tabela 3-5), duke treguar një rritje të produktivitetit.



Tabela 3-5: Detaje mbi industrinë agroushqimore (2015–2020)

Emërtimi	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Ndryshimi 2015 – 2020 (%)
Numri ndërmarrjeve	2,354	2,428	2,541	2,414	2,476	2,459	4.46%
Numri i punonjësve	12,659	13,084	13,920	13,277	14,163	13,862	9.50%
Vlera e prodhimit (000/€)	459,480	489,582	514,544	534,290	569,328	558,384	21.63%
Investimet totale (000/€)	9,998	10,424	10,905	5,943	16,923	9,859	-1.39%

Burimi: MBZHR (2020)

Në vitin 2020, numri më i madh i ndërmarrjeve përpunuese ishte në sektorin e prodhimit të bukës (56.4%), atë të qumështit dhe produkteve të qumështit (12.2%) dhe të prodhimit të vajit vegjetal (7.8%). Ndërmarrjet agroushqimore janë të përqendruara kryesisht në Tiranë (31.4%), Fier (11.7%) dhe në Durrës (10.2%). Numri më i lartë i të punësuarve në industrinë agroushqimore ishte në Tiranë (36%), i ndjekur nga Durrësi (14%) dhe Elbasani (10%).

Rritja e vëllimit të prodhimit është kryesisht për shkak të mishit të ngrirë dhe të produkteve të mishit të ngrirë, prodhimit të miellit, bukës dhe makaronave, qumështit dhe produkteve të qumështit. Ndërsa vlera e prodhimit është rritur, kryesisht në sektorët e qumështit dhe e produkteve të qumështit, në sektorin e peshkut të konservuar (shih për më shumë detaje në kapitullin 3.2.2 mbi sektorin e peshkimit), në sektorin e ujit të ambalazhuar dhe të pijeve joalkoolike.

Pesha më e madhe e investimeve gjatë viteve 2015–2020 është regjistruar në prodhimin e miellit nga drithërat, në prodhimin e bukës, prodhimin e ujit të ambalazhuar dhe të pijeve joalkoolike, produkteve të peshkut të përpunuar, të qumështit dhe produkteve të qumështit.

Përqindja më e lartë e përfitimit ekonomik është nga eksporti në sektorin e BAM-së dhe të fruta-perimeve.

Siguria ushqimore në industrinë agroushqimore është një tregues i rëndësishëm i zhvillimit të sektorit dhe aftësisë së tij për të konkurruar ndërkombëtarisht. Kategorizimi që ekziston në sistemin e sigurisë ushqimore që menaxhohet nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) bazohet në kategoritë e produkteve dhe jo në ndërmarrjet e operatorëve të biznesit ushqimor (OBU). Po punohet për përcaktimin e kriterëve për kategorizimin e OBU-ve dhe në përcaktimin më të detajuar të kategorizimeve.

Kontrollet zyrtare të bazuara në rrezik dhe në marrjen e mostrave për ushqimin, ushqimin e kafshëve, mbrojtjen e bimëve dhe inputet bujqësore, zhvillohen në bazë të një plani kombëtar.

Linjat e përpunimit kanë kapacitete të mjaftueshme përpunuese dhe kërkojnë më shumë investime për rritjen e cilësisë së prodhimit dhe sigurimin e standardeve të sigurisë ushqimore.

Standardet e cilësisë dhe sigurisë, të tilla si Global G.A.P., Analiza e Rrezikut dhe Pikat Kritike të Kontrollit (HACCP) janë të zbatuara në të gjithë sektorin shqiptar agroushqimor, por ka nevojë për përmirësime në elemente të caktuara.

Emërtim Origjine i Mbrojtur (EOM) dhe Treguesit e Mbrojtur Gjeografikë (TMGJ), bujqësia organike dhe promovimi i standardeve të mirënjohura vendore (si p.sh. ato për produktet tradicionale) janë në fazat e para të aplikimit dhe kanë nevojë për t'u zhvilluar në të ardhmen.

Aktualisht, ka një numër në rritje të fermave të hortikulturës të certifikuara me standardin Global G.A.P., e cila është një avantazh tregu për të eksportuar në tregjet më atraktive të BE-së.

Konkurrueshmëria në nivel ndërkombëtar

Sektori bujqësor dhe ai agroushqimor ka rritur në mënyrë të vazhdueshme nivelin e eksporteve, duke stabilizuar importet. Tendencat për vitin 2021 theksojnë fenomenin/trendin e vitit 2020 dhe ul më shumë raportin eksport-import. Sektori i agropërpunimit ka akoma hapa të rëndësishëm për të ndërmarrë në rritjen e produktivitetit të tij, me objektivin për të ngushtuar apo përmbysur **trendin negativ të ekuilibrit të tregtisë**.¹⁰

10

<https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do#>



Tabela 3-4: Bilanci tregtar në bujqësi (2015–2020, Shqipëria me të gjitha vendet)

Ushqime, pije duhan (milion ALL)	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Eksport ushqime, pije duhan (milion lek)	21,066.3	25,347.0	30,080.5	32,333.6	35,374.3	39,050.1
Importe ushqime, pije duhan (milion lek)	96,896.6	100,364.9	106,737.8	106,507.7	110,365.2	110,926.7
Balanca tregtare (milion lek)	(75,830.3)	(75,017.9)	(76,657.3)	(74,174.1)	(74,990.9)	(71,876.5)

Burimi: Instituti i Statistikave (INSTAT)

3.2.1.3 Politika 1. Objektivi specifik 3: Përmirësimi i reagimit ndaj kërkesave të konsumatorëve për ushqim të sigurt, me vlera të larta ushqyese dhe të qëndrueshëm

Nga këndvështrimi i kërkesës së konsumatorit për kërkesat për përmirësimin e ushqimit dhe shëndetit, prodhimi i ushqimit të sigurt, me vlera ushqyese dhe të qëndrueshëm, reduktimi i mbetjeve ushqimore dhe mirëqenia e përmirësuar e kafshëve janë të nevojshme për të zbatuar standardet dhe objektivat e përcaktuar kombëtarë të bujqësisë, si edhe në Strategjinë e BE-së nga ferma në tavolinë, në lidhje me reduktimin e mbetjeve të azotit dhe të pesticideve dhe përdorimin e substancave antimikrobike në sektorin agroushqimor.

Mirëqenia dhe shëndeti i kafshëve

Programet e mirëqenies së kafshëve janë pjesë e programeve vjetore të kontrollit të shëndetit dhe të mirëqenies së kafshëve. Njëkohësisht, ato janë pjesë e kontrolleve nga drejtoritë rajonale të veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve, në përbërje të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve. Sipas këtyre programeve, kontrollet zyrtare kryhen në fermat e mbarështimit të blegtorisë nga veterinerë zyrtarë. Zbatim i standardeve të mirëqenies së kafshëve, është shoqëruar edhe me fuqizimin e organeve të kontrollit dhe të certifikimit (trupat teknikë) dhe ka pasur mbështetjen financiare për modernizimin e të gjitha hallkave.

Në vitin 2019, u zbatua një përditësim dhe regjistrim gjithëpërfshirës i **Regjistrimit të Kafshëve (sistemi RUDA)**. Sistemi RUDA është funksional dhe regjistron numrat e kafshëve, gjatë vitit 2021 janë kryer disa përditësime, me qëllim funksionalizimin e plotë dhe ofrimin e informacionit të saktë mbi gjendjen e blegtorisë, që do të jetë plotësisht funksional në mesin e vitit 2022. Numri i kafshëve u verifikua dhe u regjistrua në mbarë vendin me një inspektim kapilar “derë më derë” për çdo fermë. Ky certifikim është përfunduar në mars 2020. Që nga nëntori i vitit 2020, identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve është transferuar nga klinikat private në sistemin veterinar shtetëror, i cili është forcuar me rekrutimin e 300 veterinerëve zyrtarë.

Pavarësisht punës së kryer për forcimin e njohurive dhe ndërgjegjësimin e blegtorëve, më shumë duhet bërë për **promovimin e regjimeve të mira të mbarështimit të blegtorisë dhe të të ushqyerit**, të cilat mbështesin shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve dhe kontribuojnë në reduktimin e konsumit të preparateve antimikrobike.

Përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB)

Në Shqipëri, deri tani, të dhënat rreth përdorimit të PMB-ve kufizoheshin me disa të dhëna për importet dhe mungonin sasitë aktuale të përdorura nga fermerët. Kontrollet fokusoheshin kryesisht në importe dhe tregti se sa në mënyrën se si pesticidet dhe plehrat ruheshin dhe aplikoheshin në nivel ferme. Që prej prillit të vitit 2022, të dhënat në ferma (libri i fermerit) për llojin dhe sasinë e pesticideve të aplikuara në parcela do të regjistrohen nga ana e fermerëve dhe do të kontrollohen nga shërbimet e specializuara të kontrollit.

Inputet bujqësore që aktualisht janë të regjistruara janë plehrat organike, PMB-të, ilaçet veterinare, produktet e bujqësisë organike dhe biocidet (preparatet e luftimit biologjik të sëmundjeve).

Analiza mundësi – Kërcënime – Politika 1, objektivi i përgjithshëm 1



Tabela 3–5: Vështrim i përgjithshëm – Mundësitë dhe kërcënimet

MUNDËSITË	KËRCËNIMET
Preferenca e konsumatorit për produktet vendëse; Rritja e të ardhurave të konsumatorëve; Akses në tregun e CEFTA-s dhe BE-së dhe kërkesë e fortë për perime në serra dhe fruta; Projekte mbështetëse nga donatorët janë akoma konsistent; Turizëm në rritje me kërkesë të fortë për prodhimet vendëse.	Rritja e kostove të inputeve, duke përfshirë kostot për plehrat, PMB-të dhe naftën; Konkurrencë e fortë nga importet, veçanërisht për mishin e ngrirë, qumështin dhe produktet e shumëllojshëm e të përpunuar të mishit dhe djathit.

Identifikimi i ndërhyrjeve sipas nevojave për mbështetje në kuadër të politikës 1, Objektivit të përgjithshëm 1

1.1 Sigurimi i të ardhurave të qëndrueshme për fermerët dhe rezistenca ndaj presioneve të tregut

Duke pasur parasysh disavantazhet e ndryshme, me të cilat përballen fermerët në Shqipëri dhe konkurrencën e hapur me vendet e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) dhe me vendet e BE-së që kanë skema më të forta mbështetëse për fermerët, është e nevojshme që **fermerët të vazhdojnë të përfitojnë pagesa direkte për sipërfaqe të shfrytëzuar dhe për bagëti**, si shtesë e të ardhurave të tyre.

Duhet të merret parasysh edhe futja graduale e skemave të tjera të drejtpërdrejta që shtetet anëtare të BE-së i kanë në përdorim, të tilla si skemat specifike të mbështetjes për ullinjtë, frutat dhe perimet në kuadër të Organizimit të Tregut të Përbashkët (OTP) për të inkurajuar disa sektorë. Konvergjenca e mbështetjes direkte drejt nivelit të vendeve me të cilat Shqipëria ka një marrëveshje të tregtisë së lirë nuk duhet parë si një garë për subvencione më të larta, por si një mjet për të mbrojtur sektorin derisa të bëhet më konkurrues, duke zhvendosur në këtë mënyrë gradualisht më shumë buxhet për skemat e grandeve dhe lidhjen e pagesave direkte me kushtëzimet e standardeve mjedisore, të shëndetit njerëzve, të kafshëve dhe bimëve, si dhe të mirëqenies së kafshëve.

Tregjet e bagëtive, marketingu i drejtpërdrejtë dhe zinxhirët e shkurtër të furnizimit duhet të përdoren si mjete për t'u rezistuar presioneve të tregut dhe për këtë arsye ato duhet të mbështeten.

1.2 Rritja e madhësisë së fermës, konsolidimi i tokës dhe orientimi ndaj tregut i fermerëve të vegjël

Duhet të diskutohet dhe të shihet mundësia e adoptimit të një kuadri rregullator ligjor për **konsolidimin e tokës**, që synon të drejtat e parablerjes nga pronarët e tokave pranë tyre.

Gjithashtu, qëndrueshmëria e mbështetjes publike për fermerët varet shumë nga aftësia e fermave për t'i rezistuar vetë presioneve të tregut, gjë që është më e vështirë në rastin e madhësisë mesatare të vogël të fermave. Pavarësisht se pjesëmarrja në treg e bujqësisë së fermave të vogla në Shqipëri është në rritje, ajo mbetet e ulët në krahasim me Evropën, për shkak të konsumit të lartë vetjak (i cili është në raport të zhdrejtë me madhësinë e fermës). Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i forcave midis fermerëve, do të bëjë të mundur rritjen e fuqisë së tyre në tregje.

Mbështetja publike duhet të lidhet, gjithashtu, me objektivin e rritjes së madhësisë së fermave. Pagesat direkte duhet të jenë më të larta për fermat e mesme të qëndrueshme ekonomikisht, ndërsa në fund të mbështetjes duhet të vërtetohet rritja e madhësisë së fermës (qoftë rritje fizike ose ekonomike). Fermerët më të vegjël duhet të stimulohen që të shfrytëzojnë mundësinë e kultivimit të kulturave që nxjerrin të ardhura më të larta ose të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin. Të gjithë përfituesit e skemave të grandeve duhet të inkurajohen me një kontribut formal në treg të rritin nivelin e formalizimit të shitjes së prodhimit e të tregtimit të tyre.

1.3 Rritja e qëndrueshmërisë/elasticitetit (aftësisë për të reaguar) të fermave ndaj faktorëve klimatikë

Bujqësia është shumë e ekspozuar ndaj faktorëve klimatikë dhe paqëndrueshmërisë së tregut. Duhet të arrihet një **ulje e ndikimit ndaj sektorit bujqësor të faktorëve klimatikë** si thatësira dhe përmbytjet, veçanërisht për bujqësinë e produkteve me vlerë të lartë, duke siguruar në këtë mënyrë për



këto ferma një prodhimtari të lartë e të qëndrueshme nëpërmjet vazhdimet të investimeve në sistemin e ujitjes dhe të kullimit. Në të njëjtën kohë, rritja e elasticitetit të fermave ndaj faktorëve klimatik do të thotë gjithashtu edhe një **mbrojtje më e mirë e fermerëve ndaj rreziqeve në bujqësi** me anë të **skemave të sigurimit**, që mbulojnë një sërë fenomenesh të motit që dëmtojnë prodhimin.

1.4 Lehtësimi i aksesit në kapitalin financiar

Lehtësimi i aksesit në kredi: Sektori bankar duhet të zhvillojë produkte specifike për sektorin e bujqësisë. Nevoja për instrumente financiare në bujqësi është jashtëzakonisht e lartë dhe duhet të vazhdojë të përfshijë skemat e garancisë, si për akses më të mirë në kredi, ashtu edhe të portofolit të ndarjes së rrezikut të huave, të cilat reduktojnë nevojën për kolateral, por edhe normat e interesit.

Në rastin e fermerëve të rinj duhen menduar skema të veçanta mbështetëse për të shmangur barrën e financimit paraprak dhe atë të bashkëfinancimit të investimeve.

1.5 Tërheqja dhe mbështetja e fermerëve në moshë të re për të ngritur dhe për të zhvilluar biznese bujqësore.

Fermerët e rinj janë veçanërisht të rrezikuar nga papunësia dhe nga një perceptim mbi mungesën e jetës sociale në zonat rurale. Prandaj, ata janë veçanërisht të ekspozuar ndaj migrimit në qytete brenda vendit, por dhe jashtë vendit. Kjo nuk është një veçori shqiptare, por që haset gjerësisht. Fermerët e rinj kanë një interes më të madh në **adoptimin e teknologjive të reja dhe praktikave miqësore me mjedisin**. Rrjedhimisht, nevojitet inkurajimi i fermerëve të rinj edhe me mjete të tjera për të ngritur një biznes në bujqësi, përveç diferencimit me pikë në klasifikimin për grande. Kjo, për sa kohë që vetëm një numër shumë i kufizuar i të rinjve kanë aktualisht akses në grande ose janë në gjendje të përdorin grande si rrjedhojë e kushtit të financimit paraprak dhe vetëm pjesërisht të faturave (shpenzimeve) të rimbursueshme. Gjithashtu, është e nevojshme të ketë mbështetje plotësuese të të ardhurave për fermerët e rinj. Skema të veçanta të mbështetjes me pagesa paradhënie të bazuara në planet e dorëzuara të biznesit janë më të përshtatshme për fermerët e rinj. Duhet të mbahet në konsideratë mundësia e të rinjve të diplomuar nga universitetet bujqësore.

1.6 Nxitje e zgjerimit të sektorit bujqësor me vlerë më të lartë të shtuar dhe kërkesës së tregut

Stimulimi i sektorëve me vlerë të lartë të shtuar do të bëjë diferencën për t'i dhënë bujqësisë shqiptare një perspektivë të qartë ndaj tregut dhe për të reduktuar akoma më shumë deficitin e saj tregtar. Shqipëria ka mundësinë të përdorë potencialin e saj të lartë natyror (veçanërisht klimën e saj të ngrohtë), fuqinë punëtore ende me kosto të ulët dhe kanalet e konsoliduara të shpërndarjes shoqëruar edhe me kërkesën e lartë të tregut për perime dhe fruta, rrush dhe verëra si dhe bimë aromatike dhe mjekësore (BAM). **Zgjerimi i serrave dhe plantacioneve të reja intensive të pemishteve dhe vreshtave janë pjesë e zgjidhjes.** Realizimi i ambicieve më të larta mjedisore dhe klimatike nëpërmjet përdorimit të energjisë së rinovueshme dhe aplikimit të praktikave dhe teknikave të prodhimit që përdorin në mënyrë eficiente burime natyrore, dhe që janë miqësore me mjedisin dhe me klimën duhet të diferencohet në programet e financimit.

Sektori i mbarështimit të kafshëve është një sektor me vlerë të shtuar. Duhet të nxitet rritja e cilësisë së qumështit të furnizuar nga fermat për përpunim në njësitë e përpunimit. Për këtë arsye është një nevojë urgjente të rritet prodhimi blegtoral. Mekanizmat për pagesat direkte dhe për grandet duhet ta marrin parasysh këtë, ndërkohë që duhet të trajtojnë edhe sfidat e standardeve të kullotjes së qëndrueshme dhe të prodhimit të qëndrueshëm të foragjereve, të zbatimit të standardeve të shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve.

1.7 Konsolidimi i sistemit të ujitjes dhe të kullimit

Në kontekstin e rritjes së konkurrencës në tregje edhe të ndryshimeve klimatike, sistemi modern dhe eficient i ujitjes dhe kullimit është thelbësor. Strategjia Kombëtare e Ujitjes dhe Kullimit 2019–2031 dhe Plani i saj i Veprimtari do të zbatohen me qëllim rritjen e sipërfaqes të tokës bujqësore të ujitur në mënyrë efikase ndaj përdorimit të burimeve ujore ose duke rehabilituar sistemin në sipërfaqet e mbetura, ku aktualisht sistemi nuk është në përdorim. Krahës fuqizimit të rolit dhe të kapacitetit të bashkive, duhet



të inkurajohen dhe mbështeten edhe autoritetet vendore, sidomos në menaxhimin e infrastrukturës në nivel dytësor dhe terciar.

Në rast të grave, sistemet eficiente të ujitjes duhet të vazhdojnë të jenë të detyrueshme për investimet për sektorët e frutave dhe të perimeve.

1.8 Investime në mbështetje të përmirësimit të produktivitetit në punë, si p.sh. në mekanizim dhe në pajisje të reja.

Sektori i bujqësisë në Shqipëri nuk mund të mbështetet më gjatë në fuqinë punëtore me kosto të ulët si një premisë për zhvillimin e tij. Ekziston mundësia për të investuar në mekanizimin për rritjen e produktivitetit të fuqisë punëtore. Përmirësimi i produktivitetit të punës nevojitet edhe për sektorin e agropërpunimit.

1.9 Optimizimi i zinxhirëve të furnizimit në bujqësi

Në zinxhirin e furnizimit për shumicën e kulturave bujqësore duhet përmirësuar akoma më shumë kapaciteti i pamjaftueshëm i magazinimit dhe objektet dhe pajisjet (facilitetet) për periudhën e pas vjeljes. Skemat e grave me fondet kombëtare ose IPARD për fermerët duhet të synojnë facilitetet për magazinimin edhe në periudhën e pasvjeljes, si për fermerët ashtu edhe për përpunuesit, ndërsa grandet për industritë agroushqimore duhet të synojnë integrimin më të mirë me fermerët vendës, për të zhbllokuar potencialin e prodhimit vendës dhe për të mundësuar zinxhirë të shkurtër furnizimi. Skemat e mbështetjes duhet të kenë në konsideratë edhe platformat e bashkëpunimit të fermerëve, të administruara nga njësitë e qeverisjes vendore.

1.10 Inkurajimi i organizatave prodhuese

Bujqësia e Shqipërisë është shumë e varur nga inputet e importuara. Tregtarët janë krijuesit e tregut dhe vendosin çmimet. Organizatat e prodhuesve, siç janë grupet e prodhuesve, duhet të mbështeten me njohuri dhe financiarisht në ngritjen dhe funksionimin e tyre për të rritur fuqinë negociuese në blerjen dhe shitjen e përbashkët. Kooperativat kanë potencial për të inkurajuar fermerët për përdorimin e përbashkët të shoqërive të makinerive, depove dhe objekteve të nevojshme pas vjeljes. Tregjet në të cilat fermerët tregtojnë bashkë, është një tjetër rrugë që duhet të ndiqet.

1.11 Përafrimi gradual me standardet e BE-së në fushat e mjedisit, sigurisë ushqimore, shëndetit të bimëve dhe kafshëve dhe të mirëqenies së kafshëve

Sektori privat është në qendër të përpjekjeve për përafrimin me BE-në. Duhet të parashikohen periudha të përshtatshme në kohëzgjatje që nga momenti i miratimit të legjislacionit deri në hyrjen e tij në fuqi, si dhe alokimet e nevojshme financiare për të mbështetur sektorin privat në realizimin e investimeve. Fermerët dhe përpunuesit agroushqimor janë të detyruar të investojnë në objekte, pajisje dhe makineri që kërkojnë më tej kosto operative shtesë. Siguria e ushqimit dhe menaxhimi i mbetjeve janë çështje kyçe. Standardeve duhet t'u jepet prioritet si në investime edhe të mbështeten financiarisht me kuotë më të lartë të ndihmës financiare publike. Gjithashtu duhet të merren parasysh edhe mbështetja për fermat që angazhohen në aktivitete demonstrimi.

Objekti është përmirësimi i kushteve kornizë për t'u përgjigjur kërkesës së konsumatorëve për produkte agroushqimore, për të mbështetur aktorët e zinxhirit agroushqimor për të aksesuar prodhimin, tregun dhe informacionin mjedisor/klimatik, si dhe në shërbimet mbështetëse financiare, logjistike dhe teknike, të përputhura me nevojat dhe që janë të nevojshme për të hyrë në segmentet strategjike të tregut.

Menaxhimi kolektiv i plehut organik: Ndër masat e tjera në mbrojtje të mjedisit dhe të burimeve natyrore nga ndikimi i aktivitetit ekonomik bujqësor, është një pjesë e zgjidhjes për bujqësinë bazuar në ferma të vogla.

Mbajtja e të dhënave (regjistrave) mbi përdorimin e PMB-ve, produkteve plehëruese dhe PMV-ve, apo edhe e vaksinimeve dhe përdorimit të antibiotikëve në mjekimin e kafshëve në nivel ferme duhet të jetë një nga kushtet e përfitimit të pagesave direkte.

1.12 Skemat e cilësisë dhe marketingu i produkteve vendëse

Duke përfutur nga preferenca e konsumatorëve për produktet vendëse, certifikimi për skemat e cilësisë, si EOM dhe TMGJ do të mbështetet më tej, por së pari duhet të krijohet besimi i

konsumatorëve (verifikueshmëria, cilësia) në këto skema. Nevojitet një kornizë ligjore e përmirësuar dhe krijimi i strukturave të menaxhimit dhe kontrollit për njohjen e standardeve bazë të cilësisë për produktet EOM/TMGJ. Duhet të instalohet një sistem kontrolli i besueshëm, ndërsa në të njëjtën kohë, duhet të merret në konsideratë një fushatë informuese dhe promovimi i produkteve të regjistruara si EOM/TMGJ, duke rritur në këtë mënyrë besimin e konsumatorit. Informacioni për skemat e ndryshme të cilësisë duhet t'u komunikohet qartë konsumatorëve në mënyrë që të parandalohet konfuzioni dhe të dallohet qartë nga skemat e tjera të cilësisë për prodhuesit e vegjël të ushqimit (objektivi 3 – Marketing i drejtpërdrejtë). Promovimi i zinxhirëve të furnizimit të shkurtër do të stimulojë konsumin e produkteve vendëse me cilësi të lartë, ndërsa përfshirja nga operatorët turistikë në fushatat e tyre promovuese mund të rrisë sinergjinë midis EOM/TMGJ dhe turizmit.

1.13 Konsolidimi i mëtejshëm i shërbimeve këshillimore drejt sistemeve të njohurive dhe inovacionit bujqësor dhe transferimit të njohurive (për më shumë shih Objektivin ndërsektorial 1).

Shqipëria e ka mundësinë të shkojë përtej formatit klasik të trajnimit. Inovacioni është në qendër të ndryshimeve, drejt një bujqësie të modernizuar dhe sektorëve që kanë lidhje me të. Njohuritë e disponueshme të QTTB-ve, AREB-ve dhe universiteteve duhet të lidhen drejtpërdrejt me sistemin e këshillimit dhe t'u transferohen fermerëve. Ekstensionistët publikë nga Shërbimi Kombëtar i Ekstensionit Bujqësor (SHKEB) duhet të jenë më të lidhur me ofruesit e inovacionit dhe të njohurive.

Ndërtimi i një skeme kombëtare të trajnimit në bujqësi përbën një zhvillim të rëndësishëm për përmirësimin e shërbimit të këshillimit në bujqësi.

Krijimi i grupeve operationale që përfshijnë institutet kërkimore/universitetet/organizatat joqeveritare (OJQ), si dhe fermerët dhe përpunuesit, duhet të stimulojnë inovacionin me zbatueshmëri të drejtpërdrejtë në praktikë (jo vetëm teorikisht).

Organizatat e fermerëve duhet të inkurajohen që gradualisht të delegojnë kompetenca të caktuara tek organizatat prodhuese (kur ato kanë kapacitetin e nevojshëm) për të ofruar shërbime specifike, të tilla si menaxhimi i platformave digjitale *online* për ofrimin e shërbimeve të informacionit të tregut, këshilla për përdorimin e inputeve bujqësore, kontrollin zyrtar të prodhimit të qumështit etj.

Ndërsa inovacioni i bazuar në kërkime mund të jetë i vështirë për t'u stimuluar, transferimi i njohurive ekzistuese nga universitetet dhe institutet kërkimore drejt fermerëve duhet të mbetet një prioritet, pasi në nivel lokal mund të perceptohet si risi në krahasim me praktikën aktuale bujqësore. Forcimi i strukturave këshillimore lokale duhet të marrë në konsideratë parimet e Sistemit të Njohurive dhe të Inovacionit Bujqësor (SNJIB). Meqenëse do të fillojnë të zbatohen Kushtet e Mira Bujqësore dhe Mjedisore (KMBM) të thjeshtëzuara, SHKF-ja duhet të fokusohet edhe në kushtëzimet (*cross compliance*).

1.14 Forcimi i kapaciteteve institucionale të MBZHR-së dhe organeve të saj teknike

Nevojat e ndryshme për forcimin e kapaciteteve janë të lidhura drejtpërdrejt me **procesin e përafrimit me *acquis* të PPB-së të BE-së, përkatësisht me negocimin e kapitujve 11, 12 dhe 13.** Detajet janë përcaktuar në Objektivin ndërsektorial 2, kapitulli 3.5.1.

3.2.2 Politika 1. Objektivi i përgjithshëm 2: Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe i veprimeve lidhur me klimën

Sektori bujqësor, por edhe ai i pyjeve, vazhdojnë të përballen me sfida thelbësore për sa u përket mjedisit dhe klimës. Fermerët luajnë një rol kyç në trajtimin e ndryshimeve klimatike, mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e peizazheve, biodiversitetit dhe burimeve natyrore (toka, uji dhe ajri).

Reflektimi i ambicieve më të larta mjedisore dhe klimatike përputhet me angazhimet e Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor (Deklarata e Sofjes 11/2020) bazuar në Marrëveshjen e Gjellbër të BE-së (12/2019) për të arritur neutralitetin klimatik të kontinentit Evropian deri në vitin 2050, përdorimin e reduktuar dhe më shumë të efektshëm të plehrave dhe pesticideve dhe rritjen e sipërfaqeve bujqësore të përdorura në bujqësinë organike, që mund të sjellin përfitime për mjedisin, klimën dhe prodhimin e ushqimit të shëndetshëm.


Këta objektiva kërkojnë një kusht shtesë për pagesat e drejtpërdrejta, skemat pilot ekologjike, përmirësimin e SHKF-së, si dhe masat dhe investimet agromjedisore dhe klimatike. Përgatitja graduale

e sektorit bujqësor në Shqipëri për aplikimin e praktikave bujqësore mjedisore do të rrisë perspektivat e anëtarësimit dhe aksesin në fondet konsistente të BE-së për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit në respektim të parimeve të qëndrueshmërisë.

3.2.2.1 Politika 1. Objektivi specifik 4: Kontributi në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe në energjinë e rinovueshme

Sipas Profilit të Vendit të Rrezikuar nga Klima 2021¹¹, “tendencat e parashikuara tregojnë rritje të temperaturave, si dhe ndryshueshmëri të reshjeve”. Gjithashtu, “rritja e ngjarjeve ekstreme të motit ka gjasa të përbjëjë një kërcënim serioz për prodhimin bujqësor, furnizimin me ujë, sigurimin e ushqimit dhe rritjen ekonomike për shumicën e popullsisë rurale”. Rritja mesatare e temperaturave pritet të ndryshojë në bazë mujore nga 1°C deri në 2°C në fund të verës.

Figura 3–2: Ndryshimi i parashikuar i temperaturave mujore për Shqipërinë në vitin 2020–2039



Burimi: Portali i njohurive për ndryshimet klimatike¹².

Bazuar në dokumentin kombëtar të përcaktuar 2021–2030 (NDC), miratuar me VKM-n nr. 581ë, datë 6.10.2021, projeksionet për Shqipërinë tregojnë se temperaturat **mesatare vjetore do të rriten deri nga 1.3–2.2°C deri në vitin 2050**, dhe me 1.2–4.4°C deri në vitin 2100. Rritja e temperaturave në verë mund të jetë deri në 5.3°C deri në vitin 2100. Reshjet vjetore parashikohet të ulen me 8.5% deri në vitin 2050 dhe me 18.1% në vitin 2100.

Sipas organizatës që mbikëqyr të dhënat mbi klimën (*Climate WatchData*) (tabela 3-8: Emetimet e GS nga bujqësia në periudhën 2014–2018 (pa konsideruar emetimet nga përdorimi i tokës dhe ndryshimi i përdorimit të tokës) tendenca e Emetimeve të Gazrave Serrë (GS) nga sektori i bujqësisë shqiptare është në rënie. Në vitin 2018, **sektori i bujqësisë kontribuoi me 2,97 MtCO₂ emetime GS**, të cilat përfaqësonin **29,49% të totalit të emetimeve të vendit**.¹³

Tabela 3–6: Emetimet e GS nga bujqësia 2014–2018 (pa emetimet nga përdorimi i tokës dhe ndryshimi i përdorimit të tokës)

Viti	2014	2015	2016	2017	2018
Të gjitha GS-të me burime bujqësore (MtCO ₂ e)	3.13	3.19	3.21	3.13	2.97

Burimi: *Climate Watch Data*¹⁴

¹¹ <https://climateknowledgeportal.worldbank.org/sites/default/files/2021-06/15812-Albania%20Country%20Profile-WWB.pdf>

¹² <https://climateknowledgeportal.worldbank.org/country/albania/climate-data-projections>

¹³ <https://www.climatewatchdata.org/data-explorer/historical-emissions?historical-emissions-data-sources=cait&historical-emissions-gases=all-ghg&historical-emissions-regions=ALB&historical-emissions-sectors=&page=1>

¹⁴ https://www.climatewatchdata.org/countries/ALB?end_year=2018&start_year=1990#ghg-emissions



Shqipëria emeton 2.52 tonë të ekuivalentura të GS-së për 1000 ha, shifër kjo më e ulët se niveli i BE-së (2.83 GS tonë ekuivalent/1000 ha). Sasia më e madhe e emetimit rezulton nga fermentimi i ushqimeve në traktin tretës të kafshëve rripërtypëse¹⁵ dhe nga mospërpunimi i rregullt i jashtëqitjeve (mbetjeve) të tyre.

Potenciali për energji nga mbetjet e kafshëve, si dhe nga mbetjet bujqësore llogaritet në rreth 70 tonë naftë ekuivalent¹⁶. Megjithatë, përdorimi i biogazit (nga plehu) nuk është zhvilluar, pasi menaxhimi i plehut organik mungon pothuajse plotësisht (fabrikat e biogazit kërkojnë sasi të mëdha plehu organik të freskët, për të përfutur sa më shumë nga emetimet e CH₄ përgjatë procesit të mineralizimit, duke nënkuptuar flukse të qëndrueshme të grumbullimit të plehut organik dhe transportit). Ekziston një potencial i konsiderueshëm i biomasës nga mbetjet bujqësore, i cili vlerësohet rreth 2300 GWh/vit.¹⁷

Pyjet si kontribues në zbutjen e ndryshimeve klimatike

Pyjet janë një aset me efekt të lartë stabilizues për klimën dhe efektet e saj. Roli që burimet pyjore mund të luajnë në zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe kontributi në realizimin e objektivave të Marrëveshjes së Gjellbër varet nga mënyra se si pyjet menaxhohen. Ato rregullojnë ekosistemet, mbrojnë biodiversitetin, luajnë një rol integral në ciklin e karbonit, mbështesin të ardhurat e banorëve ruralë, duke ofruar mallra dhe shërbime, që mund të nxisin rritjen ekonomike të qëndrueshme.

Në Shqipëri, pyjet përfaqësojnë një nga burimet më kryesore natyrore të vendit. Sipas Inventarit Kombëtar të Pyjeve (2020), 41,6% e sipërfaqes totale (2,87 milionë ha) është e mbuluar nga pyje, ndërkohë që 17,6% janë livadhe dhe kullota dhe 24% tokë bujqësore. Në 20 vitet e fundit, rreth 100,000 ha pyll janë shkatërruar me pasoja të dukshme në rritjen e erozionit dhe rrëshqitjeve të dheut, humbja e habitatit për jetën e egër (shpendët dhe biodiversiteti). Pyjet e

mbrojtura përfaqësojnë 20% të sipërfaqes pyjore dhe shërbejnë kryesisht për mbrojtjen e tokës, ujërave, biodiversitetit dhe peizazhit; duke përfshirë parqet kombëtare, parqet natyrore dhe rezervat e natyrës, pyjet e destinuar për aktivitete të kohës së lirë, sporte, rekreacion, mësimdhënie ose kërkime shkencore.

Reforma e në sektorin pyjor, e vitit 2016, i përcakton bashkitë si pronarë të pyjeve dhe i kullotave që ndodhen brenda territoreve administrative të tyre. Aktualisht, 81% e sipërfaqes totale pyjore është në pronësi të bashkive, 16% në pronësi të shtetit dhe 3% është në pronësi private, kryesisht nga individë.

Pyjet në Shqipëri përfaqësojnë një potencial të madh në sekuestrimin e karbonit. Sipas Vlerësimit Global të Burimeve Pyjore të FAO-së, raporti për Shqipërinë 2015¹⁸ (këto janë të dhënat më të fundit të disponueshme), pyjet e Shqipërisë sekuestrojnë një total prej 142.2 milionë tonë karbon, duke përfshirë 49.3 milionë tonë karbon në biomasë të gjallë dhe 67.3 milionë tonë karbon në toka, me shtresë aktive deri në 30 cm thellësi. Zvogëlimi i emetimit aktual kërkon veprim të rëndësishëm afatshkurtër. Kjo përfshin vazhdimin e mbrojtjes së përmirësuar dhe të detyrueshme të pyjeve, menaxhimin më të qëndrueshëm të pyjeve, ripyllëzim të qëndrueshëm, si dhe menaxhim të përmirësuar të tokës, duke përfshirë restaurimin e ligatinave, tokave torfike dhe tokës së degraduar. Rritja e sekuestrimit të karbonit nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzimit të tokës shumë të degraduar do të çojë, gjithashtu, në rritjen e burimeve të jetesës dhe të ardhurave në zonat e varfra rurale, zvogëlimin e degradimit të tokës, përmirësimin e cilësisë së ujit dhe të ruajtjen e biodiversitetit, uljen e rreziqeve nga zjarret në pyje që rriten me ndryshimin e klimës. Masa për përmirësimin dhe shtimin e pyjeve do të jetë pjesë e skemave të financimit IPARD III, gjë e cila shihet si një mundësi për të rritur dhe përmirësuar rolin e pyjeve në sekuestrimin e karbonit.

Në nëntor 2020, Shqipëria nënshkroi Deklaratën e Sofjes për Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor (AGJBP), duke u përballur në këtë mënyrë me strategjinë e Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane drejt një ekonomie moderne, neutrale ndaj klimës, burimeve efikase dhe konkurruese. Ndër

¹⁵ Objektivi i Neutralitetit të Degradimit të Tokës për Shqipërinë dhe Normat dhe Standardet e Matjes së Erozionit të Tokës, Raporti Përfundimtar, 2019.

¹⁶ <https://cordis.europa.eu/article/id/124474-renewable-energy-potentials-of-albania>

¹⁷ Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Energjisë së Rinovueshme në Shqipëri, 2015–2020.

¹⁸ <http://www.fao.org/3/az146e/az146e.pdf>



veprimet e dakordësuara në zbatim të ligjit nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike” janë zbatimi i masave të parashikuara në Kontributin Kombëtar të Përcaktuar të Republikës së Shqipërisë 2021–2030, e cila synon një zbutje prej -20,9% të emetimeve të gazeve me efekt serrë deri në vitin 2030, dhe Planit të Klimës dhe Energjisë për Shqipërinë me një vizion për arritjen e neutralitetit klimatik deri në vitin 2050, **përmes zhvillimit dhe zbatimit të masave të qarta të hartuara për të reduktuar emetimet e gazeve serrë, duke integruar veprimet klimatike në të gjitha politikat përkatëse sektoriale.** Në këtë mënyrë, me nënshkrimin e AGJBP-së, Shqipëria shprehu interesin e saj për të ndjekur strategjinë e BE-së nga “ferma në tavolinë”, duke siguruar në këtë mënyrë që bujqësia, peshkimi dhe akuakultura mund të kontribuojnë siç duhet në synimet e *ligjit të BE-së për klimën*, me një këndvështrim të veçantë në përdorimin e pesticideve dhe antimikrobikëve, zvogëlimin e plehërimit të tepërt, rritjen e bujqësisë organike, përmirësimin e mirëqenies së kafshëve dhe mbrojtjen e biodiversitetit.

Bujqësia është veçanërisht e ekspozuar ndaj ndryshimeve klimatike. Zvogëlimi i reshjeve dhe rritja e temperaturave do të ndikojnë, si në sasinë ashtu edhe në cilësinë e ujërave të ëmbla. Kjo do të ndikojë në produktivitetin bujqësor dhe sigurimin e ushqimit të vendit, si dhe në jetesën rurale. Pavarësisht se niveli i reshjeve do të ulet në përgjithësi, shirat priten të jenë më intensive – **duke e bërë bujqësinë më të varur nga sistemet e ujitjes dhe kullimit.**

Bujqësia shqiptare po integron praktikat më të mira për ndryshimet klimatike. Megjithatë, racat lokale të bagëtive të imta, që përbëjnë mbi 90% të dhive dhe 33% të deleve¹⁹, janë përshtatur mirë dhe menaxhimi ekstensiv i tyre është një shprehje e përshtatjes/qëndrueshmërisë edhe ndaj ndryshimeve klimatike.

Pagesat direkte nuk janë të lidhura me asnjë kusht mjedisor. Ndërsa, IPARD III përfshin për herë të parë skemat për agromjedisin – prodhimin organik dhe masën për pyllëzim.

Zbutja e efektit të ndryshimeve klimatike aktualisht është një çështje me interes të

kufizuar për fermerët, për sa kohë marrin prodhime të larta në kushtet e pengesave në zinxhirët e vlerës dhe konkurrencës në treg, të cilat janë ende çështje kritike për fermerin shqiptar. Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike është, gjithashtu, në një nivel të pamjaftueshëm ndërgjegjësimi, pavarësisht se është i lidhur drejtpërdrejt me prodhimin në fermë (p.sh. shfrytëzimi sa më i mirë i sezonit të zgjatur të kultivimit për rreth 15 ditë shtesë²⁰, aplikimi i praktikave për ruajtjen më të mirë të ujit në tokë – çka përmirëson qëndrueshmërinë e fermës etj.).

3.2.2.2 Politika 1. Objektivi specifik 5: Nxitja e menaxhimit të qëndrueshëm dhe të efektshëm të burimeve natyrore

Erozioni mbetet një sfidë për t'u përballur, nisur edhe nga vështirësitë e terrenit të cilat e favorizojnë fenomenin. Shpatet e zhveshura janë veçanërisht të ekspozuara. Ujitja, gjithashtu, përshpejton erozionin, nëse uji përdoret në mënyrë joefikase. Përdorimi i ujit nëntokësor ka sjellë në disa raste kripëzimin të sipërfaqeve tokës.

Djegia e kashtës në ara e varfëron lëndën organike të tokës së punueshme dhe, përveç kësaj, nga zjarret rrezikohen pyjet, drurët frutorë dhe objekte të tjera publike dhe private.²¹

Për sa i përket **disponueshmërisë së ujërave**, Shqipëria konsiderohet relativisht e pasur me burime të ujërave të ëmbla me 7 lumenjtë kryesorë që rrjedhin në drejtim të lindjes. Vëllimi i përgjithshëm i prurjes së lumenjve është 39 miliardë m³/vit. Megjithatë, ekziston një mospërputhje e fortë ndërmjet periudhës së lagësht (tetor–maj, me 86% të prurjes vjetore të ujit)²² në krahasim me periudhën e thatë, duke e bërë bujqësinë të ndjeshme ndaj mungesës së ujit gjatë sezonit të rritjes.

Bujqësia është përdoruesi më i madh i ujit të ëmbël, duke zënë 40 deri në 60% të totalit²³, në varësi të variacionit vjetor të reshjeve dhe

²⁰ UNECE – Shqipëri, Rishikimi i Performancës Mjedisore, Rishikimi i Tretë, 2018 – https://unece.org/DAM/env/epr/epr_studies/ECE.CEP.183_Eng.pdf

²¹ MTE/UNDP/GEF (2019): Objektivi i Neutralitetit të Degradimit të Tokës për Shqipërinë dhe Normat dhe Standardet e Matjes së Erozionit të Tokës.

²² <https://www.climatechangepost.com/albania/fresh-water-resources/>

²³ <https://www.worldometers.info/water/albania-water/>

¹⁹ MBZHR (2021): Studimi i Sektorit të Qumështit; përgatitur nga AGT International/DSA, në kuadër të Projektit GIZ-SRD, maj 2021.



strukturës së kulturave bujqësore. Në total, janë 670 RUB, me një sipërfaqe totale të pasqyrës ujore prej rreth 6758 ha.

Direktiva e Nitrates nuk është transpozuar ende, kështu që ende nuk është detyrim që të zbatohen kushtet mjedisore për menaxhimin e plehut organik në ferma në kuadër të skemave të IPARD. Akoma nuk është i detyrueshëm Kodi i Praktikave të Mira Bujqësore për shmangien e ndotjes me nitrato të shkaktuar nga bujqësia. Po kështu, duhet të përmbushen detyrimet ndërkombëtare lidhur me nivelet e shkarkimeve nga aktivitetet ekonomike të sektorit, që i linden vendit tonë në zbatim të Konventës së Ajrit (CLRTAP), aderuar me ligjin nr. 9425, datë 6.10.2005, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e vitit 1979, ‘Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të madhe’” dhe protokolleve të saj.

Ndikimi i bujqësisë në ndotjen e ujërave nëntokësore ndodh për shkak të ruajtjes dhe përdorimit jo të duhur të **pesticideve**, gjë që duhet, gjithashtu, të përmirësohet, por edhe të shfrytëzimit më intensiv të **racave shumëproduktive të gjedheve të cilat zënë një pjesë të madhe të fermave të blegtorisë**. Rritja e prodhimit shoqërohet me rritjen e sasive të ushqimit dhe mbetjeve, e si rrjedhojë sasia e plehut organik dhe përmbajtja e tij me azot, si dhe përdorimi i barnave veterinarë është e mundshme që të rritet dhe del e nevojshme miradministrimi dhe mirëmenaxhimi i tyre.

Bujqësia organike është pjesë e Strategjisë së BE-së “Nga ferma në tavolinë” dhe konsiderohet si një sistem i rëndësishëm e i qëndrueshëm bujqësor, me një objektiv që të paktën 25% e tokës bujqësore të BE-së të jetë nën bujqësi organike deri në vitin 2030. Shqipëria ka **896.9 ha tokë bujqësi organike**, e cila është rreth 1.3% e sipërfaqes bujqësore.²⁴ Duke qenë se potenciali për eksport është i lartë dhe tregu i BE-së për produkte organike vazhdon të rritet, ndërkohë që edhe preferenca e konsumatorit vendës shfaq, gjithashtu, një tendencë pozitive²⁵. Pritet që sipërfaqja me bujqësi organike në Shqipëri të rritet, kjo edhe si

pasojë e vazhdimit të mbështetjes nga skemat kombëtare për fermat organike, por edhe e fillimit të zbatimit të masës agromjedisore-organike të programit IPARD III.

Masat dhe praktikat e burimeve natyrore të qëndrueshme dhe miqësore me klimën duhet të promovohen sistematikisht nga aktivitete të shtuara kërkimore, inovative dhe demonstrimi, që përfshijnë veprimet në kuadër të SNJIB-së.

3.2.2.3 Politika 1. Objektivi specifik 6: Mbrojtja e biodiversitetit, rritja e shërbimeve të ekosistemit dhe ruajtja e habitateve dhe peizazhit

Shqipëria ka një biodiversitet shumë të pasur dhe peizazhe të larmishme. Pjesa lindore e Shqipërisë i përket rajonit biogeografik alpin, ndërsa pjesa perëndimore i përket rajonit biogeografik mesdhetar.²⁶ Diversiteti i lartë i ekosistemeve dhe habitateve të tij (ekosistemet detare dhe bregdetare, ligatinat, deltat e lumenjve, dunat e rërës, liqenet, lumenjtë, shkurret mesdhetare, gjethegjerët, halorët dhe pyjet e përziera, kullotat alpine dhe subalpine dhe livadhet, dhe ekosistemet malore), biodiversiteti i florës dhe i faunës janë tipare të jashtëzakonshme në Evropë. Shqipëria është e mbuluar në një pjesë të madhe të saj nga pyje dhe kullota. Kullotat dhe livadhet kanë një sipërfaqe prej 478 081 ha, ekuivalente me 27,5% të fondit pyjor dhe kullor (INSTAT 2019).

Në zonat livadhore, kryesisht përdoren vetëm plehra natyrore, në kullota akoma kullotet në mënyrë ekstensive (dendësia e bagëtive e llogaritur në 1,36 NJGJ/ha) dhe datat e kositjes janë tradicionalisht jo në intervale të rregullta. Përveç tokave livadhore, ullishtat tradicionale me përdorim të ulët të plehrave kimike janë, gjithashtu, të rëndësishme për menaxhimin e peizazhit dhe për mbrojtjen e biodiversitetit.

Sfidat më të mëdha për ruajtjen e biodiversitetit në fushën e bujqësisë lidhen me dëmtimin e llojeve dhe fragmentimin e habitateve, si rrjedhojë e ndërtimit të rrugëve rurale, ndërtimin e hidrocentraleve të reja, veprimtarisë së peshkimit dhe rritjen ekonomike në përgjithësi.

²⁴ Sektori i prodhimit organik në ministri, të dhënat e vitit 2020.

²⁵ MBZHR (2021): Studimi i sektorit të frutave dhe perimeve; përgatitur nga *AGT International/DSA*, në kuadër të projektit GIZ-SRD, maj 2021.

²⁶ https://www.eea.europa.eu/data-and-maps/figures/biogeographical-regions-in-europe-2/map_2-1_biogeographical-regions/image_large



Si vend kandidat për në BE, Shqipëria po punon dhe është në një fazë të avancuar për përafrimin e legjislacionit të saj me direktivat e BE-së për shpendët dhe habitatet. Strategjia e BE-së për biodiversitetin përfshin angazhime dhe veprime shtesë që duhen përmblusur deri në vitin 2030. Kjo përfshin edhe krijimin e një rrjeti më të madh zonash të mbrojtura, çka përbën sfidë të madhe për strukturën institucionale dhe administrative, si dhe zbatimin e këtij legjislacioni. **Gjithashtu, Shqipëria angazhohet në kuadër të AGJBP-së për të rritur kapacitetin administrativ për zbatimin e angazhimeve mjedisore kombëtare dhe rajonale për të monitoruar, promovuar dhe zbatuar përputhshmërinë me prioritetet e BE-së për biodiversitetin.**

Zonat malore janë përcaktuar në vitin 2011 dhe lista është miratuar me udhëzimin nr. 3 të datës 10.02.2011, të MBZHR-së. Për shkak të abandonimit (moskultivimit) të tokave bujqësore në zonat malore, programi IPARD III parashikon

për këto zona pikë shtesë në sistemin e përzgjedhjes dhe një shkallë më të lartë të intensitetit të mbështetjes publike, që është një qasje konstruktive. Në rast se këto veprime mund të rezultojnë të jenë jo mjaftueshëm tërheqëse, do të merren parasysh ndërhyrje të tjera mbështetëse.

Pyllëzimi është një masë shumë efektive për sekuestrimin e karbonit dhe për kontrollin e erozionit të tokës, por **pyllëzimi i kullotave nuk duhet të lejohet**, pasi mund të çojë në humbjen e biodiversitetit të vlefshëm të kullotave.

Duhet të shtohen veprimet për të mbyllur boshllëqet e treguesve bazë që mungojnë, të tilla si sasia e produkteve kimike sintetike të përdorura (pesticidet, ilaçet veterinarë dhe plehrat), indeksi i shpendëve të tokës bujqësore, zonat bujqësore me VLN, balanca bruto e lëndëve ushqyese dhe nitratat në ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore.

Politika 1 – Objektivi i përgjithshëm 2

Tabela 3–7: Mundësi – Kërcënime – Objektivi i përgjithshëm 2

MUNDËSITË	KËRCËNIMET
Një ligj i ri (i parashikuar) për lëndët djegëse mund të inkurajojë prodhimin e kulturave energjetike, në rast të vendosjes së niveleve minimale të biokarburanteve nga biomasa; Përpjekjet për vendosjen e objektivave (neutralitetin e degradimit të tokës – LDN), në përputhje me udhëzuesit ndërkombëtarë (p.sh., OZHQ-të dhe Konventat e Rios); Kërkesa e lartë për eksport për produkte organike.	Rritja e emetimeve të GS-së dhe amoniakut, në rast të zhvillimit të sektorit të blegtorisë pa adoptuar praktika të mira mjedisore; Fenomeni i ndryshimit të klimës; Intensifikimi i bujqësisë në tokat e zonave të ulëta çon në humbje të biodiversitetit dhe ndotje të ujit, për shkak të përdorimit të pesticideve, plehrave dhe ilaçeve veterinarë/antimikrobiale; Aktivitetet e zhvillimit të hidrocentraleve dhe minierave në ndryshimin e përdorimit të tokës në zonat pyjore;

Identifikimi i ndërhyrjeve sipas nevojave në kuadër të politikës 1, objektivit të përgjithshëm 2

2.1 Promovimi i veprimeve për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike

Kontributi në zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike nëpërmjet masave të sekuestrimit të karbonit mund të mbështetet nëpërmjet masave të pyllëzimit, ndërsa në të njëjtën kohë duke trajtuar edhe problemin e erozionit të tokës edhe nëpërmjet ruajtjes së shfrytëzimit ekstensiv të kullotave, të mirënjohura si një thithës i rëndësishëm karboni dhe për rolin në reduktimin e emetimeve të amoniakut. Sekuestrimi i karbonit në tokë mund të intensifikohet duke futur praktika bujqësore konservimi (pa plugim dhe punim të

reduktuar të tokës) dhe mbulim të tokës me kultura mbuluese, me pemë, elemente peizazhi dhe duke ndaluar djegjen e kashtës.

Prodhimi i kulturave energjetike mund të jetë, gjithashtu, një opsion, dhe nëse tregu do ta kërkojë, do të hartohet legjislacioni kombëtar për biokarburantet. Përdorimi i biomasës për prodhimin e energjisë do të varet, gjithashtu, shumë nga disponueshmëria e granteve për investime të tilla.

Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike përfshin ruajtjen e racave lokale dhe varieteteve të bimëve lokale për të siguruar një sistem bujqësor të qëndrueshëm ndaj presionit të faktorëve klimatik, si dhe promovimi i kulturave të përshtatura nëpërmjet mbështetjes ose instituteve/qendrave



kërkimore. Fermerët duhet të inkurajohen të diversifikojnë fermën, të përdorin lloje dhe varietete të reja të pemëve frutore rezistente ndaj thatësirës, ngricave dhe insekteve dhe sëmundjeve të reja që po shfaqen. Mbrojtja nga breshri/rrjetat kundër breshrit janë një investim që duhet të merret parasysh në zonat me dominim të sipërfaqeve me pemishte dhe perime.

Mjete të tjera shumë të rëndësishme në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike janë vazhdimi i rehabilitimit dhe i modernizimit të sistemit të ujitjes dhe kullimit, menaxhimi i rrezikut nëpërmjet skemave të sigurimit dhe promovimi i praktikave më të mira, si përdorimi i kulturave mbuluese, pa plugim ose punim minimal, diversifikimi dhe qarkullimi i kulturave etj.

2.2 Ruajtja e biodiversitetit të lartë të lidhur me livadhet dhe kullotat e shfrytëzuara në mënyrë ekstensive dhe me ullishtat tradicionale

Tradita e gjatë në menaxhimin e kullotave përmes **kullotjes ekstensive dhe pa përdorimin e inputeve kimike ka çuar në një biodiversitet të lartë të kullotave**. Aktualisht, kullotja e deleve nuk është shumë tërheqëse për brezin e ri. Megjithatë, kullotat me biodiversitet të lartë rrezikojnë të dominohen nga speciet pushtuese dhe peizazhi mund të ndryshojë. Ullishtat tradicionale, pa ose me inpute të kufizuara kimike dhe të shoqëruara me livadhet konsiderohen me vlerë të lartë natyrore, por rrezikohen të zëvendësohen nga varietete më intensive të ullit.

2.3 Mirëmbajtja e burimeve gjenetike në bujqësi dhe blegtori

Si shembull për të ilustruar rëndësinë e mirëmbajtjes së burimeve gjenetike shërben rasti i racave vendëse të bagëtive të imta. 90% e popullatës së dhive dhe 40% e popullatës së deleve janë raca vendëse, të cilat janë përshtatur shumë mirë me kushtet klimatike lokale. Pragu relativisht i lartë i tufës për qëndrueshmërinë ekonomike (120–130 dele ose dhi), hezitimi i brezit të ri për kullotjen tradicionale të bagëtive të imëta kanë çuar në ulje të ripërtypësve të vegjël me më shumë se 8% midis vitit 2015 dhe vitit 2019. Prandaj, mirëmbajtja e tyre është e rëndësishme nga perspektiva ekonomike, sociale, kulturore dhe mjedisore, duke siguruar qëndrueshmëri të bujqësisë tradicionale në zona të largëta.

2.4 Inkurajimi i bujqësisë organike

Shqipëria ka një mundësi të artë për të zhvilluar bujqësinë organike, në harmoni me objektivin e Strategjisë së BE-së “Nga ferma në tavolinë”, për të arritur që bujqësia organike të zërë 25% e tokës bujqësore deri në vitin 2030, po ashtu me shtyllën IV të Deklaratës së Sofjes për Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor: *“Promovimi i bujqësisë miqësore me mjedisin dhe organike dhe reduktimi i produkteve kimike sintetike të përdorura në prodhimin e ushqimit: pesticidet, ilaçet veterinarë dhe pleprat”*. Përveç kësaj, kërkesa në rritje e tregut për produkte organike është një potencial dhe mundësi reale që duhet të shfrytëzohet.

2.5 Përafrimi gradual me standardet e BE-së dhe promovimi i praktikave të mira për mirëmbajtjen e burimeve natyrore, si ajri, toka dhe uji (shih, gjithashtu, objektivin ndërsektorial 1).

Aktualisht, praktikatat e mira bujqësore promovohen sistematikisht në Shqipëri. Ato do të zbatohen nëpërmjet hartimit dhe futjes në zbatim të **Kushteve të Mira Bujqësore dhe Mjedisore (KMBM)** të thjeshtuara, përveç standardeve minimale ligjore dhe të cilat do të jenë të detyrueshme për përfituesit e mbështetjes së të ardhurave dhe pagesave kompensuese. Kuadri i standardeve të KMBM-ve synon të kontribuojë në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, në mbrojtjen e ujit, tokës dhe biodiversitetit.

Ujita e papërshtatshme mund të shkaktojë erozion të tokës dhe, gjithashtu, mund të krijojë toka të kripura (në rast se përdoret ujë nëntokësor i kripur).

Masa e agropylltarisë do të ishte një nga mjetet më të efektshme për të trajtuar fenomenin intensiv të erozionit, veçanërisht në tokat e braktisura bujqësore, shpatet e zhveshura etj.

2.6 Forcimi i ndërgjegjësimit publik, i njohurive dhe i aftësive të administratës, dhe i strukturave këshilluese, por dhe i fermerëve mbi standardet e BE-së në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike

Është shumë e nevojshme rritja e ndërgjegjësimit publik, e njohurive dhe aftësive të administratës, strukturave të ekstensionit në sektorin e bujqësisë, si edhe e fermerëve mbi standardet e BE-së, në lidhje me mbrojtjen e



mjedisit dhe me masat zbutëse dhe përshtatëse ndaj ndryshimeve klimatike. Përveç avantazheve të drejtpërdrejta, MBZHR-ja ka një objektiv strategjik në sigurimin e aksesit në fondet e BE-së për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Ndërkohë që vendi po përshtatet me kërkesat bazë të *acquis* të PPB-së, BE-ja po shkon drejt një politike ambicioze të gjelbër në të gjithë sektorët, e cila është, gjithashtu, mjaft sfiduese për vendet anëtare të BE-së.

2.7 Konsolidimi i Shërbimit Këshillimor për Fermat (SHKF) (shih, gjithashtu, objektivin ndërsektorial 2)

Në këtë aspekt kërkohen kompetenca të përmirësuara të këshilluesve (publikë dhe privatë) dhe një strukturë e përshtatshme për transferimin e informacionit, e këshillimit dhe të trajnimit me fokus në kushtet mjedisore që janë pjesë e PPB-së të BE-së.

Rrjetet e transferimit të njohurive për praktikatat e mira bujqësore dhe mjedisore shihen si jashtëzakonisht të rëndësishme. Prodhimi i materialeve trajnuese për zbutjen e efekteve dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe për mbrojtjen e peizazhit, tokës, ujit dhe biodiversitetit, kërkon përfshirjen e instituteve kërkimore, universiteteve, OJF-ve mjedisore dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile, ndërsa ofrimi i trajnimeve që përfshijnë organizatat e fermerëve në demonstrimet në praktike është ideale për qëndrueshmërinë e rrjeteve. Është e domosdoshme që SHKF-ja të fokusohet qartësisht në kushtëzimet (*cross-compliance*).

2.8 Sigurimi i treguesve bazë bujqësorë të lidhur me mjedisin

Treguesit bazë janë gur themeli për përgatitjen e politikës dhe vlerësimin e ndikimit të saj. Në Shqipëri po llogariten pjesa më e madhe e treguesve bazë. Përdorimi i pesticideve dhe i ilaçeve veterinarë, zonat bujqësore me vlerë të lartë natyrore, cilësia e ujit dhe erozioni i tokës nga uji janë tregues të rëndësishëm, pjesë e treguesve bazë që duhet të vihen në dispozicion për përafrimin me *acquis* të BE-së, si dhe në vendimmarrjen për politikatat e bazuara në të dhëna dhe fakte.

2.9 Përmirësimi i kapaciteteve pyjore për zbatimin e standardeve mjedisore

Sektori i pyjeve kontribuon në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, siç është roli i tij në mbrojtjen e burimeve ujore dhe shërbimet mjedisore. Skema e certifikimit që siguron

menaxhimin e duhur të burimeve pyjore janë instrumente të cilat do të integrohen. Kjo kërkon mbështetje nëpërmjet ndihmës direkte financiare dhe vendosjes së standardeve për përfshirjen e produkteve të drurit në ndërtimet e gjelbra. Qëllimi është adresimi i sfidave të ndryshimeve klimatike, të integritetit të energjisë së rinovueshme dhe të ruajtjes së biodiversitetit. Kjo përfshin masa për të mbështetur planifikimin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve, krijimin e koncepteve dhe sistemeve të menaxhimit të zjarrit që do të realizohen nëpërmjet programit IPARD.

2.10 Rritja e sekuestrimit të karbonit nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzimit të tokave shumë të degraduara

Sektori i pylltarisë lëshon gazra serrë dhe thith CO₂ në tokën dhe biomasën e tij. Nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzimit të tokave pyjore të degraduara, mund të rritet sekuestrimi i karbonit. Pyllëzimi mund të synojë tokat me erozion.

3.2.3 Politika 1. Objektiv i përgjithshëm 3: Forcimi i strukturës sociale-ekonomike të zonave rurale

Zonat rurale në Shqipëri kanë një rol kyç pasi ato janë vendi i punës dhe jetesës së fermerëve, sipërmarrësve dhe konsumatorëve dhe përfshijnë pjesë të mëdha të burimeve natyrore dhe ekosistemeve. Zhblllokimi i potencialit në këtë drejtim nënkupton mbështetjen e një cikli, në të cilin mundësitë e reja ekonomike krijojnë shtysa pozitive për të reduktuar varfërinë, migrimin dhe papunësinë dhe për të përmirësuar aksesin në shërbime. Qëllimi është të krijohen perspektiva pozitive, duke përfshirë zonat dhe grupet sociale më të cënueshme, në mënyrë që qytetarët të përfitojnë nga zonat tërheqëse rurale, si vende për të jetuar dhe për të bërë biznes, si dhe për pushim/çlodhje dhe turizëm.

Politika e zhvillimit rural luan një rol jetik në Shqipëri për të mbajtur njerëzit në zonat rurale dhe për të adresuar sfida të tjera sociale që kërkojnë kushte favorizuese, të tilla si aspektet gjinore, aksesin në mundësi biznesi, organizata të forta lokale, shërbime dhe infrastrukturë bazë, arsimim digjital, njohuri dhe inovacion.

Objektivi është në përputhje me vizionin afatgjatë të BE-së 2040 për zona rurale dhe komuniteteve rurale më të forta, ekonomikisht të qëndrueshme dhe me prosperitet.



3.2.3.1 Politika 1. Objektivi specifik 7: Forcimi i punësimit rural dhe i zhvillimit të biznesit

Cilësia e jetës në zonat rurale

Zonat rurale të Shqipërisë karakterizohen nga një **ristrukturim gradual ekonomik dhe nga ndryshime të shpejta demografike**. Përqindja e popullsisë rurale ka rënë vazhdimisht nga 42,57% në vitin 2015 në 38,89% në vitin 2019, e shkaktuar nga migrimi jashtë vendit dhe nga nivelet përgjithësisht më të ulëta të lindjeve. Emigrantët brenda vendit përthithen kryesisht nga zonat urbane, pasi shkalla e urbanizimit po rritet pavarësisht nga një rënie e përgjithshme e popullsisë. Parashikimet tregojnë se popullsia shqiptare do të ulët me 100,000 njerëz në rreth 2.75 milionë në vitin 2031 krahasuar me vitin 2020.

Të dhëna të specifikuar për **nivelin e varfërisë** në zonat urbane dhe rurale aktualisht nuk janë në dispozicion. Treguesit e zhvillimit (p.sh., aksesit në infrastrukturë dhe shërbime, tregu i punës, mjedisi i biznesit) sugjerojnë **se situata e privimit të banorëve është më e pasigurt në zonat rurale**.

Të dhënat e specifikuar të fuqisë punëtore, papunësisë dhe pagave në zonat urbane dhe rurale nuk janë të disponueshme. **Shkalla zyrtare e papunësisë** në zonat rurale konsiderohet më e ulët se në zonat urbane²⁷. Shkalla e papunësisë së të rinjve (grup-mosha 15–24 vjeç) ishte 27.2% në vitin 2019. Në vitin 2020, paga mesatare mujore bruto ishte 52,380 lekë, ndërsa në bujqësi, pyje dhe peshkim ishte 33.359 lekë.

Përmirësimi i infrastrukturës rurale dhe i shërbimeve bazë kontribuojnë në mbylljen e hendekut midis popullsisë rurale dhe urbane dhe i bëjnë zonat rurale më tërheqëse dhe ekonomikisht të qëndrueshme edhe për brezat e rinj. Struktura e të dhënave, si dhe të dhëna të ndara për infrastrukturën urbane dhe atë rurale, si edhe për shërbimet bazë do të duhet të përmirësohen. Në vitin 2019, 100% e familjeve ishin të lidhura me **energjinë elektrike**, 91.2% e popullsisë kishin **furnizim me ujë të pijshëm** në shtëpitë e tyre. Në vitin 2017, 39,9% e popullsisë kishin në përdorim një sistem sanitar “të menaxhuar në mënyrë të sigurt”, një strukturë bazë që asgjëson në mënyrë të

sigurt mbetet njerëzore. Sistemi **shëndetësor** në Shqipëri është kryesisht publik, megjithëse kujdesi shëndetësor privat është bërë gjithnjë e më popullor, veçanërisht në zonat kryesore urbane. Bazuar në të dhënat më të fundit të publikuara nga INSTAT-i, shërbimet e grumbullimit të mbetjeve janë përmirësuar ndjeshëm në shumë bashki: rreth 87% e popullsisë së Shqipërisë ka përfituar nga shërbimet e grumbullimit të mbetjeve në vitin 2020, një rritje prej 26% krahasuar me vitin 2017.

Rreth gjysma e **rrethit rrugor rajonal dhe lokal** (11,000 km rrugë rajonale, lokale dhe urbane nga gjithsej 15,000 km) është në **gjendje të mirë ose shumë të mirë**, duke mundësuar aksesin në shërbimet kryesore publike dhe qendrat ekonomike dhe ofron mundësi për t'i shërbyer industrisë së turizmit në zhvillim. Duke pasur në konsideratë se në Shqipëri industria agroushqimore është përgjegjëse (në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe indirekte) për pothuajse gjysmën e vendeve të punës në të gjithë ekonominë, përmirësimi i aksesit në treg nëpërmjet një lidhjeje më të mirë rrugore është kritike për zhvillimin e vendit.

Infrastruktura e ndërlidhjes digjitale në zonat rurale përmirëson performancën ekonomike dhe cilësinë e jetës përmes përmirësimit të aksesit në njohuri, tregje, shërbime sociale dhe kulturore, teknologji dhe infrastrukturë që zakonisht janë të aksesueshme vetëm për banorët urbanë (“Koncepti i fshatit të zgjuar” i BE-së). **Një mbulim i madh i internetit me brez të gjerë** dhe akses të përmirësuar në internet janë thelbësore për të mundësuar një tranzicion digjital në ekonominë shqiptare dhe për të përmirësuar përfshirjen sociale të popullsisë dhe komuniteteve rurale. **Strategjia e BE-së për Konektivitetin për një Shoqëri Evropiane Gigabit 2030** përcakton objektivin që çdo familje evropiane të ketë akses në internet me shpejtësi të lartë deri në vitin 2025 dhe në lidhjen gigabit deri në vitin 2030.

Infrastruktura financiare në zonat rurale është në zhvillim. Pavarësisht se në Shqipëri operojnë 16 banka tregtare dhe më shumë se njëqind institucione të tjera financiare, ato janë më pak të pranishme në zonat rurale dhe të thella. Sondazhet tregojnë se vetëm 10% e banorëve ruralë janë të prirur të përdorin shërbimet bankare

²⁷ OUB (2020) Fermat me pronarë të vegjël dhe familjare, shih: <http://www.OUB.org/3/ca7450en/CA7450EN.pdf>



dhe pjesa e përgjithshme e kredisë për bujqësinë në të gjithë huadhënien është afërsisht 1,7–1,9%²⁸.

Diversifikimi i të ardhurave nga ferma dhe zhvillimi i biznesit rural

Krijimi i biznesit rural, modernizimi dhe diversifikimi i të ardhurave nga ferma sjellin aktivitet ekonomik në zonat rurale, edhe jashtë sektorit bujqësor. Kjo është thelbësore nga këndvështrimi i rritjes së përqindjes së fermerëve që punojnë në fermë me kohë të pjesshme, si edhe i ndryshimit strukturor në sektorin e bujqësisë, i cili pritet të rritet në vitet e ardhshme.

Nuk ka të dhëna të specifike për zonat urbane/rurale për llojet e aktiviteteve ekonomike jashtë sektorit primar. **Zhvillimi ekonomik në zonat rurale** karakterizohet akoma nga një varësi e lartë në bujqësi. Megjithatë sektori i bujqësisë po përjeton rritje të qëndrueshme, me KPPM-në vjetore prej rreth 53.7 milionë eurosh dhe një vlerë vjetore produktiviteti (VSHB për njësi pune në bujqësi) prej 5,680 euro (në vitin 2020), produktiviteti bujqësor duhet të përmirësohet, jo vetëm në krahasim me BE-në 27, por edhe krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.²⁹

Më shumë se **rreth 95% janë ferma familjare**, shpesh të angazhuara në prodhime për familjen, për shkak të madhësisë të vogël dhe parcelizimit të madh të tyre. Si rrjedhojë edhe aksesit në treg është ende i ulët me rreth 15% të produkteve të shitura për shkak të sasive të tyre të vogla, mungesës së lidhjeve në zinxhirët e vlerës dhe aksesit të ulët në mjetet mekanike³⁰ (shih, gjithashtu, Objektivi i përgjithshëm 1).

Sistemet lokale ushqimore dhe zinxhirët e shkurtër të furnizimit, që lidhin fermerët dhe prodhuesit e vegjël artizanale të ushqimit në zonat rurale me konsumatorët nëpërmjet marketingut të drejtpërdrejtë, duhet të zhvillohen akoma për të

arritur një gamë të gjerë përfitimesh ekonomike, sociale dhe mjedisore, e cila mund të jetë, gjithashtu, tërheqëse për fermerët e rinj, të rinjtë dhe gratë rurale.³¹ Zinxhirët e shkurtër të furnizimit janë më të dobishëm nëse rrisin vlerën e shtuar rajonale duke kontribuar në stimulimin e cikleve të zhvillimit ekonomik lokal nëpërmjet lidhjes së bujqësisë me sektorë të tjerë, p.sh. agroturizmin dhe turizmin rural, zhvillimin e tregjeve lokale dhe panairët lokale, dhe duke e integruar atë në iniciativë të zhvillimit lokal.

Ligji kombëtar i ushqimit nr. 9863/2008, i ndryshuar, neni 26(7), ofron terren për **fleksibilitet nga zbatimi i sistemit të vetëkontrollit (ARPKK)** për fermerët dhe prodhuesit vendës të produkteve ushqimore tradicionale në sasi të vogla, në përputhje me nivelet e pranueshme higjienike të përcaktuara në nivel kombëtar, sipas praktikave të mira të prodhimit dhe nga ana tjetër, diversiteti i produkteve nga operatorët e vegjël ushqimorë duhet të zhvillohet akoma më shumë që të përmbushë preferencat e shumta të konsumatorëve dhe mundësinë e marketingut për të lidhur më mirë marketingun e drejtpërdrejtë në fermë me zhvillimin e agroturizmit.

Marketingu i drejtpërdrejtë nga fermeri te konsumatori ofron një strategji alternative marketingu për fermerët, duke siguruar të ardhurat e tyre, duke përmbushur, gjithashtu, kërkesën në rritje të konsumatorëve për ushqim lokal. Fermerët shqiptarë janë mësuar t'i shesin herë pas here produktet e tyre direkt te klienti fundor, por kryesisht në mënyrë informale. Një nga arsyt kryesore që ky treg nuk është i zhvilluar sa duhet është mungesa e njohurive, që lidhen me krijimin e biznesit të marketingut të drejtpërdrejtë. Kjo së bashku me frikën e barrierave të rënda administrative janë ndër arsyt kryesore për zhvillimin e një ekonomie gri në sektorin bujqësor/zinxhirin ushqimor, pasi shumica e fermerëve nuk i regjistrojnë aktivitetet e tyre të marketingut të drejtpërdrejtë, por kufizojnë në këtë mënyrë, gjithashtu, mundësitë e tyre ekonomike, p.sh., shitjen e produkteve të tyre te subjektet turistike, të cilat nga ana e tyre duhet të respektojnë kuadrin e sigurisë ushqimore.

²⁸ Banka e Shqipërisë - 2021

²⁹ SWG (2020). Politikat e Diversifikimit Ekonomik dhe Turizmit Rural në EJL, mundësohen në http://seerural.org/wp-content/uploads/2020/11/Economic_diversification_policies_and_rural_tourism_in_SEE_2020.pdf

³⁰ OUB (2018). Fleta e vendit të fermave të vogla familjare, Shqipëri, shih <http://www.OUB.org/3/I8914EN/i8914en.pdf>. INSTAT (2017), deri në 9.8% (31372 ferma) janë të regjistruara zyrtarisht pranë autoriteteve fiskale dhe pjesa tjetër (deri në 90.2% e fermave) operon në mënyrë informale.



Për të rritur besimin e konsumatorëve në cilësinë e produkteve ushqimore të prodhuara në mënyrë artizanale dhe të shitura lokalisht (p.sh. reçel, verë, raki, jufka, gliko, gjize, pastërma), kërkohet një marketing i shëndoshë. Këto produkte, sipas traditës së zonës, mund të përfshihen në regjimin e “përcaktimit të produktit të certifikuar tradicional” të sistemeve kryesore të përafërta të cilësisë së BE-së (DPO, TMGJ), të cilat janë të orientuara edhe për marketingun rajonal dhe ndërkombëtar.

Turizmi i qëndrueshëm rural

Nuk disponohen të dhëna të detajuara për segmentin e turizmit rural. **Spektori i turizmit** është **zgjeruar** vazhdimisht përpara pandemisë COVID-19. Norma e rritjes në vitin 2018 ishte më e lartë se për shërbimet e tjera (më shumë se 14%), ku peshën më të madhe e zënë produktet e turizmit bregdetar dhe të plazhit.

Zonat rurale kanë një **potencial të lartë për turizmin natyror** (p.sh., agroturizëm, turizëm malor, ekoturizëm, turizëm në zona të mbrojtura, aktivitete në natyrë, vizita studimore, turizëm kulinar) por edhe për shkëmbim kulturash me anë të aktiviteteve kulturore, konferencave dhe ekspozitave (MICE), por i cili nuk është vlerësuar akoma sa duhet. Shembujt e mirë të disa zonave (ndërkufitare) të turizmit malor (p.sh. ecja në këmbë “Majat e Ballkanit”, “Shtegu i Lartë Scardus”) janë praktika të mira. Megjithatë, në Strategjinë Kombëtare të Turizmit, produktet e turizmit rural nuk janë përpunuar më tej. Mungon akoma një koncept i përmirësuar kombëtar i zhvillimit të agroturizmit bazuar në përcaktimin mbi një fermë funksionale dhe përgjegjësitë janë akoma të paqarta midis institucioneve të përfshira (kryesisht MTE, MBZHR, PMO, NAPTA, AZHBR).

Rritja e investimeve për kampingjet, sheshet e parkimit për rulotët kanë një kërkesë edhe më të madhe të pritshme pas pandemisë COVID 19, si një produkt i sigurt turistik që do të ndërlihet mirë me fermat bujqësore në zonat rurale. **Turizmi rural tregoi tendenca premtuese përpara pandemisë, por ka ende një potencial të lartë, të pashfrytëzuar** për shkak të mungesës së operatorëve dhe stafit të kualifikuar, mungesës së marketingut të pikave të përbashkëta të shitjes dhe rritjes së cilësisë dhe standardeve të sigurta për të përmbushur pritshmëritë e turistëve pas pandemisë

COVID-19. 60% e rajoneve të Shqipërisë kanë burime dhe pasuri të mjaftueshme natyrore për të zhvilluar turizmin rural dhe rekreativ. Ndryshimet vjetore të hyrjeve në Shqipëri (rezidentë dhe jorezidentë) në vitet 2018–2019 në Rajonin Verior, që është kryesisht rural kanë shënuar rritjen më të lartë me 12.6%.³²

Anketa mbi diversifikimin, e kryer nga MBZHR-ja (2021) identifikoi afërsisht 660 njësi akomodimi në zonat rurale. Pak më shumë se 40% e këtyre subjekteve kanë nga 6 deri në 10 dhoma.³³

Në vitin 2020, **21 ferma u regjistruan si “Subjekt i Certifikuar Agroturistik”** për 5 vjet, sipas VKM-së nr. 22/12.1.2018, si dhe 13 subjekte janë pajisur me certifikatë paraprake, në kuadër të cilit MTE dhe MBZHR bashkëpunojnë. Agroturizmi është një biznes relativisht i ri (afërsisht 5 vjet) kryesisht i menaxhuar nga fermerë të rinj (mesatarisht rreth 35 vjeç) me një shpërndarje të barabartë të operatorëve burra dhe gra. Madhësia mesatare e fermave me aktivitet agroturizmi prej 7.3 ha është mbi madhësinë mesatare të fermave (1.2 ha) dhe vendndodhja e tyre është afër zonave më të mëdha urbane dhe në përgjithësi jo shumë larg nga një rrugë automobilistike.³⁴ Numri i vlerësuar i fermave që kanë potencial për t’u transformuar në ferma agroturistike, si biznes familjar është shumë më i madh.

Kërkesa për produktet e turizmit rural pritet të rritet për disa shtigje ecjeje në distanca të gjata, ato ndërkufitare (p.sh. “Majat e Ballkanit”, “Shtegu i Lartë Scardus”) në rajonet veriore dhe perëndimore dhe për disa aktivitete në natyrë (p.sh., parashutizëm, kanoe, rafting) në rajonin qendror dhe jugor ku kanë mundësi të mëdha zhvillimi. Rritja e ofertës së tregut për kampingjet, sheshet e parkimit për rulotët, me kërkesë edhe më të madhe të pritshme pas pandemisë COVID-19 duhet të merren në konsideratë. Duhet të shqyrtohen mundësitë në rritje për **Ballkanin**

³² <http://www.instat.gov.al/en/themes/industry-trade-and-services/tourism/#tab3>

³³ MBZHR (2021): Studimi i Sektorit të Diversifikimit; përgatitur nga AGT International/DSA, në kuadër të Projektit GIZ-SRD, maj 2021.

³⁴ Të dhënat e siguruar nga MBZHR-ja dhe MTE-ja në: OUB, RASP (2020): Zhvillimi i agroturizmit në Shqipëri. Rasti i rajonit Malësi e Madhe, Belsh dhe Korçë. Dokumenti i Pozicionit (12/2020).



Perëndimor si një destinacion turistik, pasi barrierat tregtare janë hequr në vitin 2021 nga CEFTA (licencat për agjencitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë për të operuar në të 7 tregjet e CEFTA-s), për të ndërtuar një Treg të Përbashkët Rajonal.

Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve si një potencial për zhvillimin rural

Pyjet ofrojnë një gamë të gjerë të mirave materiale, si: dru, ushqim, foragjere dhe bimë mjekësore, përveç mundësive për rekreacion. Biomasa e drurit është një burim i rëndësishëm për ngrohjen dhe gatimin në zonat rurale të Shqipërisë. Nëpërmjet pyllëzimit të tokave të abandonuara, ekziston një mundësi jo vetëm për të përmirësuar sekuestrimin e karbonit dhe për të marrë biomasë druri, por edhe për të nxitur zhvillimin rural dhe për të gjeneruar të ardhura.

Koleksioni i Produkteve Pyjore JoDrunore (NTFP) është një komponent kyç i sistemeve pyjore dhe kullosore malore dhe është ende një aktivitet i rëndësishëm i diversifikimit ekonomik, duke përfshirë BAM të egra, kërpudhat e egra, një numër manash toke të egra dhe arrorë të ngrënshëm (gështenja dhe arra). Mbledhja e NTFP-ve të tjera është më e lokalizuar dhe lidhet me mundësitë specifike të tregut (si kërpudhat), traditat (boronicat në Shqipërinë Verilindore). Mbledhja e MAP-ve të egra është një aktivitet dhe burim i rëndësishëm të ardhurash për shumë familje rurale. Megjithatë, gjatë dekadës së fundit, ka pasur një zhvendosje të aktivitetit nga grumbullimi i BAM-së së egër në ato të kultivuara.

Prodhimi i energjisë së rinovueshme

Duhet të promovohen mundësitë për **prodhimin e energjisë së rinovueshme** përmes energjisë diellore në zonat rurale. Strategjia e re Kombëtare e Sektorit të Energjisë 2030 synon të ketë një pjesë 48% të energjisë së rinovueshme të konsumit final bruto të energjisë. Shqipëria ka rrezatim të jashtëzakonshëm diellor në pjesën më të madhe të territorit të saj, duke paraqitur një potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e njësive të prodhimit të energjisë nga dielli (Fotovoltaike - FV) për prodhimin e energjisë dhe pajisje termikë diellore për qëllime ngrohjeje. Potenciali teknik i Shqipërisë për vendosjen e njësive të prodhimit të energjisë nga dielli (FV) vlerësohet në 2,378 mw dhe kapaciteti i instaluar i

FV-ve diellore është propozuar në nivelin e 1,074 mw deri në vitin 2030.³⁵

3.2.3.2 Politika 3. Objektivi specifik 8: Forcimi i formimit të kapitalit social për iniciativat e zhvillimit lokal gjithëpërfshirës

Iniciativat për Zhvillimin Lokal të Udhëhequr nga Komuniteti (ZHLUK)

Iniciativat e ZHLUK-ut mundësojnë zhvillim lokal gjithëpërfshirës, rritje të pjesëmarrjes në qeverisjen vendore dhe formimin e kapaciteteve të kapitalit social. Sipas konceptit të ZHLUK-ut, aktorët lokalë marrin drejtimin e zhvillimit të territorit të tyre dhe formojnë një partneritet lokal që harton dhe zbaton një strategji të integruar zhvillimi për territorin (rajonin) e tyre. Strategjia hartohet për përforcuar “asete” sociale, mjedisore dhe ekonomike të komunitetit lokal më shumë se sa thjesht të kompensojë problemet e tij.

Fokusi është në rritjen e demokracisë lokale nëpërmjet qasjeve nga poshtë-lart, e cila u jep palëve të interesit akses më të mirë në proceset e vendimmarrjes për planifikimin lokal dhe në përzgjedhjen e prioritetëve.

Duke pasur parasysh faktin se iniciativat e ZHLUK-ut i vendosin aktorët lokalë në qendër të zhvillimit lokal, ashtu siç mbështeten nga qasja LEADER e BE-së. Kjo qasje mbështetet shumë në kapitalin social dhe kërkon besim midis aktorëve dhe popullsisë vendëse, gjë që është ende një temë kritike në Shqipërinë rurale.

Gjatë 20 viteve të fundit, disa projekte ndërkombëtare në Shqipëri kanë promovuar nismat e komunitetit rural përmes qasjeve pjesëmarrëse dhe të integruara. Kjo ka çuar në forcimin e kapitalit social në zonat rurale dhe në trajnimin e një grupi ekspertësh kombëtarë, të cilët mund të zbatojnë me kompetencë nismat e ZHLUK-ut. Megjithatë, akoma nuk ka financim të qëndrueshëm për të mundësuar grupet/iniciativat lokale të veprimtari të kryejnë aktivitetet e tyre zhvillimore në afat të gjatë, kështu që shumë prej grupeve janë joaktive ose janë shpërbërë pas përfundimit të projekteve. **Një partner i dobët vendor janë bashkitë**, pasi ato nuk disponojnë burime financiare dhe njerëzore për të mbështetur zbatimin e iniciativave të ZHLUK-ut, e cila është thelbësore për qëndrueshmërinë e tyre.

³⁵ Shih IRENA (2021).



Në fillim të vitit 2021, ekzistonin 17 iniciativa të institucionalizuara për ZHLUK-un: 8 grupe vendore të veprimit (GVV) të regjistruara, nga të cilat 4 ishin joaktive, 7 GVV potenciale dhe 2 struktura partneriteti lokal, të cilat ndërtojnë një masë kritike të burimeve institucionale dhe njerëzore të trajnuara, me njohuri në planifikimin e zhvillimit lokal, ngritjen e strukturave të partneritetit dhe metodave për mobilizimin e komunitetit.³⁶

Nëpërmjet programit ndërsektorial dhe të integruar shumëpalësh për zhvillimin rural, “Programi 100-Fshatrat” (2018–2020) i QSH-së, palët vendore të interesit fituan përvojë dhe njohuri të mtejshme në koordinimin e ndërhyrjeve për zhvillimin lokal. Kjo do të përbëjë një bazë shumë të mirë në zbatimin e qasjes LEADER e programuar për zbatim nga MBZHR-ja, në kuadër të programit IPARD III.

Rrjetet dhe platformat e OSHC-ve në zhvillimin rural, mbrojtjen e mjedisit dhe klimës

Aktualisht, në Shqipëri ekziston një numër relativisht i lartë i OSHC-ve të cilat luajnë një rol të mirë në rritjen e kapaciteteve të fermerëve dhe të aktorëve rurale. Një pjesë e tyre janë bashkuar dhe kanë ngritur **Rrjetin Shqiptar për Zhvillimin Rural (RRSHZHR)**, i krijuar në vitin 2015 dhe në vitin 2021 kishte 23 anëtarë.

Me ligjin nr. 9817/22.10.2007, për bujqësinë dhe zhvillimin rural, është në fuqi një kuadër ligjor që mbështet krijimin e nismave lokale për nxitjen e partneritetit publik-privat. Akti ligjor i munguar për organizimin dhe funksionimin e GVV-ve në kuadër të masës LEADER, në kuadër të IPARD-së është përgatitur dhe konsultuar me grupet e interesit dhe është miratuar në muajin prill në parlament.

Autoriteti menaxhues për IPARD (IPARD-MA) në MBZHR, po ndërton kapacitetet për ngritjen e **një organi kombëtar koordinues për zbatimin e Iniciativave ZHLUK/LEADER** për të mbështetur zbatimin e një rrjeti të bazuar tek anëtarët, Rrjetin Kombëtar Rural Shqiptar (RRKRSH), bashkëfinancuar nga IPARD. Është e dobishme të ndërtohet mbi kapitalin social ekzistues, siç është RRSHZHR-ja dhe mbi besimin e fituar nga anëtarët e OJF-ve nëpërmjet tij për të maksimizuar rezultatet pozitive dhe për të konsoliduar platformën për shkëmbimin e informacionit kombëtar, rajonal dhe evropian mbi strategjitë, programet dhe projektet.

Politika 1. Objektivi i përgjithshëm 3

³⁶ www.anrd.al



Tabela 3-8: Mundësitë dhe kërcënimet - Objektivi i përgjithshëm 3

MUNDËSITË	KËRCËNIMET
Diversifikimi i të ardhurave nga ferma dhe zhvillimi i biznesit rural Preferenca të forta të konsumatorëve për produktet ushqimore vendëse Preferenca në rritje për të blerë direkt nga prodhuesit. Burime të pasura natyrore për zhvillimin e akuakulturës (shih Objektivi i përgjithshëm 4). Rritja e numrit të vizitorëve të huaj dhe shqiptarë, në kuadër të turizmit rural dhe agroturizmit, të cilët kanë preferenca të forta për ushqimin autentik të prodhuar në vend. Kuadri ligjor që përjashton e operatorët e vegjël të ushqimit nga zbatimi i HACCP-së.	Madhësia e vogël dhe fragmentimi i fermës, informaliteti i lartë dhe situata shpesh herë e paqartë lidhur me pronësinë e tokës në sektorin e bujqësisë. Konkurrencë e fortë me konsoliduesit, tregjet me shumicë dhe supermarketet në zhvillimin e zinxhirëve të shkurtër të furnizimit.
Turizëm i qëndrueshëm rural Turizmi në tërësi, por edhe ai rural ka qenë një sektor ekonomik në rritje dhe pritet të rimëkëmbet pas pandemisë COVID-19. Zonat rurale kanë një potencial të lartë për turizëm natyror dhe të aventurës. Kërkesat e banorëve vendës për mbështetje për aktivitete rekreative janë në rritje. Rritja e mundësive për Ballkanin Perëndimor, si destinacion turistik nëpërmjet lehtësimit/heqjes së barrierave tregtare në kuadrin e CEFTA-s. Shumë të rinj shqiptarë kanë njohuri të mira gjuhësore, gjë që është një pasuri në sektorin e turizmit.	Çështjet e pazgjidhura të së drejtës pronësore në zonat rurale. Informalitet në zonat rurale turistike, p.sh. në akomodim dhe hotelieri. Madhësia e vogël dhe fragmentimi i fermës, informaliteti i lartë dhe situata shpesh herë e paqartë lidhur me pronësinë e tokës janë kushte të pafavorshme për investimet në fermë në agroturizëm. Infrastrukturë e pamjaftueshme turistike në zonat rurale. Kryesisht janë investitorë ndërkombëtarë dhe kombëtarë në turizëm me nivel të ulët përfitimi për komunitetet lokale.
Infrastruktura publike rurale Ekspozimi i jashtëzakonshëm ndaj diellit paraqet një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e elementeve (PV-ve) diellore për prodhimin e energjisë dhe për qëllime ngrohje. Planet kombëtare dhe strategjitë sektoriale për zhvillimin e qëndrueshëm të internetit të brezit të gjerë deri në vitin 2025 stimulojnë investimet në brez të gjerë me shpejtësi të lartë, në përputhje me objektivin e shoqërisë 2030 gigabit të BE-së. Mbulimi 99% i lidhjes G4 siguron lidhje celulare edhe në zona të largëta. Programi IPARD III që përmban masën për përmirësimin e menaxhimit të pyjeve.	Kostot e larta të investimeve të ndërtimit dhe mirëmbajtjes në infrastrukturën publike rurale. Nevojiten investime të larta në infrastrukturën turistike publike rurale.
Iniciativat e zhvillimit lokal bazuar në qasjen LEADER Kuadri ligjor i ri ligjor i hartuar për të stimuluar iniciativat lokale dhe për të promovuar partneritetet publik-privat. Është përgatitur projekt-akti ligjor për organizimin dhe funksionimin e GVV-së sipas IPARD LEADER. Masa LEADER është planifikuar përgatitur dhe do të dërgohet që të akreditohet sipas kërkesave të IPARD III. Përvojat e grumbulluara nga aktorët lokalë për të koordinuar ndërhyrjet e zhvillimit lokal në zonat rurale, në kuadër të Programit të Qeverisë Shqiptare “100-Fshatrat”.	Mungesa e burimeve dhe e ndërgjegjësimit në nivel bashkiak për të mbështetur partneritetet ndërmjet aktorëve publikë, privatë dhe të shoqërisë civile në zonat rurale. Bazë të ulët të kapaciteteve të aktorëve lokalë, gjë që është thelbësore për qasjet e zhvillimit me pjesëmarrje.



Identifikimi i ndërhyrjeve sipas nevojave në kuadër të politikës 1, objektivit të përgjithshëm 3

3.1 Përmirësimi i mundësive të zinxhirit të shkurtër të furnizimit për fermerët dhe për prodhuesit e vegjël të ushqimit.

Ndryshimet në udhëzimin nr. 5, datë 4.5.2018, të MBZHR-së për zbatimin me fleksibilitet të HACCP-së, siç parashikohet në ligjin kombëtar të ushqimit nr. 9863/2008, neni 26(7) për **prodhuesit e vegjël të ushqimit**, nevojiten për të rritur mundësitë e tyre për të investuar në zinxhirët e furnizimit të shkurtër që janë premtues për ta. Kjo nënkupton një rregullim (rritje) të pragjeve dhe të gamës së produkteve, që lidhen me produktet ushqimore me origjinë shtazore, për të nxitur zinxhirët e shkurtër të furnizimit dhe për t'iu përgjigjur kërkesave të konsumatorëve për ushqim të shëndetshëm, të prodhuar lokalisht.

Për rritjen e investimeve në **tregtimin e drejtpërdrejtë të produkteve agroushqimore të freskëta dhe të përpunuara nga fermerët**, duhet të përcaktohet një koncept i përshtatshëm i marketingut të drejtpërdrejtë, që lidhet me mundësinë e fleksibilitetit nga zbatimi i sistemit të vetëkontrollit, por edhe që merr parasysh preferencat e konsumatorëve për produkte të larmishme. Kjo mund të përfshijë, gjithashtu, mundësinë që fermerët të bëjnë përpunimin e produkteve të tyre, bazuar në kontrata të lidhura me ndërmarrjet e përpunimit artizanal (duke mbështetur në këtë mënyrë punësimin dhe të ardhurat), me kusht që produktet të përpunohen veçmas nga produktet e njëjësive të tjera prodhuese/përpunuese.

Me vendosjen e kushteve të duhura të kuadrit ligjor dhe administrativ, për diversifikimin e ekonomisë rurale është e nevojshme **mbështetja për investime në pajisje të reja dhe për modernizimin e pajisjeve** ekzistuese në fermë për përpunimin e ushqimit në fermë dhe prodhimin artizanal, të shitjes, ruajtjes, ftohjes, paketimit dhe etiketimit dhe objekteve për marketing të drejtpërdrejtë.

Zbatimi i **sistemeve të gjurmueshmërisë së ushqimit dhe i skemave të duhura vullnetare të cilësisë së ushqimit** (p.sh., “marketing i drejtpërdrejtë bujqësor”, “blerje direkt në fermë”, “produkte ushqimore tradicionale të prodhuara në mënyrë artizanale”) për fermerët dhe prodhuesit

artizanalë të ushqimeve do të përmirësojë pozicionin e tyre në zinxhirin ushqimor të vlerës dhe do të përmbushë më mirë pritshmëritë e klientëve ndaj kanaleve të shitjes me marketing të drejtpërdrejtë. Informacioni mbi skemat e ndryshme të cilësisë është i nevojshëm t'u komunikohet qartë konsumatorëve, në mënyrë që të parandalohet konfuzioni dhe të bëhet dallimi i qartë i kësaj skeme prodhimi kundrejt skemës së cilësisë për prodhuesit më të mëdhenj (objektivi 2).

Për të nxitur zhvillimin e zinxhirëve të shkurtër të furnizimit, mundësitë e trajnimit dhe shkëmbimit të njohurive për fermerët dhe prodhuesit e vegjël të ushqimit në marketing dhe në komunikim, duhet të mbështeten si shitjet direkte në fermë ose në bashkëpunim midis fermerëve dhe të tjera si skemat jashtë fermës (si tregjet e fermerëve, kanalet e shpërndarjes), bujqësia e mbështetur nga komuniteti, shitjet kolektive në veçanti tek institucionet publike (si p.sh. edhe për ushqimin e shkollave) dhe në bujtina ose si katering.

3.2 Forcimi i turizmit rural dhe në veçanti i zinxhirit të vlerës së agroturizmit.

Nevojitet **konsolidimi i kuadrit të përgjithshëm për zhvillimin e turizmit rural**, veçanërisht për zhvillimin e agroturizmit (koncepti agroturizëm i bazuar në një fermë në aktivitet). Kjo përfshin, gjithashtu, zhvillimin/përshtatjen e standardeve të duhura të sigurimit të cilësisë, certifikimet e lidhura me produktin, standardet e shëndetit publik dhe udhëtimit të sigurt, si dhe çështjet fiskale, financiare dhe ligjore.

Forcimi i turizmit rural dhe, në veçanti, i zinxhirit të vlerës së agroturizmit, përfshin edhe anën e kërkesës, siç është: përmirësimi i marketingut në nivel të operatorëve individualë / rrjeteve/komuniteteve/destinacioneve (përfshirë mundësitë digjitale), koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet operatorëve agroturistikë, përfshirë dhënien e markës dhe shqyrtimin e mundësive për “Agroturizmin e Ballkanit Perëndimor”, si promovues turistik, rrjetëzimi rreth temave dhe grupimi gjeografik, që përfshijnë bashkëpunimin ndërkufitar rreth atraksioneve turistike, përfshirjen e organizatave me bazë në komunitet ose promovimin e koncepteve të turizmit rajonal të Ballkanit Perëndimor.

Për sa i përket **infrastrukturës së përgjithshme sociale-ekonomike, infrastruktura turisti-**



ke rurale në vend duhet të përmirësohet në përputhje me traditat dhe kulturën vendëse, si dhe me kujdesin ndaj peizazhit dhe mjedisit për të forcuar origjinalitetin si pika kryesore e promovimit për turizmin rural. **Pikat e informacionit, muzetë, tregjet lokale, festivalet dhe atraksionet e tjera turistike në zonat rurale** duhet të zhvillohen edhe më tej, në një linjë me zhvillimin e produkteve më të larmishme të turizmit rural. Përzgjedhja e lokaliteteve duhet të bazohet në studimet e fizibilitetit të autoriteteve kombëtare kompetente dhe duhet t'i japë prioritet të lartë mbështetjes së nevojave të turizmit rural, por edhe lidhjes së zonave më të largëta me potenciale turistike të paeksploruara.

Ngritja e kapaciteteve për operatorët e turizmit rural, sipas llojeve të tyre të biznesit duhet të forcohet për të përmbushur pritshmëritë në rritje të vizitorëve për shëndetin, sigurinë dhe peizazhin natyror të paprekur, për të mbështetur zbatimin e standardeve cilësore dhe të sigurt të udhëtimit bazuar në udhëzimet e praktikave më të mira të aplikuara ndërkombëtarisht,³⁷ që synojnë rëfillimin dhe përshejtimin e rimëkëmbjes së sektorit në vazhden e pandemisë COVID-19.

3.3 Forcimi i një ekonomie lokale të larmishme (diversifikuar) të bazuar në sektorin privat

Për të diversifikuar ekonominë lokale dhe për të rritur atraktivitetin ndaj zonave rurale, nevojitet mbështetje për investime në asete fikse dhe marketing të bizneseve ekzistuese rurale ose bizneseve rurale, që nisin aktivitetin e tyre, në lidhje me produktet/nënsektorët premtues, si: BAM, produktet jodrusore të pyllit, produktet e bletarisë, produktet e akuakulturës (shih kapitullin 3.2.2), produktet jotipike bujqësore, aktivitetet në sektorin e shërbimeve. Këto aktivitete janë të favorshme për sipërmarrësit e rinj dhe ato gra, bizneset që nisin aktivitetin e tyre (*start-up*) ose aktivitetet e lidhura drejtpërdrejt me sektorin bujqësor ose të turizmit rural, si p.sh. punimet artizanale.

3.4 Mbështetje e sistemeve të qëndrueshme pyjore

Investimet në **pyllëzime** do të konsistojnë në pyllëzimin e tokave bujqësore, të tokave

jobujqësore dhe të tokave të braktisura nga fermerët, të cilat do të nxisin diversifikimin e ekonomisë rurale dhe do të gjenerojnë të ardhura.

Promovimi i **sistemeve të agropylltarisë** së qëndrueshme, që kombinojnë pylltarinë me praktikat ekstensive bujqësore, të njohura për rëndësinë e tyre për mirëmbajtjen e biodiversitetit dhe për përshtatjen e tyre në zonat me ndjeshmëri të lartë ndaj shkretëtirëzimit të tokës.

Nevojitet një studim fizibiliteti, në lidhje me rrugët rurale dhe pyjore, për të vlerësuar rrjetin rrugor pyjor dhe për të vendosur mbi nevojat prioritare për investime, të tilla si toka pyjore e klasifikuar si me rrezik të lartë për zjarret pyjore për të parandaluar dëmtimet nga zjarret e përsëritura në pyje.

3.5 Investimet publike në ndërtimin dhe rehabilitimin e infrastrukturës publike rurale dhe prodhimin e energjisë së rinovueshme

Investimet publike në rrugët rurale, rrugët pyjore, shëndetësi, ujërat e zeza dhe menaxhimin e mbetjeve, duke përfshirë mbetjet bujqësore në zonat rurale janë të domosdoshme për të përmirësuar aksesin në shërbimet kryesore publike. Këto investime mundësojnë rritjen e standardeve mjedisore dhe i shërbejnë sektorit të turizmit rural, që ndodhet në zhvillim e sipër. Këtu përfshihen edhe investimet në prodhimin e decentralizuar të energjisë elektrike dhe të ngrohjes së ndërtesave publike në komunat rurale nga burimet e rinovueshme si p.sh. energjia diellore.

Përmirësimi i cilësisë së infrastrukturës rrugore rurale është tashmë një prioritet kombëtar.

MBZHR-ja do ta trajtojë këtë nevojë në kuadër të programit IPARD III, masa e infrastrukturës publike rurale.

Nevojitet **përmirësimi i aksesit në brezin e gjerë** në zonat rurale, i cili parashikohet të zhvillohet në programe të tjera sektoriale të QSH-së dhe është i lidhur me investimet në infrastrukturën publike të telekomunikacionit.

3.6 Zhvillimi i zinxhirëve të vlerës së bioekonomisë

Programet e financimit publik, bazuar në vlerësime paraprake, duhet të mbështesin aktivitete brenda zinxhirëve të vlerës të bioekonomisë rurale, duke përfshirë dhe energjinë e rinovueshme me bazë bujqësinë dhe pyjet, të cilat mund të ofrojnë edhe përfitime klimatike dhe mjedisore.

³⁷ Për shembull, kuadri i aplikuar gjerësisht i WTTC-së për të miratuar një qasje të bazuar në rrezik të bazuar në kontekste me rrezik të lartë dhe të ulët për protokollet e udhëtimit të sigurt.



3.7 Mbështetja e zhvillimit të territorit në bazë të Strategjive të Zhvillimit Lokal (SZHL)

Kapitali social dhe qeverisja vendore në zonat rurale mund të përmirësohen nëpërmjet institucionalizimit të partneriteteve zhvillimore lokale ndërmjet aktorëve vendorë privatë, publikë dhe të shoqërisë civile për të zbatuar SZHL-të e bazuar në terriore të caktuara (të GVV-së). Kjo nënkupton, gjithashtu, kapitalizimin e kapitalit social dhe të partneriteteve lokale dhe nismave komunitare që ekzistojnë tashmë.

Nëpërmjet hartimit të bazuar në qasjen nga poshtë-lart të SZHL-së të bazuara në territor, që përmban nevojat dhe potencialet e identifikuar sociale, ekonomike dhe mjedisore, duhet të zbatohen veprimet dhe investimet prioritare.

Për të pasur akses në financim të qëndrueshëm, nevojitet forcimi i kapaciteteve financiare-administrative, menaxhuese dhe komunikuese të koordinatorëve të tanishëm dhe të ardhshëm të GVV-ve.

Sigurimi i financimit dhe i mbështetjes afatgjatë kërkon, gjithashtu, burime dhe rritje të ndërgjegjësimit të bashkëpunimit midis bashkive (aktorëve publikë).

3.8 Forcimi i kapaciteteve të rrjetëzimit dhe të kapaciteteve mbështetëse

Zbatimi i qasjes LEADER (zhvillimi i një territori të caktuar që mbulon një GVV) do të hapte një dritare financimi afatgjatë për GVV-të. Kjo qasje do të zbatohet qoftë me mbështetjen përmes fondeve kombëtare (buxhetet komunale, programet kombëtare), ashtu edhe në kuadër të programit IPARD III të bashkëfinancuar nga BE-ja. Kjo nënkupton një kapitalizim efektiv të kapitalit tashmë ekzistues social (OSHC-ve dhe rrjetit aktiv në zhvillimin rural RRSZHHR-ja) të aktorëve, që jetojnë dhe ushtrojnë aktivitetet në zonat rurale.

Qasja LEADER, meqenëse është një qasje e re dhe që përmban sfida në zbatimin e saj, është planifikuar që të financohet me një buxhet mbështetëse, i cili synon përgjigjen ndaj kërkesës që mund të shfaqin GVV-të në të ardhmen afatmesme.

Zbatimi i kësaj qasje do të kontribuojë edhe në forcimin e rrjetëzimit dhe të **veprimeve të përbashkëta të aktorëve ruralë të zhvillimit mjedisor dhe rural**, në lidhje me zbatimin e masave agromjedisore dhe klimatike, të skemave

eko ose për masat në zonat e mbrojtura, pasi palët e tyre të interesit janë, gjithashtu, fermerët dhe popullsia rurale.

3.9 Forcimi i kapaciteteve institucionale të MBZHR-së dhe organeve të saj teknike

Ndërhyrjet sipas nevojave janë të lidhura drejtpërdrejt me **procesin e përafrimit me EU acquis të BE-së për PPB, respektivisht me negocimin e kapitujve 11 dhe 12**. Nevojat në mënyrë më të detajuar janë përshkruar më poshtë në kuadër të objektivit ndërsektorial 2, kapitulli 3.5.1).

3.2.4 Politika 2. Objektiv i përgjithshëm 4: Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm të peshkimit detar dhe të ujërave të brendshme

Objektivat e strategjisë shqiptare të peshkimit janë në përputhje me PPP-në të BE-së, që përcakton rregullat për menaxhimin e peshkimit, mbron burimet e gjalla të detit dhe kufizon ndikimin mjedisor të peshkimit. Kjo përfshin përcaktimin e kuotave të kapjes, menaxhimin e kapacitetit të flotës, rregullat për tregjet dhe akuakulturën, si dhe mbështetjen për peshkimin dhe komunitetet bregdetare. Ky objektiv synon, gjithashtu:

- Ruajtjen e rezervave të peshkut dhe reduktimin e mbi peshkimit në mënyrë që t'u ofrohet qytetarëve një furnizim afatgjatë i qëndrueshëm, i sigurt dhe i shëndetshëm me ushqim;

- Mbështetjen e përpunimit dhe tregtimit të produkteve të peshkimit për ofrimin e ushqimit me cilësi të lartë, të sigurt, ushqyes dhe të qëndrueshëm, si dhe informacion për konsumatorin;

- Mbështetjen e peshkimit në shkallë të vogël dhe shfrytëzimin racional të burimeve të rinovueshme, si dhe qëndrueshmërinë e tyre afatgjatë;

- Mbështetjen për zhvillimin e kapaciteteve të strukturave institucionale dhe administrative;

- Mbështetjen e mbikëqyrjes, kontrollit, zbatimit, shkëmbimit të informacionit dhe aktiviteteve të bashkëpunimit në peshkim në detin Adriatik;

- Mbrojtjen dhe rivendosjen e biodiversitetit dhe ekosistemeve detare dhe bregdetare, e cila është një sfidë kryesore për të pasur dete dhe oqeanë të shëndetshme;



- Mbështetjen për përafrimin me *acquis* të BE-së (kapitulli 13) në peshkim dhe PPP.

3.2.4.1 Politika 2. Objektivi specifik 9: Forcimi i akuakulturës dhe tregjeve konkurruese dhe të qëndrueshme, si dhe komuniteteve bregdetare të qëndrueshme

Struktura e fermave të akuakulturës

Në Shqipëri janë të regjistruara **82 ferma akuakulture** (MBZHR, 2021), nga të cilat 78.05% operojnë në ujërat detare dhe lagunat bregdetare (32 ferma të peshqve bregdetarë dhe 32 ferma për kultivim midhjesh³⁸) dhe 21.95% janë ferma akuakulture të ujërave të ëmbla në ujërat e brendshme (14 ferma për peshkun troftë dhe 4 ferma për peshkun krap).

Falë progresit të bërë dhe potencialit ekzistues në **akuakulturën e peshqve detarë dhe të molusqeve**, deri në vitin 2017 janë dhënë dy licenca për objekte të reja të akuakulturës. Licenca të reja priten që të jepen pas **miratimit** nga Këshilli i Ministrave të studimit të MBZHR-së për përcaktimin e **Zonës potenciale të Përcaktuar për Akuakulturën** (ZPA) për ujërat detare dhe të brendshme³⁹, me synimin për të përmirësuar zhvillimin e qëndrueshëm të akuakulturës detare. Përcaktimi i ZPA-së vjen pas një procesi me pjesëmarrje të aktorëve në kuadrin e hartimit të planeve të menaxhimit të integruar të zonës bregdetare, për të nxitur investimet për fermat e vogla dhe të mesme të akuakulturës dhe për të shfrytëzuar plotësisht kapacitetet prodhuese të fermave ekzistuese, të cilat në disa raste shfrytëzojnë vetëm një të katërtën e kapacitetit të tyre në Shqipëri. Kjo do të krijojë mundësi punësimi, por, gjithashtu, do të ndihmojë sektorin të sigurojë kontributin e tij në sigurimin e ushqimit dhe të mbështesë tranzicionin e gjelbër.

Shumica e **fermave të akuakulturës së peshqve detarë** janë të vendosura në zonat bregdetare jugore të Shqipërisë (Vlorë, Sarandë dhe Himarë/Porto Palermo).⁴⁰ Sistemi kryesor i prodhimit të akuakulturës bazohet në sistemin e

kultivimit në kafaz lundrues detarë. **Madhësitë e fermave të akuakulturës ndryshojnë nga 2 deri në 38 kafaze.**

Fermat e akuakulturës së molusqeve ekzistojnë, si në ujërat e brendshme (laguna me ujë të kripur), ashtu edhe në det të hapur, gjë që ka avantazhin se produktet janë të larmishme dhe janë të pranishme për një kohë më të gjatë në treg, për shkak të periudhave të ndryshme të vjeljes së tyre. Nga 32 fermat e licencuara të molusqeve në ujërat e brendshme, rreth dy të tretat janë ferma aktive që ndodhen në zonën historike të prodhimit të lagunës së Butrintit⁴¹, të cilat të gjitha përdorin objekte betoni. Pesë fermat kryesore të licencuara të akuakulturës së molusqeve detare (në Sarandë, Shëngjin dhe Durrës) përdorin sisteme të litarëve të gjatë.

Në të gjithë vendin përdoren 184 pellgje ujore dhe RUB⁴² për **akuakulturën e peshqve të ujërave të ëmbla dhe për peshkim**, si një lloj akuakulture ekstensive ose gjysmë intensive të pellgjeve. Gjashtë liqenet më të mëdha natyrore, ku përfshihen edhe ato të hidrocentraleve të mëdha dhe disa nga 103 liqenet më të vogla natyrore shfrytëzohen për akuakulturë dhe peshkim. Shumica e RUB-ve kanë potencialin për t'u përdorur si pellgje për akuakulturë dhe peshkim. Potenciali vjetor i prodhimit të peshkut të RUB-ve është mbi 1500 tonë. Fauna e peshkut në ujërat e brendshme shpesh është e ekspozuar ndaj ndotjes urbane, industriale dhe bujqësore dhe efektit të uljes së nivelit të ujit në liqenet artificiale, si pasojë e prodhimit të energjisë së hidrocentraleve me luhatje ditore dhe sezonale.

Akuakultura e peshqve të ujërave të brendshme përfshin kultivimin e troftës në sisteme vaskash me përqendrim në juglindje të Shqipërisë. Lloji i akuakulturës së pellgjeve është kryesisht ekstensiv deri në gjysmë intensiv, duke u ofruar mundësi familjeve rurale për të zgjeruar të ardhurat e tyre. Kultivimi i peshkut endemik koran (*salmo letnica*) është i kufizuar në liqenin e Ohrit, ku edhe një fermë mbarështimi është e specializuar në prodhimin e rasateve të koranit për rimbushjen e liqenit. Janë të paktën 57 ferma familjare të

³⁸ Prodhimi fokusohet te levreku, krap dhe karkaleca deti, si dhe midhjet blu (*Mytilus galloprovincialis*).

³⁹ Baza ligjore është ligji nr. 103/2016 për akuakulturën me përcaktimin e zonave të akuakulturës.

⁴⁰ Bakiu R. Hala, E. dhe Demiri, A. Akuakultura Detare e Shqipërisë për Prodhimin e Koces dhe Levrekut: Analiza dhe Konsiderata Sektoriale. Pro Aqua Farm Marine Biol 2019, 2(2): 180020.

Faqe | 12608

⁴¹ Në statistikat zyrtare të INSTAT-it, ky liqen me ujë të njelmët grupohet së bashku me liqenet e mëdha të brendshme të vendit.

⁴² 670 AWS janë regjistruar në MBZHR (2019).



akuakulturës së troftës në të gjithë Shqipërinë⁴³, nga të cilat një e treta kanë edhe fermë mbarështimi. Katër inkubatorë privatë kultivojnë krapin e zakonshëm, krapin e barit, krapin ballëgjërë dhe krapin e argjendtë për qëllime rimbushjeje, por vetëm dy (në Elbasan dhe Fier) janë funksionale.

Operatorët në sektorin e peshkimit

Peshkimi tregtar përbëhet nga peshkimi tregtar profesional dhe artizanal i përcaktuar në ligjin nr. 64/2012, “Për peshkimin”. Peshkimi tregtar profesional përfshin anije me gjatësi më të madhe se 12 metra dhe fuqi motorike më të madhe ose të barabartë me 56 kw, ndërsa peshkimi artizanal tregtar ose artizanal bregdetar kryhet me varka me gjatësi më të vogël se 12 metra dhe që nuk përdorin vegla peshkimi fundore, me ose pa timon, vegla peshkimi me tërheqje të peshkimit pelagjik me timon ose çift pelagjik, rrjeta binjake me timon dhe draga hidraulike.

Peshkimi bregdetar (bregdeti, laguna) përfshin **peshkimin artizanal në shkallë të vogël**, i cili është një burim i rëndësishëm të ardhurash për komunitetet lokale bregdetare. Peshkimi në laguna ndjek metodat tradicionale si rrjetat (e varura) dhe barrierat (dajlanët) e peshkimit. Ky sistem fiks peshkimi i bazuar në parimin e kurtheve në formë V bëhet me tuba plastikë në kanalet që lidhin lagunat me detin. Përgjatë bregdetit shqiptar ka tetë laguna bregdetare, me një sipërfaqe totale rreth 10.000 ha, thellësi mesatare 1 metër, ku maksimumi mund të arrijë 5 metra. Më të rëndësishmet janë: Velipoja; Patoku, Vaini, Karavasta, Narta dhe Butrinti. Speciet kryesore janë ato shtegtare të detit: barbuni, levreku, krapë dhe ngjala evropiane.

Të tetë sistemet lagunore janë pak të kërcënuara nga sedimentimi, llumëzimi i kanaleve që i lidhin me detin, episodet e anoksisë hipertrofike dhe nga ndotja shtëpiake dhe industriale. Menaxhimi i integruar duhet të optimizohet, duke përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve lokale, kërkueseve shkencorë dhe qeverisë.

Aktivitetet e peshkimit në shkallë të vogël (PSHV) është forma më e vjetër e aktivitetit të peshkimit në ujërat detare dhe të brendshme në Shqipëri dhe përfshin numrin më të madh të anijeve dhe peshkatarëve vendës. Mungojnë të dhënat gjithëpërfshirëse për PSHV-në. Prej disa vitesh, qeveria ka ndërmarrë përpjekje të rëndësishme për një rregullim gradual të PSHV-së për të stabilizuar kapacitetin e tyre të peshkimit dhe për të reduktuar peshkimin e paligjshëm, të raportuar dhe të parregulluar (PPPP), i cili varfëron rezervat e peshkut, shkatërron habitatet detare, shtrembëron konkurrencën, vendos në disavantazh peshkatarët e ndershëm dhe dobëson komunitetet bregdetare.

Organizatrat profesionale të peshkimit

Që nga viti 2002, në Shqipëri janë krijuar **Organizatrat e Menaxhimit të Peshkimit (OMP)** si subjekte juridike private, në përputhje me ligjin Nr. 8870/2016, bazuar në ndryshimet në Ligjin për Peshkimin dhe Akuakulturën (2020), i cili është në përputhje me konceptet përkatëse të BE-së.

⁴³ MBZHR (2021): Studim i Sektorit të Peshkimit; përgatitur nga AGT International/DSA, në kuadër të Projektit GIZ-SRD, maj 2021.



Tabela 3-9: Shpërndarja e OMP-ve në Shqipëri viti 2020

Emri i OMP	Ujërat e menaxhuara		Varkë peshkimi		Varkat (nr.)	Peshku i kapur për peshkatar (kg)		Licenca
	Emri	(ha)	Nr.	Nr./ha		Aktualisht	Potencial	
Kukës	Fierza	5,000	40	17	40	0.7	1.7–2.0	Jo
Ulza	Ulza	1,250	20	63	10	NA	5.0–6.3	Jo
	Shkopeti	80	5	16	Nuk ka tregues	NA	1.2–1.6	Jo
	Total	6,330	65	19	Nuk ka tregues	NA	1.9–2.3	-
Narta	Narta	2,600	35	74	Nuk ka tregues	0.6	4.9–9.7	Po
	Orikum	130	6	22	Nuk ka tregues	0.3	0.3	Po
	Total	2,730	41	67	Nuk ka tregues	0.5	4.2–8.3	
Ohër	Total	11,890	300	40	150	0.3	0.5	Po
Shkodër	Shkodër	14,790	420	35	210	0.7	1.5–2.0	Po
	Komani	700	25	28	Nuk ka tregues	NA	2.8–3.4	Po
	Vau Dejës	1,000	30	33	Nuk ka tregues	NA	3.3–4.0	Po
	Vilun	280	30	9	15	NA	0.5–1.1	Po
	Total	30,260	955	32	Nuk ka tregues	NA	1.0–1.3	-
Prespa	Prespa e Madhe	4,940	78	63	Nuk ka tregues	0.7	1.0–1.2	Po
	Prespa e Vogël	400	10	40	Nuk ka tregues	0.5	1.0	Po
Karavasta	Divjaka Total	4,100	40	100	Nuk ka tregues			Po
Durrësi	Total	5,340	88	61	Nuk ka tregues	0.7	1.0–1.1	-
Butrinti	Total	1,600	150	11	Nuk ka tregues	0.07	0.2–0.4	Jo

Burimi: MBZHR (2020)

Janë dhjetë **OMP të licencuara nga MBZHR-ja** (shih tabelën 3-13), e cila është përgjegjëse për dhënien e lejeve për peshkatarët, mbikëqyrjen e aktiviteteve të tyre të përditshme dhe rregullimin e sezonalitetit të aktivitetit të peshkimit. Një licencë ka vlefshmëri nga 5 deri në 10 vjet. OMP-të lëshojnë leje vjetore për anëtarët e tyre, të cilët në këmbim paguajnë një tarifë vjetore. Liqeni i Shkodrës është më i madhi nga liqenet shqiptare dhe peshkimi menaxhohet nga OMP-ja lokale. Ajo ka 427 anëtarë të organizuar në 210 njësi të përbëra nga dy persona dhe një varkë. Anëtarëve u përcaktohet një pjesë e caktuar e liqenit ku lejohen të peshkojnë, por ata mund të aplikojnë në OMP për të ndryshuar zonën nëse duan të lëvizin në një pjesë tjetër.

Detyrat kryesore të nivelit drejtues të OMP-ve përfshijnë rimbushjen e planifikuar të ujërave dhe patrullimin për identifikimin e gjuetarëve pa leje dhe peshkimit të paligjshëm. Kjo është në përputhje me rregullat e BE-së, pasi rimbushja e

ujërave të dhëna me qira është detyra e vetme dhe në interesin e vetëm ekonomik të qiramarrësve dhe roli i qeverisë është i kufizuar në mbikëqyrjen dhe zbatimin e kontratave dhe ligjit.

OMP-të e Shkodrës, Ohrit, Prespës dhe Kukësit janë të lidhura me Konfederatën e Organizatave të Peshkimit të Brendshëm (KOPUB) me seli në Shkodër. KOPUB-ja ofron një zë uniform, përfaqësim dhe lobim për nënsektorin e peshkimit në ujërat e brendshme. Ka dy organizata të tjera, Konfederata e Prodhuesve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Shoqata e Investitorëve të Peshkimit në Durrës.

Kriteret që karakterizojnë **gatishmërinë** për t'u konvertuar dhe **rruga për konvertimin e OMP në Organizata Prodhuesish (OP)** dhe Shoqata e Organizatave të Prodhuesve (SHOP) nuk janë përcaktuar ende, duke përfshirë instrumentet për të



siguruar njohjen dhe funksionimin e tyre ligjor.⁴⁴ Rritja e numrit të OP/SHOP-së shoqëruar me kuadrin ligjor të duhur do të sillte efikasitet më të madh dhe menaxhim më të mirë për OMP-të, do të reduktonte kostot e transaksionit dhe do të forconte bashkëpunimin në përpunimin dhe tregtimin e produkteve të tyre.

Peshkimi tregtar detar është një nga sektorët më të formalizuar të ekonomisë shqiptare, për shkak të skemës së subvencionimit të naftës së peshkimit. Anijet e peshkimit kanë të drejtë për naftë pa akcizë, pa taksë qarkullimi dhe taksë karboni. Gjithashtu, subjektet për të rimbursuar TVSH-në duhet të shesin prodhimin e tyre përmes faturave tatimore me TVSH-në. Aktualisht është vendosur sistemi i lëshimit të certifikatave të peshkimit për produktet e peshkimit. Sistemi i Monitorimit të Anijeve me bazë satelitore (SMA) është riaktivizuar dhe është funksional që nga maji 2021. **Flota tregtare e peshkimit** detar u rrit nga 651 anije në vitin 2019 në 752 anije në vitin 2021, sipas Regjistrat Kombëtar të Flotës në MBZHR. Anijet janë në pronësi ose me qira. Shqipëria ka bërë përpunim në përmirësimin e statistikave të zbarkimit. Operatorët kryesorë kanë flota prej 10 deri në 15 anije me tonazhe të ndryshme dhe pajisje peshkimi për t'iu përgjigjur aktiviteteve të ndryshme të peshkimit. Më shumë se 80% e anijeve të peshkimit tregtar me një gjatësi më të vogël se 12 metra janë pa kuvertë dhe me motor jashtë bordit me fuqi deri në 50 kw. Përveç kësaj, 363 anije tregtare kanë një gjatësi deri në 6 metra.⁴⁵

Megjithatë rritja e numrit të anijeve ka nisur kryesisht që nga viti 2017, **flota mesatare shqiptare e peshkimit mbetet e vjetër në krahasim me flotën evropiane**: anijet janë të një moshe mesatare 49-vjeçare, krahasuar me moshën prej 29 vjet në BE, gjë që ndikon negativisht në konkurrencën e tyre dhe ndikimin e tyre në mjedis. Qeveria shqiptare mbështet rinovimin e flotës dhe riparimin e saj me anë të skemave kombëtare të mbështetjes.

Së fundmi, janë miratuar nga Regjistri Detar Shqiptar, katër objekte për riparimin e anijeve (të cilat nuk ndodhen në zonën e porteve të peshkimit) të vendosura në qarqet e Durrësit, Vlorës dhe Fierit. Por anijet riparohen akoma në Itali dhe Greqi, që do të thotë kosto shtesë për flotën e vlerësuar në 0.5 milionë euro në vit dhe një humbje e aktivitetit ekonomik për vendin, pasi flota aktive shpenzon rreth 4.3 milionë euro në vit për riparime jashtë vendit.⁴⁶ Kostot e ndërtimit për një kantier detar për riparimin janë nga 1 deri në 1.5 milionë euro, të cilat janë përballuar nga kompanitë private.

Infrastruktura akoma e pamjaftueshme dhe menaxhimi i porteve me vende të pamjaftueshme zbarkimi vazhdojnë të jenë pengesë për zhvillimin e sektorit. Flota e peshkimit është e përqendruar në katër portet kryesore të peshkimit Durrës, Vlorë, Sarandë dhe Shëngjin, të ndjekur nga portet e Himarës, Lushnjës dhe Fierit. Portet e peshkimit janë në faza të ndryshme zhvillimi dhe amortizimi. Në Durrës është ndërtuar një port i ri peshkimi, Sigurimi i magazinimit të akullit dhe produkteve të ftohta në porte janë efikase, por duhet të zhvillohen akoma më shumë.

Prodhimi i peshkut, krustaceve dhe molusqeve nga ujërat e brendshme dhe detare dhe nga akuakultura

Sektori i kapjes detare dominohet nga blerësit/përpunuesit kryesorë dhe peshkatarët prirën të kenë një pozicion negociues jooptimal. Peshkimi artizanal në trupat ujorë bregdetarë, lagunorë dhe në ujërat e brendshme kanë mundësi të kufizuar shitjesh, përveç një ose dy blerësve kryesorë. Nuk ekziston një platformë ankandi elektronik që mund të lidhë peshkatarët dhe blerësit e peshkut dhe të sjellë më shumë

⁴⁴ Banka Botërore (2020): Realizimi i Potencialit të Ekonomisë Blu të Shqipërisë (nëntor 2020).

⁴⁵ Nënkomiteti BE-Shqipëri (2019):

https://ec.europa.eu/info/food-farming-fisheries/key-policies/common-agricultural-policy/market-measures/agri-food-supply-chain/producer-and-interbranch-organisations_en

⁴⁶ Këto vlerësime supozojnë se çdo mjet lundruar mbi 12 metra kryen një javë riparime në Itali një herë në vit, gjë që rezulton në kosto shtesë (bazuar në 3000 euro në javë në shpenzimet e ekuipazhit dhe kosto shtesë të karburantit për një ditë avullimi në çdo drejtim. Për flotën aktuale aktive kjo arrin në 489,000 euro. Nëse merren parasysh të gjitha mjetet lundruese të licencuara mbi 12 m, këto kosto shtesë rriten në 813,000 euro - 4.3 milionë euro riparime vjetore të flotës vlerësohen bazuar në 143 mjete lundruese aktive mbi 12 metra me një shpenzim mesatar prej 30,000 euro; shih MBZHR (2021): Studimi i Sektorit të Peshkimit; krijuar nga AGT International/DSA, në kuadër të Projektit GIZ-SRD, maj 2021.



transparencë në zinxhirin e vlerës, ndërkohë që përjashtohet edhe peshku PPPP.⁴⁷

Prodhimi i përgjithshëm i peshqve, krustaceve dhe molusqeve (akuakulturë dhe peshkim) tregoi një rritje mesatare vjetore pozitive prej 6.93% ndërmjet periudhës 2015–2019 me 11,170 tonë në vitin 2015 krahasuar me 15,010 tonë në vitin 2019, ku rritja mesatare vjetore e akuakulturës ishte dukshëm më e lartë 12.53% krahasuar me peshkimin (peshkimi detar, lagunor dhe në ujërat e brendshme) me 2.46%. Në të njëjtën periudhë, peshkimi në ujërat e brendshme tregon një tendencë rritjeje.

Vihet re një rritje vjetore e **prodhimit në sektorin e akuakulturës**, duke iu përgjigjur edhe kërkesës në rritje të konsumatorëve vendës, veçanërisht për produktet e peshkut detar, ku kontribuoi edhe zhvillimi i sektorit të turizmit, ndërsa në të njëjtën kohë fermat e marikulturës lider në treg janë kryesisht të orientuara nga eksporti.

Prodhimi i **akuakulturës detare të peshqve të detit** (levreku dhe krapit) ka një tendencë pozitive vjetore prej rreth 5% (nga 800 në 1000 tonë) përkatësisht 11,10% (nga 1,600 në 2,600 ton) gjatë periudhës 2015–2019, në vijim të kërkesave të rritura të konsumatorëve. Ka një polarizim të firmave aktive në sektorin e akuakulturës, të cilat kanë një standard të teknologjisë së lartë, me një sistem të menaxhimit dhe të monitorimit të prodhimit plotësisht të automatizuar, të mbështetur nga *software* dhe të paktën një certifikim të cilësisë (Global GAP, pa antibiotikë ose ASC, standardet bazë ISO (p.sh. ISO 9001) ose HACCP). Nëpërmjet marrëdhënieve të tyre të drejtpërdrejta biznesi me kompanitë e huaja (veçanërisht me ato italiane), marrin edhe mbështetje teknologjike, shërbime dhe inpute, **gjë që është jashtëzakonisht e rëndësishme, duke pasur parasysh faktin se shërbimet e riparimit dhe të mirëmbajtjes, por edhe ushqimi i peshkut dhe rasatet e peshkut të prodhuar në vend, janë në mungesë dhe përbëjnë kostot kryesore në biznes.**⁴⁸

Në nënsektorin e **akuakulturës në ujërat e brendshme**⁴⁹, fermat e vogla të akuakulturës familjare (përfshirë fermat e pa licencuara) vlerësohen të prodhojnë midis 600 dhe 700 tonë (2015 - 2019) **troftë** ylber në vit⁵⁰. Në vitin 2018, prodhimi është më shumë se dyfishuar (nga 700 në 1,850 tonë) përmes një objekti të ri të madh të akuakulturës në kafaz, në një liqen artificial hidroenergjetik. Ky stabiliment është kryesisht e orientuar nga eksporti dhe është e vetmja fermë akuakulture me ujëra të brendshme me standarde të certifikuara të cilësisë.

Një program kombëtar për ripopullimin me peshq fokusohet në troftën e Ohrit (*Salmo letnica*) në liqenin e Ohrit me rreth 1.5 milionë rasate (në vitin 2019). **Prodhimi i krapit** ka shfaqur një tendencë stabilizim gjatë periudhës 2015–2019, e cila reflekton kërkesën e konsumatorëve vendës të orientuar drejt krapit të madh (≥ 3.5 kg). Dy inkubatorë operativë të krapit kanë një sipërfaqe prej 20 ha dhe një prodhim vjetor prej rreth 2 milionë rasatesh (krapit i zakonshëm, krapit i barit, krapit ballgjër dhe krapit i argjenditë). Ekzistojnë dy inkubatorë mbarështimi të vogla publike të tjera (6.5 ha) me prodhimin vjetor të 300.000 rasate të krapit të zakonshëm, si pjesë e një programi kombëtar të ripopullimit të liqenit të Prespës.

Peshkimi në ujërat e brendshme dominohet nga specie të familjes së krapit, të cilët tregojnë një tendencë rritjeje vjetore prej 7,12% (midis 460 dhe 653 ton), 9,29% (midis 364 dhe 538 tonë) dhe 20,18% (ndërmjet 4,18% dhe 523 tonë) përkatësisht në periudhën 2015–2019. Kapiet e perkës (evropiane) tregojnë normën më të lartë të rritjes vjetore prej 36,39% mesatarisht, por me një sasi më të ulët (nga 19 në 189 tonë) në të njëjtën periudhë. Lloje të tjera të ruajtura janë krapit i argjenditë, giuca, salmonoidet, ngjala evropiane dhe barbuni (MBZHR, 2020).

Sa u përket **kapjeve detare**, speciet kryesore janë açugja evropiane, e cila është specie kryesore me një trend pozitiv të rritjes vjetore në periudhën 2015–2019 prej 19,64% (midis 250 dhe 1,516 ton) dhe karkalecat blu dhe të kuqe me një trend pozitiv prej 15,15% (2017–2019). Lloje të tjera janë

⁴⁷ Banka Botërore (2020): Realizimi i Potencialit të Ekonomisë Blu të Shqipërisë (nëntor 2020).

⁴⁸ OJF HYDRA (2019): Regjistrimi dhe analiza e kostos së peshkimit në shkallë të vogël (artizanale).

⁴⁹ OJF HYDRA (2019): Regjistrimi dhe analiza e kostos së peshkimit në shkallë të vogël (artizanale).

⁵⁰ MBZHR 2021: Studimi i Sektorit të Peshkimit; përgatitur nga AGT International/DSA, në kuadër të Projektit GIZ-SRD, maj 2021.



karavidhja norvegjeze, barbuni i kuq dhe peshq të ndryshëm detarë (MBZHR, 2020).

Struktura e sektorit të përpunimit të peshkut

Sektori i përpunimit të peshkut është pothuajse ekskluzivisht i orientuar drejt tregut të eksportit. Në Shqipëri, të **28 kompanitë përpunuese**, të cilat janë të gjitha të **licencuara për eksport në tregun e BE-së**, operojnë në zonat e Shkodrës, Shëngjinit, Durrësit, Elbasanit dhe Tiranës me qendrat kryesore në qytetet Elbasan, Lezhë, Durrës dhe Sarandë⁵¹. 10 prej këtyre kompanive kanë akses edhe në aktivitetet e akuakulturës. 20 kompanitë më të mëdha të përpunimit, nga të cilat disponohen të dhëna, përpunojnë 17,881 tonë në vit (në vitin 2019, mesatarisht 894,05 tonë në vit, duke arritur nga 5 në 3,800 tonë) me një **nivel të ulët të shfrytëzimit të kapacitetit të tyre prej 39,03%**. Investimet në industrinë përpunuese arrijnë në më shumë se 40 milionë euro në vitin 2019 (MBZHR 2020). Përveç përputhshmërisë me standardet e BE-së, operatorët e përpunimit të peshkut vërtetojnë përputhshmërinë e aktivitetit të tyre të përpunimit nëpërmjet standardeve private të sigurisë dhe cilësisë si standardi “Ushqimi me cilësi të sigurt”, ai i “Konsorciumi Britanik i Shitjes (BRC)” për shitjen me Pakicë ose Standardi Ndërkombëtar i Ushqimit.

Tendencat në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare për përpunimin, eksportin dhe importin e peshkut.

Konsumi i ushqimeve të detit në Shqipëri është ende relativisht i ulët, sipas standardeve ndërkombëtare me një mesatare prej 5.3 kg për frymë krahasuar me një mesatare globale prej 16.3 kg për frymë. Si kërkesa e brendshme ashtu edhe ajo për eksport mund të pritet të rritet në terma afatgjatë, për shkak të rritjes së pritshmërisë së konsumatorëve dhe standardit të jetesës, që lidhet me anëtarësimin në BE.⁵²

Tregu vendës, për shkak të çmimeve më interesante në vendet e BE-së dhe madhësisë së tij të kufizuar, përbën vetëm një pjesë minimale të produkteve të peshkut të përpunuar, të vlerësuar **në më pak se 5% të prodhimit** (MBZHR 2020).

Bazuar në programin e QSH-së, MBZHR-ja ka prioritet ndërtimin/rehabilitimin e katër tregjeve të shitjes me shumicë të peshkut. Katër portet e mëdha të peshkimit në Shqipëri (Durrës, Vlorë, Shëngjin, Sarandë) janë në faza të ndryshme zhvillimi dhe amortizimi. Tregu i Shëngjinit është tregu i parë me shumicë i peshkut në Shqipëri që është inauguruar së fundmi. Tregu i shitjes me shumicë në portin e peshkimit të Vlorës është në ndërtim e sipër dhe do të përfundojë së shpejti. Në vitin 2022, investimet në rivendosjen e qendrës frigoriferike në portin e peshkimit të Durrësit do të fillojnë për ta kthyer atë në një treg të vërtetë me shumicë të peshkut. Me ndërtimin e portit të ri të Sarandës do të përfundojë cikli i tregtisë me shumicë në katër portet e mëdha të peshkimit.

Shumë anije peshkimi kanë lidhur kontrata paraprake (ose marrëveshje) me qendrat e grumbullimit të peshkut që përfshijnë çmimet kryesisht të fiksuara paraprakisht. Në kushtet e ndryshimit të përditshëm të çmimeve të produkteve të peshkut nga bursat në mbarë botën, çmimet fikse shpesh nuk pasqyrojnë çmimet reale të tregut për hir të anijeve të peshkimit. Megjithatë, për shkak të teknologjisë së vjetruar të anijeve dhe mungesës së investimeve edhe në arka etj., peshku shpesh nuk pastrohet dhe sistematizohet, gjë që nënkupton kosto shtesë për pikat e grumbullimit të peshkut për përgatitjen e produkteve për tregun e brendshëm dhe për eksportin.

Tregu i BE-së përfaqëson **kanalin kryesor tregtar për produktet e përpunuara të peshkut**.⁵³ Eksporti tregon një trefishim ndërmjet vitit 2020 ndaj 2013, duke arritur në vlerën 104 milionë euro. Zhvlerësimi i euros në lekë ka ndikuar negativisht në vlerën e produkteve të eksportuara që nga viti 2018. Shifrat nuk përfshijnë rritjen e vlerës së nënprodukteve (p.sh., nënproduktet e përpunimit të karkalecave). Produktet e përpunuara nuk janë mjaftueshëm të larmishme dhe vlera e tyre e shtuar është e ulët. Mbi 70% e eksporteve janë açuget e përgatitura ose të konservuara. Kuotat e eksportit në BE për açuget e përpunuara (1600 tonë) dhe sardelet (100 tonë) kufizojnë kompanitë e përpunimit për t'u zgjeruar. Produktet shtesë përfshijnë fileto peshku

⁵¹

https://webgate.ec.europa.eu/sanco/traces/output/AL/FP_AL_en.pdf

⁵² Banka Botërore (2020): Realizimi i Potencialit të Ekonomisë Blu të Shqipërisë (nëntor 2020).

⁵³

https://webgate.ec.europa.eu/sanco/traces/output/AL/FP_AL_en.pdf


të kripur, sepje të ngrira, karkaleca deti të përgatitura, karkaleca deti të ngrira dhe karkaleca deti dhe ton të konservuar.

Kontributi në PBB-në dhe punësimin në sektorin e peshkimit

Kontributi i sektorit të peshkimit në ekonominë shqiptare është relativisht i ulët në masën e 0,79% të PBB-së (2019, INSTAT 2020), ku nuk përfshihet industria e përpunimit të peshkut. Kontributi i tij në **punësimin** total është, gjithashtu, në zhvillim, me një punësim total me kohë të plotë prej 9,279 personash në vitin 2020.

Megjithatë, peshkimi luan një rol të rëndësishëm social-ekonomik për komunitetet bregdetare dhe zonat e largëta të brendshme për sa i përket gjenerimit të të ardhurave, punësimit dhe ushqimit, si dhe për punësimin e grave në fabrikat e përpunimit të peshkut. 90% e 5100 personave të punësuar në kompanitë e përpunimit të peshkut dhe në shërbimet ndihmëse janë gra. Një numër i kufizuar grash janë të punësuar edhe në peshkimin aktiv, kryesisht në anijet e peshkimit familjar dhe në fermat e peshkut.

Figura 3-1: Punësimi në sektorin e peshkimit (2019)



Burimi: MBZHR (2020)

Shifrat e punësimit në peshkimin në ujërat e brendshme dhe në peshkimin bregdetar detar nuk pasqyrojnë situatën aktuale të punësimit në këtë sektor. Vlerësohet se **disa mijëra peshkatarë** nxjerrin të ardhura nga peshkimi, kështu që sektori i peshkimit luan një rol të rëndësishëm social-ekonomik në jetesën bregdetare dhe rurale, i cili nuk përfshihet plotësisht në të dhënat statistikore zyrtare të disponueshme.

Ekonomia blu, turizmi blu

Burimet bregdetare dhe detare janë pasuri ekonomike të vlefshme, potenciali i plotë i të cilave ende nuk është eksploruar në Shqipëri. Ndërkohë që investimet publike në **ekonominë blu të**

qëndrueshme janë integruar në nivel kombëtar⁵⁴, përmirësimi i kushteve për zhvillimin e ekonomisë blu të qëndrueshme dhe për heqjen e pengesave për të lehtësuar investimet dhe zhvillimin e tregjeve dhe teknologjive ose shërbimeve të reja është pjesë e politikës së peshkimit.

Për të vazhduar përpjekjen e saj drejt qëndrueshmërisë, rritja blu mbështetet nga

⁵⁴ Shih, gjithashtu, Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2019–2022 dhe Planin e Veprimt, i cili është në përputhje me elementet kryesore të SBERAJ 2021–2027. Këto të fundit përfshijnë veprime për përmirësimin e niveleve të aftësive dhe ekspertizës për fuqinë punëtore në sektorin detar dhe ekonominë blu, të planifikuara për t'u mbështetur në kuadër të IPA III "Mbështetje për sektorin e turizmit detar dhe nxitjen e ekonomisë blu (40 milionë euro) në Qeverinë Shqiptare (05/2021): Përgjigja strategjike e draftit të përgjigjes IPA III.

transferimi dhe përvetësimi i kërkimit dhe inovacionit, investimi në biznese të reja detare dhe në bioekonominë, duke përfshirë modelet e qëndrueshme të turizmit, të cilat mund të krijojnë vende pune dhe në të njëjtën kohë të përmirësojnë zhvillimin në nivel lokal kaq i rëndësishëm në nivel social-ekonomik dhe kulturor për komunitetet bregdetare. Përfitimet e një **turizmi blu** të qëndrueshëm për të tërhequr më shumë turistë për aktivitetet rekreative bregdetare dhe detare nuk janë vlerësuar ende. Mundësi të mëtejshme qëndrojnë në zhvillimin e aktiviteteve ekonomike të energjisë së rinovueshme të bazuar në hapësirat detare⁵⁵.

3.2.4.2 Politika 2. Objektivi specifik 10: Nxitja e peshkimit të qëndrueshëm dhe ruajtja e burimeve biologjike detare

Mbrojtja e mjedisit, klimës dhe biodiversitetit, kontributi për zbatimin e Agjendës së Gjellbër të vendeve të Ballkanit Perëndimor

Rritja e prodhimit të akuakulturës ka ndikim të rëndësishëm në shfrytëzimin e burimeve ujore dhe ndotjen e mundshme të tyre. Akuakultura luan një rol të rëndësishëm në rritjen e përdorimit të antibiotikëve për parandalimin e sëmundjeve. Dendësia e lartë e stokut në akuakulturë favorizon shfaqjen e sëmundjeve të shumta që mund të transmetohen edhe në stoqet e egra. Nënsektori i akuakulturës në Shqipëri tregon disa shembuj të mirë që shkojnë përtej respektimit të standardeve minimale. Disa ferma aplikojnë një numër të reduktuar peshqish në kafaze për të siguruar një cilësi më të mirë të produktit me pasojë përmirësimin e kushteve të mirëqenies. Dy ferma të akuakulturës detare në Shqipëri kanë marrë një certifikim pa antibiotikë.

Peshkimi mbi normë në detin Adriatik dhe Jon ka një ndikim të drejtpërdrejtë në biodiversitetin, veçanërisht kur ekspozohet ndaj ndryshimeve klimatike. FAO vlerëson se deri në 80% e stokut të peshkut brenda zonave ekonomike ekskluzive të Shqipërisë është i mbishfrytëzuar.⁵⁶ Me ndikimet antropogjene që rrisin vazhdimisht presionin e tyre mbi rezervat e peshkut, nocioni i një sektori të orientuar nga prodhimi është sfiduar nga nevoja për një qasje ekosistemi ndaj peshkimit. Do të ishte

e domosdoshme të ndiqet kjo qasje edhe në të ardhmen, duke promovuar iniciativë, që mbështeten në një qasje ekosistemi ndaj peshkimit, duke përfshirë restaurimin e ekosistemeve të pasura me karbon dhe zona të mjaftueshme për riprodhimin dhe rritjen e larvave të peshqve për të trajtuar barrierat për menaxhimin e qëndrueshëm të peshkimit (p.sh. mbipeshkimi, peshkimi PPPP dhe praktikatat shkatërruese të peshkimit, ndryshimet klimatike, humbja e biodiversitetit dhe ndotja detare, duke përfshirë mbetjet detare dhe speciet joindigjene).

Mbetjet e ngurta që gjenden në Shqipëri nga akuakultura detare intensive, jo vetëm prekin zonën përreth, por mund të ndryshojnë edhe një zonë më të gjerë bregdetare në nivele të ndryshme të ekosistemeve, duke reduktuar kështu biomasën dhe dendësinë e specieve. Përveç kësaj, peshqit e larguar nga fermat e akuakulturës mund të shkaktojnë, gjithashtu, kontaminim gjenetik të popullatave të egra.

Dendësia e peshkut është më e ulët se standardet e BE-së, megjithatë të dhënat mungojnë dhe dendësia ideale duhet të vlerësohet, sipas parametrave të tillë si përqendrimi i oksigjenit dhe rrjedha/shkëmbimi i ujit, mbetjet e fermës në mjedis me referencë specifike për gjallesat, planktone dhe nektone, dhe rrjetat ushqimore natyrore.

Anëtarësimi në marrëveshje ndërkombëtare

Si palë kontraktuese në KPPM, Shqipëria zbaton rekomandimet e saj, të tilla si masat për të kufizuar përpjekjet e peshkimit në rezervat e vogla pelagjike, miratimi i planeve shumëvjeçare të menaxhimit për ruajtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të ngjallës evropiane dhe është gati të miratojë planin shumëvjeçar të menaxhimit për aktivitetet e qëndrueshme të peshkimit në detin Adriatik. Shqipëria zbaton rekomandimin e KPPM-së për numrin e Organizatës Ndërkombëtare Detare (OND) të caktuar për anijet metalike të peshkimit mbi 24 metra.

Një marrëveshje bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut është nënshkruar në fund të vitit 2020 për ruajtjen, monitorimin dhe menaxhimin e peshkimit në liqenin e Ohrit dhe liqenin e Prespës.

Shqipëria ka nënshkruar **Deklaratën MedFish4Ever të Maltës** për qëndrueshmërinë e peshkimit në Mesdhe (një nismë e BE-së për të

⁵⁵ Banka Botërore (2020): Realizimi i Potencialit të Ekonomisë Blu të Shqipërisë (nëntor 2020).

⁵⁶ Banka Botërore (2020): Realizimi i Potencialit të Ekonomisë Blu të Shqipërisë (nëntor 2020).



kthyer peshkimin në Mesdhe për qëndrueshmëri dhe në këtë mënyrë për të ruajtur rritjen ekonomike dhe vendet e punës) dhe deklaratën e konferencës së nivelit të lartë të peshkimit artizanal në shtator 2018 në Maltë.

Kuadri administrativ dhe institucional

Që nga viti 2005, administrata shqiptare e peshkimit dhe akuakulturës në nivel kombëtar ka

pësuar ndryshime të konsiderueshme. Një strukturë e konsoliduar administrative u krijua vetëm pas vitit 2012 dhe në vitin 2013 kur administrata e peshkimit u zhvendos nga MTE në MBZHR. Bazuar në Strategjinë e Peshkimit 2016-2021, në MBZHR është krijuar Drejtoria për Peshkimin dhe Akuakulturën.

Politika 2. Objektivi i përgjithshëm 4

Tabela 3-10: Mundësitë dhe kërcënimet – Objektivi i përgjithshëm 4

PESHKIMI DETAR	
MUNDËSITË	KËRCËNIMET
Diversifikimi në peshkimin e specieve të reja dhe të nënshfrytëzuar, p.sh. specie të vogla pelagjike dhe molusqe. Menaxhimi shumëvjeçar i peshkimit. Menaxhimi i ekosistemit të peshkimit. Më shumë peshkim selektiv. Ngritja e kapaciteteve për peshkatarët dhe menaxherët/studuesit.	Ndryshimet klimatike dhe ndotja detare. Peshkimi PPPP. Margjinalizimi nga KPPM-ja dhe mundësi të tjera të përbashkëta të menaxhimit të peshkimit, për shkak të kufizimeve buxhetore. Mbishfrytëzimi i detit Adriatik dhe Jon.
PESHKIMI NË LAGUNA DHE NË UJËRAT E BRENDSHME	
MUNDËSITË	KËRCËNIMET
Zhvillimi i ekoturizmit. Menaxhimi i ekosistemeve të peshkimit në laguna me agjenci të tjera. Koordinimi i basenit ujor ndërmjet agjencive dhe OMP-ve. Pikat e përcaktuara të zbarkimit (për të përmirësuar mbledhjen, kontrollin dhe marketingun e të dhënave).	Ndotja nga sektorët e tjerë. Zhvillimi i pakontrolluar bregdetar dhe liqenor. Ndikimet në biodiversitet nga futjet e pakontrolluara të specieve joindigjene.
AKUAKULTURA	
MUNDËSITË	KËRCËNIMET
Politikë e favorshme e qeverisë për sektorin. Legjislacioni që parashikon peshkimin në ujërat e brendshme është në përputhje me standardet e BE-së. Sektori i turizmit është në zhvillim dhe destinacionet e brendshme kanë atraksione natyrore, përfshirë, gjithashtu, liqenet natyrore që bëhen më tërheqëse, dhe peshkimin sportiv apo rekreativ. Peshkimi i bazuar në kulturë mund të krijojë kërkesë të madhe që në lumenj dhe liqene të grumbullohet peshku troftë dhe krap. E ardhmja sfiduese e kapjeve dhe kërkesa në rritje për peshq krijojnë një mundësi të favorshme për akuakulturën detare. Rritja e vëmendjes për zbatimin e kërkesave lidhur me ndotjen e mjedisit.	Ndryshimet klimatike, që ndikojnë në kushtet mjedisore kritike për prodhimin (p.sh., temperatura e ujit). Ndryshimi i zakoneve ushqimore të konsumatorëve (vetëm akuakultura e ujërave të ëmbla). Rritja e presionit të zhvillimit urban redukton burimet e disponueshme ujore. Ato duhet të përcaktohen për përdorimet e tij (peshkimi, prodhimi i energjisë, ujitja ose uji i pijshëm). Konkurrencë e lartë nga prodhues të mëdhenj të huaj (Greqi, Turqi). Mungojnë mundësitë për trajnim për prodhuesit e peshkut. Mbi peshkimi i peshqve të mëdhenj dhe të vegjël të ujërave të ëmbla vendëse mund të ndryshojë ekuilibrin e kërkuar të faunës së peshkut në liqenet natyrore.
SEKTORI I PËRPUNIMIT TË PESHKUT	
MUNDËSITË	KËRCËNIMET
Politika e favorshme e qeverisë për sektorin. Tregjet ndërkombëtare mund të thithin sasi të mëdha dhe një gamë të gjerë tipologjike të produkteve. Kërkesa e tregut të brendshëm pritet të rritet. Tregu ndërkombëtar shpërblen prodhimin organik. Tregje të reja të pa eksploruara jashtë BE-së.	Kuotat e BE-së ndikojnë shumë në sektor. Krizat financiare mund të ndikojnë shumë në sektor dhe të kërkojnë gatishmëri për t'u afruar tregjeve të reja. Ofertë e kufizuar e shërbimit cilësor të mirëmbajtjes së pajisjeve.
INSTITUCIONALE/LIGJORE	
MUNDËSITË	KËRCËNIMET
Përafrimi i mëtejshëm me PPP të reformuar të BE-së ofron	Kufizimet buxhetore.



akses në njohuri dhe financim.	Ndryshimi i kërkesave rregullatore të BE-së.
MARKETINGU DHE TREGTIA	
MUNDËSITË	KËRCËNIMET
Zhvillimi i mëtejshëm i OP-ve të lidhura me OMP-të ekzistuese. Futja e tregjeve me shumicë në vendndodhje kyçe p.sh., rinovimi me kosto të ulët i ndërtesave ekzistuese në Vlorë dhe Shëngjin. Pajtuueshmëri më e madhe me rregulloren e BE-së për cilësinë dhe sigurinë e ushqimit. Gjurmueshmëri më e madhe e produkteve të detit. Vlerë më e madhe e shtuar përmes përpunimit, zhvillimit të produktit dhe markës. Sistemi i informacionit të tregut dhe çmimeve për produktet e peshkimit. Lidhja e turizmit me prodhimin e prodhimeve të detit.	Vazhdimi i tregtisë informale. Dështimi i institucioneve kombëtare për të mbështetur zhvillimin e sektorit privat.
ASPEKTET SOCIALE/EKONOMIKE	
MUNDËSITË	KËRCËNIMET
Norma preferenciale të kreditimit për zhvillim të qëndrueshëm. Rritja e njohjes së vlerës sociale-ekonomike dhe kulturore të peshkimit në komunitetet bregdetare dhe rurale. Anëtarësimi i mundshëm në BE për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe “zhvillimin blu”. Mbështetje politike dhe rregullatore për diversifikimin e të ardhurave.	Paqëndrueshmëria globale ekonomike dhe politike. Norma të larta të interesit të huadhënies tregtare. Reduktimi i rentabilitetit do të ndikojë në investime të reja në këtë sektor. Presionet sociale-ekonomike që nxisin peshkimin PPPP (veçanërisht në liqene).

Identifikimi i ndërhyrjeve sipas nevojave në kuadër të politikës 2, objektivit të përgjithshëm 4

4.1 Përmirësimi i infrastrukturës portuale dhe vendeve të zbarkimit

Infrastruktura portuale e anijeve të peshkimit, pavarësisht ndërhyrjeve të viteve të fundit, duhet të përmirësohet më tej, në lidhje me shërbimet bazë (p.sh. furnizimi me energji elektrike, ujë, depozitimi i mbetjeve, objektet sanitare, stacionet e karburantit) dhe infrastruktura specifike portuale (p.sh., basenet e portit, vendankorimet, bankina, pontonet e fiksimit, ankorimet, vendet e zbarkimit, objektet e riparimit dhe të mirëmbajtjes së anijeve të peshkimit, tregjet e shitjes me shumicë të peshkut dhe infrastruktura hyrëse në portet e peshkimit). Më tepër infrastrukturë dhe përmirësimi i infrastrukturës bazë dhe specifike të marinës do t'i bëjë më të shpejta procedurat e shkarkimit të peshkut dhe do të rrisë cilësinë e produktit në destinacion (kanalet e shpërndarjes). Përmirësimi i infrastrukturës portuale do të rezultojë në një pjesë më të madhe të kapjes totale që zbarkohet në portet e Shqipërisë, duke përfshirë një hapësirë të dedikuar për kantieret detare, të cilat aktualisht riparohen jashtë shtetit.

4.2 Ndërtimi i tregjeve të peshkut me shumicë

Finalizimi i ndërtimit të katër tregjeve me shumicë të peshkut në Shëngjin, Vlorë, Sarandë dhe Durrës, sipas prioriteteve dhe programit të Qeverisë Shqiptare. Tregu i peshkut i Shëngjinit është i pari në Shqipëri që është inauguruar së fundmi. Tregu i shitjes me shumicë në portin e peshkimit të Vlorës është në ndërtim e sipër dhe do të përfundojë në brenda vitit 2022. Në vitin 2022, do të përgatitet projekti për qendrën frigoriferike në portin e peshkimit të Durrësit, për ta kthyer atë në një tregti të vërtetë peshku me shumicë. Me ndërtimin e portit të ri të Sarandës do të përfundojë cikli i tregtisë me shumicë në katër portet e mëdha të peshkimit.

4.3 Mbështetje për anijet e peshkimit pa rritur përpjekjet e peshkimit dhe për organet përfaqësuese sektoriale dhe shoqatat

Anijet e peshkimit në Shqipëri janë të amortizuara dhe kanë një moshë mesatare 49 vjet. Ato duhet të rinovohen për të rritur sigurinë në bord, standardet e sigurisë ushqimore dhe kushtet e punës për peshkatarët, si dhe për të reduktuar ndikimin negativ në mjedis. Në të njëjtën kohë, investimet në modernizimin e anijeve të peshkimit



nuk duhet të rrisin përpjekjet e peshkimit. Rinovimi i flotës së peshkimit mbështetet financiarisht edhe nga skemat kombëtare.

Sektori privat si objektivi përfundimtar i politikave kombëtare duhet të luajë një rol edhe në zhvillimin e politikave. Për këtë qëllim, duhet të forcohen kapacitetet e organeve përfaqësuese sektoriale dhe të shoqatave që nga njëra anë të mund të rrisin anëtarësimin dhe shtrirjen e tyre brenda sektorit, dhe nga ana tjetër të mund të artikulojnë nevojat e sektorit privat. Gjithashtu, vendosja e dialogut publik-privat mund të përmirësojë më tej formulimin dhe zbatimin e politikave.

4.4 Mbështetje për PSHV-në në përputhje me planin e veprimit të KPPM-së

Kërkohet mbështetje e peshkimit artizanal bregdetar në shkallë të vogël, për të përmirësuar dhe kontrolluar kushtet e aksesit në ujëra dhe burime ujore, për të promovuar organizimin e zinxhirit të prodhimit, përpunimin dhe tregtimin e produkteve të peshkimit, për të mbështetur nismat vullnetare për të reduktuar sforcot e peshkimit, për të nxitur mbrojtjen e burimeve dhe përdorimin e teknologjive të reja (teknikat e peshkimit që rrisin selektivitetin përtej atyre të parashikuara nga legjislacioni dhe që nuk rrisin sforcot e peshkimit).

4.5 Zhvillimi i mëtejshëm i akuakulturës detare dhe të brendshme

Studimi për përcaktimin e ZAA-ve në zonën detare ka përfunduar nga MBZHR-ja dhe pritet miratimi nga Qeveria e Shqipërisë. Këto procedura duhet të thjeshtohen për të përshpejtuar zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të akuakulturës detare dhe të brendshme në Shqipëri.

Mbivendosja ndërmjet sferave ekonomike dhe mjedisore në akuakulturë kërkon adoptimin e qasjeve të bazuara në ekosistem për menaxhimin dhe zhvillimin e sektorit. Miratimi i qasjes së bazuar në ekosistem do të mund të menaxhojë konflikte të tilla dhe të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm. Konkretisht në akuakulturë, duhet të adoptohet qasja e ekosistemit ndaj akuakulturës (EAA), si një strategji për integrimin e aktivitetit brenda ekosistemit më të gjerë, në mënyrë që të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm, barazinë dhe qëndrueshmërinë e sistemeve të ndërlidhura sociale-ekologjike.

4.6 Teknologjitë inovative dhe specie të reja për sektorin e përpunimit të peshkut dhe sektorin e akuakulturës

Sektori i përpunimit të peshkut është një sektor jetik ekonomik, me perspektiva zhvillimi në rritje të shpejtë dhe premtuese. Produktet e peshkimit me cilësi të lartë konkurrojnë gjithnjë e më shumë me sukses në tregjet ndërkombëtare. Futja e teknologjive të reja të përpunimit, të cilat janë miqësore me mjedisin dhe mbështesin vendosjen e ekonomisë me cikël të mbyllur, duke përfshirë prodhimin e ushqimit të peshkut nga mbetjet, si dhe zgjerimi i specieve të reja për qëllime përpunimi dhe akuakulture, do të zhvillonte më tej sektorin e peshkimit. Shtimi i vlerës së produkteve të peshkut të prodhuar në vend do të rrisë të ardhurat nga eksportet, duke krijuar njëkohësisht vende pune dhe të ardhura. Zhvillimi i produkteve të reja me vlerë të shtuar, si ushqimi i përgatitur ose futja e produkteve të reja me vlerë të shtuar më të lartë, siç janë prodhimet e detit të qëndrueshëm dhe organik, kërkojnë rritjen e kapacitetit të inovacionit përgjatë zinxhirit të vlerës. Sistemi i përmirësuar i inovacionit të peshkimit dhe akuakulturës do të kërkojë bashkëpunimin e qeverisë, akademisë dhe industrisë. Gjithashtu, përfshirja e interesave të shoqërisë civile dhe të mjedisit natyror si pjesë integrale e sistemit të inovacionit do të sigurojë një kontribut pozitiv të sektorit në zhvillimin social dhe qëndrueshmërinë mjedisore.

4.7 Rritja e prodhimit të produkteve të certifikuara të qëndrueshme të peshkimit

Për shkaqe antropogjene, të tilla si peshkimi i tepërt dhe shkatërrimi i mjedisit, mjediset detare janë aktualisht nën presion të jashtëzakonshëm. Megjithatë, kërkimet sugjerojnë se peshkimi mund të rikuperojë ose të stabilizojë popullatat peshkore, nëpërmjet një menaxhimi të përgjegjshëm dhe zbatimit të rregullave. Nëpërmjet certifikimit të produkteve të peshkimit të qëndrueshëm, konsumatori e di se produkti është prodhuar në mënyrë të qëndrueshme. Ky mjet vendimtar inkurajon konsumatorët të bëjnë zgjedhje miqësore me mjedisin, por, gjithashtu siguron një përfitim financiar për prodhuesit.

4.8 Ristrukturimi dhe fuqizimi institucional i administratës së peshkimit

Administrata e peshkimit ka qenë subjekt i ndryshimeve të vazhdueshme gjatë viteve të fundit.



Është i nevojshëm harmonizimi jo vetëm i legjislacionit, por edhe i administrimit të peshkimit në nivel qendror dhe vendor me praktikën dhe standardet aktuale të BE-së, në mënyrë që të forcohet kontributi i sektorit të peshkimit dhe akuakulturës në ekonomi dhe Shqipëria të përgatitet për anëtarësimin në BE.

4.9 Krijimi i një Qendre Kërkimore Kombëtare për Shkencat e Peshkimit

Një autoritet kombëtar kërkimor i organizuar dhe i administruar mirë mund të veprojë si krahu ekzekutiv i Komisionit për Koordinimin e Kërkimeve Shkencore, Teknologjike dhe Ekonomike të krijuar me ligjin nr. 64/2012, “Për peshkimin”, i aftë për të organizuar, analizuar, grumbulluar dhe ruajtur një sistem të dhënash për të gjitha aktivitetet e akuakulturës dhe peshkimit në Shqipëri. Gjithashtu, nëpërmjet një autoriteti kombëtar kërkimor, organizatat e sektorit publik, partneritetet kërkimore dhe inovative, organet organizuese të sektorit, nismat e certifikimit ekologjik dhe biologjik dhe integrimi i zinxhirit të vlerës mund të mbështeten më mirë. Laboratori i akuakulturës dhe peshkimit në Shqipëri, pjesë e strukturës institucionale, por të pavarur, mund të bëhet sërish një institut.

Një qendër kombëtare kërkimore do të përmirësojë menaxhimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të rezervave të peshkut, si dhe do të përmirësojë mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave. Qendra Kombëtare e Kërkimit mund të ketë edhe funksionin e një qendre ekselence për shkencat detare në Shqipëri, duke hapur mundësi për aktivitete dhe bashkëpunime të përbashkëta midis shkencëtarëve dhe universiteteve shqiptare dhe ndërkombëtare dhe nxit bashkëpunimin rajonal midis vendeve të Detit Adriatik dhe Jon.

4.10 Rritja e eksporteve të produkteve cilësore të peshkimit

Një element vendimtar për rritjen e eksporteve të peshkut të përpunuar është negociimi për rritjen e kuotave të peshkut si açuget dhe sardelet. Industria e përpunimit të peshkut po përdor vetëm pjesërisht kapacitetin e saj dhe përpunon kryesisht peshkun e importuar për llogari të kompanive të huaja. Kjo vlen edhe për llojet e tjera të peshqve detarë si skumbri ose të gjitha llojet e ngjashme me tonin.

Mbështetja e prodhimit dhe e përpunimit të molusqeve do të rrisë edhe eksportet. Shumë

bivalvë dhe dekapodë apo lloje të tjera molusqesh janë produkte të shtrenjta në treg, gjë që do të reflektohej në rritjen e vlerës monetare të eksporteve shqiptare.

Me miratimin e ZAA-ve, zona e kultivimit të peshkut detar mund të zgjerohet dhe eksportet e produkteve të peshkut të rriten. Rritja e akuakulturës së troftës dhe akoma më shumë përpunimi i troftës në formë filetimi do të rriste sasinë e eksportuar. Kthimi i akuakulturës së karkalecave në zonat bregdetare do të ishte një element thelbësor për rritjen e eksportit.

Produktet e ushqimit të detit, qoftë të tregtuara dhe të konsumuara në vend ose të eksportuara, duhet të tregojnë pajtueshmëri me kërkesat dhe standardet e cilësisë dhe sigurisë që mbulojnë të gjithë zinxhirin e vlerës nga furnizimet, produktet, paketimet etj. Për të përmbushur kërkesat e tilla, së pari kapaciteti i përgjithshëm i operatorëve të vlerës së zinxhirit përgjatë zinxhirit të vlerës duhet të forcohen për të qenë në gjendje të ndjekin procedurat standarde operacionale në përputhje me standardet dhe rregulloret në fuqi.

4.11 Përmirësimi i kapaciteteve të trajnimit dhe arsimimit, teknologjisë dhe inovacionit

Duke marrë në konsideratë objektivat afatgjatë të sektorit, ka një hendek të konsiderueshëm ekspertize në industri. Arsimi i lartë, si dhe trajnimi dhe arsimi teknik dhe profesional (AFP) mund të luajnë një rol të rëndësishëm në mbylljen e këtij boshllëku duke përmirësuar metodat, duke përfshirë tema të tilla, si: mirëqenia e peshqve, parandalimi i sëmundjeve, sistemet e prodhimit intensiv, ushqimet për kafshë etj. Përmirësimi i kapaciteteve nëpërmjet aktiviteteve të trajnimit dhe ekstensionit, si dhe investimet në institucionet arsimore duhet të trajtohen më plotësisht, në mënyrë që sektori i akuakulturës të japë kontributin e tij në nivelin e jetesës dhe sigurimin e ushqimit.

Është urgjente që sektori publik të investojë në arsimin e lartë për modernizimin e sektorit të peshkimit dhe akuakulturës, duke i kushtuar vëmendje të veçantë akuakulturës së peshkut detar. Nuk ekziston asnjë fermë mbarështimi eksperimentale ose tregtare e llojeve të peshqve detarë, megjithëse ka disa prej tyre në vendet fqinje. Përmirësimi i ndërveprimit të shkencëtarëve shqiptarë në projektet rajonale të peshkimit dhe akuakulturës të Komisionit Këshillimor Evropian për Peshkimin dhe Akuakulturën e Brendshme



(KKEPUBA), anëtare e të cilit është Shqipëria. Organizimi i trajnimit me operatorët e peshkimit, universitetin dhe organizatat e peshkimit, duhet të kthehet në një praktikë të përhershme.

4.12 Mbështetje për zhvillimin e një ekonomie blu të qëndrueshme

Valorizimi i burimeve bregdetare dhe detare varet nga transferimi dhe përvetësimi i kërkimit dhe i inovacionit, investimi në biznese të reja detare dhe në bioekonominë, duke përfshirë modelet e qëndrueshme të turizmit, të cilat mund të krijojnë vende pune dhe në të njëjtën kohë të rrisin zhvillimin e orientuar në vend.

Politika 3. Objektivat ndërsektoriale

3.2.5 Politika 3. Objektivi ndërsektorial 1: Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative drejt përafrimit me *acquis* të BE-së

Shqipëria si një vend **kandidat për anëtarësim në BE** dhe në fazë përgatitjeje për negociatat për anëtarësimin ka një sfidë të dyfishtë: të rrisë konkurrenshërinë e saj ndërkohë që përrputh legjislacionin e saj me *acquis* të BE-së. Përrputhja e legjislacionit implikon vendosjen dhe zbatimin e standardeve të reja për sektorin e bujqësisë. Kjo nuk është vetëm një sfidë institucionale që lidhet me transpozimin dhe kapacitetin institucional për monitorim dhe kontroll të zbatimit të tij, por kryesisht është një sfidë për sektorin privat (fermerë, agropërpunues e të tjerë aktorë) për të përballuar kostot për investime të reja dhe për funksionimin dhe mirëmbajtjen e tyre të mëtejshme për t'u përshtatur me kërkesat dhe reformat e nevojshme.

Mbështetja e fortë publike për sektorin agroushqimor dhe kuadri ligjor efektiv varet në një masë të madhe nga kapaciteti institucional dhe administrativ, por edhe i aktorëve të sektorit privat për të përgatitur dhe zbatuar reformat dhe politikat publike që do të adresojnë në mënyrë eficiente nevojat dhe mundësitë e sektorit dhe të aktorëve që veprojnë në këta sektorë për të realizuar reformat e kërkuara në procesin e përafrimit/anëtarësimit në BE.

Ndërrhyrjet afatshkurtër dhe afatmesme që do të adresohen sipas kapitujve të negociimit në fushën e përgjegjësisë të MBZHR-së.

Në kuadër të kapitullit 11 – Bujqësia dhe zhvillimi rural

Krijimi i **Rrjetit të të Dhënave të Kontabilitetit të Fermave (FADN)**, pranë një njësie të veçantë në MBZHR, do të krijojë data bazën e të dhënave të domosdoshme, të cilat ofrojnë evidence të mirëqena që do të lejojë një të kuptuar të drejtë të tendencave të ndryshme në sektor si bazë për të hartuar politika të bazuara në prova.

Zbatimi i **Regjistrimit të Fermave**, si pjesë e **Sistemit të Integruar të Administrimit dhe Kontrollit** (SIK), siguron regjistrimin unik të çdo përfituesi të fondeve publike. Përdoruesi kryesor i Regjistrimit të Fermave është AZHBR-ja dhe departamenti i TI-së i integruar në strukturën e saj.

Regjistrimi i kafshëve (sistemi RUDA) i MBZHR-së është kryesisht funksional. Baza për digjitalizimin e sistemit RUDA është harmonizuar. Zbatimi i tij është planifikuar për vitin 2024. Sistemi RUDA është integruar në sistemin e thertoreve, që nga data 15.10.2021.

Informacione të tjera që mungojnë janë statusi shëndetësor i kafshëve të fermave dhe rezultatet e ushqimit të kafshëve (nga këndvështrimi i sigurisë ushqimore) janë duke u plotësuar gjatë gjysmës së parë të 2022-shit.

Autoriteti Menaxhues IPARD (IPARD AM) dhe Agjencia e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (AZHBR), si Agjencia IPARD duhet të konsolidohen më tej për të garantuar një proces të shpejtë dhe pa probleme të thirrjeve për aplikime dhe përkatësisht përpunimit të aplikimeve, dhe ndër të tjera, për të reduktuar numrin e projekteve të refuzuara për arsye të mospërshtatshmërisë me kriteret. Autoriteti menaxhues po përgatit akreditimin e masave për IPARD III.

Përgatitja për akreditimin dhe zbatimi i pesë masave shtesë të planifikuara në kuadër të Programit **IPARD III 2021–2027**, që janë: i. zbatimi i qasjes LEADER – *Liaison entre actions de développement de l'économie rurale* (LEADER); ii. mbështetja e Shërbimit këshillimor; iii. masat agromjedis – klimë dhe bujqësi organike; iv. investimet në infrastrukturën publike rurale; dhe v. krijimi dhe mbrojtja e pyjeve, i kërkon burime shtesë, staf të konsiderueshëm dhe zgjerimin e sistemit të TI-së me Regjistrin e Fermave dhe një sistem kontrolli të bazuar në sipërfaqen – sistemi i identifikimit të parcelave të tokës (SIPT).

Masa IPARD TA luan një rol të rëndësishëm në konsolidimin e strukturës operacionale të



IPARD, si dhe për financimin e aktiviteteve mbështetëse për përgatitjen dhe zbatimin e masave, si p.sh. kryerja e studimeve dhe mbledhja e të dhënave, aktivitetet e promovimit dhe të informimit të aktorëve etj., krahas mbështetjes së jashtme nga BE-ja dhe donatorët ndërkombëtarë, në kuadër të projekteve bilaterale.

Kapaciteti i MBZHR/AM i IPARD për përgatitjen e politikave të gjelbra duhet të vitalizohet. Masat agromjedisore dhe kushtet e ndërperputhshmërisë/mjedisore do të duhet të jenë nën një njësi të dedikuar të MBZHR-së.

Nevoja të tjera specifike në nivel institucional janë instalimi i **një sistemi certifikimi për OP-të (organizatat/grupet e prodhuesve) dhe SHOP-et**, si edhe përafrimi i mëtejshëm i **kuadrit ligjor kombëtar të verës dhe bujqësisë organike** me legjislacionin e BE-së, duke përfshirë edhe një sistem kontrolli të përfortuar.

Në kuadër të kapitullit 12 – Politikat e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë dhe ato Fitosanitare

Kapaciteti i AKU-së për vlerësimin e rrezikut të sigurisë ushqimore duhet të forcohet në lidhje me planin vjetor të kontrollit. Statistikat zyrtare të kontrollit dhe auditimet e brendshme janë sfidat kryesore institucionale, së bashku me monitorimin dhe veprimet e kontrollit, të gjurmueshmërisë dhe të etiketimit.

Për sa i përket **politikës veterinarë**, legjislacioni që përcakton kriteret për programet kombëtare për zhdukjen e përshpejtuar të sëmundjeve të caktuara, është përditësuar në vitin 2021. Por kapaciteti i Agjencisë së re Kombëtare të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve duhet të përmirësohet, në lidhje me zbatimin e programeve në fushat përkatëse. Veçanërisht, thelbësore është përmirësimi i procedurave të kontrollit dhe i bazës të dhënave përkatëse me mbështetje të TI-së.

MBZHR-ja ka miratuar urdhrin e ministrit nr. 559, datë 10.10.2019, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kriterëve të planeve kombëtare për përshpejtimin e zhdukjes së brucelozës, tuberkulozit dhe leukozës enzootike në gjedhë”, përafruar me rregulloren 78/52/KE.

Shtimi i 300 veterinerëve zyrtarë në drejtoritë rajonale të veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve e ka bërë më të lehtë zbatimin e programeve të kontrollit të sëmundjeve.

Në vitet e ardhshme do të shtohen programe të tjera për kontrollin dhe zhdukjen e sëmundjeve dhe mbikëqyrjen për zbulimin e hershëm të sëmundjeve.

Në lidhje me politikën fitosanitare, MBZHR-ja ka akoma një sistem të dobët kontrolli mbi përdorimin e substancave aktive për mbrojtjen e bimëve. Duhet të forcohet sistemi i kontrollit për përdorimin e substancave aktive fitosanitare, së bashku me fushata ndërgjegjëse dhe trajnime për fermerët dhe personelin e autorizuar ose potencial të autorizuar për aplikimin e produkteve fitosanitare që janë me përdorim të kufizuar. Duhet të zhvillohen dhe zbatohen procedurat e unifikuara të regjistrimit për inputet e ndryshme bujqësore.

Laboratorët për sigurinë ushqimore, shëndetin e kafshëve dhe mbrojtjen e bimëve duhet të kenë një metodë akreditimi për laboratorët rajonalë, në nivelin e parë të laboratorëve dhe, gjithashtu, për laboratorët referencë.

Është e nevojshme të përcaktohen kriteret e kategorizimit të **krijimit** të OBU-ve dhe të vazhdohet me përgatitjen e kategorizimeve **për përputhshmëri me *acquis* të BE-së**.

Në kuadër të kapitullit 13 – Peshkimi

Shqipëria ka arritur një nivel përgatitjeje në **peshkim** dhe ka bërë **përparim të mirë** me riaktivizimin e Sistemit të Monitorimit të Anijeve - SMA (në maj 2021), duke lejuar kontrolle më të mira të peshkimit në ujërat detare dhe rikuperimin e rezervave. Shqipëria, si palë kontraktuese e KPPM-së dhe ICAAT-së po zbaton plotësisht rekomandimet për të kontrolluar përpjekjet e peshkimit. Për sa i përket menaxhimit të burimeve dhe flotës, regjistri i anijeve përditësohet rregullisht dhe raportohet në KPPM për të gjitha segmentet e flotës.

Rezultatet e analizës së situatës tregojnë se ka akoma **kapacitete që duhen përmirësuar, administrative dhe institucionale**, në sektorin e peshkimit për të siguruar një menaxhim të duhur të burimeve të peshkimit, në përputhje me prioritetet kombëtare, PPP-në e BE-së dhe angazhimet ndërkombëtare. Kjo i referohet menaxhimit të burimeve të peshkimit, zbatimit të Planit Rajonal të Veprimit për PSHV-në, duke përfshirë përmirësimin e mbledhjes së të dhënave dhe statistikave të zbarkimit nga PSHV-ja dhe forcimin e kapaciteteve të inspektimit dhe kontrollit për të dekurajuar peshkimin PPPP.

Në shkurt 2019, **ligji i peshkimit** u ndryshua për të përfshirë dispozita për menaxhimin e burimeve që përfshijnë organizatat e peshkimit në zona të vogla bregdetare. Gjithashtu, për të garantuar qëndrueshmërinë afatgjatë të burimeve të peshkimit në detin Adriatik, në përputhje me rekomandimet e KPPM-së, në prill të vitit 2020 u miratua një amendament në ligjin e peshkimit për të përfshirë masa për të vendosur kufizime në numrin, fuqinë e motorit dhe tonazhit bruto të anijeve të peshkimit.

Për politikën e tregut, rregulloret për organizimin e tregjeve dhe shitjen e produkteve të peshkimit dhe akuakulturës janë miratuar në vitin 2019.

Në kuadër të kapitullit 27 – Mjedisi dhe klima

Për negocimin e kapitullit 27 – Biodiversiteti, institucioni përgjegjës është MTM (Ministria e Turizmit dhe Mjedisit). Ky kapitull përmban tema horizontale, që prekin edhe fushat teknike për zbatimin e të cilave është përgjegjëse MBZHR, si p.sh. politikat mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mbrojtja e tyre nga ndotja, si: toka, uji dhe ajri nëpërmjet p.sh. përdorimit të plehrave dhe pesticideve.

MBZHR-ja është institucioni direkt përgjegjës për përgatitjen dhe zbatimin e strategjisë, të politikave të sektorit të bujqësisë, si edhe të reformave që lidhen me përafrimin dhe zbatimin e legjislacionit me *acquis* të BE-së, në kuadër të kapitujve të negocimit 11 – Bujqësia dhe zhvillimi rural; 12 – Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe ato fitosanitare; 13 – Peshkimi, që janë të përfshirë në CLUSTER-in 5 të kuadrit negociator: burimet, bujqësia dhe kohezioni.

Në këtë kontekst MBZHR-ja dhe MTM-ja janë të angazhuara të bashkëpunojnë për të përgatitur pozicionet respektive të negocimit, që do të duhet të dakortësohen me BE-në si palë negociuese.

3.2.6 Politika 3. Objektivi ndërsektorial 2: Transferimi i njohurive dhe i inovacionit


Transferimi i njohurive dhe i inovacionit sjell kërkimin bujqësor, inovacionin dhe shërbimet e ekstensionit më afër nevojave të fermerit, duke pasur një këndvështrim afatgjatë për një qasje të re institucionale në dhënien e informacionit dhe njohurive, duke ngritur Sistemin e Njohurive dhe të Inovacionit Bujqësor (SNJIB),

domethënë duke zbatuar praktikat më të mira të BE-së.

Në kuadër të PPB-së, pas 2020-ës, të BE-së, ngritja, buxhetimi dhe funksionimi i SNJIB-së është një objektivi kriteri i detyrueshëm *për vendet anëtare për të marrë miratimin për financimin e planeve strategjike përkatëse, që i paraqiten Komisionit Evropian për miratim të buxheteve.*

Meqenëse inovacioni dhe transferimi i njohurive kanë kapacitetin për të nxitur zhvillimin dhe konkurrencën, boshllëqet në ndërtimin e një SNJIB-je dhe përshpejtimin e transferimit të teknologjisë të fermerët duhet të vlerësohen dhe adresohen në vijimësi. SHKKB-ja⁵⁷ duhet të organizohet në atë mënyrë, që masat e SNJIB-së të integrohen në të gjitha aktivitetet e tij, si trajnimi i këshilltarëve, shkëmbimi i njohurive me studiuesit-kërkuesit shkencorë, organizimi ose pjesëmarrja në demonstrimet në fermë, planifikimi dhe përdorimi i buxhetit për mobilitetin e këshilltarëve, për të mësuar nga praktikat dhe eksperiencat jashtë vendit dhe për të shpërndarë njohuri të reja në vend/rajon. Është thelbësore që njohuritë të zbatohen në praktikë në mënyrë koncize dhe të kuptueshme. Ngritja e një SNJIB-je do të thotë të hapësh SHKF-në, të përfshihen të gjithë këshilltarët publikë dhe privatë, për të forcuar dhënien e këshillave dhe rritjen e kompetencave këshilluese. Për shkak të financimit të pamjaftueshëm dhe mungesës së kapaciteteve, progresi i arritur deri më tani ka qenë i kufizuar.

Figura 3-2: Aktorët e SINJB në Shqipëri⁵⁸



Në kuadrin e projektit IPA të financuar nga BE-ja “Përmirësimi i performancës dhe cilësisë së

⁵⁷ Struktura e reformuar e ekstensionit këshillimor të MBZHR-së përfshin në total 261 punonjës në mbarë vendin, nga të cilët 189 janë ekstensionistë (kryejnë detyra këshillimi), shumica e të cilëve janë të trajnuar në agronomi, blegtori ose ekonomi dhe ka një pjesë të madhe e tyre janë me moshë të madhe.

⁵⁸ Burimi: Projekti IPESA (2019): Plani Strategjik i Veprimit 2021–2022 – Shërbimi Kombëtar i Ekstensionit Bujqësor të Shqipërisë.



shërbimit publik të ekstensionit në sektorin e blegtorisë” (IPESA), u përgatit Plani Strategjik i Veprimit për SHKEB-në, me synim zhvillimin e mëtejshëm të tij për t’u integruar në një SNJIB, në përputhje me strategjitë e vendeve anëtare të BE-së dhe PPB-në pas 2020. Aktualisht, në Shqipëri ka një numër aktorësh që zotërojnë njohuri të larmishme në fushën e bujqësisë dhe të inovacionit bujqësor. Koordinimi dhe bashkëpunimi institucional i tyre është e nevojshme që të forcohet më tej, që ata të mos veprojnë të shkëputur nga njëri-tjetri, gjë që nga njëra anë e ul efektivitetin në informimin e fermerëve mbi teknologjitë e reja për rritjen e produktivitetit në mënyrë të qëndrueshme, duke ruajtur burimet natyrore, si tokën dhe ujërat, dhe nga ana tjetër, mban të ulur eficiencën e përdorimit të fondeve publike, që i alokohen institucioneve publike të ndryshme si p.sh. universiteteve dhe qendrave të tjera të specializuara, si QTTB-të etj. për aktivitetin e kërkim-zhvillimit, por edhe atyre që angazhohen në shpërndarjen e njohurive dhe të teknologjive të reja.

Aktorët (subjektet e ndryshme publike dhe jopublike) janë të angazhuar për të promovuar njehsimin e agjendave kërkimore të institucioneve kërkimore – edukuese me sfidat reale të fermerëve, për të mësuarin e ndërsjellë, për të krijuar, ndarë dhe përdorur njohuritë dhe informacionin e lidhur me bujqësinë, teknologjitë inovative, përfshirë digjitalizimin. Këto aktivitete nuk janë të ndërlidhura me anë të një strategjie të dedikuar, e nevojshme që të mundësojë arritjen e objektivave të strategjisë kombëtare, ndërkohë që veprimtaritë e këtyre aktorëve drejtohen kryesisht nga nevojat e të ofertës dhe jo të kërkesës.

Sistemi i **arsimit profesional bujqësor** përfshin nëntë shkolla të mesme, të cilat mbulojnë këto fusha: prodhimin bujqësor (bimor) (në 9 shkolla), prodhimin shtazor (në 1 shkollë), veterinarinë (në 2 shkolla), agrobiznesin (në 5 shkolla), silvikulturën, prodhimin e drurit dhe mobilieve (në 1 shkollë), mekanizimin bujqësor (në 2 shkolla). **Në nivel universitar** arsimi në shkencat bujqësore ofrohet nga Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) dhe Fakulteti i Bujqësisë i Korçës. UBT është i vetmi universitet i specializuar në ofrimin e studimeve universitare dhe pasuniversitare, kërkimore, trajnime dhe ekstensionit në fushën e bujqësisë dhe përpunimit të ushqimit.

50 shoqëri të bashkëpunimit bujqësor (SHBB) operojnë në fushën e prodhimit dhe tregtisë së frutave dhe perimeve (27 SHBB), prodhimin dhe tregtimin e bimëve mjekësore dhe aromatike (5 SHBB), blegtori përfshirë bletarinë (18 SHBB). Ata zhvillojnë takime të rregullta me individë dhe grupe fermerësh dhe organizojnë shkëmbime.

SHKEB-ja përfaqësohet nga njësi përgjegjëse në MBZHR dhe **katër Agjenci Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB-e)**. Kjo strukturë është përgjegjëse për ofrimin e informacionit, këshillimit dhe trajnimit për fermerët. Në total, ky shërbim ka në total 261 punonjës në nivel qendror dhe vendor, nga të cilët 189 janë staf teknik me detyra këshillimi (ekstensionistë). AREB-et janë të lokalizuara në Shkodër (e cila mbulon edhe qarkun Lezhë dhe Kukës), në Tiranë, e cila mbulon edhe qarqet Durrës dhe Dibër), në Lushnjë (e cila mbulon qarqet Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë) dhe në Korçë (e cila mbulon edhe qarkun Elbasan dhe Berat). Çdo agjenci ka në përbërjen e saj edhe Sektorin e Specialistëve të Profilizuar me deri në 7 ekspertë.

Secila prej të cilave, aktualisht, punëson 7 specialistë të fushave të ndryshme, si kultivimi i perimet, prodhimi i frutave, blegtorinë, mbrojtja e bimëve dhe ekonomia bujqësore. Pjesa tjetër e stafit të ekstensionit është e punësuar në qendrat e informacionit bujqësor (120 punonjës) në nivel vendor, të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejta me fermerët. Pjesa më e madhe e tyre ndodhen në Elbasan, Shkodër, Fier dhe Korçë.

Pesë **QTTB, të specializuara sipas kulturave bujqësore**/llojeve të kafshëve, me vendndodhje në Fushë-Krujë, Korçë, Vlorë, Lushnjë dhe Shkodër janë përgjegjëse për kryerjen e kërkimeve të aplikuara në fusha të ndryshme të bujqësisë. Krahas evidentimit dhe shpërndarjes së teknologjive të përparuara bujqësore, në bashkëpunim me AREB-et, QTTB-të mbështesin MBZHR-në në formulimin e strategjive dhe hartimin e skemave kombëtare, transferimin e teknologjive të bizneset bujqësore dhe agropërpunuese, furnizimin me material mbjellës të certifikuar për disa nga farat dhe fidanët etj. Numri i përgjithshëm i të punësuarve në QBTT është 280.

Në skemat kombëtare të mbështetjes në bujqësi për vitin 2022 është përfshirë edhe një skemë trajnimi në bujqësi, për ekstensionistët e të gjitha



niveleve për të rifreskuar njohuritë e tyre dhe për fermerët, peshkatarët, blegtorët, bletarët dhe përpunuesit e qumështit. Kjo skemë që do të ofrohet nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, përbën një zhvillim të rëndësishëm në forcimin e transferimit të njohurive dhe forcimit të kapaciteteve në nivel operatori të bujqësisë dhe ekstensionisti.

4 Pjesa III: Strategjia dhe instrumentet e ndërhyrjes

4.1 Strategjia e ndërhyrjes në kuadër të SBZHRP 2021–2027

Strategjia e ndërhyrjes është e orientuar drejt modelit të ri të PPB-së pas vitit 2020, asaj të ofrimit të ndërhyrjeve të orientuara drejt rezultateve në përputhje me burimet e disponueshme dhe të pritshme, si edhe me instrumentet e financimit

kombëtar dhe ndërkombëtar, të strukturuar në tri shtylla si vijon:

- Shtylla I: Pagesat e direkte;
- Shtylla II: Masa mbështetëse për investime dhe bashkëpunim;
- Asistencë teknike, asistencë financiare (kryesisht nga donatorët).

Mekanizmat e ndërhyrjes, që rrjedhin prej tyre, u referohen nevojave prioritare të agreguara të identifikuara në kapitujt e objektivave të përgjithshëm, specifike dhe ndërsektoriale.

Mekanizmat e ndërhyrjeve për bujqësinë dhe zhvillimin rural, përfshirë pylltarinë janë përshkruar në tabelën 4-1.

Mekanizmat e ndërhyrjes në sektorin e peshkimit janë përshkruar veçmas në tabelën 4-2.



4.2 Përshkrimi i instrumenteve dhe i masave të ndërhyrjes së planifikuar, në kuadër të SBZHRP 2021–2027

Tabela 4-1: Mekanizmat e planifikuar të ndërhyrjes në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural, duke përfshirë pylltarinë

Masa/ndërhyrja e planifikuar	Përshkrim i shkurtër i instrumenteve të ndërhyrjes	Referenca përkatëse me nevojat e identifikuar	Burimi i buxhetit (pa bashkëfinancim nga privatët)
	1. Pagesat e drejtpërdrejta (llojet e shtyllës I)		
1. Mbështetje kalimtare për të ardhurat për sektorët e orientuar nga tregu nën organizimin e përbashkët të tregut (perime, fruta dhe ullinj)	- Përfitues janë fermerët, përdorues të tokës bujqësore. - Pagesat duhet të lidhen me kërkesat e thjeshtuara të Kushteve të Mira Bujqësore dhe Mjedisore (KMBM). - Pagesat duhet të bëhen çdo vit, për ha.	1.1, 1.2	Buxheti Kombëtar
2. Mbështetja e të ardhurave për fermën sipas kriterit të sipërfaqes bujqësore të shfrytëzuar (pagesa në buxhetin e fermës që janë të shkëputura nga lloji i prodhimit bimor apo blegtoral ose nga faktorët specifikë të prodhimit)	- Përfitues janë fermerët, përdorues të tokës bujqësore. - Pagesat duhet të lidhen me kërkesat e KMBM (nën kushtin e një kontrollit minimal prej 1%). - Mbështetja plotësuese e të ardhurave për fermerët e rinj (<i>start-up</i>) duhet të sigurohet për një kohëzgjatje maksimale prej pesë vjetësh, duke filluar nga viti i parë i paraqitjes së aplikimit për pagesën për fermerët e rinj. - Pagesat duhet të bëhen çdo vit, për ha.	1.1, 1.2, 1.5	Buxheti Kombëtar
3. Mbështetja e të ardhurave për fermën për krerë të kafshëve	- Përfitues janë fermat blegtorale. - Pagesat duhet të lidhen me kërkesat e thjeshtuara për Kushtet e Mira Bujqësore dhe Mjedisore (KMBM) (nën kushtin e një kontrolli minimal prej 1%). - Pagesat duhet të bëhen çdo vit, për krerë kafshësh/koshere bletësh.	1.1, 1.2, 1.6	Buxheti Kombëtar
4. Kompensimi për naftën në bujqësi	- Përfitues janë fermerët, përdorues të tokës bujqësore. - Për kulturat/grupet e kulturave, konsumi standard i karburantit të naftës duhet të llogaritet për ha. Kompensimi mbulon taksa dhe tatime që aplikohen mbi çmimin e naftës.	1.1, 1.2	Buxheti Kombëtar
5. Skema e cilësisë së qumështit	- Përfitues janë fermat blegtorale që prodhojnë qumësht. - Pagesat duhet të bëhen për çdo litër qumështi të dorëzuar në njësi përpunimi, të diferencuara t në varësi të cilësisë së tij.	1.1, 1.2, 1.6	Buxheti Kombëtar
2. Zhvillimi Rural (masa të tipit të shtyllës II)			
6. Grandet për investime në asetet fizike të ekonomive bujqësore	- Përfitues janë fermerët/grupe fermerësh, si persona fizikë dhe/ose juridikë. - Qëndrueshmëria ekonomike e përfituesve duhet të vërtetohet përmes planeve të biznesit. - Investimi duhet të jetë në përputhje me standardet e BE-së për mbrojtjen e mjedisit dhe mirëqenien e kafshëve - Intensiteti i ndihmës duhet të jetë më i lartë për fermerët e rinj, gratë, organizatat e prodhuesve, për investimet në zonat malore, për përputhshmërinë me standardet e BE-së, dhe për bujqësinë organike dhe investime të tjera të lidhura me mjedisin dhe klimën. - Kriteret e përzgjedhjes, gjithashtu, do të adresojnë sfidat e sektorëve (të identifikuar në këtë strategji) ose për të mbështetur zhvillimin e sektorëve me vlerë të shtuar të lartë (p.sh. blegtoria, pemët frutore, ullishtat, sipërfaqet e kultivuara me perime), priorizimin i organizatave të prodhuesve dhe përafrimin me standardet e BE-së, duke përfshirë mirëmenaxhimin dhe depozitimin e plehut organik. - Sistemet efektive të ujitjes do duhet të jenë të detyrueshme për investimet në sektorët e fruta-perimeve. - Në përfundim të investimit duhet të vërehet një rritje e madhësisë së fermës (përmasa fizike ose ekonomike).	1.2, 1.4, 1.6, 1.7, 1.8, 1.9, 1.10, 1.11, 2.4, 2.5	EU IPARD III + Buxheti Kombëtar (bashkëfinancim)



Masa/ndërhyrja e planifikuar		Përshkrim i shkurtër i instrumenteve të ndërhyrjes	Referenca përkatëse me nevojat e	Burimi i buxhetit (pa bashkëfinancim nga privatët)
		Të ardhurat e parashikuara, siç përmendet në planet e biznesit duhet t'u nënshtrohen kontrolleve, pasi investimi është funksional, duke stimuluar kështu formalizimin fiskal të sektorit.		
7. Grandet për investime në asete fizike që kanë të bëjnë me përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore		- Përfitues janë ndërmarrjet/njësitë e përpunimit të ushqimit. - Intensiteti i ndihmës është më i lartë për investimet që realizojnë përputhshmërinë me standardet e BE-së. - Prioritet i jepet përafrimit të standardeve të BE-së, veçanërisht për sigurinë ushqimore dhe menaxhimin e mbetjeve (trajtimi i ujit dhe ripërdorimi i mbetjeve) dhe për integrimin e prodhimit të prodhuesve vendës/ inkurajimin e zinxhirëve të furnizimit të shkurtër. - Kriteret për zinxhirët e produkteve lokale duhet të pasqyrojnë objektivat e barazisë gjinore dhe të sigurojnë përfshirjen e grave dhe të rinjve. - Duhet të mundësohen paradhënie. - Në përfundim të investimit, i gjithë objekti ku kryhet investimi duhet të jetë në përputhje me të gjitha standardet kombëtare, ndërsa investimi me rregullat e BE-së.	1.6, 1.8, 1.9, 1.11	EU IPARD III + Buxheti Kombëtar (bashkëfinancim)
8. Grande për rehabilitimin e sistemit të ujitjes dhe kullimit		Përfitues janë bashkitë për rehabilitimin dhe ose ndërtimin e infrastrukturës publike për ujitjen dhe kullimin në administrim të tyre, ndërsa fermerët përfitojnë mbështetje me investime për ujitjen brenda fermës.	1.7	Buxheti Kombëtar, Donatorët
9. Grande për fermerët e rinj		- Përfitues janë fermerë të rinj meshkuj dhe femra (deri në 40 vjeç), drejtues të fermës me trajnime apo aftësi të përshtatshme. - Mbështetja financiare do të sigurohet për fillimin e bizneseve rurale (<i>start-up</i>) të lidhura me bujqësinë, duke përfshirë krijimin e fermave të reja, bazuar në një plan biznesi. 75% e mbështetjes duhet të jepet menjëherë pas miratimit të planit të biznesit dhe lidhjes së kontratës, dhe pjesa tjetër prej 25% në përfundim të zbatimit të planit të biznesit, por jo më vonë se 3 vjet nga momenti i nënshkrimit të kontratës. - Plani i biznesit duhet të përfshijë detyrimisht përafrimin e standardeve, mekanizimin/përmirësimin e produktivitetit të punës dhe përmirësimin e aksesit në treg. - Përparësi kanë sektorët me vlerë të lartë të shtuar dhe bujqësia organike, si dhe të diplomuarit e rinj meshkuj dhe femra të universiteteve bujqësore. - Fermerët e rinj duhet të kenë përparësi në trajnimet e lidhura me inovacionin. - Në përfundim të zbatimit të planit të biznesit, ferma duhet të jetë në përputhje me të gjitha standardet kombëtare.	1.2, 1.4, 1.5, 1.6, 1.8, 1.11, 1.13	Buxheti Kombëtar, Donatorët (TA dhe skema pilot)
10. Grupet e prodhuesve për ullinj, fruta dhe perime		- Përfitues janë grupet e prodhuesve të regjistruar. - Mbështetja është e kufizuar në 10% të prodhimit të tregtuar gjatë pesë vjetëve të para pas regjistrimit dhe nuk mund të kalojë një nivel të caktuar, por që është stimulus.	1.6, 1.10	EU IPA III, Buxheti Kombëtar, Donatorët
11. Skemat agromjedisore dhe klimatike	Racat lokale	- Përfitues janë fermat blegtorale. - Rregullat për menaxhimin e plehut organik, mirëqenien e kafshëve dhe shëndetin e kafshëve duhet të jenë pjesë e rregullave bazë/standardeve minimale të detyrueshme. Gjithashtu, duhet të përcaktohen dhe zbatohen kërkesat e thjeshtuara të KMBM-së. - Fermerët përfitues duhet të kenë akses në njohuri/kenë trajnimin përkatës. - Pagesat duhet të bëhen çdo vit për krerë kafshësh, me synimin për t'i vijuar për një periudhë afatmesme.	2.1, 2.2, 2.5, 2.6, 2.7	EU IPARD III + Buxheti Kombëtar (bashkëfinancim)
	Ullishte tradicionale	- Përfitues janë fermerët që kultivojnë ullishte tradicionale. - Kërkesat e thjeshtuara të KMBM duhet të përcaktohen dhe zbatohen si pjesë e standardeve bazë/minimale të	2.2, 2.5, 2.6, 2.7	EU IPARD III + Buxheti Kombëtar



Masa/ndërhyrja e planifikuar		Përshkrim i shkurtër i instrumenteve të ndërhyrjes	Referenca përkatëse me nevojat e	Burimi i buxhetit (pa bashkëfinancim nga privatët)
		- detyrueshme. - Krasitja vjetore dhe ndalimi i inpleteve kimike janë të detyrueshme. - Fermerët përfitues duhet të kenë akses në njohuri/kenë trajnimin përkatës. - Pagesat duhet të bëhen çdo vit për ha, me synimin për t'i vijuar për një periudhë afatmesme.		(bashkëfinancim)
	Bujqësia organike	- Përfitues janë fermerët që kultivojnë sipërfaqe, në proces konvertimi ose të certifikuar si organike. - Kërkesat e thjeshtuara të KMBM-së duhet të përcaktohen dhe zbatohen si pjesë e standardeve bazë/minimale të detyrueshme. - Fermerët përfitues duhet të kenë akses në njohuri/kenë trajnimin përkatës. - Pagesat duhet të bëhen çdo vit për ha, me synimin për t'i vijuar për një periudhë afatmesme.	2.4, 2.5, 2.6, 2.7	EU IPARD III + Buxheti Kombëtar (bashkëfinancim)
	Menaxhimi i i shfrytëzimit ekstensiv të kullotave	- Përfitues janë përdoruesit e kullotave tradicionale të angazhuara në shfrytëzimin e kullotave në respektim të kriterëve të mirënjohur. - Kërkesat e KMBM duhet të përcaktohen dhe zbatohen si pjesë e standardeve bazë/minimale të detyrueshme. - Duhet të merren parasysh rregullat për sigurimin e një densiteti maksimal të kullotjes dhe koshtes së vonshme të livadheve, të ndalohen inputet kimike, ndërsa plehrat organike të jenë të kufizuara. - Përdoruesit e kullotave duhet të kenë akses në njohuri/kenë trajnimin përkatës. - Pagesat duhet të bëhen çdo vit për ha, me synimin për t'i vijuar për një periudhë afatmesme.	2.1, 2.2, 2.5, 2.6, 2.7,	Buxheti Kombëtar, Donatorët
	Skemat ekologjike	- Përfitues janë fermerët burra dhe gra. - Duhet të përgatiten dhe zbatohen skemat ekologjike pilot që synojnë mirëmbajtjen dhe përmirësimin e mjedisit dhe zbutjen dhe përshtatjen e ndryshimeve klimatike (siç lidhet me ndërgjegjësimin e AGJBP), duke rritur në këtë mënyrë kapacitetin institucional dhe ndërgjegjësimin. - Pagesat duhet të bëhen çdo vit dhe të jenë të lidhura me mbështetje për investim në makineri të specializuara. - Në të ardhmen, skemat ekologjike (vullnetare) do të jenë pjesë e skemave të pagesave direkte (si në shtetet anëtare të BE-së).	2.1, 2.2, 2.5, 2.6, 2.7	EU IPA III, Donatorët
12. Grandet për sistemet ushqimore lokale dhe zinxhirët e furnizimit të shkurtër		- Përfitues janë fermerë burra dhe gra, fermerë të vogël (marketing i drejtpërdrejtë) dhe prodhues të vegjël ushqimorë ruralë në zonat rurale; - Prioritet për personat e regjistruar si prodhues të vegjël të ushqimit që përjashtohen nga rregullat HACCP, por që zbatojnë standardet minimale të higjienës dhe sigurisë ushqimore sipas praktikave të mira. - Investime në rinovimin dhe pajisjen e pikave të shitjes, objekteve të përpunimit për prodhimin artizanal të produkteve ushqimore (tradicionale) për shitje direkte. - Investimet në tregjet e kafshëve të gjalla. - Zhvillimi i koncepteve/masave të marketingut duke përfshirë edhe shitjen direkte.	1.1, 3.1	EU IPARD III + Buxheti Kombëtar (bashkëfinancim), Donatorët
13. Grande për bizneset rurale dhe bizneset fillestare (start-up)		- Përfitues janë ndërmarrjet rurale të regjistruara me aktivitet në zonën rurale. - Investimet në asetet fikse dhe masat e marketingut të bizneseve ekzistuese rurale ose bizneseve fillestare rurale (biznese fillestare - <i>start-ups</i>, vetëm për të rinjtë deri në 40 vjeç dhe sipërmarrësit gra). - Prioritetet në sektorë: BAM, NTFP, produkte të bletarisë, produkte të akuakulturës, produkte bujqësore jotipike, aktivitetet në sektorin e shërbimeve, që janë të favorshme për sipërmarrësit e rinj dhe femra ose aktivitetet të lidhura drejtpërdrejt me sektorin bujqësor ose të turizmit rural dhe zejtaria.	3.1, 3.3, 3.4	EU IPARD III + Fondet kombëtare (bashkëfinancim), Donatorët



Masa/ndërhyrja e planifikuar		Përshkrim i shkurtër i instrumenteve të ndërhyrjes	Referenca përkatëse me nevojat e	Burimi i buxhetit (pa bashkëfinancim nga privatët)
14. Grand për turizmin rural		- Prioritet në intensitetin e ndihmës për zonat malore, krijimi i punësimit lokal. - Përfituesit: Fermerët dhe popullsia rurale. - Infrastruktura turistike në terren: rinovim i shtëpive të fermave dhe shtëpive në stilin arkitektonik tradicional për qëllime akomodimi, mobilim, pajisje profesionale për kuzhinë, pajisje sportive, rekreative dhe agroturistike, rrugë të brendshme dhe vende parkimi, mjedise të ujërave të zeza dhe mbetjeve. - Kostot për marketingun e produktit. - Prioritetet e ndërhyrjes do të jenë për: a) zhvillimin e agroturizmit në fermë; b) fermerët/et e rinj/reja; c) sipërmarrësit/et e rinj; e) lidhjen me marketingun e drejtpërdrejtë në fermë; d) lidhjen me zhvillimin e integruar rural /iniciativat me bazë komuniteti, që synojnë përmirësimin e infrastrukturës turistike lokale.	3.2	EU IPARD III + Fondet kombëtare (bashkëfinancim)
15. Grandet për iniciativat e zhvillimit rural		- Përfituesit: komunitetet lokale, partneritetet lokale (sektori privat, civil, publik) - Zbatimi i SZHL-së përfshirë veprimet dhe investimet prioritare, duke forcuar kapacitetet financiaro-administrative, menaxhuese dhe komunikuese të koordinatorëve të GVV-ve aktuale dhe të ardhshme - Forcimi i kapaciteteve të rrjetëzimit ndërmjet GVV-ve. - Ngritja e strukturave të Rrjetit Kombëtar Rural bazuar në kapacitetet sociale të aktorëve.	3.6, 3.7	EU IPARD III + Fondet kombëtare (bashkëfinancim), Buxheti kombëtar (bashkiak), Donatorët
16. Grande dhe kredi për infrastrukturën publike rurale		- Përfitues janë bashkitë. - Prioritet ka zhvillimi i ekonomisë, turizmit dhe cilësisë së jetës së popullatës rurale, sipas parimit të mbrojtjes së mjedisit. - Për rrugët rurale, rrugët pyjore me synim parandalimin e zjarreve në pyje, infrastrukturën për shëndetin, ujërat e zeza dhe grumbullimin e mbetjeve, bazuar në investimet dhe planet e menaxhimit të infrastrukturës lokale, instalimet FV për prodhimin e energjisë së rinovueshme në ndërtesat publike. - Infrastruktura publike turistike (pikat e informacionit, muzetë, tregjet lokale, festivalet dhe atraksione të tjera turistike).	3.5	EU IPARD III + Fondet kombëtare (bashkëfinancim), Donatorët (Ndihma financiare)
17. Grandet për pyllëzim		- Përfitues janë personat fizikë ose juridikë që angazhohen për pyllëzim. - Toka bujqësore dhe jobujqësore duhet të jetë e lejueshme për pyllëzim. - Kërkesat e thjeshtuara të KMBM-ve duhet të përcaktohen dhe zbatohen si pjesë e standardeve bazë/ minimale të detyrueshme për pjesën tjetër të tokës bujqësore të përdorur nga përfituesi. - Pyllëzimi i tokës që rrezikohet nga erozioni dhe tokave të abandonuara duhet të jetë prioritet. - Përfitohet mbështetje për përgatitjen e dokumentacionit teknik, kostot e mbjelljes dhe mirëmbajtjes.	2.1, 2.5, 2.10, 3.4	EU IPARD III, Fondet kombëtare (bashkëfinancim)
18. Instrumentet financiare	Skemat e garancisë	- Përfshihen përfituesit nga IPARD III, fermerë të tjerë dhe sipërmarrës ruralë. - Ndërmjetës dhe përfitues direkt janë institucionet financiare të përzgjedhura për menaxhimin e fondit të garancisë. - Garancia duhet të synojë paradhëniet për fondet e mbështetjes dhe kreditë rurale në përputhje me këtë strategji. - Garancitë duhet të çojnë në ulje të nivelit të kolateraleve dhe rritje të vëllimit të kredive rurale. - Kostot për garancitë duhet të mbulojnë rrezikun; garancitë duhet të jenë të ri përdorshme.	1.4, 1.5, 1.6, 1.8, 1.9, 1.11, 2.1, 2.3, 3.1, 3.2, 3.3	Fondet e BE-së + Buxheti Kombëtar (bashkëfinancim), Buxheti Kombëtar
	Hua për ndarjen e riskut	- Përfshihen përfituesit nga IPARD III, fermerë të tjerë dhe sipërmarrës ruralë. - Zbatues dhe përfitues direkt janë institucionet financiare të përzgjedhura për menaxhimin e fondeve. - Huat duhet të mbulohen me 70% kapital nga MBZHR-ja. Rreziku mbi kapitalin financiar të siguruar nga MBZHR-ja duhet të mbështetet nga bankat. Norma e interesit për kapitalin e ofruar nga MBZHR-ja duhet të jetë zero, por bankat të kompensohen për shërbimet e tyre. - Huat duhet të synojnë bashkëfinancimin e grandeve IPARD III dhe masat mbështetëse të skemës kombëtare.		



Masa/ndërhyrja e planifikuar	Përshkrim i shkurtër i instrumenteve të ndërhyrjes	Referenca përkatëse me nevojat e	Burimi i buxhetit (pa bashkëfinancim nga privatët)
19. Skemat e sigurimeve	- Përfitues janë fermerët që nënshkruajnë kontratat e sigurimit për asetet/prodhimin e fermave të tyre ndaj rreziqeve në bujqësi.	1.3	Buxheti Kombëtar
20. Kontratat e shërbimeve dhe mbështetje direkte financiare për ofrimin e shërbimeve këshillimore për fermerët	- Përfituesit për shërbimin e këshillimit mund të jenë kompani konsulence, organizata fermerësh, OJQ/organizata të shoqërisë civile. - Këshillimi duhet të synojë gratë, fermerët e rinj, skemat e agromjedisit dhe ndryshimeve klimatike, përmbushjen e standardeve të BE-së dhe kombëtare, ngritjen e grupeve operationale (SNJIB). - AREB/QTTB duhet të marrin mbështetje të drejtpërdrejtë në dhënie të këshillave për fermerët bazuar në plane të qarta veprimi. - Inovacioni dhe transferimi i njohurive duhet të jenë pjesë e çdo sistemi këshillimor.	1.11, 1.12, 1.13, 2.1, 2.2, 2.3, 2.4, 2.5, 2.6, 2.7, 3.3, 3.2, 3.1	EU IPARD III + Fondet kombëtare (bashkëfinancim); Buxheti Kombëtar, Donatorët
21. Grandet për menaxhimin kolektiv të mbetjeve (plehut të kafshëve)	- Përfitues janë bashkitë. - Investimet e pranueshme janë platformat/magazinat e plehut organik dhe pajisjet për transportin e plehut organik, kompostimin dhe aplikimin në terren. - Investimet duhet të synojnë zonat me numër të madh kafshësh nga fermat e vogla dhe të mesme. - Investimet duhet të shërbejnë edhe për trajnime për menaxhimin e plehut organik.	1.11, 2.1, 2.2, 2.3, 2.4, 2.5, 2.6, 2.7	Donatorët
22. Fermat për qëllime demonstrimi	- Përfitues janë fermerët/organizatat e fermerëve. - Prioritet duhet t'i jepet demonstrimeve që lidhen me zbatimin e skemave të agromjedisit dhe ndryshimeve klimatike, sipas standardeve të BE-së dhe ato kombëtare, dhe më vlerë në aspektet gjinore dhe sociale. Mbështetja përfshin kostot e ndërtimit/rehabilitimit dhe modernizimit, kostot për makineritë, pajisjet dhe trajnimin sipas projektit të miratuar. - Fermat demonstruese shërbejnë për trajnime. - Të gjitha të dhënat për kostot për investime, kostot operative, kostot e mirëmbajtjes si edhe projektet teknike, dhe duhet të jenë të disponueshme për të interesuarit.	1.11, 1.12, 2.1, 2.2, 2.3, 2.4, 2.5, 2.6, 2.7	Donatorët ose IPARD III në kuadër të masës "Infrastruktura rurale publike"
3. Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative në procesin e përafrimit me BE; transferimi i njohurive dhe promovimi i inovacionit			
23. Projekti AT (asistencës teknike) për konsolidimin e njësisë së AT për IPARD III në MBZHR	- Përfituesi është Autoriteti menaxhues i IPARD, veçanërisht njësia e asistencës teknike IPARD III. - Staf lokal duhet të trajnohet përmes misionëve afatmesme TAIEEX për përdorimin e rregullave të PRAG-së. - MBZHR duhet të verë në dispozicion burimet e nevojshme njerëzore për njësinë.	1.14	TAIEEX, Donatorët, Masa AT e programit IPARD
24. Projekti AT për përafrimin e legjislacionit të BE-së	24.1 Kapitulli 11 - Përfituesi është IPARD/MBZHR dhe AZHBR, si dhe njësia përgjegjëse për politikën në MBZHR - Projekte të veçanta të AT duhet të synojnë: - Krijimin e FADN dhe të një njësie të MBZHR-së për analiza ekonomike; - Konsolidimin e regjistrat të fermave (përfshirë lidhjen e tij me bazat e tjera të të dhënave); - Zhvillimi i mëtejshëm i sistemit të administrimit dhe kontrollit (IACS), përfshirë zhvillimin e sistemit të parcelave të tokë (LPIS); - Përgatitja e akreditimit për masat e reja IPARD III; - Përditësimi i legjislacionit për bujqësinë organike dhe ngritja e një njësie në MBZHR me staf për këtë sektor; - Zbatimi i qasjes LEADER duke përfshirë krijimin e rrjetit. - Këshillim për negociatat me BE-në. - MBZHR-ja duhet të sigurojë burime të mjaftueshme dhe të përshtatshme njerëzore për njësitë e saj teknike. 24.2 Kapitulli - Përfitues është MBZHR dhe autoritetet/agjencitë përgjegjëse për çështjet e sigurisë ushqimore, veterinarë dhe mbrojtjes së	1.14, 1.11, 1.12, 2.5, 2.8, 3.9 Objektivi ndërsektorial 1, kapitulli Objektivi ndërsektorial 1: Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative për përafrimin me <i>acquis</i> të BE-së	TAIEEX /IPA III, IPARD III Masa AT, Donatorët
		1.6, 1.11., Objektivi	TAIEEX /IPA III,



Masa/ndërhyrja e planifikuar		Përshkrim i shkurtër i instrumenteve të ndërhyrjes	Referenca përkatëse me nevojat e	Burimi i buxhetit (pa bashkëfinancim nga privatët)
	12	bimëve. - Mbështetja AT duhet të synojë: - Përditësimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të bazës së të dhënave të Regjistrat të Kafshëve, sigurimin e një lidhjeje të mirë me bazat e tjera të të dhënave dhe përditësimin e bazës ligjore përkatëse; - Përgatitjen e planeve të veprimit për boshllëqet institucionale që kanë të bëjnë me ushqimin e kafshëve, gjurmueshmërinë e nënprodukteve shtazore (mish dhe produkte qumështi), konsolidimin e mëtejshëm të programeve të kontrollit të sëmundjeve të kafshëve (plani i monitorimit në lidhje me sëmundjet e kafshëve dhe për nënproduktet/vlerësimin e rrezikut për fermat dhe për operatorët e biznesit) etj.; - Përmirësimin e të gjitha procedurave të kontrollit, logjistikës së nevojshme për kontrollet (përfshirë laboratorët e specializuar) dhe bazat e të dhënave përkatëse; - Bashkëpunimin ndërkufitar për parandalimin e sëmundjeve endemike rajonale dhe për sëmundjet e reja/shpërthimet e reja; - Përdorimin e pesticideve në nivel ferme dhe zbulimin e mbetjeve të pesticideve në bimë; - Unifikimin e procedurave të ndryshme të regjistrimit për inputet bujqësore; - Monitorimin e standardeve të sigurisë ushqimore për njësitë e agropërpunimit; - Përmirësimin e kapaciteteve laboratorike për sigurinë ushqimore, shëndetin e kafshëve dhe mbrojtjen e bimëve; - Hartimin e një plani veprimi për përmirësimin e cilësisë së qumështit; - Këshillim për negociatat me BE-në; - AKU-ja duhet të sigurojë burime njerëzore të përshtatshme për njësitë e saj teknike; - Projektet e AT duhet të përfshijnë të gjithë stafin e njësive teknike përkatëse të MBZHR-së.	ndërsektorial 1, kapitulli Objektivi ndërsektorial 1: Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative për përafrimin me <i>acquis</i> të BE-së	IPARD III TA /Donatorët
25. AT për të dhënat statistikore për treguesit bazë të sektorit		- Treguesit bazë të sektorit duhet të jenë të disponueshëm për monitorimin e ndikimit të strategjisë; disa prej tyre janë pjesë e FADN-së; - Të dhënat sipas gjinive të mblidhen aty ku nuk janë të disponueshme; - Njësia për monitorimin dhe vlerësimin e IPARD III, duhet të përgatisë një analizë të mangësive dhe mbështetet me një projekt AT për mbledhjen e treguesve, në përputhje me udhëzimet e BE-së (C13–C30), - Treguesit FADN, duhet të mblidhen në përputhje me metodologjinë e aplikuar në BE. - Duhet të përgatitet një manual për monitorimin e treguesve bazë të sektorit.	1.14 Objektivi ndërsektorial 1, kapitulli Objektivi ndërsektorial 1: Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative për përafrimin me <i>acquis</i> të BE-së	TAIEX, /IPA III, IPARD III TA /Donatorët
26. AT për të dhënat statistikore për treguesit mjedisorë bazë		- Treguesit bazë mjedisorë, sipas gjinive duhet të jenë të disponueshëm për monitorimin e ndikimit të strategjisë dhe për IPARD III. - Njësia për monitorimin dhe vlerësimin e IPARD III, duhet të përgatisë një analizë të mangësive dhe mbështetet me një projekt AT për mbledhjen e treguesve, në përputhje me udhëzimet e BE-së (C31 – C45). Duhet të përgatitet një manual për monitorimin e treguesve bazë mjedisorë.	2.8 Objektivi ndërsektorial 1, kapitulli Objektivi ndërsektorial 1: Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative për përafrimin me <i>acquis</i>	TAIEX /IPA III, IPARD III TA /Donatorët



Masa/ndërhyrja e planifikuar	Përshkrim i shkurtër i instrumenteve të ndërhyrjes	Referenca përkatëse me nevojat e	Burimi i buxhetit (pa bashkëfinancim nga privatët)
27. AT për ngritjen e FADN-së dhe përgatitjen e analizave ekonomike	- Krijimi i FADN-së duhet të fillojë me burime të përshtatshme njerëzore të alokuara nga MBZHR-ja. - Njësia FADN (në MBZHR) duhet që në fund të zbatimit të projektit AT të mund të përgatisë dhe publikojë analiza vjetore ekonomike bazuar në FADN.	të BE-s 1.14	TAIEX /IPA III, IPARD III TA/ Donatorët (FAO ka filluar)
28. AT për futjen e KMBM-ve të thjeshtuara	- Përfitues është MBZHR-ja. - Mbështetja AT duhet të synojë përpunimin e KMBM-ve përfshirë: - Standardet që synojnë të kontribuojnë në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, për të trajtuar sfidat e ujit, mbrojtjen dhe cilësinë e tokës dhe mbrojtjen dhe cilësinë e biodiversitetit vetëm nëpërmjet praktikave të mira. Nuk duhet të merren parasysh praktikatat për të cilat nevojiten makineri/pajisje të specializuara ose investime në asete fizike. - Përfshirja/bashkëpunimi i ngushtë me universitetet dhe institutet kërkimore të vendit dhe konsultime me shoqatat e fermerëve. - Ngritja dhe operimi i SHKF-së, si një mbështetje e dedikuar informacioni dhe këshillimi institucional për kushtet e reja mjedisore të përfshira. - Zbatimi i një fushate të madhe ndërgjegjësimi, si dhe përgatitja e kontrolleve administrative dhe në terren, si dhe trajnimi për AZHBR-në. KMBM-të duhet t'i nënshtrohen kontrollit minimal prej 1%.	2.5, 2.6	TAIEX /IPA III, IPARD III TA/ Donatorët
29. AT për hartimin/zbatimin e Kodit të Praktikave të Mira Bujqësore për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes nga nitratat të shkaktuar nga bujqësia dhe për Kodin e Praktikës së Mirë Bujqësore për Reduktimin e Emetimeve të Amoniakut	- Përfitues është MBZHR-ja dhe MTM-ja - Kodi i Praktikave të Mira Bujqësore për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes nga nitratat të shkaktuar nga bujqësia duhet të përgatitet në përpunime me Direktivën e Nitrates. AT duhet të përfshijë një fushatë ndërgjegjësimi dhe trajnim për fermerët nga sektori i blegtorisë. Trajnimi mund të shoqërohet me grante për investime, sipas nevojës për përmbushjen e standardeve. - Kodi i Praktikave të Mira Bujqësore për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes me nitrata të shkaktuar nga bujqësia duhet të përgatitet në përpunime me Direktivën NEC, e transpozuar me VKM-në nr. 162, datë 19.2.2020, “Për rregullat e hollësishme për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve të pakësimit të shkarkimeve në ajër”. AT-ja duhet të përfshijë një fushatë ndërgjegjësimi dhe trajnime për fermerët nga sektori i gjedhit. Trajnimi mund të shoqërohet me grante për investime, sipas nevojës për përmbushjen e standardeve.	2.5, 2.6	Donatorët
30. AT për konsolidimin e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e sistemeve të ujitjes dhe kullimit	- MBZHR-ja, bashkitë dhe OPU-të duhet të këshillohen dhe trajnohen për përshtatjen e procesit të transferimit të të drejtave të përdorimit tek OPU-të për kanalet dytësore dhe terciare dhe për rehabilitimin dhe menaxhimin e sistemeve të ujitjes dhe kullimit.	1.7	Buxheti Kombëtar, Donatorët
30. AT për skemat e cilësisë së ushqimit	- Përfitues është MBZHR. - Legjislacioni dhe procedurat për zbatimin e EOM dhe TMGJ duhet të përmirësohen. - TA-ja duhet, gjithashtu, të përfshijë: - Këshillim dhe trajnim për përcaktimin e kompetencave të institucioneve dhe specialistëve të përfshirë në skemën EOM /TMGJ dhe trajnime për procedurat e kontrollit dhe verifikimit të produkteve EOM/TMGJ; - Duhet të zbatohet një fushatë e gjerë publike për promovimin e produkteve tradicionale dhe produkteve EOM/TMGJ të regjistruara, me synim rritjen e shikueshmërisë së tyre në tregjet lokale dhe rritjen e besimit të konsumatorëve, me përfshirjen e operatorëve turistikë për arritjen e sinergjive me sektorin e turizmit.	1.12, 2.4	Donatorët



Masa/ndërrhyrja e planifikuar	Përshkrim i shkurtër i instrumenteve të ndërrhyrjes	Referenca përkatëse me nevojat e	Burimi i buxhetit (pa bashkëfinancim nga privatët)
	Duhet të merret në konsideratë promovimi i zinxhirëve të furnizimit të shkurtër për nxitjen e konsumit të produkteve lokale me cilësi të lartë.		
31. AT për marketing të drejtpërdrejtë/zinxhirët e shkurtër të furnizimit	- Përfitues janë MBZHR, AKU, fermerë, prodhues të vegjël ushqimesh dhe shoqatat e tyre. - Modifikimi i udhëzimit nr. 5, datë 4.5.2018, të MBZHR-së (regjistrimi i prodhuesve të vegjël ushqimorë, produktet ushqimore tradicionale) dhe lidhja e tij me mbështetjen e investimeve IPARD III (Masa e diversifikimit). - Do të përgatiten përkufizimet e mëposhtme: të fermerit/fermerit të vogël/fermerit gjysmë komercial, shitësit të drejtpërdrejtë dhe zinxhirëve të furnizimit të shkurtër. - Hartimi i udhëzimeve për praktikën e mirë të higjienës ushqimore për produktet ushqimore me origjinë shtazore dhe bimore dhe kryerjen e vetëkontrollit nga fermerët dhe përpunuesit artizanale të ushqimit të regjistruar si prodhues të vegjël ushqimesh në MBZHR. - Udhëzues dhe material trajnimi për rritjen e njohurive dhe aftësive të prodhuesve të vegjël të ushqimit. - Baza që AKU të zbatojë kontrolle të qëndrueshme në të gjithë territorin për të forcuar besueshmërinë e sistemeve të gjurmueshmërisë së ushqimit. - Përpunimi i skemave të përshtatshme vullnetare të cilësisë së ushqimit (p.sh., “tregtimi i drejtpërdrejtë bujqësor”, “blerja në fermë”, “produkte ushqimore tradicionale të prodhuara në mënyrë artizanale”) për prodhuesit e vegjël të ushqimit. - Trajnim dhe shkëmbim njohurish për fermerët dhe prodhuesit e vegjël të ushqimit në marketing dhe komunikim për zinxhirët e shkurtër të furnizimit ushqimor (skemat në fermë dhe jashtë fermës), CSA, shitje te bujtinat etj.	3.1, 1.2	IPARD III + Fondet kombëtare (Masa AT), Donatorët
32. AT për promovimin e bujqësisë organike	- Përfitues është MBZHR, ndërsa përfituesit final janë fermerët. Shërbimet këshilluese publike do të përfshihen. - Do të promovohen përfitimet mjedisore dhe të tregut. Do të sigurohet një numër veprimesh dhe një paketë informacioni praktik për kalimin në bujqësinë organike.	2.4, 2.5, 2.6, 2.7	IPA III, Donatorët
33. AT për Global G.A.P dhe HACCP	- Përfitues janë fermerët dhe përfaqësuesit e përpunuesve agroushqimor. - Projekti AT duhet të ofrojë trajnime drejt përmbushjes së standardeve GLOBAL G.A.P dhe HACCP për fermerët e orientuar nga tregu dhe operatorët e biznesit ushqimor. Trajnimi mund të shoqërohet me grande për investime sipas nevojës për përmbushjen e standardeve.	1.11	IPARD III + Fondet kombëtare (Masa AT), Donatorët
34. AT për promovimin e agroturizmit /turizmit rural	- Përfitues janë: Fermerët, popullsia rurale që investon në turizmin rural, operatorët turistikë, MBZHR, MTM. - Konsolidimi i kuadrit ligjor-administrativ për agroturizmin. - Rishikimi i standardeve të duhura të cilësisë për akomodimet turistike rurale të diferencuara sipas llojit të tyre. - Trajnime mbi standardet cilësore dhe të sigurta të udhëtimit bazuar në praktikën më të mirë të aplikuar ndërkombëtarisht (operatorë turistikë dhe fermerë, popullsi rurale). - Zhvillimi i agroturizmit me një përcaktim të qartë (koncepti i punës-fermës), standardet e duhura të sigurimit të cilësisë dhe për udhëtime të sigurta. - Konceptet e marketingut, koordinimi ndërmjet operatorëve, markat si “Agroturizmi Shqiptar” - Zhvillimi i mundësive digjitale.	3.2	IPARD III + Fondet kombëtare (Masa AT), Donatorët
35. Mbështetje fillestare (start-up) për të rinjtë e diplomuar në sektorin e bujqësisë	Program i posaçëm <i>start-up</i> për të diplomuarit për zhvillimin e biznesit në zonat rurale (AT dhe akses në grande) të lidhura me sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit.	3.6	Donatorët (AT dhe FA)
36. Studimi i fizibilitetit për rrjetin	Vlerësimi i rrjetit rrugor pyjor si bazë për nevojat prioritare për investime, të tilla si toka pyjore e klasifikuar me rrezik të	3.13	Buxheti Kombëtar, MTE



Masa/ndërhyrja e planifikuar	Përshkrim i shkurtër i instrumenteve të ndërhyrjes	Referenca përkatëse me nevojat e	Burimi i buxhetit (pa bashkëfinancim nga privatët)
rrugor pyjor	lartë për zjarret pyjore (të pranueshme për IPARD III- Infrastruktura rurale).		Masa e AT IPARD
37. AT dhe kërkim shkencor mbi bioekonominë dhe ekonominë rrethore të bazuar në bio (biomasa nga bujqësia dhe pyjet, biokarburantet)	- Përfitues janë MBZHR, MTM - Njohuri shkencore, inovacion dhe ndryshim i teknologjive për të zhvilluar dhe krijuar procese të bazuara në biobujqësore dhe pyjore. - Identifikimi i llojeve të aktiviteteve brenda zinxhirëve të vlerave të bioekonomisë rurale që ofrojnë përfitime dhe të ardhura më të mëdha klimatike dhe mjedisore për fermerët dhe pylltarët - Mbështetja dhe kërkimi i AT duhet të përfshijë 3 shtylla (të koordinuara horizontalisht): 1. Investime në kërkime, inovacion dhe aftësi; 2. Formulimi i politikave horizontale (ndërsektoriale), bashkëveprimi dhe angazhimi i palëve të interesit; 3. Rritja e tregjeve dhe konkurrueshmërisë.	3.6	Donatorët, Institucionet kërkimore (ndërkombëtare, rajonale, kombëtare)
38. Fuqizimi dhe funksionimi i një Rrjeti Kombëtar Rural	- MBPZH-ja duhet të kontrakttojë shërbime për ngritjen dhe veprimin e një Rrjeti Kombëtar Rural, i cili do të përfshijë të gjithë aktorët e rëndësishëm (organizata të fermerëve, sindikatat e përpunuesve, përfaqësuesit e pyjeve, OJQ-të mjedisore dhe sociale, përfaqësuesit e bashkive, përfaqësuesit e GVV-ve). - Përgatitja e rregullave të brendshme të rrjetit. - Kostot e aktiviteteve të Rrjetit Rural financohen nga masa AT të IPARD III	3.8	IPARD III + Fondet kombëtare (bashkëfinancim) Masa AT, Donatorët, Buxheti Kombëtar përfshirë buxhetin bashkiak
39. AT mbi iniciativat lokale të zhvillimit rural	- Përfitues janë partneritetet lokale (sektori privat, civil, publik), MBZHR, Rrjeti Kombëtar Rural - Zhvillimi i SZHL në bazë territori që pasqyron tema prioritare, si: diversifikimi ekonomik-lokal, zhvillimi i turizmit rural që përfshin infrastrukturën e turizmit, zhvillimi lokal përfshirës dhe zhvillimi social, veprimet për mbrojtjen e mjedisit dhe klimës. - Zbatimi i masave pilot prioritare në SZHL. - Ngritja e kapaciteteve për rrjetëzim (kombëtare, rajonale, ndërkombëtare). - Trajnimi i GVV-ve/partneriteteve lokale në çështjet financiare-administrative, menaxhuese dhe të komunikimit. - Ngritja e kapaciteteve për RKZHR (sipas kërkesave të PPB të BE-së) përfshirë MBZHR-në.	3.7, 3.8	IPARD III + Fondet kombëtare (bashkëfinancim) TA dhe Masat LEADER, Donatorët, Buxheti Kombëtar përfshirë buxhetin bashkiak



Tabela 4-2: Mekanizmat e ndërhyrjes në sektorin e peshkimit dhe të akuakulturës

Masa/ndërhyrja e planifikuar	Përshkrim i shkurtër i instrumentit të ndërhyrjes	Referenca përkatëse me nevojat e identifikuar	Burimi i buxhetit (pa bashkëfinancim nga privatë)
1. Investime në rinovimin e flotës së peshkimit, pa rritur sforcon e peshkimit	- Përfitues janë peshkatarët/anijet e peshkimit. - Rinovimi i flotës së anijeve të peshkimit pa rritur përpjekjet e peshkimit sipas skemës kombëtare të MBZHR-së “Mbështetje për peshkimin” (duke filluar nga viti 2022).	4.3	Buxheti Kombëtar
2. Investime për përmirësimin e infrastrukturës portuale dhe vendeve të zbarkimit	- Përfitues do të jenë të gjithë aktorët e sektorit të peshkimit profesional. - Duke qenë se përmasat e porteve të peshkimit janë të vogla dhe në disa prej tyre kushtet për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit janë të papërshtatshme, është e nevojshme të përmirësohet infrastruktura portuale dhe kapacitetet më të përshtatshme të ankorimit. - Kjo do të bëhet përmes huave sepse kërkon investime të mëdha.	4.1	Buxheti Kombëtar, Donatorët (FA: Italian Agency for Development Cooperation and Eorld Bank)
3. Vazhdimi i programit të tregjeve të peshkut me shumicë, duke rritur formalizimin e sektorit	- Përfitues janë prodhuesit kryesorë (peshkimi profesional dhe artizanal), tregtarët dhe operatorët e tjerë të shitjes me shumicë si restorantet, hotelet, pikat e shitjes me shumicë dhe pakicë etj. - Ndërtimi/rehabilitimi i katër tregjeve me shumicë të peshkut (Shëngjin, Vlorë, Durrës, Sarandë).	4.2	Buxheti Kombëtar
4. Mbështetja për PSHV dhe formalizimi i tyre përfshirë ndërtimin e vendeve të zbarkimit për PSHV	- Përfitues janë peshkatarët e vegjël që ushtrojnë aktivitet të vogël peshkimi artizanal. - Duhet të mbështetet peshkimi artizanal bregdetar në shkallë të vogël, për të përmirësuar dhe kontrolluar kushtet e burimeve ujore, për të nxitur organizimin e zinxhirit të prodhimit, përpunimin dhe tregtimin e produkteve të peshkimit, për të nxitur nismat për reduktimin vullnetar të përpjekjeve të peshkimit dhe mbrojtjen e burimeve. - Ndërtimi i vendeve të zbarkimit për të mbështetur peshkimin artizanal që shet peshq të kapur dhe nga ana tjetër rrit sigurinë ushqimore të produktit dhe rrit formalizimin e sektorit bazuar në studimin e Kooperacionit Italian, që ndan bregdetin në shtatë zona dhe në tri zonat ujore të brendshme (Pogradec, Prespë dhe Kukës). - Veprimet duhet të jenë në përputhje me Planin e Veprimit të KPPM për PSHV.	4.4	Donatorët Ndërkombëtarë (Agjencia Italiane për Bashkëpunim për Zhvillim)
5. Grande për investime në asete fizike për përpunimin dhe tregtimin e produkteve të peshkimit	- Përfitues janë ndërmarrjet e përpunimit të ushqimit në sektorin e peshkimit. - Intensiteti i ndihmës duhet të jetë më i lartë për investimet në përputhje me standardet e BE-së. - Duhet t'i jepet prioritet përafrimit të standardeve të BE-së, veçanërisht për sigurinë ushqimore dhe menaxhimin e mbetjeve (trajtimi i ujit dhe ripërdorimi i mbetjeve) dhe për integrimin e prodhimit të prodhuesve vendës/ inkurajimin e zinxhirëve të furnizimit të shkurtër. - Paradhëniet duhet të jenë të mundshme. - Në përfundim të investimit, i gjithë objekti duhet të jetë në përputhje me të gjitha standardet kombëtare, ndërsa investimi me rregullat e BE-së.	4.6, 4.7, 4.10	EU IPARD III + Buxheti Kombëtar (bashkëfinancim)
6. Prodhimi i ushqimit për akuakulturën dhe trajtimi i nënprodukteve	- Përfitues janë të gjithë aktorët që operojnë në sektorin e përpunimit dhe të gjithë sektorin e akuakulturës (në tokë dhe ujëra detare). - Përmirësimi i menaxhimit të nënprodukteve nga sektori i përpunimit të peshkut për të prodhuar ushqim peshku. Shqipëria importon ushqime për sektorin e akuakulturës, e cila redukton sasinë e mbetjeve të depozituara dhe zbut ndotjen e mjedisit. - Mbështetja është në përputhje me masën MBZHR-FDP që fokusohet në përmirësimin e trajtimit të mbetjeve dhe përdorimin e nënprodukteve	4.6, 4.7, 4.10	IPARD III + Fondet kombëtare (bashkëfinancim) Masa e diversifikimit



Masa/ndërhyrja e planifikuar	Përshkrim i shkurtër i instrumentit të ndërhyrjes	Referenca përkatëse me nevojat e identifikuar	Burimi i buxhetit (pa bashkëfinancim nga privatë)
7. Mbështetje për speciet e reja që janë objekt i përpunimit (p.sh., molusqet)	- Përfitues janë të gjithë aktorët që operojnë në sektorin e përpunimit dhe të gjithë peshkatarët profesionistë të sektorit të peshkimit. - Zgjerimi i hartës së llojeve të përpunuara në fabrikat e përpunimit do të rrisë punësimin në këtë sektor. Një alternativë e mirë do të ishte përpunimi i molusqeve, por edhe i llojeve të tjera të peshkut.	4.6	IPARD III + Fondet kombëtare (bashkëfinancim)
8. Zhvillimi i qëndrueshëm akuakulturës në përputhje me mjedisin.	- Përfitues janë të gjithë aktorët e sektorit të akuakulturës (në ujërat tokësore dhe detare). - Përcaktimi i ZPA-ve për vijën bregdetare është pothuajse i mbyllur, përcaktimi i ZPA-ve për ujërat e brendshme mbetet i nevojshëm. - Rritja e akuakulturës së troftës dhe kryesisht përpunimi i troftës në formë filetimi. - Riaktivizimi i akuakulturës së karkalecave.	4.5, 4.7	Buxheti Kombëtar, IPARD III + Fondet kombëtare (bashkëfinancim) Masa e diversifikimit
9. Grande dhe AT për zhvillimin e ekonomisë blu dhe zhvillimin e turizmit detar	- Përfitues janë aktorët e sektorit privat. - Mbështetje e integruar për sektorin e turizmit detar për të krijuar vende të reja pune dhe për të rritur zhvillimin e orientuar lokal. - Fokusi duhet të jetë në zhvillimin e komuniteteve bregdetare.	4.11	IPA III (Ministria e Ekonomisë), Buxheti Kombëtar, Donatorët
10. Rritja e eksporteve të produkteve cilësore të peshkimit	- Përfitues janë të gjithë aktorët që operojnë në sektorin e përpunimit dhe të gjithë peshkatarët profesionistë të sektorit të peshkimit. - Të rindegocohet për kuotën tarifore të BE-së për açuge të konservuara dhe levrekë deti nga Shqipëria, duke evidentuar aksesin në tregun dalës sipas MSA-së. - Investime në prodhimin dhe përpunimin e molusqeve bivalvore dhe dekapodësh. - Miratimi i ZPA-ve për zhvillimin e mëtejshëm të akuakulturës detare dhe të brendshme.	4.10, 4.7, 4.6, 4.5	Buxheti Kombëtar, Donatorët
11. AT për Zhvillimin e Kapaciteteve në MBZHR	- Për harmonizimin me kapitullin 13 nevojitet zhvillim i mëtejshëm i kapaciteteve: - Marrja e masave për plotësimin dhe forcimin e kapaciteteve administrative të sektorit të peshkimit për të siguruar një menaxhim të duhur të burimeve të peshkimit në përputhje me strategjinë kombëtare dhe detyrimet ndërkombëtare; - Vazhdimi i zbatimit të Planit Rajonal të Veprimit për PSHV duke përfshirë përmirësimin e mbledhjes së të dhënave dhe statistikave të zbarkimit nga peshkimi i vogël; - Forcimi i kapacitetit të inspektimit dhe kontrollit për të kufizuar PPPP.	4.8, 4.9	IPA III, Donatorët, Buxheti Kombëtar
12. Krijimi i Qendrës Kombëtare Kërkimore për Shkencat e Peshkimit në Shqipëri	- Për mbështetjen e menaxhimit të sektorit të peshkimit. - Përmirësim në mbledhjen e të dhënave dhe vlerësimin e stokut të peshkut. Deri më tani, aftësia për të përmbushur këto përgjegjësi pengohet nga një buxhet shumë i kufizuar, i cili është pothuajse tërësisht i varur nga mbështetja <i>ad hoc</i> e projektit. - Ngritja e kapaciteteve të stafit për mbledhjen e të dhënave në përgjegjësinë e tyre dhe angazhimin me shkencën rajonale në kuadrin e KPPM (GFCM).	4.10	IPA III, Donatorët, Buxheti Kombëtar
13. Ristrukturimi dhe fuqizimi institucional i administratës së peshkimit në MBZHR	- Përfitues është MBZHR për të qenë në përputhje me praktikat dhe standardet aktuale të BE-së, për të forcuar kontributin e sektorit të peshkimit dhe akuakulturës në ekonomi. - Ristrukturimi i administratës së peshkimit në një DP me dy drejtori (për menaxhimin e peshkimit dhe akuakulturës dhe për sistemin e menaxhimit të informacionit, përfshirë inspektoratet e peshkimit).	4.8	Buxheti Kombëtar



Masa/ndërrhyrja e planifikuar		Përshkrim i shkurtër i instrumentit të ndërrhyrjes	Referenca përkatëse me nevojat e identifikuar	Burimi i buxhetit (pa bashkëfinancim nga privatë)
14. Projekti AT për përafrimin e legjislacionit të BE-së	Kapitulli 13	- Përfitues është MBZHR në arritjen e përputhshmërisë së mëtejshme me PPP të BE-së, kuadrin ligjor dhe angazhimet ndërkombëtare në fushën e peshkimit, akuakulturës dhe ujërave të brendshme; - Forcimi administrativ i administrimit të peshkimit, duke përfshirë shërbimet e inspektimit dhe kontrollit, si dhe mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të peshkimit për hartimin e planeve të menaxhimit të peshkimit dhe raportimin në organizatat rajonale të menaxhimit të peshkimit (KPPM/GFCM); rekrutimi i monitoruesve dhe i vëzhguesve për të bashkëpunuar me shërbimin e inspektimit; - Mbështetja e vlerësimit vjetor të gjendjes së burimeve të peshkimit për të mundësuar zbatimin e politikës fleksibël të peshkimit në Shqipëri; - Forcimi i mbledhjes së të dhënave dhe i këshillimit shkencor për menaxhimin e rezervave të peshkut në përputhje me <i>acquis</i> të BE-së. - Zbatimi dhe zhvillimi i masave të politikës së tregut për organizimin e tregjeve të shitjes me shumicë të produkteve të peshkut.	4.8, 4.9 Objektivi ndërsëktorial 1, kapitulli Objektivi ndërsëktorial 1: Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative për përafrimin me të drejtën e BE-së	Buxheti Kombëtar, Donatorët



5. Përshkrimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit të SBZHRP-së zbaton dispozitat e QSH-së për hartimin e strategjive sektoriale, në përputhje me kërkesat kombëtare të sistemit të **planifikimit të dokumenteve strategjike**, të koordinuara nga Agjencia Shtetërore për Programimin Strategjik dhe koordinimin e Ndihmës” – ASHPSKN bazuar në VKM-në nr. 290, datë 11.4.2020, “Për **krijimin e Sistemit të Informacionit të Sistemit të Planifikimit të Integruar Qeveritar (IPSIS)**”. IPSIS-i është plotësisht funksional që nga viti 2021 për planifikimin/programimin, monitorimin dhe vlerësimin e kuadrit strategjik nga institucionet e qeverisjes qendrore, si dhe analizën dhe raportimin e të dhënave, në mënyrë që të shmanget fragmentimi dhe dublikimi midis politikave kryesore dhe proceset e planifikimit financiar.

Në kuadrin e përgatitjes së MBZHR-së për përafrimin me *acquis* të kapitujve 11, 12, 13 dhe 27 (si kontributor të MTE-së), modelet/pasaportat e ndikimit të përcaktuar dhe treguesit e rezultateve janë të orientuara në indikatorët e kontekstit të PPB-së së BE-së⁵⁹ – **shih kornizën logjike me buxhetin dhe objektivat deri në vitin 2024 (3 vitet e para të zbatimit) dhe objektivat e parashikuara deri në vitin 2027.**

Tri nivelet e treguesve janë:

- **Treguesit e ndikimit** (monitorim shumëvjeçar) në nivel objektiv të përgjithshëm për vlerësimin e performancës të SBZHRP-së kundrejt prioritetëve të politikave të Qeverisë.

- **Treguesit e rezultateve** (afat 3-vjeçar në vend të njëvjeçar, si në BE, për shkak të dhënave bazë të kufizuara dhe alokimeve buxhetore afatshkurtra bilanci mbyllet në fund të vitit) për monitorimin e arritjeve të Objektiveve të përgjithshëm dhe për çdo objektiv specifik bazuar në ndërhyrjet sipas SBZHRP 2021–2027.

- **Treguesit e outputit (efektit përfundimtar)** (verifikimi/konfirmimi vjetor i performancës) bazuar në treguesit e efektit (të tilla si numri i përfituesve, numri i hektarëve etj.) për çdo ndërhyrje të planifikuar dhe **të detajuar për gjininë dhe grup-moshat** (fermerët e rinj/sipërmarrësit) si dhe për p.sh., nënsektorët, rajonet etj.

Të dhënat për indikatorët e monitorimit do të mbledhen në nivel drejtorie dhe agjencie përkatëse të MBZHR-së. Drejtoritë përkatëse për strategjitë dhe politikat për bujqësinë, sigurinë ushqimore, peshkimin dhe zhvillimin rural të MBZHR-së do të grumbullojnë dhe analizojë informacionin, i cili përfshin, gjithashtu, të dhëna për zbatimin e Programit IPARD (thirrjet IPARD) të raportuara nga Autoriteti Menaxhues i IPARD dhe të mbledhura nga Agjencia IPARD (AZHBR).

Vlerësimi për arritjen e objektivit do të shoqërojë raportimin e të dhënave të monitorimit.

Progresi në përmbushjen e objektivave do të përfshihet në **Raportin Vjetor të Performancës.**

Në vitin 2025 **do të bëhet një rishikim i pavarur afatmesëm** i zbatimit të strategjisë për të bërë rregullime në objektivat përfundimtarë, bazuar në raportimin vjetor dhe planifikimin e përditësuar të buxhetit/programimit të buxhetit afatmesëm kombëtar 2025–2027.

Në vitin 2028 do të kryhet një **vlerësim i pavarur “ex-post”** për zbatimin e strategjisë.

Të gjitha aktivitetet e monitorimit dhe të vlerësimit do të përfshijnë analizën gjinore, vlerësimin e ndikimit dhe parimet monitoruese, duke dhënë impaktin në nivel objektiv, rezultati dhe *output*-i (efekti përfundimtar) dhe vlerësimin e arritjes së synimit, në lidhje me objektivin e përgjithshëm ndërsektorial që siguron zhvillimi të barabartë në bujqësi, zhvillim rural, dhe në peshkim¹, siç paraqitet në: https://agridata.ec.europa.eu/extensions/DataPortal/cmef_indicators.html.

⁵⁹ Siç paraqitet në:

https://agridata.ec.europa.eu/extensions/DataPortal/cmef_indicators.html.



6. Anekset

6.1 Korniza logjike e SBZHRP-së me objektivat dhe treguesit (ndikimi, rezultati dhe *output*-i) për 2022–2027 e buxhetuar për periudhën 2022–2024.

Referenca e përdorur për hartimin e treguesve të ndikimit (impaktit) dhe të rezultateve është e orientuar tek indikatorët e PPB-së së BE-së, siç paraqitet në: https://agridata.ec.europa.eu/extensions/DataPortal/cmef_indicators.html.

Tabela 6-1: Korniza logjike në lidhje me objektivin dhe treguesit për 2024–2027 dhe buxhetin për 2022–2024

Objektivi /treguesi		Vlera e treguesve bazë – 2020				Objektivi për vitin 2024	Objektivi për vitin 2027	
Objektivi i përgjithshëm 1: Promovimi i prodhimit të qëndrueshëm dhe cilësisë të ushqimit nëpërmjet zhvillimit të një sektori konkurrues dhe inovativ agroushqimor								
	Treguesi i ndikimit 1.1: Vlera e shtuar bruto e produktit (në euro) synohet të rritet me 15% deri në vitin 2027	2,559,051,109				+7%	+15%	
	Treguesi i ndikimit 1.2: Deri në vitin 2027 do të rritet me 10% numri i vendeve të punës në sektorin e agropërpunimit (e përllogaritur në njësi vjetore punuese-AWU)	13,862- nr. i të punësuarve në agropërpunim				+5%	+10%	
	Treguesi i ndikimit 1.3: Produktiviteti i punës (euro/NJPV) deri në vitin 2027 do të rritet me 20%	5,680				+15%	+20%	
Objektivi specifik 1.1: Rritja e qëndrueshmërisë ekonomike dhe e reziliencës së fermave								
	Treguesi i rezultatit 1.1: Numri total i përfituesve të mbështetur për të ardhurat vjetore	3,973				40,000	80,000	
	Veprimi /Ndërhyrja /Masa	Treguesit e <i>output</i> -it	Buxheti total 2022 – 2024 (EUR)	Buxheti i alokuar 2022 – 2024 (euro) (N = nevoja, nuk mbulohet nga buxheti kombëtar)			Objektivi më 2024-n	Objektivi më 2027-n
				2022	2023	2024		
	Mbështetja kalimtare e të ardhurave për sektorët e orientuar nga tregu (organizimi i tregut të përbashkët), pagesa të lidhura me prodhimin ose vlerën e shitjeve për produktet si perime, fruta dhe ullinj	Numri vjetor i fermave të mbështetura	BK ⁶⁰	BK			400	2,000
	Mbështetja e të ardhurave të fermës bazuar në sipërfaqen bujqësore të shfrytëzuar/ ferma prodhimit bimor (përfshirë skemat <i>decoupling</i>)	Numri i fermave të mbështetura në bazë vjetore, përfshirë BAM (orientuese)					1,200	1,500
	Mbështetje për serrat	Numri i fermave të modernizuara (orientues)					450	1,000
		Sipërfaqe në Ha me nën serra (si sipërfaqe totale në nivel kombëtar, edhe si efekt indirekt (orientues)					3,000	4,500
	Mbështetja e të ardhura në fermë për fermat	Numri i fermave blegtorale të					25,00	3,000

⁶⁰BK– Buxheti Kombëtar (sipas ndarjeve vjetore)



	blegtorale	mbështetura në vit						
		Numri i bletarëve të mbështetur në një vit ra gjinore mbi pronësinë dhe për menaxhimin e aktivitetit.					1,000	1,200
	Kompensimi për naftën në bujqësi	Numri i fermave të mbështetura					35,000	40,000
	Skemat pilot të Sigurimeve në bujqësi	Numri i fermave të mbështetura	N:50,000	0	0	N:50,000	0	100

Objektivi specifik 2: Rritja e konkurreshmërinë dhe orientimit drejt tregut e sektorit agroushqimor								
Treguesi i rezultatit 2.1: Bilanci tregtar agroushqimor (raporti eksport- import) ushqim-pije-duhan			1 : 2.84				1 : 2.4	1 : 2.0
Veprimi /ndërhyrja :	Treguesi i <i>output</i> -it:		Buxheti total 2022 – 2024 (EUR)	Buxheti i alokuar (euro) 2022 – 2024 (N = nevoja, nuk mbulohet nga buxheti kombëtar/buxheti IPA III)			Objektivi për 2024 (shumator, sipas treguesit të <i>output</i> -it)	Objektivi për 2027 (shumator, sipas treguesit të <i>output</i> -it)
				2022	2023	2024		
Investime në modernizimin e aseteve fizike të njërive bujqësore/mekanizimi	Numri i fermave përfituese të mbështetura nga IPARD III – masa 1		15,323,333	5,333,333	3,990,000	4,656,667	250	540
	Numri i fermave të mbështetura me buxhetin kombëtar (indikativ)		BK	BK	BK	BK	500	1,000
	Në kuadër të IPARD III – Masa 1, sasia në Ha serra, e sipërfaqeve të reja ose të modernizuara	E pazbatueshme (e përfshirë në BK dhe në buxhetin për M1)	E pazbatueshme (e përfshirë në BK dhe në buxhetin për M1)	E pazbatueshme (e përfshirë në BK dhe në buxhetin për M1)	E pazbatueshme (e përfshirë në BK dhe në buxhetin për M1)	E pazbatueshme (e përfshirë në BK dhe në buxhetin për M1)	500	1,000
	Numri i graveve në kuadër të IPARD III – Masa 1 për investime për fermat e reja (<i>start-up</i>).	E pazbatueshme (e përfshirë në buxhetin për M1)	E pazbatueshme (e përfshirë në buxhetin për M1)	E pazbatueshme (e përfshirë në buxhetin për M1)	E pazbatueshme (e përfshirë në buxhetin për M1)	E pazbatueshme (e përfshirë në buxhetin për M1)	40	90
Investimet në modernizimin e aseteve fizike në lidhje me përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit	Numri i përpunuesve agroushqimor të mbështetur nga IPARD III – Masa 3.		14,394,570	4,000,000	5,226,667	5,167,903	110	270
Rehabilitimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	Rritja dhe përmirësimi i aftësisë ujëtare në HA		BK	BK	BK	BK	10,000	30,000
Instrumentet financiare	Numri i fermave dhe përpunuesve agroushqimorë të mbështetura përmes skemës të garancive për kreditë agroushqimorë		4,832,392	641,008	274,685	3,916,699	500	2,000



Grand për instalimin (start-up) të fermerëve të rinj	Numri i fermerëve të rinj të mbështetur me grande për start-up do të arrijë në 800 të tillë deri në vitin 2027.	N: 1,000,000	0	0	1,000,000	200	800
Grand për Grupet e prodhuesve për ullinj, fruta dhe perime (M2)	Numri i grupeve të prodhuesve të mbështetur (IPARD III) do të jetë 60 grupe deri në vitin 2027.	N: 1,000,000	0	0	1,000,000	15	60

Objektivi specifik 3: Përmirësimi i reagimit ndaj kërkesave të konsumatorëve për ushqim të sigurt, me vlera ushqyese dhe të qëndrueshëm

	Treguesi i rezultatit 3.1: Tregtimi dhe përdorimi i PMB-ve dhe i antibiotikëve veterinarë bëhet në përputhje me standardet e BE-së		Nuk ka vlerë bazë disponibël				Deri në mesataren e BE-së	Deri në mesataren e BE-së
	Masa /Veprimi /Ndërhyrja:	Treguesi i <i>output</i> -it :	Buxheti total 2022 – 2024 (euro)	Buxheti i alokuar (euro) 2022 – 2024 (N = nevoja, nuk mbulohet nga buxheti kombëtar/buxheti IPA III)			Objektivi 2024 (shumator, sipas treguesit të <i>output</i> -it)	Objektivi 2027 shumator, sipas treguesit të <i>output</i> -it)
				2022	2023	2024		
	Grande për sistemet lokale ushqimore dhe zinxhirët e shkurtër të furnizimit	Numri i prodhuesve të mbështetur nga IPARD III – Masa 7 (me një buxhet orientues 20% i buxhetit të total të masës).	2,234,941	562,667	647,638	1,024,636	67	160
	Skema e cilësisë/sigurisë së qumështit	Numri i fermave të mbështetura në një vit me këtë skemë synohet të arrijë në 1000 deri në vitin 2027.	N: 600,000	0	N:300,000	N:300,000	0	1000
	Mbështetje për investime për të harmonizuar në mënyrë progresive me standardet e BE-së për higjienën dhe mirëqenien e kafshëve	Numri i fermave dhe ndërmarrjeve të përpunimit të ushqimit, të mbështetura (IPARD III) do të arrijë në 320 në vitin 2027.	(e përfshirë në buxhetin për M1 dhe M3)	-	-	-	150	320
	AT për Global GAP dhe HACCP	Numri i fermave të mbështetura për certifikimin me standardin Global G.A.P. do të arrijë në 30 (tregues orientues) do të arrijë në 10 deri në vitin 2024 dhe në 30 deri vitin 2027.	BK	BK	BK	BK	10	30
		Numri i fermerëve të trajnuar për Global GAP. Do të arrijë në 500 në 2024 dhe në 1,500 deri në vitin 2027.	N:200,000	0	N:100,000	N:100,000	500	1,500
		Numri i punonjësve të njëjësive agro-përpunuese të trajnuar për HACCP-ndo të rritet në 125 deri në vitin 2024 dhe në 375 deri në vitin 2027.	N:50,000	0	N:25,000	N:25,000	125	375



OBJEKTIVI/TREGUESI		Vlera bazë – 2019				Objektivi deri më 2024-n	Objektivi deri më 2027-n	
Objektivi i Përgjithshëm 2 - Forcimi i menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe ndërmarrja e veprimeve klimatike								
	Treguesi i ndikimit 2.2: Sipërfaqja e tokave livadhore - Kullota me vlerë të lartë natyrore (VLN) do të përmirësohet në drejtim të mirë menaxhimit nga përdoruesit.	Nuk ka vlerë bazë disponibël				Mirëmbajtja	Mirëmbajtja	
	Treguesi i ndikimit 2.3: Përmbajtja e nitrates në ujërat sipërfaqësore do të arrijë vlera më të ulëta ose deri në 50 mg NO ₃ /litër	Nuk ka vlerë bazë disponibël				Nën 50 mg NO ₃ /l	Nën 50 mg NO ₃ /l	
	Objektivi specifik 4: Kontributi në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe në energjinë e rinovueshme							
	Treguesi i rezultatit 4.1: Pjesa e emetimeve të GS nga bujqësia do të pakësohet me 2,5% deri në vitin 2027 krahasuar me treguesin bazë 29.48% (2018)	29.49% (2018)				28%	27%	
	Masa /veprimi /ndërhyrja	Treguesi i <i>output</i> -it	Buxheti total 2022 – 2024 (Euro)	Buxheti i alokuar (Euro) 2022 – 2024 (N = nevoja, nuk mbulohet nga buxheti kombëtar/buxheti IPA III)			Objektivi më 2024-n	Objektivi më 2027-n
				2022	2023	2024		
	Futja në zbatim e kushteve të mira bujqësore dhe mjedisore	Numri i fermave të mbështetura me kushtëzime që lidhen me zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike (p.sh., ndalimi i djegies së bimësisë/mbetjet e bimësisë/barërat e këqija/kashta) do të rritet në 10,000 deri në vitin 2027.	Jo disponibël - pasi është vetëm një kusht i lidhur me pagesat për sipërfaqen.	-	-	-	7,000	10,000
	Mbështetje për mbarështimin e Racave lokale	Numri i fermave të ripërtypësve të vegjël të mbështetura në vit (IPARD III – Masa 4, orientuese - 50% e buxhetit të M4) do të arrijë në 2,100 në vitin 2024.	118,840	0	48,000	70,840	2,100	2,100
	Mbështetje për ullishte tradicionale të mirëmbajtura	Ha të mbështetur në vit në kuadër të IPARD III – Masa 4 (buxheti orientues- 25% e totalit të M4) do të arrijë në 500 ha në vitin 2024.	60,000	0	24,000	35,420	500	500
	Mbështetje për pyllëzimin/ripyllëzimin	Numri i ha të pyllëzuar me mbështetjen e ofruar në kuadër të IPARD III – Masa 11 do të arrijë në 297 ha në 2027.	2,400,000	0	1,200,000	1,200,000	60	297
	Investime për fermat dhe përpunuesit agrorë në prodhimin e energjisë së rinovueshme.	Numri i përfituesve të granteve, mbështetje në investime në prodhimin e energjisë së rinovueshme nga IPARD III do të arrijë në 40 në vitin 2027.	(është e përfshirë në buxhetin për M1 dhe M3)	-	-	-	16	40



Objektivi specifik 5: Nxitja e menaxhimit të qëndrueshëm dhe eficient të burimeve natyrore								
	Treguesi i rezultatit 5.1: Bilanci bruto i lëndëve ushqyese në tokat bujqësore të shfrytëzuara do të përmirësohet, si rrjedhojë e pakësimit të gërryerjes nga ujërat.		Nuk ka vlerë bazë disponibël				Nuk ka vlerë bazë disponibël	Nuk ka vlerë bazë disponibël
	Treguesi i rezultatit 5.2: Pjesa e tokës bujqësore të shfrytëzueshme nën rrezikun e fortë të erozionit nga uji do të zvogëlohet me 10% deri në vitin 2027 krahasuar me vlerën e treguesit bazë (70%).		70%				65%	60%
	Masa /veprimi /ndërhyrja	Treguesi i <i>output</i> -it	Buxheti total 2022 – 2024 (Euro)	Buxheti i alokuar (Euro) 2022 – 2024 (N = nevoja, nuk mbulohet nga buxheti kombëtar/buxheti IPA III)			Objektivi më 2024-n	Objektivi më 2027-n
				2022	2023	2024		
	Zbatimi i kushteve/standardeve të thjeshtuara Bujqësore dhe Mjedisore të Mira	Numri i fermave përfituese që plotësojnë kushtëzimet lidhur me erozionin e tokës dhe cilësinë e ujit do të rritet në 100 deri në vitin 2027.	Nuk ka vlerë të fondit, pasi është kusht për pagesat për sipërfaqen.	-	-	-		100
	Grandet për investime në asetet fizike të ekonomive bujqësore	Numri i fermave totale që investojnë në përmirësimin e stallave të kafshëve dhe menaxhimin e plehut (IPARD III, Masa 1) do të arrijë në 300 deri në vitin 2027.	(i përfshirë në buxhetin për M1 dhe M3)	-	-	-	125	300
	Mbështetje për bujqësinë organike	Numri i përfituesve të mbështetur në programin IPARD III – Masa 4, me buxhetit orientues - 25% e ndaj totalit, do të arrijë në 410 deri në vitin 2027.	NB	0	24,000	35,420	410	410
		Numri i ha nën mbështetje vjetore me Buxhetin kombëtar synohet në 410.	NB	NB	NB	0	410	410
	Mbështetja e skemave ekologjike pilot	Sipërfaqja në ha nën mbështetje të skemave-eko synohet të arrijë në 100 Ha në vitin 2027.	N:20,000	0	0	20,000		100



Objektivi specifik 6: Mbrojtja e biodiversitetit, rritja e shërbimeve të ekosistemit dhe ruajtja e habitateve dhe i peizazheve								
	Treguesi i rezultatit 6.1: SBSH sipas skemave agromjedisore për mbrojtjen e kullotave (në Ha) do të kapë shifrën e 500 ha deri në vitin 2024.		Vlera bazë e treguesit 0				500	500
	Veprimi/ndërhyrja	Treguesi i <i>output</i> -it	Buxheti total 2022–2024 (euro)	Buxheti i alokuar (euro) 2022–2024 (N = nevojë, nuk mbulohet nga buxheti kombëtar /buxheti IPA III)			Objektivi për vitin 2024	Objektivi për vitin 2027
				2022	2023	2024		
	Menaxhimi/shfrytëzimi ekstensiv i kullotave	Numri vjetor i fermerëve që plotësojnë angazhimet agromjedisore do të arrijë në 50 në vitin 2024.	N:150,000	0	N:75,000	N:75,000	50	50
		Sipërfaqja vjetore në ha e kullotave që plotësojnë angazhimet agromjedisore do të kapë shifrën 500 ha në vitin 2024.					500	500

OBJEKTIVI/TREGUESI			Vlera bazë e treguesit 2019	Objektivi për vitin 2024	Objektivi për vitin 2027
Objektivi i përgjithshëm 3: Forcimi i strukturës sociale-ekonomike të zonave rurale					
Treguesi i impaktit 3.1: Shkalla e punësimit rural do të rritet me 2% deri në vitin 2024 dhe me 5% deri në vitin 2027.			Nuk ka tregues bazë	+ 2%	+ 5%

Objektivi specifik 7: Rritja e punësimit rural dhe zhvillimi i biznesit								
Treguesi i rezultatit 7.1: Numri i sipërmarrjeve në zonat rurale në sektorin jobujqësor do të rritet me 500 deri në vitin 2027.			Nuk ka tregues bazë				200	500
Veprimi/ndërhryrja	Treguesi i <i>output</i> -it	Buxheti total 2022–2024 (EUR)	Buxheti i alokuar (EUR) 2022–2024 (N = nevoja, nuk mbulohet nga buxheti kombëtar /buxheti IPA III /Donatorët)			Objektivi për vitin 2024	Objektivi për vitin 2027	
			2022	2023	2024			
Grand për diversifikimin në turizmin rural dhe agroturizmin	Investime në turizmin rural dhe agroturizmin do të arrijë 100 në vitin 2024 dhe në 200 në vitin 2027 (orientues).	NB	NB	NB	NB	100	200	
	Numri i objekteve të mbështetura të turizmit rural nga IPARD III – Masa 7 do të rritet me 30 deri në vitin 2024 dhe me 60 deri në vitin 2027 (buxheti orientues – 20% e buxhetit total të masës).	2,234,941	562,667	647,638	1,024,636	30	60	
Grandet për bizneset rurale dhe bizneset fillestare (<i>start-up</i>) (përveç objekteve të turizmit rural)	Numri i bizneseve rurale dhe <i>start-up</i> -ve të mbështetur nga IPARD III – Masat 7 do të rritet në 30 deri në vitin 2024 dhe në 60 deri në vitin 2027 (buxheti orientuese – deri në 60% e buxhetit të masës 7).	6,704,823	1,688,001	1,942,914	3,073,908	30	60	



Grande dhe hua për infrastrukturën publike rurale	Numri i projekteve për infrastrukturën rurale të mbështetura nga IPARD III – Masa 6 do të arrijë në 12 deri në vitin 2024 dhe në 90 deri në vitin 2027.	2,666,667	0	0	2,666,667	12	90
---	---	-----------	---	---	-----------	----	----

Objektivi specifik 8: Fuqizimi i procesit të formimit të kapitalit social për iniciativat e zhvillimit lokal gjithëpërfshirës										
Treguesi i rezultatit 8.1: Përqindja e popullsisë rurale që përfiton nga iniciativat e reja të zhvillimit rural dhe investimet në infrastrukturën rurale (programi IPARD III) do të rritet në 60% deri n do të rritet në 60% vitin 2024 dhe n do të rritet në 60% 70% deri n do të rritet në 60% vitin 2027.				Nuk ka tregues bazë pasi është masë e re			60%		70%	
	Veprimi /ndërrhyrja	Treguesi i <i>output</i> -it	Buxheti total 2022–2024 (EUR)	Buxheti i alokuar (EUR) 2022–2024 (N = nevojitet, nuk mbulohet nga buxheti kombëtar/buxheti IPA III)			Objektivi për vitin 2024	Objektivi për vitin 2027		
				2022	2023	2024				
	Ngritja e Rrjetit Kombëtar Rural	Rrjeti Kombëtar Rural (IPARD III – masa 9 - TA), do të jetë i krijuar dhe funksional	1,000,000	250,000	250,000	500,000	1	1		
	Konsolidimi i rrjetit kombëtar rural	Numri i aktiviteteve të rrjetit rural kombëtar të mbështetura nga (IPARD III – masa 9 e AT) do të arrijë në 10 në vitin 2024 dhe në 20 në vitin 2027.	210,000	70,000	70,000	70,000	10	20		
	Grandet për iniciativat e zhvillimit lokal rural	Numri i GVV-ve të mbështetura për t'u formuar, konsoliduar dhe të filluar aktivitetin në kuadër të IPARD III – Masa 5 do të arrijë në 10 deri në vitin 2024.	0	720,000	720,000	720,000	10	10		

OBJEKTIVI/TREGUESI		Vlera e treguesit bazë 2020		Objektivi për vitin 2024	Objektivi për vitin 2027
	Objektivi i përgjithshëm 4: Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm detar dhe të ujërave të brendshme				
	Treguesi i ndikimit 4.1: Rritja e eksportit të produkteve të përpunuara të peshkimit do të jetë me 10% deri në vitin 2024 dhe me 20% deri në vitin 2027.	16,340 Ton		+10%	+20%



Objektivi specifik 09: Forcimi i akuakulturës, tregjeve konkurruese dhe të qëndrueshme, si dhe një komunitet i begatë bregdetar								
Treguesi i rezultatit 9.1: Niveli i përdorimit të kapacitetit ekzistues të përpunimit të peshkut do të arrijë në 90% në vitin 2024 dhe 100% në vitin 2027.			39%				90%	100%
Veprimi /ndërhyrja	Treguesi i <i>output</i> -it	Buxheti total 2022–2024 (EUR)	Buxheti i alokuar (EUR) 2022–2024 (N = nevojitet, nuk mbulohet nga buxheti kombëtar/buxheti IPA III)			Objektivi 2024	Objektivi 2027	
			2022	2023	2024			
Grandet për rinovimin e flotës së peshkimit, pa rritur sforcot e peshkimit	Numri i anijeve të rinovuara të peshkimit do të arrijë shifrën 45 në vitin 2024 dhe 100 deri në vitin 2027.	450,000	250,000	200,000	0	45	100	
Investime për përmirësimin e kapacitetit për ankorim të anijeve të peshkimit	Numri i porteve të peshkimit me infrastrukturë të përmirësuar do të arrijë në 4 deri në vitin 2027.	Buxheti duke filluar nga viti 2025	0	0	0	0	4	
Vazhdimi i programit të tregjeve me shumicë të peshkut për rritur formalizimin e sektorit.	Numri i tregjeve të ndërtuara me shumicë të peshkut do të arrijë në 3 deri në vitin 2024.	NB	NB	NB	NB	3	3	
Programi mbështetës për peshkimin në shkallë të vogël dhe formalizimi i sektorit	Numri i varkave të peshkimit që hyjnë në skemën e karburantit do të arrijë në 700 deri në vitin 2027.	Buxheti duke filluar nga viti 2025	0	0	0	0	700	
	Numri i vendeve të ndërtuara të zbarkimit për peshkim në shkallë të vogël do të arrijë në 3 deri në vitin 2027.	Buxheti duke filluar nga viti 2025	0	0	0	0	3	
Rritja e kuotave të eksportit për speciet që aktualisht janë të kufizuara për import në BE	Numri i kuotave të negociuara.	0	0	0	0	5	5	
Llojet e reja që i nënshtrohen përpunimit (p.sh., molusqet).	Numri i specieve të reja që janë objekt për përpunim do të shtohet me 10 specie deri në vitin 2024.	0	0	0	0	10	10	

Objektivi specifik 10: Nxjtja e peshkimit të qëndrueshëm dhe ruajtja e burimeve biologjike detare									
	Treguesi i rezultatit 10.1: Monitorimi për mirëmenaxhimin e rezervës peshkore të faunës së peshkut detar me interes tregtar në krahasim me nivelet ekzistuese do të arrijë në masën 100% deri në vitin 2024.			N/A				100%	100%
	Veprimi /ndërhyrja	Treguesi i <i>output</i> -it	Buxheti total 2022–2024 (EUR)	Allocated budget (EUR) 2022–2024 (N = nevojitet, not covered by the Buxheti Kombëtar/IPA III budget/Donatorët)			Objektivi për vitin 2024	Objektivi për vitin 2027	
				2022	2023	2024			
	Prodhimi i ushqimit për akuakulturën dhe	Deri në vitin 2024 do të mbështetet	Planifikohet				1	2	



trajtimet e “nënprodukteve”	ngritja e 1 fabrike dhe deri në vitin 2027 do të janë ngritur dhe në funksion 2 fabrika të tilla.	mbështetje si pjesë e IPARD-së M3 ose M7					
Zhvillimi i akuakulturës së qëndrueshme, në përputhshmëri me mjedisin	Numri i zonave të përcaktuara për akuakulturën (ZPA) në ujërat e brendshme do të arrijë në 3 deri në vitin 2024.					3	3
Grande për zhvillimin e ekonomisë blu dhe zhvillimin e turizmit detar	Numri i aktorëve të sektorit privat të mbështetur do të arrijë në 10 deri në vitin 2024 dhe në 15 deri në vitin 2027.	N: 2,000,000 (jashtë buxhetit të BE-së për MBZHR, i menaxhuar nga ministri të tjera)	0	1,000,000	1,000,000	10	15
AT për zhvillimin e “ekonomisë blu” dhe zhvillimin e turizmit detar	Numri i projekteve të AT-së për zhvillimin e “ekonomisë blu” të zbatuar do të jetë 2 deri në vitin 2024 dhe 4 deri në vitin 2027.	N:500,000 (jashtë buxhetit të BE-së për MBZHR, i menaxhuar nga ministri të tjera)	N/A	250,000	250,000	2	4

OBJEKTIVI HORIZONTAL 1 /TREGUESI		Vlera e treguesit bazë në vitin 2020				Objektivi për vitin 2024	Objektivi për vitin 2027
<i>Nuk ka tregues rezultati, pasi objektivi horizontal është nënkuptuar që përfshihet në treguesit në nivelin e të gjithë treguesve të tjerë të mësipërm</i>							
Objektivi 1: Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative drejt përafrimit me <i>acquis</i> të BE-së							
Treguesi i impaktit 1.1: Niveli i transpozimit dhe zbatimit të legjislacionit të BE-së nga MBZHR-ja do të jetë në masën 35% deri në vitin 2024 dhe në masën 100% deri në vitin 2027.		Transpozim i pjesshëm				35%	100%
Veprimi/ndërhyrja		BK, IPA III, IPARD III dhe donatorët e tjerë	Buxheti i alokuar (euro) 2022–2024 (N = nevoja, nuk mbulohet nga buxheti kombëtar/IPA III, donatorët)			Objektivi për vitin 2024	Objektivi për vitin 2027
			2022	2023	2024		
Projekti AT për konsolidimin e njësisë së asistencës teknike për IPARD III	Niveli i njësisë së asistencës teknike do të jetë plotësisht funksional për të zbatuar rregullat e PRAG deri në vitin 2024.	(TAIEX ose projekte të tjera të vogla AT)	-	-	-	100%	100%
Projektet e AT për përafrimin e legjislacionit të BE-së në kapitullin 11	FADN do të jetë gati/e plotësuar në 80% deri në vitin 2024 dhe 100 deri në vitin 2027.		0	500,000	500,000	80%	100%
	Regjistri i fermës do të jetë gati/i		500,000	0	0	100%	100%



		plotësuar në masën 100% deri në vitin 2024.						
		Sistemi i identifikimit të parcelave të tokës (LPIS) do të jetë gati në masën 50% deri në vitin 2024 dhe në masën 100% deri në vitin 2027.		0	750,000	750,000	50%	100%
		Numri i masave të reja IPARD III të akredituara për zbatim do të arrijë në 5 deri në vitin 2024 dhe në 9 deri në vitin 2027.		-	-	-	5	9
		Legjislacioni i përditësuar për bujqësinë organike dhe një njësi përgjegjëse në MBZHR për këtë sektor do të jetë efektive në nivelin 100% në vitin 2024.		25,000	25,000	25,000	100%	100%
		Numri i departamenteve të MBZHR-së dhe agjencive të varësisë të trajnuara për negociatat me BE-në do të arrijë në 5 deri në vitin 2024.		N:50,000	N:75,000	N:75,000	5	5
		Numri i stafit të trajnuar të MBZHR-së për përcaktimin e kompetencave të institucioneve dhe specialistëve të përfshirë në skemën PMO/TMGJ, si dhe për procedurat e kontrollit dhe verifikimit të produkteve PMO/TMGJ do të arrijë në 10 deri në vitin 2024 dhe në 20 deri në vitin 2027.	0	-	-	-	10	20
		Deri në vitin 2024 do të realizohet një fushatë për promovimin e produkteve tradicionale dhe produkteve EOM/TMGJ.		0	N:250,000	N:250,000	1	1
	Projektet AT për përafrimin e legjislacionit të BE-së në kapitullin 12	Niveli i përditësimit dhe përmirësimit të bazës së të dhënave të Regjistrit të Kafshëve dhe sigurimi i një lidhjeje të mirë me bazat e tjera të të dhënave si dhe përditësimi i bazës ligjore përkatëse do të arrijë nivelin 80% deri në vitin 2024 dhe në nivelin 100% deri në vitin 2027.			N:100,000	N:100,000	80%	100%
		Niveli i përgatitjes së planeve të	(TAIEX ose	-	-	-	100%	100%



	veprimet për mbushjen e boshllëqeve institucionale në lidhje me ushqimin për blegtorinë, për gjurmueshmërinë e nënprodukteve shtazore (mish dhe produkte të qumështit) do të përmirësohet në masën 100% deri në vitin 2024.	projekte të tjera të vogla AT)					
	Konsolidimi plotë i programeve të kontrollit të sëmundjeve të kafshëve (plani i monitorimit në lidhje me sëmundjet e kafshëve dhe për vlerësimin e nënprodukteve/rrezikut për fermat dhe për operatorët e biznesit) do të arrihet në masën 100% deri në vitin 2024.	(TAIEX ose projekte të tjera të vogla AT)	-	-	-	100%	100%
	Niveli i përmirësimit të procedurave të kontrollit dhe logjistikës së nevojshme për kontrollet (përfshirë laboratorët e specializuar) dhe bazat e të dhënave përkatëse do të arrijë masën 100% deri në vitin 2024.	(TAIEX ose projekte të tjera të vogla AT)	-	-	-	100%	100%
	Numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërkufitar për parandalimin e sëmundjeve endemike rajonale dhe për sëmundjet e reja/shpërthimet e reja do të jetë 2 deri në vitin 2024 dhe 3 deri në vitin 2027.		0	0	N:50,000	2	3
	Numri i personave të trajnuar për kontrollet mbi ruajtjen dhe përdorimin e pesticideve në nivel ferme dhe për zbulimin e mbetjeve të pesticideve në bimë do të arrijë në 30 deri në vitin 2024 dhe në 50 deri në vitin 2027.		0	0	N:50,000	30	50
	Niveli i procedurave të unifikuara të regjistrimit për inputet bujqësore do të arrijë masën 100% deri në vitin 2024.	(TAIEX ose projekte të tjera të vogla AT)	-	-	-	100%	100%
	Numri i stafit të trajnuar për monitorimin e standardeve të sigurisë ushqimore për fabrikat e		0	0	N:50,000	30	50



		agropërpunimit do të rritet në 30 deri në vitin 2024 dhe në 50 deri në vitin 2027.						
		Numri i stafit të trajnuar për metodën e akreditimit të laboratorëve rajonalë do të arrijë në 10 deri në vitin 2024.	(TAIEX ose projekte të tjera të vogla AT)	-	-	-	10	10
		Niveli i përgatitjes të një Plani të Veprimit për përmirësimin e cilësisë së qumështit do të jetë në masën 100% deri në vitin 2024	(TAIEX ose projekte të tjera të vogla AT)	-	-	-	100%	100%
		Niveli i zbatimit të planit të veprimit për përmirësimin e cilësisë së qumështit do të arrijë masën 100% deri në vitin 2027	(TAIEX ose projekte të tjera të vogla AT)	-	-	-	0	100%
		Numri i departamenteve dhe agjencive të MBZHR-së të trajnuar për negociatat me BE-në do arrijë në 3 deri në vitin 2024.		N:50,000	N:50,000	N:50,000	3	3
	Projektet AT për përafrimin e legjislacionit të BE-së në kapitullin 13	Numri i stafit të trajnuar të MBZHR-së për negociatat me BE-në do arrijë në 5 deri në vitin 2024.	(TAIEX ose projekte të tjera të vogla AT)	-	-	-	5	5
	AT për të dhënat statistikore për treguesit mjedisorë bazë të kontekstit	Niveli i gatishmërisë institucionale për monitorimin e treguesve mjedisorë, që lidhen me PPB do të arrijë në 30% deri në vitin 2024 dhe në 50% deri në vitin 2027		0	N:200,000	N:200,000	30%	70%
	AT për krijimin e një njësie të analizës ekonomike në MBZHR	Deri në vitin 2024 do të ngrihet dhe do të jetë plotësisht funksionale një njësi e analizave ekonomike.			N:25,000	N:25,000	1	1
	AT për futjen/zbatimin e kushteve të mira bujqësore dhe mjedisore (KMBM) të thjeshtuara	Niveli i gatishmërisë institucionale për të zbatuar KMBM do të arrijë në 50% deri në vitin 2024 dhe në 100% deri në vitin 2027.	(TAIEX ose projekte të tjera të vogla AT)	-	-	-	50%	100%
	AT për hartimin e Kodit të Praktikave të Mira Bujqësore për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes me nitrato të shkaktuar nga bujqësia dhe për hartimin e Kodit të Praktikave të Mira Bujqësore për Reduktimin e Emetimeve të Amoniakut.	Niveli i gatishmërisë institucionale për të futur në zbatim Kodin e Praktikave të Mira Bujqësore për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes me nitrato të shkaktuar nga bujqësia dhe për hartimin e Kodit të Praktikave të Mira Bujqësore për Reduktimin e Emetimeve të		0	-	N:50,000	50%	100%



		Amoniakut do të arrijë në 50% deri në vitin 2024 dhe në 100% deri në vitin 2027.						
	AT për konsolidimin e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e sistemeve të ujitjes dhe kullimit	Numri i stafit të MBZHR-së, bashkive dhe shoqatave të përdoruesve të ujit të trajnuar për transferimin e të drejtave të përdorimit të shoqatat e përdoruesve të ujit për kanalet dytësore dhe terciare si dhe për rehabilitimin dhe menaxhimin e sistemeve të ujitjes dhe kullimit do të arrijë në 50 deri në vitin 2024 dhe në 100 deri në vitin 2027.		0	-	N:50,000	50	100
	AT për marketing të drejtpërdrejtë dhe strukturimin e zinxhirëve të shkurtër të furnizimit	Niveli i përshtatjes dhe i vënies në zbatim të udhëzimit nr. 5, datë 4.5.2018 të MBZHR-së, që mbështet regjistrimin e prodhuesve të vegjël ushqimorë, produkte ushqimore tradicionale do të arrijë në 100% deri në vitin 2024.	(TAIEX ose projekte të tjera të vogla AT)	-	-	-	100%	100%
		Niveli i përfshirjes në legjislacionin kombëtar të përkufizimeve të mëposhtme fermer /fermer i vogël /fermer gjysmë komercial /komercial (ose fermer i madh), shitës direkt dhe zinxhir i shkurtër furnizimi do të bëhet në masën 100% deri në vitin 2024.	(TAIEX ose projekte të tjera të vogla AT)	-	-	-	100%	100%
		Niveli i gatishmërisë teknike dhe institucionale për të përgatitur, publikuar dhe promovuar udhëzime të reja për Praktikën e Mirë të Higjienës Ushqimore dhe kryerjen e vetëkontrollit nga fermerët dhe përpunuesit artizanale të ushqimit të regjistruar në MBZHR, udhëzues dhe material trajnimi për rritjen e njohurive dhe aftësive të prodhuesve të vegjël të ushqimit do të arrijë në 100% deri në vitin 2024.		N:30,000-	-	-	100%	100%
		Numri i stafit të trajnuar të AKU-së	(TAIEX ose	-	-	-	10	20



		për forcimin e besueshmërisë së sistemeve të gjurmueshmërisë së ushqimit do të arrijë në 10 deri në vitin 2024 dhe në 20 deri në vitin 2027.	projekte të tjera të vogla AT)					
		Numri i skemave të reja vullnetare të cilësisë së ushqimit të prezantuara (p.sh., “marketing i drejtpërdrejtë në bujqësi”, “blerje në fermë”, “produkte ushqimore tradicionale të prodhuara në mënyrë artizanale” - gjithashtu si skema pilot) për prodhuesit e vegjël të ushqimit do të arrijë në 4 deri në vitin 2027.	(TAIEX ose projekte të tjera të vogla AT)	-	-	-	0	4

	OBJEKTIVI HORIZONTAL 2/TREGUESI <i>Nuk ka tregues rezultati, pasi objektivi horizontal është nënkuptuar që përfshihet në treguesit në nivelin e të gjithë treguesve të tjerë të mësipërm</i>		Vlera treguesit bazë 2019				Objektivi për vitin 2024	Objektivi për vitin 2027
Objektivi horizontal 2: Transferimi i njohurive dhe inovacionit në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimin rural								
	Treguesi i impaktit 2.1: Sistemi i njohurive dhe i inovacionit në bujqësi (SNJIB-AKIS) deri në vitin 2024 është ngritur dhe funksionon në formë pilot dhe është plotësisht funksional deri në vitin 2027		Aktualisht nuk ka një vlerë bazë				(Pilot)	100% (Plotësisht në funksion)
	Masa /Veprimi /Ndërhyrja	Treguesi i <i>output</i> -it	BK, IPA III, IPARD III dhe donatorë të tjerë	Buxheti i alokuar (euro) 2022–2024 (N = nevoja, nuk mbulohet nga buxheti kombëtar/buxheti IPA III)			Objektivi për vitin 2024	Objektivi për vitin 2027
				2022	2023	2024		
	Hartimi i konceptit strategjik mbi ngritjen e sistemi SNJIB për Shqipërinë është miratuar nga QSH-ja	Koncepti strategjik mbi ngritjen e sistemi SNJIB (AKIS) për Shqipërinë është miratuar nga QSH deri në vitin 2025.	NB		Donatorët TAIEX BK	Donatorët TAIEX BK		1
	Hartimi i konceptit strategjik mbi integrimin dhe rolin e AREB-ve dhe të QTTB-ve në sistemin SNJIB në përputhje me PPB pas 2021	Koncepti strategjik mbi përfshirjen, rolin dhe funksionin e SHKF-së dhe QTTB-ve në sistemin SNJIB (AKIS) është miratuar nga MBZHR-ja deri në vitin 2027.				Donatorët TAIEX BK ndoshta IPARD III		1
	Mbështetje për ngritjen e strukturave operacionale në kontekstin e SNJIB-së, si p.sh. grupet operacionale, rrjetet tematike në nivel kombëtar të bazuar në iniciativën e organizatave	Deri në vitin 2027 janë ngritur deri në 5 struktura,sipas SINJB (AKIS).			Donatorët TAIEX BK ndoshta IPARD III	Donatorët TAIEX BK ndoshta IPARD III		5



	të fermerëve, por edhe të AREB-ve, QTTB-ve, AUT etj.							
	Kontrata shërbimi dhe mbështetje direkte financiare për ofrimin e këshillimit për fermat	Numri i fermerëve të këshilluar/trajnuar në vit (IPARD III – Masa 10 buxhet) do të arrijë 25,200 deri në vitin 2027.		200,000	300,000	400,000	12,600	25,200
	Mbështetje për ferma demonstrimi	Numri i fermave të demonstrimit të ngritura deri në vitin 2024 arrin në 50, ndërsa deri në vitin 2027 në 150 ferma.		0	N:100,000	N:100,000	50	150
	AT për marketing të drejtpërdrejtë dhe zinxhirë të shkurtër të furnizimit	Numri i fermerëve dhe prodhuesve të vegjël të ushqimit të trajnuar në marketing dhe komunikim mbi zinxhirët e shkurtër të furnizimit me ushqim (skemat në fermë dhe jashtë fermës), shitje drejt bujtinave do të arrijë në 100 deri në vitin 2024 dhe në 500 deri në vitin 2027.		0	N:250,000	N:250,000	100	500
	AT për promovimin e bujqësisë organike	Deri në vitin 2024 do të realizohet një fushatë promovimi për bujqësinë organike		0	N:250,000	N:250,000	1	1
	AT për promovimin e agroturizmit/turizmit rural	Niveli i zbatimit të një standardit të rishikuar të cilësisë për akomodimin për agroturizmin/turizmin rural do të jetë në masën 100% deri në vitin 2024	(TAIEX ose projekte të tjera të vogla AT)	-	-	-	100%	100%
		Deri në vitin 2024 do të arrijë në 500 dhe deri në vitin 2027 në 1,000 numri i fermerëve, popullatës rurale dhe zyrtarëve të trajnuar për standardet e udhëtimit cilësor dhe të sigurt		0	N:100,000	N:100,000	500	1,000
	Mbështetje fillestare (start-up) për të rinjtë e diplomuar në sektorin e bujqësisë	Deri në vitin 2024 do të arrijë në 50 dhe deri në vitin 2027 në 300 numri i të rinjve të diplomuar të trajnuar për marrjen e graveve për bujqësinë		N:5,000	N:5,000	N:5,000	50	300
	AT mbi mundësitë e bioekonomisë	Deri në vitin 2024 do të arrijë në 10 numri i zyrtarëve të trajnuar për ngritjen e një platforme të njohurive shkencore, inovacionit dhe ndryshimit të teknologjive mbi	E pazbatueshme - (TAIEX ose projekte të tjera të vogla AT)	-	-	-	10	10



		proceset e bazuara në ekonominë biobujqësore dhe pyjore						
	AT dhe kërkim shkencor mbi bioekonominë dhe ekonominë rrethore të bazuar në bio (biomasa nga bujqësi dhe pyjet, biokarburantet)	Plani i veprimit për promovimin e bioekonomisë, i përgatitur në masën 100% deri në vitin 2024		0	0	N:50,000	100%	100%
	Krijimi i një Qendre Kombëtare Kërkimore për Shkencat e Peshkimit në Shqipëri	Deri në vitin 2027 do të ngrihet dhe jetë në funksion të plotë Qendra Kombëtare e Shkencave të Peshkimit.	Nevojitet një studim fizibiliteti				70%	100%
	Përgatitja e një plani veprimi për zbatimin e parashikimeve të Agjendës së Gjellbër të Ballkanit Perëndimor	Deri në vitin 2024 do të përgatitet në masën 100%, Plani i Veprimit për zbatimin e parashikimeve të Agjendës së Gjellbër të Ballkanit Perëndimor			N:200,000		100%	100%
	AT mbi iniciativat lokale	Deri në vitin 2024 janë trajnuar 10 persona që bëjnë pjesë në stafin e trajnuar të GVV-ve dhe anëtarë të rrjetit rural në çështjet financiare-administrative, menaxhuese dhe komunikuese		N:50,000	N:50,000	N:50,000	10	10
		Numri i stafit të Rrjetit Rural dhe MBZHR të trajnuar në lidhje rrjetet rurale do të arrijë në 50 deri në vitin 2024	(TAIEX ose projekte të tjera të vogla AT)	-	-	-	50	50



6.2 Plani i Veprimit i MBZHR-së 2022–2024 për përgatitjen dhe zbatimin e ndërhyrjeve

Plani i Veprimit paraqet një vështrim të përgjithshëm për tri vitet e para të zbatimit 2022–2024 të SBZHRP-së, mbi veprimet që do të ndërmerren nën drejtimin e institucionit përgjegjës për përgatitjen dhe zbatimin e mekanizmit të ndërhyrjes të përshkruar në kapitullin 4.

Tabela 6-2: Plani i Veprimit i MBZHR-së për periudhën 2022–2024

Institucioni lider	Mekanizmat e ndërhyrjes	Veprimet	2022	2023	2024
MBZHR	Mbështetje për të ardhurat për një periudhë kalimtare për sektorët e orientuar nga tregu (perime, fruta dhe ullinj)	Përcaktimi i sasisë së mbështetjes për ha dhe/ose ton; përgatitja dhe miratimi i kriterëve të përfitimit		x	x
		Planifikimi i buxhetit kombëtar /buxhetit afatmesëm për 2025–2027			x
AZHBR		Përgatitja e modelit të kërkesës për pagesë të vetme dhe të procedurave të zbatimit (të gjitha tipat e pagesave të shtyllës I duhet të jenë pjesë e një skeme pagese të vetme, e nisur në fillim të çdo viti)	x	x	x
		Zgjerimi i sistemit TI të AZHBR-së		x	x
AZHBR	Mbështetje për të ardhurat e fermës për SBSH /ferma	Zbatimi vjetor si zakonisht edhe për masat e tjera të nisura - Konsolidimi i sistemit të TI nëpërmjet: - Zhvillimit të Regjistrat të Fermës; - Zhvillimit të SIPT (LPIS); - Përgatitjes së procedurave të kontrollit për KMBM; - Rishikimit të përlogaritjes /kompensimit të pagesave për bujqësinë organike duke përfshirë kostot vjetore të inspektimit dhe certifikimit; - Përgatitja e udhëzuesve ose e procedurave për përditësimin e bazës së të dhënave të çmimeve të referencës; - Kalimi drejt pagesave plotësisht të ndara (<i>decoupled</i>) (për ha); - Konsolidimi i procedurave dhe i sistemit TI për aplikimet <i>online</i>.	x	x	x
AZHBR	Mbështetje për ardhurat e fermës për fermat e kafshëve	Konsolidimi i sistemit të TI-së nëpërmjet : - Zhvillimit të Regjistrat të Fermave, - Lidhjes së sistemit TI të AZHBR-së me sistemin RUDA dhe zhvillimi i kontrolleve administrative për numrin e kafshëve; - Pagesa për krerë të kafshëve.	x	x	x
MBZHR Drejtoria e Politikave	Skema e Sigurimeve Bujqësore	Diskutimi me organizatat e fermerëve dhe kompanitë e sigurimeve për skemën më të përshtatshme		x	
		Përcaktimi i sasisë së mbështetjes për ha dhe/ose ton; përgatitja dhe miratimi i kriterëve të përfitimit		x	x
		Planifikimi i buxhetit kombëtar/buxhetit afatmesëm për 2025–2027			x
AZHBR		Përgatitja e modelit të kërkesës për pagesën dhe procedurat e zbatimit		x	x
		Përgatitja e sistemit TI të AZHBR-së		x	x
Drejtoritë e politikave MBZHR	Kompensimi për naftën në bujqësi	Monitorim i skemës dhe vazhdimi /përmirësimi i saj	x	x	x
AM IPARD MBZHR	Masat IPARD III: M1, M3, M7, M9	- Rishikimi nëse është e nevojshme i udhëzuesit për aplikantët dhe procedurat e vlerësimit	x	x	x



		- Përgatitja e ToR dhe procedurës së prokurimit sipas M9 - Përgatitja e raporteve për Komitetin e Monitorimit IPARD III; - Komisionin Evropian, NIPAC dhe NAO mbi progresin në përdorimit të fondeve, <i>output</i>-et dhe rezultatet.			
AM IPARD MBZHR + AZHBR	Masat IPARD III: M4, M5, M6, M10, M11	Përgatitja për akreditim dhe marrja e besueshmërisë (<i>entrustment</i>)	x	x	x
AM IPARD MBZHR + AZHBR	Zbatimi i qasjes LEADER	- Miratimi i ligjit për GVV-të - Përgatitja e SZHL-ve dhe përzgjedhja e GVV-ve - Përzgjedhja e GVV-ve (përfshirë GVV-të e reja) duhet të fillojë sa më shpejt për të mundësuar financimin paraprak. - Përgatitja e SZHL-ve duhet të bëhen sipas një modeli të miratuar. Për të gjitha SZHL-të e paraqitura sipas modelit, pagesat duhet të konsiderohen të shpenzuara siç duhet dhe të mos rimerren përsëri. - Kostot e funksionimit (kostot operacionale) për funksionimin e GVV-ve dhe SZHL-në e përgatitur duhet të sigurohen sa më shpejt që të jetë e mundur. - Duhet të zbatohet një sistem për të rimbursuar në kohë kostot e aktiviteteve të funksionimit të GVV-ve.	x	x	
AM IPARD MBZHR	Reflektim/analiza dhe konsultime për përgatitjen për masa të reja (alternative) të IPARD-së: - Ngritja e SNJIB/AKIS - Grupet e prodhuesve të ullinjve, frutave dhe perimeve (M2) - Menaxhimi i gjerë i kullotave (nën M4) - Instrumentet financiare (M12)	- Konsolidimi i ligjit për organizatat e prodhuesve; - Adresimi i tregut informal të frutave dhe të perimeve; - Praktikant tradicionale të menaxhimit të kullotave të promovuara sipas një skeme agromjedisore; - Promovimi një skeme kreditimi (me normë interesi të subvencionuar); - Analizat studimore përkatëse dhe mbledhja e evidencave (të dhënave) si bazë për hartimin e masave të reja dhe ngritjes së kapaciteteve për zbatimin e tyre.	X	x	x
MBZHR Drejtoria e Politikave	Grand për fermerët e rinj	Përgatitja e një mase të re për fermerët e rinj me buxhetin kombëtar. Përcaktimi i fondit të mbështetjes dhe miratimi i kriterëve të përfitimit	x	x	
AZHBR		Planifikimi i buxhetit kombëtar /buxhetit afatmesëm 2025–2027 për këtë masë mbështetëse			x
		Përgatitja e udhëzuesit për aplikantët dhe procedurat e zbatimit			x
		Përgatitja e sistemit TI të AZHBR-së			x
MBZHR Drejtoria e Politikave	Skema e cilësisë së qumështit dhe skemat eko	Diskutim me organizatat e fermerëve për skemën më të përshtatshme	x	x	
AZHBR		Përcaktimi i sasisë së mbështetjes për ha dhe/ose ton; përgatitja dhe miratimi i kriterëve të përfitimit		x	x
		Planifikimi i buxhetit kombëtar /buxhetit afatmesëm 2025–2027			x
		Përgatitja e modelit të kërkesës për pagesë dhe procedurat e zbatimit	x	x	x
		Përgatitja e sistemit TI të AZHBR-së		x	x
MBZHR Drejtoria e Politikave	AT për të dhënat statistikore për treguesit bazë të sektorit AT për të dhënat statistikore për treguesit bazë mjedisor	Përgatitja e termave të referencës dhe buxhetit	x	x	
AM IPARD		Hapja e tenderit në kuadër të masës AT në masën 9 të IPARD-së		x	x
		Menaxhimi i zbatimit të projektit			x



MBZHR	Grande për rehabilitimin e sistemeve të ujitjes dhe kullimit	Përditësimi i planit të veprimit për investimet në bujqësi bazuar në buxhetin në dispozicion dhe monitorimi i investimeve të MBZHR-së	x	x	x
Drejtorja e Politikave MBZHR, Drejtorja për Bashkëpunim Ndërkombëtar në bashkëpunim të ngushtë me Drejtoritë e tjera Teknike përkatëse	Mbështetje me AT: - AT për ngritjen e një njësie të analizës ekonomike - AT për zbatimin e KMBM-ve; - AT për hartimin e Kodit të Praktikave të Mira Bujqësore për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes me nitrato të shkaktuar nga bujqësia dhe për Reduktimin e Emetimeve të Amoniakut; - AT për grande për sistemet kolektive të menaxhimit të plehut organik - projekt pilot - Përgatitja e Planit të Veprimit për zbatimin e parashikimeve të Agjendës së Gjellbër të Vendeve të Ballkanit Perëndimor (AGJVBP); - AT për konsolidimin e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e sistemeve të ujitjes dhe kullimit - AT për skemat e cilësisë; - AT për Skemat Ekologjike – projekt pilot; - AT për menaxhimin ekstensiv të kullotave – projekt pilot; - Kontratat e shërbimeve për ofrimin e këshillave për fermerët dhe zhvillimin rural dhe fermat demonstruese; - AT për Global GAP dhe HACCP; - AT mbi iniciativat lokale; - AT për promovimin e agroturizmit/turizmit rural - AT për marketing të drejtpërdrejtë dhe zinxhirë të shkurtër të furnizimit; - Grandet për <i>start-up</i>-et për të rinjtë e diplomuar në sektorin e bujqësisë; - Studim parafizibiliteti i rrjetit rrugor pyjor; - AT mbi mundësitë e bioekonomisë; - AT dhe kërkime mbi bioekonominë dhe ekonominë rrethore të bazuar në bio (biomasë nga bujqësia dhe pyjet, biokarburantet).	Diskutim me donatorët e mundshëm për mbështetje financiare/projekte në koherencë me nevojat e ndërhyrjeve dhe mekanizmin e zbatimit të tyre. Emërimi i stafit të çdo drejtorie përgjegjëse për nevojat për AT Përgatitja e ToR për mbështetjen e planifikuar të AT	x	x	x
Drejtorja e Politikave MBZHR, AZHBR, AM IPARD	- Projektet AT për përafrimin e legjislacionit të BE-së me kapitullin 11; - Krijimi i FADN dhe një njësie në MBZHR për analiza ekonomike; - Zbatimi ndërpërputhshmërisë (<i>cross compliance</i>) (KMBM si hap i parë); - Përfshirja e SHKF (me fokus në KMBM) në SHKKB,	Identifikimi i mbështetjes më të përshtatshme me AT (TAIEX, IPA III, Donatorët) dhe përgatitja e kërkesave. MBZHR dhe AZHBR duhet të planifikojnë burime të mjaftueshme njerëzore shtesë për ndërhyrjet e reja.	x	x	x



	dhe forcimi i mëtejshëm i njësisë përkatëse për zbatimin e SNJIB/AKIS; - Konsolidimi i Regjistrit të Fermës (përfshirë lidhjen e tij TI me bazat e tjera të të dhënave); - Zhvillimi i mëtejshëm i SIAK (IACS), përfshirë zhvillimin e SIPT-së/LPIS-së; - Sistemet e TI-së duhet të forcohen drejt një SIAK (IACS) të plotë, lidhjet me bazat e tjera të të dhënave kombëtare për të lejuar kontrolle të kryqëzuara; - Përditësimi i legjislacionit për bujqësinë organike, verërat dhe OP dhe rritja e kapaciteteve (stafeve) të MBZHR-së; - AT duhet të konsolidojë njësinë e asistencës teknike për IPARD III; - Të fillohet me përdorimin e kostove standarde/konfigurimin dhe të përdoret një bazë të dhënash çmimesh referencë.				
MBZHR dhe agjencitë e varësisë	- Projekte AT për përafrimin e legjislacionit të BE-së me kapitullin 12 - Përditësimi dhe përmirësimi i mëtejshëm i bazës së të dhënave të Regjistrit të Kafshëve, sigurimi i një lidhjeje të mirë me bazat e tjera të të dhënave dhe përditësimi i bazës ligjore përkatëse; - Përgatitja e planeve të veprimit për boshllëqet institucionale, në lidhje me ushqimin e kafshëve, gjurmueshmërinë e nënprodukteve shtazore (mishi dhe produktet e qumështit), konsolidimin e mëtejshëm të programeve të kontrollit të sëmundjeve të kafshëve (plani i monitorimit për sëmundjet e kafshëve dhe për nënproduktet/vlerësimi i riskut për fermat dhe për operatorët e biznesit) etj.; - Përmirësimi i të gjitha procedurave të kontrollit, logjistikës së nevojshme për kontrollet (përfshirë laboratorët e specializuar) dhe bazat e të dhënave përkatëse; - Bashkëpunimi ndërkufitar për parandalimin e sëmundjeve endemike rajonale dhe për sëmundjet e reja/shpërthimet e reja; - Përdorimi i pesticideve në nivel ferme dhe monitorimi i mbetjeve të pesticideve në produktet bimore; - Unifikimi i procedurave të ndryshme të regjistrimit të	Identifikimi i mbështetjes më të përshtatshme me AT (TAIEX, IPA III, Donatorët) dhe përgatitja e kërkesave. MBZHR dhe agjencitë e varësisë duhet të planifikojnë burime të mjaftueshme njerëzore shtesë për ndërhyrjet e reja.	x	x	x



	inputeve bujqësore; - Monitorimi i standardeve të sigurisë ushqimore për fabrikat e agropërpunimit; - Fuqizimi i laboratorëve në fushën e sigurisë ushqimore, shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjes së bimëve; - Hartimi i një plani veprimi për përmirësimin e cilësisë së qumështit; - Këshillim për negociatat me BE-në.				
MBZHR DP e Peshkimit dhe Akuakulturës	Grandet për rinovimin e flotës së peshkimit, pa rritur sforcot e peshkimit	Sigurimi i një procesi zbatimi operacional dhe transparent të buxhetit të alokuar	x	x	x
	Investime për përmirësimin e kapacitetit ankorues të anijeve të peshkimit	Sigurimi i një procesi zbatimi operacional dhe transparent të buxhetit të alokuar Diskutim me donatorët potencialë për mbështetje financiare.			
	Vazhdimi i programit të tregtimit të peshkut me shumicë duke rritur formalizimin e sektorit.		x	x	x
	Programi mbështetës për FF, formalizimi i sektorit dhe ndërtimi i vendeve të zbarkimit për peshkimin në shkallë të vogël				
	Rritja e kuotave të eksportit për në BE për speciet që aktualisht janë të kufizuara				
	Llojet e reja që i nënshtrohen përpunimit (p.sh., molusqet).	IPARD III, masa 3 duhet të japë përparësi përpunuesve të peshkut që diversifikojnë prodhimin e tyre.	x		
MBZHR Drejtoria e Peshkimit dhe Akuakulturës	Prodhimi i ushqimit për akuakulturën dhe trajtimet e “nënprodukteve”	Diskutim me donatorët e mundshëm për mbështetje financiare/projekte në koherencë me nevojat e ndërhyrjeve dhe mekanizmin e zbatimit të tyre Përpunimi i nënprodukteve duhet të verifikohet sipas IPARD III (diversifikimi). Emërimi i stafit të çdo drejtorie përgjegjëse për AT-në. Përgatitja e ToR-ve për mbështetjen e planifikuar të AT.	x	x	x
	Zhvillimi i akuakulturës së qëndrueshme, në përputhje me mjedisin				
	Grande për zhvillimin e ekonomisë blu dhe zhvillimin e turizmit detar				
	AT për zhvillimin e “ekonomisë blu” dhe zhvillimin e turizmit detar				



VENDIM
Nr. 2, datë 31.5.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji i Posaçëm i Apelit, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Albana Shtylla	kryetare;
Ina Rama	anëtare;
Mimoza Tasi	anëtare;
Natasha Mulaj	anëtare;
Rezarta Schuetz	anëtare;
Sokol Çomo	anëtar,

mori në shqyrtim në seancë plenare publike, në datat 15.12.2021, 20.1.2022, 21.2.2022, 23.3.2022, 14.4.2022, 10.5.2022, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit Disiplinor (JD) nr. 4/2021, datë 21.5.2021, që u përket:

ANKUESE: Enkeleida Hoxha, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, përfaqësuar me prokuror nga avokat Ardian Visha.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli i Lartë Gjyqësor, përfaqësuar me autorizim nga Qemal Zaimi;

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, përfaqësuar me autorizim nga Isida Koka dhe Alma Troshani.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 92, datë 17.3.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

BAZA LIGJORE: Neni 131, shkronja “P”, neni 134, pika 1, shkronja “I”, dhe pika 2, neni 179, pika 7, e Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; neni 5, pika 3, e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar; ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 100, pika 1, e ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

KOLEGJI I POSAÇËM I APELIT,

pasi shqyrtoi pretendimet e ankueses Enkeleida Hoxha, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Këshillit të

Lartë Gjyqësor dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, dëgjoi relatorin e çështjes Albana Shtylla, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Ankuesja Enkeleida Hoxha ka ushtruar detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë (në vijim “ILD”), me vendimin nr. {***} prot., datë 16.7.2020, ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë ndaj magjistrates Enkeleida Hoxha, për shkelje të rënda profesionale që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës, të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës dhe shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, shkronjat “ç” dhe “dh”, dhe pika 2, shkronjat “a” dhe “c”, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (në vijim “ligji nr. 96/2016”).

3. ILD-ja, me vendimin nr. {***} prot., datë 20.11.2020, ka vendosur bashkimin e procedimeve hetimore, pas kërkesës së paraqitur nga Ministria e Drejtësisë, me shkresën nr. {***} prot., datë 23.7.2020, për verifikimin e të njëjtave fakte dhe pretendime të analizuara në vendimin nr. {***} prot., datë 16.7.2020, për fillimin e hetimit disiplinor.

4. ILD-ja ka depozituar në Këshillin e Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) kërkesën me nr. {***} prot., datë 10.12.2020, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates Enkeleida Hoxha. Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, ILD-ja ka paraqitur propozimin për caktimin ndaj magjistrates Enkeleida Hoxha të masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja “a”, e Kushtetutës, neni 105, pika 1, shkronja “dh”, dhe neni 111, pika 1, e ligjit nr. 96/2016.

5. KLGj-ja, me vendimin nr. {***}, datë 23.12.2020, ka vendosur caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistrates Enkeleida Hoxha.

6. KLGj-ja, në kuadër të procedimit disiplinor, me vendimin nr. 92, datë 17.3.2021, ka vendosur:



“1. Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. 2. Shkarkimin nga detyra të magistrates Enkeleida Hoxha, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë. 3. Pezullimin e përfitimit të pagës në masën 50%, si dhe përfitimet e tjera të magistrates Enkeleida Hoxha, deri kur ky vendim të marrë formë të prerë. 4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, afati i të cilit fillon nga e nesërja e njoftimit të arsyetimit të këtij vendimi. 5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”

7. Magjistratja Enkeleida Hoxha ka paraqitur në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”) ankim ndaj vendimit të KLGj-së nr. 92, datë 17.3.2021, i cili është regjistruar në regjistrin e çështjeve të Juridiksionit Disiplinor me (JD) nr. 4/2021, datë 21.5.2021.

8. Kolegji për Shqyrtimin Paraprak në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, me vendimin nr. {***}, datë 6.7.2021, ka vendosur kalimin për shqyrtim në seancë plenare publike të çështjes (JD) nr. 4/2021, datë 21.5.2021, që i përket kërkesës së magistrates Enkeleida Hoxha për shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 92, datë 17.3.2021, si dhe thirrjen si person të interesuar të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

9. Në përgjigje të shkresës së Kolegjit nr. {***}, datë 21.10.2021, KLGj-ja, me shkresën nr. {***}, datë 5.11.2021, ka përcjellë prapësimet për ankimin e paraqitur nga ankuesja Enkeleida Hoxha.

10. Kolegji, bazuar në nenin 38, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në seancën e datës 15.12.2021, vendosi të thërrasë si subjekt të interesuar Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, pjesëmarrja e të cilit u konsiderua e nevojshme për zhvillimin efektiv të procesit.

11. Në përgjigje të njoftimit të Kolegjit nr. {***} prot., datë 16.12.2021, për thirrjen si subjekt i interesuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me shkresën nr. {***} prot., datë 10.1.2022, ka përcjellë parashtrimet me shkrim lidhur me çështjen.

12. Në seancat plenare të zhvilluara në Kolegji, ankuesja realizoi mbrojtjen e saj personalisht, si dhe me prezencën e përfaqësuesit ligjor, sipas prokurës së posaçme nr. repertori {***}, datë 27.1.2021, me të cilën kishte caktuar si përfaqësues ligjor avokatin Ardian Visha. Sipas kësaj prokure, përfaqësimi i ankueses në kuadër të këtij gjykimi, do të bëhej si

në prani dhe në mungesë të saj. Gjatë gjykimit në Kolegji, për shkak të gjendjes së ankueses në masën e sigurimit personal “arrest në burg”, u garantua prania e saj në seancë, nëpërmjet korrespondencës zyrtare me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale “Ali Demi” Tiranë.

13. Në seancën e datës 23.3.2022, me kërkesë të përfaqësuesit ligjor për shtyrje seance, Kolegji, pavarësisht mungesës së ankueses për shkaqe të vlerësuara joobjektive, duke pasur në konsideratë rrethanat specifike të ankueses, lirinë e kufizuar dhe vështirësinë për të garantuar një mbrojtje të efektshme nga përfaqësuesi ligjor pa prezencën e saj, vendosi pranimin e kërkesës për shtyrjen e gjykimit, për t’i dhënë mundësi magistrates Enkeleida Hoxha për t’u dëgjuar personalisht.

14. Kolegji, në seancën e datës 10.5.2022, pas verifikimit të pranisë së palëve, mori në shqyrtim kërkesën e ankueses për shtyrje të seancës gjyqësore, për arsye shëndetësore. Kolegji kreu verifikimet përkatëse, duke komunikuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe me IEVP “Ali Demi”, nga të cilët u konfirmua se ankuesja ishte në gjendje të mirë shëndetësore. Nisur nga ky konfirmim, si dhe nga fakti që përfaqësuesi ligjor i ankueses nuk paraqiti asnjë shkak të përligjur për mosmarrjen pjesë në seancë, apo kërkesë për shtyrjen e seancës, Kolegji vendosi të vijojë gjykimin e çështjes në mungesë të ankueses dhe të përfaqësuesit të saj ligjor.

15. Kolegji, bazuar në nenet 1, paragrafi 2, dhe 42, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në seancën e datës 15.12.2021, vendosi t’i drejtohet KLGj-së për të depozituar fashikullin e plotë me të gjitha aktet e administruara dhe të krijuara në funksion të procedimit disiplinor, në bazë të të cilit është marrë vendimi nr. 92, datë 17.3.2021, i KLGj-së. Ankuesja dhe përfaqësuesi i saj ligjor u njoftuan dhe ushtruan të drejtën për njohjen dhe marrjen e kopjeve të akteve të KLGj-së, të përcjella në Kolegji.

16. Në seancën e datës 23.3.2022, pas kërkesës së përfaqësuesit ligjor të ankueses për thirrjen e dëshmitarëve dhe marrjen si prova të disa akteve zyrtare, Kolegji vendosi rrëzimin e kërkesës pasi u vlerësua se kërkesat nuk janë të nevojshme për sqarimin e fakteve që lidhen me çështjen në



shqyrtim, sipas neneve 41 dhe 42, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

II. Pretendimet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

17. Kolegji fillimisht konstaton se ankuesja, në kërkesën drejtuar Kolegjit, ka parashtruar dy grupe pretendimesh. Grupi i parë i pretendimeve ka natyrë procedurale dhe lidhet në disa aspekte me cenimin e së drejtës për proces të rregullt, ndërsa grupi i dytë përfshin pretendime lidhur me vendimarrjen e Këshillit.

18. **Ankuesja**, në ankimin drejtuar Kolegjit, ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

- *Lidhur me procedurën e hetimit dhe shqyrtimit të çështjes në ILD dhe KLGj:*

18.1 Kërkesat e paraqitura nga përfaqësuesi i magjistrates për prova, u rrëzuan pa asnjë argumentim nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke mohuar të drejtën për të kundërshtuar pretendimet e paraqitura në raport nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

18.2 Magjistrates nuk i është marrë në konsideratë kërkesa për marrëveshje, si një mundësi e parashikuar nga ligji. Mosdëgjimi dhe mospranimi i kërkesës për marrëveshje, i ka cenuar ankueses standardin e procesit të rregullt.

18.3 Masa disiplinore “shkarkim nga detyra” është vendosur pa ligj, për shkak se shkeljet disiplinore të pretenduara, në kohën e kryerjes nuk konsideroheshin si të tilla, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 34/2017, për shfuqizimin e nenit 102, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

18.4 Procesi ndaj magjistrates ka qenë i paragykuar dhe i ndikuar politikisht.

- *Lidhur me vendimarrjen e KLGj-së:*

18.5 Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk ka analizuar shkelje disiplinore të gjyqtarës apo sjellje diskredituese të figurës dhe statusit të gjyqtarit, por ka bërë një analizë të mirëfilltë të një gjykate më të lartë, lidhur me mënyrën si është zbatuar ligji.

18.6 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka mbajtur qëndrime të ndryshme për dy rastet e gjykuara nga magjistratja. Këshilli, në rastin e të dënuarit H. B., ka shqyrtuar mënyrën e zbatimit të ligjit procedural dhe material nga ana e magjistrates, edhe pse këtë tagër ia përjashtoi vetes në rastin e të dënuarit I. P.

18.7 Vendimarrja për lirim të të dënuarit H. B. nuk është ankimuar dhe nuk ka një vendim të një shkalle më të lartë që të jetë shprehur nëse është shkelur ligji material apo procedural i saj.

18.8 Rasti i të dënuarit H. B. shoqërohet me kompleksitetin që prodhon një raport bashkëpunimi me Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, në fushën e njohjes së vendimeve penale të huaja.

19. **KL Gj-ja**, në mënyrë të përmbledhur ka parashtruar si vijon.

19.1 Procesi i zhvilluar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka qenë në përputhje me Kushtetutën, ligjin nr. 96/2016, si dhe me Kodin e Procedurave Administrative. Procedimi disiplinor i zhvilluar nga Këshilli, ka mbajtur në konsideratë parimet që udhëheqin këtë proces, të mirëpërcaktuara në nenin 100 të ligjit për statusin.

19.2 Magjistrates Enkeleida Hoxha i është dhënë gjithë koha e nevojshme për të realizuar mbrojtjen e saj, si dhe për të paraqitur argumentet dhe provat në funksion të mbrojtjes së vet.

19.3 KLGj-ja ka vlerësuar dhe analizuar të gjitha kërkimet e bëra nga pala mbrojtëse në seancën dëgjimore. Për këtë arsye, Këshilli ka vlerësuar shtyrjen e seancës së datës 25 shkurt 2021, ndër të tjera edhe për të kërkuar kohë për vlerësimin e kërkesave. Të gjitha kërkimet e bëra për marrjen e provave, janë analizuar dhe për secilën prej tyre Këshilli, në mbledhjen e datës 4.3.2021, ka dhënë shkaqet për të cilat është vlerësuar rrëzimi i kërkesës, kryesisht si kërtime që nuk kanë lidhje me objektin e procedimit.

19.4 Procedimi disiplinor i zhvilluar në KLGj është tërësisht i bazuar në fakte dhe prova të cilat nuk krijojnë asnjë mëdyshje për vërtetësinë e tyre, për rëndësinë e shkeljeve të kryera, dhe çdo pretendim se qëndrimi i Këshillit përmban tharm politik, është i pabazuar.

19.5 Për sa i përket pretendimit të ankueses se shkarkimi nga detyra është bërë në mungesë të parashikimeve ligjore, KLGj-ja, në vendimin nr. 92/2021, objekt shqyrtimi, ka theksuar faktin se neni 102, i ligjit nr. 96/2016, është shfuqizuar me vendimin nr. 34, datë 10.4.2017, të Gjykatës Kushtetuese dhe se ky nen është plotësuar më vonë me ligjin nr. 48/2019. Në vijim të arsytimit, Këshilli ka theksuar se: “30.1 [...] prandaj, në ndryshim nga qëndrimi i ILD-së, Këshilli do ta mbështesë vendimin e tij vetëm në parashikimet e bëra drejtpërdrejt në nenin 140,



pika 2, germa “a”, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe dispozitat e tjera ligjore, që në kohën kur pretendohet se janë kryer shkeljet kanë pasur kurs ligjor në territorin e Republikës së Shqipërisë.”.

20. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka parashtruar në mënyrë të përmblodhur se:

- Në lidhje me pretendimin se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra është vendosur pa ligj:

20.1 Inspektori i Lartë i Drejtësisë, mbështetur në parimin kushtetues të hierarkisë së akteve, duke qenë se referuar ligjit në fuqi në kohën e dhënies së vendimeve gjyqësore nga magjistratja Enkeleida Hoxha, shkeljet disiplinore, të parashikuara në nenet 101, 102, 103 dhe 104, të ligjit nr. 96/2016, ishin shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese, u është referuar në mënyrë të drejtpërdrejtë parashikimeve kushtetuese, konkretisht nenit 140, pika 2, shkronja “a”, të Kushtetutës, që parashikon se: “Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur: a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike, që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës.”.

20.2 Referimi i drejtpërdrejtë në dispozitat kushtetuese mbështetet në vetë jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, vendimet nr. 78/2017 dhe nr. 55/2016, ku arsyetohet se: “Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koberencës në sistemin ligjor. Parimi i shtetit të së drejtës nënkupton supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie dhe në secilin prej këtyre niveleve, qëndron një normë ose grup normash, duke përfshirë kështu edhe fuqinë e caktuar juridike. Piramida e akteve normative, e sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, përcakton marrëdhëniet midis normave juridike, të cilat bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike.”.

20.3 Fakti që në kohën e shqyrtimit të pesë çështjeve gjyqësore për të cilat magjistratja u gjend disiplinarisht përgjegjëse, nenet 101, 102, 103 dhe 104, të ligjit nr. 96/2016, ishin shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese, nuk mund të nënkuptojë kurrësi që magjistratja të mos përgjigjet disiplinarisht në rast se nga hetimi dhe procedimi disiplinor rezulton e provuar, se janë plotësuar kriteret e parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja “a”, e Kushtetutës.

20.4 Edhe neni 111, i ligjit nr. 96/2016, dispozitë ligjore që parashikon shkarkimin nga

detyra, referon në rastet e parashikuara në nenin 140, pika 2, shkronja “a”, të Kushtetutës, për shkarkimin e magjistratit. Kjo dispozitë ligjore parashikon shkarkimin nga detyra ndërmjet të tjerave, edhe për “sjellje të kryer me pakujdesi të rëndë, që shkel haptazi vlerat themelore të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë”. Nga mënyra e formulimit, del e qartë që edhe vetë dispozita ligjore në këtë rast, i referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë parashikimit të bërë nga neni 140, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës. Nëse ligji do të parashikonte raste të tjera për shkarkimin e magjistratit tej atyre të parashikuara në Kushtetutë, atëherë norma ligjore do të konsiderohej antikushtetuese.

20.5 Ekzistenca e vakumit të përkohshëm ligjor, në dispozitat ligjore që parashikojnë veprimet / mosveprimet dhe sjelljet që konsiderohen shkelje disiplinore, nuk mund të interpretohet kurrësi si cenim i parimit të procesit të rregullt ligjor, të konsiderohet si shkak i shmangies nga përgjegjësia disiplinore, apo të mund të përdoret nga magjistrati si shkak për të mos përmblodhur funksionin e tij në mënyrë të rregullt ose për të kryer shkelje profesionale të natyrës që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës. Çdo vlerësim i ndryshëm do të cenonte jo vetëm sistemin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies së magjistratëve, por do të përbënte edhe një precedent të rrezikshëm, duke ndikuar drejtpërdrejt në cenimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

- Për sa i takon thelbit të çështjes:

20.6 Gjykata Kushtetuese, nëpërmjet vendimit nr. 75/2002, arsyeton se: “Shprehja “akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën [...]”, parashikuar nga nenet 128, 140 dhe 149, pika 2, të Kushtetutës, përmblodh në vetvete një sërë elementesh, të cilat mund dhe duhet të identifikohen rast pas rasti nga organi përkatës që merr vendimin për shkarkimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe Prokurorit të Përgjithshëm. Ato janë të lidhura me aktet dhe sjelljet e parregullta e të padenja që këta funksionarë të lartë kryejnë gjatë ushtrimit të detyrës, për shkak të saj, por edhe jashtë detyrës. Këto veprime apo mosveprime që analizohen në bazë të rrethanave të kryerjes së tyre, momentit subjektiv, si dhe nga dëmet që ato i sjellin shoqërisë e shtetit, janë të asaj natyre që e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese nga këto subjekte.”.



20.7 Në këndvështrim të analizës së elementeve të referuara në vendimin e sipërcituar të Gjykatës Kushtetuese në raport me sjelljen e ankueses Enkeleida Hoxha, rezultoi se:

20.8 *Për sa i takon elementit të rrethanave të kryerjes së tyre, gjatë hetimit disiplinor dhe procedimit rezultoi e provuar se ankuesja:*

20.8.1 Ka kryer veprime dhe mosveprime që kanë të bëjnë me mosrespektim të rëndë e të vazhduar të dispozitave materiale dhe procedurale penale, përkatësisht: nenet 57, 59/a, pika 1, shkronja “c”, 64 të Kodit Penal; nenet 149, 152, 178, 182, 366, 367, 380, 383/1/ç, 438, 514, 518 të Kodit të Procedurës Penale, nenet 2 dhe 63, të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”, të ndryshuar; neni 9, pika 3, e ligjit nr. 8499, datë 10.6.1999, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës Për transferimin e personave të dënuar”; neni 61, pika 2, e ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, si dhe parashikimet e vendimeve unifikuese nr. 154/2000 dhe nr. 2/2015, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

20.8.2 Nuk ka respektuar dispozitat penale me karakter urdhërues, të cilat parashikojnë kriteret me karakter objektiv, ndalues dhe me një përmbajtje të drejtpërdrejtë dhe lehtësisht të kuptueshme për lirimin e të dënuarit, ku përvoja e gjatë profesionale në detyrë e magjistrates, e lejon të interpretojë dhe zbatojë drejt këto dispozita, përkatësisht nenet 4 dhe 5, të ligjit nr. 141/2016, “Për dhënie amnistie”.

20.8.3 Nuk ka marrë prova vendimtare për zgjidhjen e çështjes në kundërshtim me praktikën e konsoliduar të Kolegjeve Penale të Gjykatës së Lartë, duke cenuar parimin e paanësisë së gjykimit.

20.8.4 I ka atribuuar të dënuarit H. B. cilësi të ndryshme, herë si i paraburgosur dhe herë si i dënuar, gjatë periudhave të njëjta në funksion të pranimit të çdo kërkesë të paraqitur nga ana e të njëjtit ankues, me qëllim krijimin e mundësive për përfundimin nga instituti i lirimit para kohe me kusht.

20.8.5 Në 5 raste është konstatuar një mungesë thelbësore në arsyetimin e vendimeve gjyqësore, të cilat detyrimisht duhet të jenë të arsyetuara, në respektim të procesit të rregullt ligjor dhe mundësisë për ushtrimin e kontrollit të tyre nga gjykatat më të larta, por edhe për efekt procedimi disiplinor.

20.9 *Për sa i takon momentit subjektiv, rezultoi se nga ankuesja:*

20.9.1 Janë ndërmarrë veprime/mosveprime, të cilat kanë të bëjnë me mosrespektim të rëndë dhe të vazhduar të legjislacionit material dhe procedural penal, pasi jo vetëm nuk është respektuar kërkesa e një dispozite të ligjit material apo procedural, por edhe nuk janë respektuar një tërësi dispozitash materiale dhe procedurale.

20.9.2 Këto veprime/mosveprime janë kryer në mënyrë të drejtpërdrejtë, të vazhduar, të vullnetshme dhe të pajustificuar në disa procese gjyqësore, ku përvoja e gjatë profesionale në detyrë e magjistrates e lejon të interpretojë dhe zbatojë drejt këto dispozita.

20.10 *Në lidhje me elementin e tretë, atë të pasojave që i shkaktohen shoqërisë, rezultoi se shkeljet disiplinore të kryera nga ankuesja kanë sjellë pasoja jo vetëm në cenimin e imazhit të gjyqtarit dhe humbjen e besimit ndaj tij, por kanë cenuar edhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Besimi i publikut nuk është nocion i papërkufizuar, pasi ai gjën mbështetje të vlerat themelore dhe standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së magjistratëve, sipas përcaktimeve të neneve 3 dhe 4, të ligjit “Për statusin”. Në nenin 3, pika 5, të ligjit nr. 96/2016, është parashikuar se sjellja e magjistratit është e lidhur me garantimin e ruajtjes e forcimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë. Nëse magjistratët nuk e përmbushin plotësisht rolin e tyre për dhënien e sigurimin e drejtësisë në shoqëri, ekziston rreziku i humbjes së besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Besimi i publikut dhe respekti për sistemin e drejtësisë janë garanci të demokracisë dhe stabilitetit në një shoqëri demokratike.*

III. Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e ankueses

21. Juridiksioni dhe kompetenca e Kolegjit të Posaqëm të Apelit, në kuadër të Juridiksionit Disiplinor, janë parashikuar në nenin 179, pika 7, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas së cilës:

“Gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar, gjyqtarët e Kolegjit të Apelit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kolegji i Apelit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të



Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.”.

22. Në vendimin nr. 2/2018 (JD), datë 21.6.2018, Kolegji ka vlerësuar se shqyrtimi i të gjitha ankesave apo kërkesave të paraqitura e të regjistruara në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, në kuadër të Juridiksionit të tij Disiplinor, do të gjykohej sipas dispozitave të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, për sa i përket natyrës e procedurës së gjykimit. Kolegji, në këtë mënyrë, i ka konsideruar këto kërkesa si një gjykim kushtetues, të ndryshëm për nga natyra me gjykimin që Kolegji i Posaçëm i Apelimit bën në rastet kur ai gjykon sipas juridiksionit të tij rivlerësues.

23. Çështja e legjitimitetit është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P”, dhe 134, pika 1, shkronja “I”, dhe pika 2 e Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

24. Ankimi kushtetues individual duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

25. Në çështjen objekt shqyrtimi, lidhur me legjitimitetin e ankueses, Kolegji vlerëson se ankuesja Enkeleida Hoxha legjitimohet *ratione personae*, pasi vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, të cilin ka ankimuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, është marrë në kuadrin e një procedimi disiplinor ndaj saj dhe ankuesja ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

26. Në lidhje me shterimin e mjeteve juridike, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, konstatohet se bazuar në nenin 179, pika 7, të Kushtetutës dhe nenin 100, pika 1, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, vendimet e Këshillit të Lartë

Gjyqësor për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve, ankimohen në Gjykatën Kushtetuese (Kolegjin e Posaçëm të Apelimit brenda mandatit nëntëvjeçar). Pra, ankuesja nuk ka mjet tjetër ligjor ankimi, përveç kërkesës drejtuar Kolegjit.

27. Ankuesja legjitimohet dhe *ratione temporis*, pasi vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor që ankimohet është i datës 17.3.2021, ndërsa kërkesa e ankueses, është protokolluar në Kolegji me nr. {***} prot., datë 11.5.2021, dhe është regjistruar pas plotësimit të dokumentacionit, në datën 21.5.2021, pra brenda afatit ligjor 4-mujor, të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000.

28. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji çmon se pretendimet e ankueses ndaj vendimit nr. 92, datë 17.3.2021, të KLGj-së, janë pretendime që *prima facie* hyjnë në juridiksionin disiplinor të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe do të shqyrtohen në vijim.

B. Për themelin e pretendimeve

B1. Lidhur me të meta procedurale të betimit dhe shqyrtimit të çështjes në ILD dhe KLGj

29. Ankuesja parashtron në ankimin drejtuar Kolegjit, se dëgjimi si palë gjatë procedurës disiplinore në KLGj ka qenë tërësisht formal dhe kërkesat e paraqitura nga përfaqësuesi i saj për prova u rrëzuan pa asnjë argumentim nga KLGj-ja, duke i mohuar të drejtën për të kundërshtuar pretendimet në raportin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

29.1 KLGj-ja, në prapësimet e paraqitura, si dhe gjatë seancave publike në Kolegji, duke kundërshtuar këtë pretendim të ankueses, është shprehur se ka vlerësuar dhe analizuar të gjitha kërkimet e bëra nga pala mbrojtëse e ankueses në seancat dëgjimore. KLGj-ja ka vendosur shtyrjen e seancës të datës 25 shkurt 2021, ndër të tjera, edhe për të marrë kohë për vlerësimin e kërkesave të paraqitura nga përfaqësuesi i magistrates. KLGj-ja ka analizuar të gjitha kërkimet e bëra nga ankuesja për marrjen e provave dhe për secilën prej tyre, në mbledhjen e datës 4.3.2021, me vendim të ndërmjetëm, janë dhënë shkaqet për të cilat është vlerësuar rrëzimi i kërkesës, kryesisht si kërtime që nuk kanë lidhje me objektin e procedimit.

29.2 Kolegji konstaton, nga aktet e depozituara, se KLGj-ja, në seancën e datës 25.2.2021, është njohur me kërkesën e përfaqësuesit të ankueses drejtuar ILD-së, për reduktimin e shkeljeve vetëm



në atë pjesë të pranuar nga magjistratja, si dhe me kërkesën drejtuar KLGj-së për thirrjen e dëshmitarëve dhe pranimin e administrimin si prova të disa akteve shkresore.

29.3 Në këtë seancë, siç rezulton nga procesverbali i mbledhjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor, përfaqësuesi i magistrates ka kërkuar të thirren si dëshmitarë: 1. z. A. I., Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve; 2. Znj. O. Th., Drejtoreshë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Ministrinë e Drejtësisë, lidhur me raportin problematik të marrëdhënieve juridiksionale penale me Britaninë e Madhe, në fushën e njohjes vendimeve penale të huaja dhe transferimin e të dënuarve përkatës; 3. Të gjithë pjesëmarrësit në proceset gjyqësore, të konsideruara në shkellje të gjyqtares, z. A. L., jurist i Drejtorisë së Burgjeve, prezent në gjykatë; z. E. K., punonjës i Zyrës së Shërbimit të Provës; dy prokurorët e dy çështjeve, z. B. M. dhe z. B. Ç.; si dhe edhe z. I. P. dhe/ose përfaqësuesi ligjor i tij.

29.4 Gjithashtu, përfaqësuesi i magistrates ka kërkuar marrjen në cilësinë e provave të akteve: 1. vërtetimin e datës 19.1.2021, të Gjykatës së Apelit Tiranë, që provon për vijimësi të gjykimit të çështjeve; 2. vendimin nr. {***}, datë 20.12.2016, të Gjykatës së Lartë, që provon faktin që magjistratja është pa masë; si dhe ka kërkuar nga Këshilli marrjen e disa akteve zyrtare nga Ministria e Drejtësisë, Shërbimi i Provës Tiranë dhe Shërbimi i Provës Shkodër.

29.5 Në përfundim, KLGj-ja ka vendosur të shtyjë seancën, me qëllim për të shqyrtuar dhe marrë vendim në lidhje me kërkesën për marrjen si provë të akteve të paraqitura, si dhe thirrjen e dëshmitarëve.

29.6 Në vazhdim të shqyrtimit, në seancën e datës 4.3.2021, sipas procesverbalit të kësaj seance, rezulton se KLGj-ja ka vendosur:

“Mospranimin e provave dhe thirrjen në cilësinë e dëshmitarëve të shtetasve: z. A. I., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve; Znj. O. Th., me detyrë Drejtoreshë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Ministrinë e Jashtme; z. A. L., me detyrë jurist i Drejtorisë së Burgjeve; z. E. K., punonjës i Zyrës së Shërbimit të Provës; z. B. M., me detyrë prokuror; z. B. Ç., ish-prokuror (aktualisht në pension); z. I. P., me argumentin se faktet me të cilat pretendohet të provohen me marrjen e këtyre provave, nuk kanë lidhje me objektin e procedimit”⁶¹.

29.7 Gjithashtu, në këtë seancë, KLGj-ja ka vendosur: “Mospranimin në cilësinë e provave të akteve

*shkresore: a) vërtetim me nr. {***} prot., datë 19.1.2021, të Gjykatës së Apelit Tiranë; b) kopje të akteve drejtuar Ministrisë, Shërbimit të Provës Tiranë, që më datë 6.2.2021 dhe atij dërguar Shërbimit të Provës Shkodër datë 10.2.2021, krahas pritjes së mbërritjes së përgjigjeve përkatëse, me argumentin se ajo që pretendohet të provohet nëpërmjet këtyre provave, nuk ka lidhje me objektin e këtij procedimi, pasi personat e dënuar nuk janë pjesë e këtij procedimi disiplinor, pasi për këtë është pezulluar”⁶².*

29.8 Lidhur me kërkesën për marrjen si provë të vendimit nr. {***}, datë 20.12.2016, të Gjykatës së Lartë, KLGj-ja ka vendosur, po në këtë seancë, mospranimin e marrjes së këtij akti si provë shkresore, pasi ky akt është pjesë e dosjes së procedimit disiplinor, të përcjellë nga ILD-ja⁶³.

29.9 Në vendimin nr. 92, KLGj-ja është shprehur se: “18.4 Në lidhje me provat e kërkuara nga mbrojtja e magistrates, Këshilli vendosi të rrëzojë kërkesën për marrjen e tyre, pasi ato nuk kanë lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, sepse nga ILD-ja nuk ngrihen pretendime në lidhje me sjelljen e të dënuarit I.P. pas dërgimit në shtëpi [...]. Gjithashtu nuk ka pasur probleme gjatë transferimit të të dënuarit H. B. nga Mbretëria e Bashkuar në Shqipëri, por shkelljet e pretenduara nga ILD-ja kanë ndodhur pasi ky i dënuar është instaluar në IEVP Fushë-Kryjë dhe këto shkellje kishin të bënin me moszbatimin e ligjit procedural dhe material nga ana e magistrates Enkeleida Hoxha.”.

29.10 Nga aktet e administruara, të cituara më sipër, si dhe nga shpjegimet e dhëna nga palët gjatë seancave publike, Kolegji çmon se rezulton i pabazuar pretendimi i ankueses se KLGj-ja ka rrëzuar pa asnjë argumentim kërkesat për marrjen e provave. Kolegji vëren se KLGj-ja, gjatë procedimit disiplinor të zhvilluar ndaj ankueses, ka marrë kohën e nevojshme për shqyrtimin e provave të paraqitura, duke shtyrë seancën dëgjimore të datës 25.2.2021. Në seancën e radhës, KLGj-ja, pasi ka analizuar rrethanat konkrete, aktet e administruara në proces, si dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesja lidhur me kërkesat për marrje aktesh dhe thirrje dëshmitarësh, është shprehur mbi pranueshmërinë e provave, duke konkluduar se ato nuk kanë lidhje me çështjen objekt shqyrtimi. Nëse argumentet dhe konkluzionet e dhëna nga KLGj-ja në vendimin e ndërmjetëm për mospranimin e provave, nuk kanë plotësuar pritshmëritë e ankueses, ky nuk përbën

⁶¹ Procesverbali i mbledhjes së KLGj-së, datë 4.3.2021, f. 10.

⁶² Po aty.

⁶³ Po aty.



një shkak për të konkluduar se vendimmarrja e KLGj-së është e cënueshme në drejtim të mosrespektimit të procesit të rregullt ligjor. *Kolegji sjell në vëmendje se GjEDNj-ja ka pohuar se neni 6 i KEDNj-së, që garanton të drejtën për proces të rregullt, nuk përcakton rregulla për pranueshmërinë e provave ose mënyrën se si duhet të vlerësohen ato, të cilat janë çështje që rregullohen nga ligji i brendshëm dhe vlerësohen nga gjykatat vendase. U takon këtyre gjykatave të vlerësojnë rëndësinë e provave të paraqitura, vlerën e tyre provuese dhe barrën e provës (shih *Lady S.R.L. k. Republika e Moldavisë*, 23 tetor 2018, § 27; *Centro Europa 7 S.r.l. dhe Di Stefano k. Italisë* [DHM], 7 qershor 2012, § 198).*

29.11 Sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, parimi i barazisë së armëve nuk u imponon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm që këto të pranojnë të gjitha argumentet dhe provat që paraqet një palë në proces. Kur kryen detyrën e saj të vlerësimit të lirë të provave, gjykata mund të bindet mbi bazën e disa provave, duke përjashtuar një ose disa prova të tjera, që ajo i konsideron të parëndësishme për çështjen (shih vendimin nr. 19, datë 19.7.2005, të Gjykatës Kushtetuese).

29.12 Standardi i GjEDNj-së, i sjellë në vëmendje më sipër, në kuadër të garantimit të të drejtave të palëve për proces të rregullt, si dhe interpretimi i Gjykatës Kushtetuese, janë të aplikueshëm dhe në rastin konkret gjatë procesit administrativ të zhvilluar në KLGj.

29.13 Në përfundim, Kolegji vlerëson se vetëm fakti që KLGj-ja nuk ka pranuar kërkesat për marrjen e provave të kërkuara nga ankuesja, nuk është i mjaftueshëm për të vënë në dyshim respektimin e procesit të rregullt ligjor në procedimin disiplinor ndaj ankueses.

30. Ankuesja pretendon se gjatë procesit të zhvilluar në KLGj, nuk i është marrë në konsideratë kërkesa për marrëveshje si një mundësi e parashikuar nga ligji. Injorimi i kërkesës për marrëveshje deri në mosdëgjim të saj e jo më në shqyrtim dhe dakordësim të mundshëm, sipas ankueses, përbën moment të mosrespektimit të hapave proceduralë, etikës së raporteve midis palëve në proces, dhe i ka cënuar ankueses standardin e procesit të rregullt.

30.1 Nga procesverbalet e seancave të zhvilluara në KLGj, konstatohet se në seancën e datës 25.2.2021, është zhvilluar një diskutim mbi këtë

marrëveshje, gjatë të cilit përfaqësuesi i ankueses ka pranuar gabimet e magjistrates, në lidhje me llogaritjen si kohë paraburgimi të dënimit në shtetin e huaj, si dhe përfitimin nga amnistia, dhe ka kërkuar ndërprerjen e seancës dhe dhënien e kohës për hartimin e marrëveshjes me ILD-në dhe nënshkrimin përkatës, sipas pikës 3, të nenit 135, të ligjit 96/2016.

30.2 Po në këtë seancë, ILD-ja është shprehur se: “[...] raporti i hetimit i është dërguar magjistrates që në datë 16 korrik, kur ka filluar hetimi. Kështu që raportin e ka pas magjistrati. Pra, momenti për të menduar për marrëveshje, i ka filluar që në atë moment. Ideja për marrëveshje mund t’i lindte që në atë moment sepse e ka pas raportin e hetimit edhe provat mbi të cilat unë mbështesja hetimin e kryer ose që po kryeja për magjistraten.”.

30.3 Në vendimin nr. 92, datë 17.3.2021, KLGj-ja shprehet se: “55. Kjo shkelje disiplinore është pranuar gjatë procedimit disiplinor edhe nga përfaqësuesi i magjistrates, av. Ardian Vishaj, por ai ka pretenduar se shkelja nuk përbën një shkelje të rëndë disiplinore të magjistratit gjatë kryerjes së detyrës, duke i kërkuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë bërjen e një marrëveshjeje të përbashkët pranimit, në përputhje me kërkesat e nenit 135, të ligjit “Për statusin”, të ndryshuar, gjë e cila nuk u pranua nga ky i fundit [...]”.

30.4 Lidhur me pretendimin e ankueses për mospranimin e marrëveshjes, KLGj-ja ka prapësuar se: “Është e vërtetë që gjatë shqyrtimit të procedimit disiplinor pranë Këshillit, në një prej mbledhjeve është paraqitur kërkesa procedurale, e cila i adresohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke kërkuar prej tij reduktimin e shkeljeve vetëm në atë pjesë të pranuar nga magjistratja dhe përfaqësuesi i saj dhe dakordësimi i një marrëveshjeje me shkrim, sipas nenit 135 të ligjit për statusin. [...] Ndonëse palët nuk kanë konkluduar në një mirëkuptim të pranimit të shkeljeve disiplinore që i atribuohen magjistrates, kjo nuk do të thotë se ka pasur “injorim” apo “mosdëgjim” të palës tjetër. Mosdakordësia për një marrëveshje, me gjithë vullnetin që mund të kenë palët, nuk mund të konsiderohet, siç bën ankuesja, apriori si injorim i saj.”.

30.5 Nga ILD-ja, gjatë seancave publike të zhvilluara në Kolegji, është parashtruar se si nga magjistratja, ashtu dhe nga përfaqësuesi i saj ligjor, në asnjë moment të hetimit disiplinor nuk është paraqitur kërkesë me shkrim, që të dërgohet zyrtarisht në institucion. Sipas ILD-së, edhe gjatë parashtrimit që ka bërë përfaqësuesi ligjor i ankueses në KLGj, në seancën e datës 25.2.2021



dhe, në përfundim të kësaj seance, nuk ka pasur në asnjë moment kërkesë zyrtare për marrëveshje pranimit të nënshkruar dhe të paraqitur zyrtarisht nga ana e magistrates apo mbrojtësi i saj.

30.6 Lidhur me këtë pretendim të ankueses, Kolegji çmon se duhet vlerësuar bazuar në parashikimet e dispozitave të ligjit nr. 96/2016. Në nenin 135 të këtij ligji, parashikohet se: “1. *Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe magjistrati në çdo kohë mund të dakordësojnë marrëveshjen e përbashkët të pranimit lidhur me shkeljen disiplinore që i atribuohet magjistratit [...]. 9. Nëse marrëveshja refuzohet, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të fillojë ose vazhdojë veprimet hetimore disiplinore ndaj magjistratit, brenda një muaji nga dita e refuzimit të kësaj marrëveshjeje.*”.

30.7 Nga përmbajtja e dispozitës, si dhe përfshirja e saj në kreun për procedurat hetimore, rezulton se marrëveshja e përbashkët e pranimit është një procedurë që mundësohet kryesisht gjatë fazës së hetimit disiplinor. Edhe parashikimi në pikën 9, të nenit 135, të ligjit nr. 96/2016, e lidh refuzimin e kësaj marrëveshjeje, në kuadrin e veprimeve që kryhen gjatë hetimit disiplinor. Roli i KLGj-së në këtë fazë është ai i “certifikuesit” të kësaj marrëveshjeje, pasi ka vlerësuar përmbushjen e kriterëve formale dhe ligjore. Por parashikimi në pikën 1, të nenit 135 – *në çdo kohë mund të dakordësojnë marrëveshjen* – në një interpretim të zgjeruar, mundëson që me dakordësinë e të dyja palëve, kjo marrëveshje të lidhet dhe në faza të mëvonshme, gjatë procedimit disiplinor.

30.8 Për sa i përket formalizimit të kërkesës për marrëveshje, Kolegji çmon se nga pala kërkuese e marrëveshjes, nga ankuesja dhe përfaqësuesi i saj ligjor duhet të ishte vepruar në drejtim të paraqitjes së një kërkesë zyrtare me shkrim ndaj ILD-së, në përmbajtje të së cilës, sipas elementeve të parashikuara në nenin 135, pika 4, të ligjit 96/2016, të kishte një përmbledhje të fakteve dhe shkeljeve që pranohen nga magjistratja, qëndrimin për këto shkelje, si dhe propozimin e masës disiplinore. Pavarësisht fazës procedurale në të cilën ndodhej shqyrtimi i çështjes, ankuesja dhe përfaqësuesi i saj ligjor duhej t'i drejtoheshin paralelisht me një kërkesë formale ILD-së për paraqitjen e propozimit për marrëveshje. Duke mosvepruar vetë në drejtim të formalizimit të kërkesës, ankuesja nuk mund të pretendojë mosrespektimin e hapave proceduralë dhe mungesën e etikës së raporteve

midis palëve në proces, në mospranimin e kërkesës së saj për marrëveshje.

30.9 Në konkluzion të sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimi i ankueses, se duke mos iu marrë në konsideratë kërkesa për marrëveshje, i është cenuar standardi i procesit të rregullt, është i pabazuar. Marrëveshja e pranimit është një mundësi që ligji i jep magjistratit për të thjeshtuar procedimin disiplinor ndaj tij, me qëllim zhvillimin e një procedure administrative sa më të shpejtë dhe efektive. Por marrëveshja e përbashkët e pranimit gjithashtu, është një akt që kërkon dhe reflekton vullnetin e të dyja palëve, të ILD-së dhe të magjistratit. Mungesa e dakordësisë për marrëveshje nuk prek të drejtat e magjistratit në drejtim të cenimit të standardeve të procesit të rregullt të magjistratit, për sa kohë që procesi i rregullt garantohej në të gjitha elementet e tij, gjatë të gjithë fazave të hetimit dhe procedimit disiplinor. Gjithashtu, Kolegji sjell në vëmendje se realizimi i marrëveshjes midis palëve nuk sjell shmangien nga përgjegjësia disiplinore të magjistratit, pasi kushtet e marrëveshjes përcaktohen në përputhje me parimin e proporcionalitetit, si dhe duke respektuar parashikimet e ligjit nr. 96/2016.

31. Ankuesja pretendon se masa disiplinore “shkarkim nga detyra” është vendosur pa ligj, për shkak se shkeljet disiplinore të pretenduara, në kohën e kryerjes nuk konsideroheshin si të tilla, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 34/2017, për shfuqizimin e nenit 102, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

31.1 Në vendimin nr. 92, rezulton se KLGj-ja ka konstatuar faktin në kohën kur janë dhënë vendimet objekt procedimi disiplinor, neni 102 i ligjit nr. 96/2016 është shfuqizuar nga vendimi nr. 34, datë 10.4.2017, i Gjykatës Kushtetuese, duke u shprehur se:

“30.1 [...] Është momenti për t'u vënë në dukje se të gjitha shkeljet për të cilat kërkohet procedimi disiplinor i magistrates Enkeleida Hoxha, kanë ndodhur pasi Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, ndërmjet të tjerave, ka shfuqizuar edhe nenet 101–104, të ligjit “Për statusin” dhe përpara se të hynte në fuqi ligji nr. 48/2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i cili bënte plotësimin e tyre, prandaj në ndryshim nga qëndrimi i ILD-së, Këshilli do ta mbështesë vendimin e tij vetëm në parashikimet e bëra drejtpërdrejt në



nenin 140, pika 2, germa “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe dispozitat e tjera ligjore që në kohën kur pretendohet se janë kryer shkeljet kanë pasur kurs ligjor në territorin e Republikës së Shqipërisë. [...] 41. [...] Meqenëse shkeljet për të cilat kërkohet procedimi disiplinor i magjistrates Enkeleida Hoxha kanë ndodhur pasi Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar ndërmjet të tjerave, edhe nenet 101–104, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” [...], për rrjedhojë këto dispozita ligjore nuk mund të zbatohen në rastin objekt shqyrtimi, prandaj çështja duhet të zgjidhet duke iu referuar direkt nenit 140, pika 2, germa “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe dispozitave ligjore që ishin në fuqi në kohën e kryerjes së shkeljeve të pretenduara.”.

31.2 ILD-ja, në prapësimet e paraqitura në Kolegj, ka pranuar se në kohën e dhënies së vendimeve gjyqësore nga magjistratja Enkeleida Hoxha, shkeljet disiplinore të parashikuara në nenet 101, 102, 103 dhe 104, të ligjit nr. 96/2016, ishin shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese, dhe se mbështetur në parimin kushtetues të hierarkisë së akteve, duke zbatuar me përparësi Kushtetutën, u është referuar në mënyrë të drejtpërdrejtë parashikimeve kushtetuese, konkretisht nenit 140, pika 2, shkronja “a”, të Kushtetutës, normë e cila parashikon përgjegjësinë disiplinore të magjistratit në rastin e kryerjes së shkeljeve të rënda profesionale ose etike, që diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit gjatë ushtrimit të detyrës, por edhe masën disiplinore. Ndërkohë, ka theksuar ILD-ja, ligji nr. 96/2016 ka detajuar veprimet/mosveprimet dhe sjelljet që klasifikohen si shkelje disiplinore, por kjo nuk nënkupton që në mungesë të këtij detajimi ligjor magjistrati të mos përgjigjet disiplinarisht. Të njëjtin arsyetim, shprehet ILD-ja në prapësime, ndjek edhe parashikimi i nenit 111, shkronja “b”, të ligjit 96/2016, që parashikon shkarkimin nga detyra, ndërmjet të tjerave edhe për “sjellje të kryera me pakujdesi të rëndë, që shkel haptazi vlerat themelore të sistemit gjyqësor dhe prokurorisë”. Nga mënyra e formulimit, del e qartë që edhe vetë dispozita ligjore në këtë rast, i referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë parashikimit të bërë nga neni 140, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës.

31.3 Kolegji konstaton se KLGj-ja, në konkluzionet e pikës 81 dhe në tërësi në vendimin nr. 92, është bazuar në përcaktimet dhe në frymën e nenit 140, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës, si dhe në nenet 111 dhe 115, të ligjit nr. 96/2016 “,

për analizimin e kriterëve për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore dhe për përcaktimin e llojit të masës disiplinore ndaj magjistrates, dhe çmon se është i pabazuar pretendimi i ankueses se masa disiplinore “shkarkim nga detyra” është vendosur pa ligj.

31.4 Duke iu referuar përmbajtjes së nenit 140, pika 2, të Kushtetutës, Kolegji çmon se kjo dispozitë në mënyrën si është formuluar, në rastin e kryerjes së shkeljeve të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, nuk i ka dhënë mundësi delegimi ligjit për të përcaktuar masën disiplinore, por është shprehur qartë se këto raste përbëjnë shkaqe kushtetuese që shërbejnë për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit. Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 75/2002, shprehet se: “*cilësimi “rëndë”, i përdorur si për rastin e diskreditimit të pozitës dhe figurës së gjyqtarit e të prokurorit, ashtu dhe të shkeljes së ligjit, i shërben njëkohësisht organit kompetent që fillon procedurat e shkarkimit për të dalluar këto veprime nga sjelljet e një kategorie më të lehtë, të cilat nuk mund të përdoren për të motivuar shkarkun e shkarkimit.*”. Në këtë mënyrë, kushtetutëbërësi, në përcaktimin e shkaqeve me vërtetimin e të cilave zbatohet direkt masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, e ka konsideruar nenin 140 si një dispozitë drejtpërdrejt të zbatueshme, në frymë dhe në harmoni me parashikimin e nenit 4, pika 3, të Kushtetutës.

32. Ankuesja parashtroi në ankim se ka pasur një motivim politik të procesit disiplinor dhe ecuria e tij në shqyrtimin pranë KLGj-së përmban dukshëm tharm politik dhe paragjykes. Sipas ankueses, vetë inspektimi i ILD-së ka pasur si shkak artikullimin në media të caktuara të shkrimeve kundër magjistrates, dhe shqyrtimi i çështjes në KLGj përkoi me arrestimin e magjistrates nga Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

32.1 KLGj-ja ka prapësuar në Kolegj se ky pretendim i magjistrates nuk mbështetet në asnjë provë dhe nuk ka asnjë bazë ligjore. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur shkarkimin nga detyra të magjistrates Enkeleida Hoxha, për shkelje disiplinore të kryera nga ana e saj dhe të parashikuara në nenin 140, pika 2, shkronja “a”, të Kushtetutës, pasi zhvilloi një procedurë disiplinore në përputhje me parimet e procesit të rregullt ligjor, duke zbatuar me përpikëri ligjet dhe aktet nënligjore që normojnë veprimtarinë e këtij institucioni.



32.2 Lidhur me këtë pretendim, në seancat publike në Kolegj, ILD-ja është shprehur se ka vendosur verifikimin e fakteve të bëra publike në media në lidhje me proceset gjyqësore, për sa u përket të dënuarve H. B. dhe I. P., duke kërkuar dhe administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë të dhëna dhe informacione shtesë sa u takon proceseve gjyqësore. Nga shqyrtimi i të dhënave, është krijuar dyshimi i arsyeshëm se magjistratja ka kryer shkelje të rënda profesionale, dhe ILD-ja ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë. Në momentin e nxjerrjes së vendimit për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë të ILD-së, nga Ministria e Drejtësisë nuk ishte paraqitur ende ankesë. Ndërkohë, gjatë zhvillimit të hetimit disiplinor nga ILD-ja, Ministria e Drejtësisë, me shkresën nr. {***} prot., datë 23.7.2020, ka përcjellë shqetësimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, dhe në vazhdim ILD-ja, me vendimin nr. {***}, datë 20.11.2020, ka vendosur bashkimin e procedimeve hetimore. ILD-ja ka theksuar se është e pajisur nga Kushtetuta dhe ligji me tagrat e nevojshme për kryerjen e një procesi të plotë, të gjithanshëm hetimi disiplinor, në funksion të respektimit të parimit të procesit të rregullt ligjor dhe se ka zhvilluar një hetim tërësisht të pavarur dhe të orientuar nga parimet, rregullat dhe detyrimet që sanksionon ligji për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

32.3 Lidhur me sa më sipër, Kolegji vlerëson se procesi i hetimit i zhvilluar në ILD është kryer brenda kompetencave të njohura nga Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi, duke respektuar dhe garantuar të drejtat procedurale të ankueses, të parashikuara në nenet 129–132, të ligjit 96/2016. Gjithashtu, Kolegji vlerëson se procedimi disiplinor i zhvilluar në KLGj dhe vendimmarrja përkatëse janë bazuar në fakte dhe prova konkrete, në vlerësimin e zbatimit të ligjit material dhe procedural në vendimet e marra prej ankueses Enkeleida Hoxha, si dhe në rëndësinë e shkeljeve të kryera prej saj.

33. Në përfundim, Kolegji vlerëson se pretendimet e paraqitura nga ankuesja për shkelje të procesit të rregullt gjatë fazave të hetimit dhe procedimit disiplinor, janë të pabazuara. Nga aktet e administruara në fashikull, provohet se magjistrates, sipas parashikimeve të legjislacionit në

fuqi, i janë komunikuar nga ILD-ja⁶⁴, aktet e nxjerra gjatë procesit të hetimit, si dhe i është dhënë mundësia të paraqesë shpjegime me shkrim dhe të depozitojë dokumente në lidhje me rezultatet e hetimit. Gjatë procedimit disiplinor të zhvilluar nga KLGj-ja, ankuesja ka realizuar të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur në seancat dëgjimore⁶⁵, ka paraqitur provat, si dhe i është dhënë koha e nevojshme për të përgatitur mbrojtjen dhe argumentet përkatëse. Gjithashtu, konstatohet se vendimi i KLGj-së paraqitet i plotë dhe i arsyetuar në të gjitha elementet, sipas parashikimeve të nenit 100 të Kodit të Procedurave Administrative.

B2. Lidhur me vendimmarrjen e KLGj-së

34. Ankuesja pretendon se KLGj-ja nuk ka analizuar shkelje disiplinore të gjyqtarës apo sjellje diskredituese të figurës dhe statusit të gjyqtarit, por në rastin e të dënuarit H. B. ka bërë një analizë të mirëfilltë të një gjykate më të lartë, lidhur me mënyrën si është zbatuar ligji.

35. Në prapësimet drejtuar Kolegjit, KLGj-ja shprehet se përkundër pretendimit të ankueses se normat e cituara nga KLGj-ja nuk analizojnë shkelje disiplinore të gjyqtarës apo sjellje diskredituese të figurës dhe statusit të gjyqtarit, por mbeten një analizë e mirëfilltë e një “gjykate më të lartë”, nuk qëndron, për sa kohë që në vendimmarrjen e saj KLGj-ja u ka bërë një analizë të mirëfilltë të gjitha pretendimeve, si të ILD-së, ashtu edhe të magjistrates, dhe evidentimin rast pas rasti të çdo shkeljeje të konstatuar të magjistrates. Në vendimin e arsyetuar gjenden të trajtuara të gjitha momentet e pretenduara si nga ILD-ja, ashtu dhe nga magjistratja apo përfaqësuesi i saj, dhe çdo vlerësim i KLGj-së lidhur me to.

36. Këtë shkak ankimi përgjithësues, Kolegji e vlerësoi rast pas rasti, duke analizuar çdo çështje dhe vendim gjyqësor të magjistrates që i është nënshtruar procedimit disiplinor. Nga shqyrtimi i vendimeve objekt procedimi disiplinor të magjistrates Enkeleida Hoxha, nga përmbajtja e vendimit nr. 92 të KLGj-së, si dhe nga shpjegimet e dhëna nga palët gjatë seancave publike, Kolegji vëren se:

⁶⁴ Me shkresat nr. {***} prot., datë 16.7.2020; nr. {***} prot., datë 11.11.2020 dhe nr. {***} prot., datë 20.11.2020.

⁶⁵ Seancat e datave 8.1.2021, 29.1.2021, 16.2.2021, 25.2.2021, 4.3.2021, 11.3.2021, 17.3.2021.



36.1 Me vendimin nr. {*}, datë 25.5.2017,** magjistratja, me kërkesë të të dënuarit H. B., ka vendosur:

“- *Pranimin e kërkesës së kërkuarit H. B.*

- *Uljen e dënimit për kërkuarin H. B. në masën 24 muaj, për periudhën nga data 14.10.2008 deri në datën 25.5.2017.”.*

36.1.1 Lidhur me këtë vendimarrje të magjistrates, KLGj-ja, pa mohuar të drejtën e të dënuarit për të përfituar ulje dënimi sipas nenit 63, të ligjit nr. 8328/1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, është shprehur në vendimin nr. 92 se: “*Këshilli vlerëson se i dënuari H. B. mund të bënte kërkesë për ulje dënimi vetëm për periudhën e dënimit të kryer pas datës 26.1.2016, ditë kur ai është vendosur në IEVP Fushë-Krujë duke plotësuar në mënyrë kumulative të gjitha kërkesat e parashikuara nga ligji nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, të cilin magjistratja Enkeleida Hoxha e ka injoruar në mënyrë të hapur. I ndodhur në këto rrethana, Këshilli e gjen të bazuar në nenin 140/2/a të Kushtetutës këtë kërkim të ILD-së, pasi shkelja e kryer nga magjistratja përbën një shkelje të rëndë profesionale që diskrediton pozitën dhe figurën e magjistratit gjatë ushtrimit të detyrës.”.*

36.1.2 Pretendimi i ankueses në ankimin e paraqitur në Kolegj, si dhe gjatë seancave publike, është se përfitimi 90 ditë për çdo vit burgimi të ekzekutuar në vendin e huaj, mbetet një e drejtë e pamohueshme dhe e realizueshme në moment ekzekutimi në territorin shqiptar dhe me retrospektivë. Vendimi, sipas ankueses, është marrë në shqyrtim të akteve të sjella nga pala kërkuar, duke marrë në konsideratë dokumentacionin e sjellë nga institucioni i ekzekutimit ku i dënuari vuante dënimin, raportin e sjellë nga Zyra Vendore e Shërbimit të Provës Krujë, dhe në mbështetje të dokumentacionit me të cilin kërkuar argumentonte apo parashtronte rrethanat apo kriteret e veçanta për të cilat kërkonte lirimin para kohe me kusht.

36.1.3 Nga aktet e depozituara, Kolegji konstaton se me vendim të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. {***}, datë 20.7.2016, është bërë njohja e vendimit penal të huaj nr. {***}, datë 14.10.2008, të Gjykatës së Kurorës Snaresbook, Angli, për të dënuarin H. B. dhe në bashkim të dënimeve është dënuar me 25 vite burgim. I dënuari H. B. është marrë në dorëzim nga autoritetet shqiptare tek ato

angleze, dhe është transferuar në IEVP Fushë-Krujë, më datë 27.1.2016.

36.1.4 Pas kërkesës së të dënuarit të datës 13.3.2017, magjistratja Enkeleida Hoxha, me vendimin nr. {***}, datë 25.5.2017, ka vendosur uljen e dënimit për ankuesin në masën 24 muaj, për periudhën nga data 14.10.2008 deri në datën 25.5.2017.

36.1.5 Magjistratja vendimin e ka bazuar në nenin 63, të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” (në vijim “ligji nr. 8328/1998”), në të cilin parashikohet se: “*Të dënuarit që zbatojnë rregullat dhe kanë një pjesëmarrje shembullore në veprimtaritë trajtuese, duke dhënë prova për riintegrim në shoqëri, mund të përfitojnë një ose disa ulje, deri 90 ditë në çdo vit të vuajtjes së dënimit.*

Në burgjet e sigurisë së lartë, ulja e dënimit bëhet deri 45 ditë në vit. Për dhënien e këtij shpërblimi të veçantë, vlerësohet qëndrimi i të dënuarit nga ulja e mëparshme ose gjatë 12 muajve të fundit. Ulja e dënimit bëhet me vendim të gjykatës, në bazë të kërkesës së të dënuarit apo përfaqësuesit të tij, ose të drejtorit të institucionit.”.

36.1.6 Kolegji konstaton nga aktet e administruara, se koha e vuajtur e dënimit nga i dënuari H. B., pranë IEVP Fushë-Krujë, është nga data 27.1.2016 deri në momentin e shqyrtimit të kërkesës së tij, të paraqitur më datë 13.3.2017, e në vazhdim. Kjo periudhë nuk përfshin të gjithë kohën e dënimit të ankuesit, i cili një pjesë të madhe të dënimit, nga data 14.10.2008 deri në datën 26.1.2016, e ka kryer në një shtet të huaj. Për këtë pjesë dënimi, që përbën edhe kohën më të gjatë të dënimit të kryer nga i dënuari H. B., gjyqtarja nuk ka pasur një vlerësim nga institucionet e shtetit të huaj lidhur me sjelljen dhe provat për riintegrim në shoqëri të të dënuarit, por ka marrë të mirëqena në mënyrë të njëanshme dhe është mjaftuar, siç citohet në vendimin nr. {***}, “*në akte dhe certifikime të marra nga ankuesi gjatë kohës së vuajtjes së dënimit në shtetin anglez, ku dokumentohet pjesëmarrja e tij në kurse profesionale dhe arsimore.”.*

36.1.7 Kolegji vlerëson se bazuar në nenin 63, të ligjit nr. 8328/1998, periudha e vetme për të cilën gjyqtarja duhej të vlerësonte dhe të vendoste për ulje dënimi, duhej të ishte periudha e vuajtjes së dënimit në IEVP Fushë-Krujë. Sipas kësaj dispozite, mund të përfitojnë ulje të dënimit të dënuarit që zbatojnë rregullat dhe kanë një pjesëmarrje shembullore në veprimtaritë trajtuese,



duke dhënë prova për riintegrim në shoqëri. Magjistratja, në pranimin e kërkesës për ulje dënimi, është bazuar vetëm në vlerësimin e sjelljes së bërë nga Komisioni i Vlerësimit pranë IEVP Fushë-Krujë, që është shprehur për pranimin e kërkesës së të dënuarit H. B., me objekt ulje dënimi. Për sa kohë që nuk ka pasur asnjë provë/dokument zyrtar për zbatimin e rregullave, sjelljen dhe qëndrimin e të dënuarit për periudhën e dënimit të kryer në shtetin e huaj, magjistratja mund të dispononte dhe të njihte të drejtën e përfitimit për ulje dënimi, vetëm për periudhën e kryerjes së dënimit në institucionet shqiptare të vuajtjes së dënimit, por gjithmonë në respektim, në mënyrë kumulative, të të gjitha kriterëve të parashikuara nga neni 63, i ligjit nr. 8328/1998.

36.1.8 Duke pasur në konsideratë parashikimin e nenit 63, të ligjit nr. 8328/1998, se dhënia e uljes së dënimit nga gjykata bëhet duke vlerësuar qëndrimin e të dënuarit nga ulja e mëparshme ose gjatë 12 muajve të fundit, i dënuari H. B. mund të përfitonte deri në 90 ditë ulje dënimi për periudhën kur ka vuajtur dënimin në IEVP Fushë-Krujë, dhe jo 24 muaj siç ka vendosur magjistratja.

36.1.9 Në përfundim, Kolegji konkludon se në dhënien e vendimit nr. {***}, datë 25.5.2017, magjistratja ka shkelur legjislacionin në fuqi, shoqëruar me pasojën e përfitimit të padrejtë të uljes së dënimit nga ana e të dënuarit, dhe vlerëson si të bazuar qëndrimin e Këshillit se magjistratja, bazuar në parashikimin e nenit 140, pika 2, shkronja “a”, të Kushtetutës, si dhe në interpretimin që i ka bërë këtij neni, Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 75/ 2002, nisur nga rëndësia e ligjit të shkelur, pasojat e ardhura, apo që mund të vinin nga shkelja, me frekuencën e shkeljes, kohëvazhdimin e pasojave dhe të vështirësive për riparimin e tyre, si dhe me qëndrimin subjektiv që mban autori i shkeljes kundrejt saj dhe pasojës së ardhur [...], ka kryer shkelje të rëndë profesionale dhe ka diskredituar pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës.

36.2 Me vendimin nr. {*} akti, datë 14.2.2018**, magjistratja Enkeleida Hoxha, pas kërkesës së të dënuarit H. B. të datës 10.1.2018, me objekt “Njohje e kohës së paraburgimit”, ka vendosur:

“- Pranimin e kërkesës së kërkuarit H. B.

- Njohjen e ditëve të paraburgimit për kërkuarin H. B. nga data e arrestimit të tij nga ana e autoriteteve angleze, më

datë 15.11.2007, deri kur vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë ka marrë formë të prerë në datën 20.7.2016 [...]”.

36.2.1 KLGj-ja, lidhur me këtë vendim të magjistrates, në vendimin nr. 92, datë 17.3.2021, ka konkluduar se: “56. Këshilli vlerëson se shkelja që ka bërë magjistratja në këtë rast është një shkelje shumë e rëndë gjatë kryerjes së detyrës, pasi sipas Konventës së Këshillit të Evropës “Për transferimin e personave të dënuar”, përlllogaritja e paraburgimit bëhet sipas ligjit të vendit pritës, pra sipas ligjit shqiptar, duke e përlllogaritur me një ditë e gjysmë kohën nga arrestimi/ndalimi i të pandehurit dhe derisa vendimi i Gjykatës së Kurorës së Mbretërisë së Bashkuar ka marrë formë të prerë, gjë të cilën e ka bërë organi i prokurorisë shqiptare në momentin që i dënuari ka ardhur në territorin e Republikës së Shqipërisë.

36.2.2 Këtë shkelje të gjyqtarës e ka pranuar edhe përfaqësuesi i saj në seancat dëgjimore të zhvilluara në KLGj, si dhe në ankimin drejtuar Kolegjit.

36.2.3 Në ankimin drejtuar Kolegjit, si dhe në parashtrimet gjatë seancave në Kolegji, nga ankuesja dhe përfaqësuesi i saj ligjor, pavarësisht se pranohet gabimi për njohjen si paraburgim për vitet e kryera të dënimit në Mbretërinë e Bashkuar, pretendohet se rasti i të dënuarit H. B. shoqërohet me një kompleksitet që prodhon një raport bashkëpunimi me Mbretërinë e Bashkuar, dhe që ka mundësuar gabime gjyqësore, që i dedikohet thelbësisht rregullimit të ndryshëm të lirit para kohe me kusht dhe pamundësimin të njohjes së vendimeve penale për shkak se marrëveshja e vitit 2013, e ratifikuar me ligjin nr. 98/2013, ka “ngrirë” së vepruari dhe ka prodhuar nënshkrimin e një akti të ri.

36.2.4 Lidhur me këtë pretendim, KLGj-ja prapëson se nuk qëndron dhe se shkelja që ka bërë magjistratja në këtë rast është vlerësuar nga KLGj-ja si një shkelje shumë e rëndë, pasi sipas Konventës së Këshillit të Evropës “Për transferimin e personave të dënuar”, përlllogaritja e paraburgimit bëhet sipas ligjit të vendit pritës, duke e përlllogaritur me një ditë e gjysmë kohën nga arrestimi/ndalimi i të pandehurit dhe derisa vendimi i gjykatës merr formë të prerë, në këtë rast deri kur vendimi i Gjykatës së Kurorës ka marrë formë të prerë. Kur njihet një vendim i një gjykate të huaj në vendin tonë, gjykata shqiptare nuk ka të drejtë të disponojë mbi atë që ka vendosur gjykata e huaj, por vetëm kontrollon kriteret ligjore të njohjes, dhe përshtat masën e dënimit që ka dhënë



gjykata e huaj me dënimin korrespondues që parashikon ligji shqiptar, dhe jo siç ka vepruar magjistratja në këtë rast, duke njohur periudhën e paraburgimit, në shkelje të Konventës së Këshillit të Evropës, të vendimit nr. {***}, datë 20.7.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë, dhe legjislacionit në fuqi.

36.2.5 Nga aktet e administruara, rezulton se, bazuar në nenin 57 të Kodit Penal, prokurori në urdhrin e ekzekutimit ka kryer përlllogaritjen e kohës së paraburgimit, si dhe të dënimit të kryer në shtetin e huaj, duke përcaktuar se të dënuarit i mbeteshin për të kryer edhe 16 vjet, 4 muaj dhe 3 ditë burgim. Urdhri i ekzekutimit ka qenë pjesë e dosjes së administruar nga magjistratja gjatë shqyrtimit të kërkesës së të dënuarit H. B.

36.2.6 Në arsyetimin e vendimit, magjistratja, pa bërë një analizë të kuadrit ligjor të legjislacionit të zbatueshëm për çështjen në shqyrtim, dhe pavarësisht përlllogaritjes së paraburgimit të kryer nga prokurori, i ka rinjohur të dënuarit H. B. kohën e burgimit në shtetin e huaj si kohë paraburgimi deri në dhënien e vendimit të njohjes së vendimit të huaj nga Gjykata e Apelit Tiranë.

36.2.7 Kolegji çmon se në shqyrtimin gjyqësor të kërkesës për njohjen e kohës së paraburgimit, dispozitat e zbatueshme që duhet të merreshin në konsideratë nga magjistratja, janë si vijojnë.

- Neni 9, i ligjit nr. 8499, datë 10.6.1999, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës Për transferimin e personave të dënuar”, në pikën 3 të të cilit parashikohet se: “3. Ekzekutimi i dënimit rregullohet nga ligji i shtetit zbatues dhe vetëm ai shtet është kompetent për të marrë të gjitha vendimet përkatëse [...]”.

- Neni 61, i ligjit 10193, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, që parashikon se: “[...] 2. Gjatë ekzekutimit, dënimi i dhënë me vendimin gjyqësor të huaj mund të ulet, falet ose amnistohet, sipas rregullave të legjislacionit shqiptar”.

- Nenet 438, 518 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilëve:

Neni 438 - “[...] 4. Vendimi i Kolegjit Penal dhe kolegjeve të bashkuara është i detyrueshëm për gjykatat në gjykimin e çështjeve të ngjashme”.

Neni 518 - “1. Pasi janë njohur vendimet penale të gjykatave të huaja ekzekutohen sipas ligjit shqiptar [...]”.

- Vendimi unifikues 154/2000, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në të cilin përcaktohet se:

“Për efekt të njësimt të praktikës gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara pranojnë se për të gjykuar [...] dhe në çdo rast, vendimi i gjykatës shqiptare nuk është një vendim i ri. Për këtë shkak, gjykata shqiptare nuk shqyrton çështjen në themel dhe as nuk verifikon provat e marra nga gjykata e huaj. Ajo verifikon nëse ekzistojnë kushtet për njohjen e vendimit të huaj dhe duhet t’i përgjigjet atij vendimi me një vendim që konverton dënimin e huaj me një dënim të parashikuar nga legjislacioni shqiptar, duke përcaktuar edhe dispozitat përkatëse të cilat aplikohen. E rëndësishme sipas Kolegjeve të Bashkuara, është të evidentohet fakti se është vendimi i huaj ai që vihet në ekzekutim nëpërmjet një vendimi njohës të gjykatës shqiptare.”.

36.2.8 Siç rezulton nga dispozitat e mësipërme, si dhe nga jurisprudenca e Gjykatës së Lartë, në rastin e të dënuarit H. B., Kolegji vëren se ligji i zbatueshëm për uljen e dënimit ka qenë ligji shqiptar, si ligji i shtetit që po ekzekutonte dënimin. Sipas akteve të administruara në fashikull, dënimi i H. B. nuk ka filluar me vendimin nr. {***}, datë 20.7.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë, por me vendimin e formës së prerë të Gjykatës së Mbretërisë së Bashkuar të datës 14.10.2008. Kolegji çmon se llogaritja e kohës së vuajtur të dënimit⁶⁶, para datës së transferimit në Shqipëri si kohë paraburgimi, është bërë në kundërshtim me nenin 518 të Kodit të Procedurës Penale dhe me vendimin unifikues 154/2000 të Gjykatës së Lartë, dhe se është i drejtë vlerësimi i KLGj-së, e cila lidhur me këtë vendimmarrje të magjistrates, është shprehur se: “57.1 Duhet të sqarohet se kur njihet një vendim i një gjykate të huaj në vendin tonë, gjykata shqiptare nuk ka të drejtë që të disponojë mbi atë që ka vendosur gjykata e huaj, por vetëm pasi kontrollon kriteret ligjore të njohjes, e përshtat masën e dënimit që ka dhënë gjykata e huaj me dënimin korrespondues që parashikon ligji shqiptar, dhe jo siç ka vepruar magjistratja Enkeleida Hoxha në këtë rast, kur konsideron se vendimi penal për të dënuarin H. B. ka marrë formë të prerë kur ka vendosur Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. {***}, datë 20.7.2016, veprim i cili është krejtësisht abuziv, pasi ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 14.10.2008, kur ai vuante dënimin me burgim në Mbretërinë e Bashkuar.”.

36.3 Me vendimin nr. {*} akti, datë 21.11.2018,** magjistratja Enkeleida Hoxha, pas

⁶⁶ Nga data 15.11.2007 deri në datën 20.7.2016.



kërkesës së të dënuarit H. B., të datës 4.7.2018, me objekt “Njohje amnistie”, ka vendosur:

“- *Pranimin e kërkesës së kërkuarit H. B.*

- *Njohjen e amnistisë për kërkuarin H. B. duke i ulur një vit nga dënimi sipas ligjit nr. 141/2016, “Për amnistinë”.*”

36.3.1 Lidhur me këtë vendim të magjistrates, KLGj-ja ka vlerësuar se: “64. *Vendimi nr. {***} akti, datë 21.11.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë është dhënë në shkelje të parashikimeve të nenit 5, të ligjit nr. 141/2016, “Për amnistinë”, i cili parashikon shprehimisht se: ‘Të gjithë personat e dënuar, të cilët nuk përfitojnë nga parashikimi i nenit 3 të këtij ligji, pavarësisht nga kriteret ndaluese të nenit 4, lirohen nëse u kanë mbetur pa vuajtur nga dënimi i dhënë: [...] b) deri në 1 vit për personat e dënuar burra’.*

65. *Nga dokumentacioni i verifikuar, del qartë se në kohën e amnistisë i dënuari H. B. ka pasur më shumë se një vit nga dënimi i pavuajtur, prandaj nuk gjen zbatim parashikimi i nenit 5, të ligjit nr. 141/2016, “Për amnistinë”. Por duhet thënë që ligji që cituam, megjithëse ka kriteret ndaluese për veprat penale, për të cilat është dënuar ankuesi H. B., në nenin 5 të tij ai i jep kësaj kategorie të dënuarish të drejtën se, kur ata kanë deri në një vit burgim, duhet të lirohen nga burgju. Pra, vetë ligji i amnistisë nuk është kategorikisht ndalues për personat e dënuar për vepra penale të tilla, por përfitim të tyre nga amnistia e lidh me kohën e pavuajtur të dënimit, gjë e cila e ul edhe rëndësinë e shkeljes disiplinore të bërë nga magjistratja, për sa i përket kësaj çështjeje.”*

36.3.2 Për sa i përket pretendimit të ankueses në ankimin drejtuar Kolegjit, se neni 4 i ligjit për amnistinë i vitit 2016, është shkruar jo qartë, KLGj-ja prapëson se nuk qëndron për sa kohë që kjo dispozitë ka një përmbajtje të drejtpërdrejtë dhe lehtësisht të kuptueshme, dhe përvoja e gjatë profesionale në detyrë e magjistrates e lejon të interpretojë dhe zbatojë drejt këto dispozita ligjore.

36.3.3 Shkelja e magjistrates në zbatimin e ligjit nr. 141/2016, “Për amnistinë”, është pranuar nga përfaqësuesi i saj në seancat dëgjimore të zhvilluara në KLGj, si dhe në ankimin drejtuar Kolegjit.

36.3.4 Kolegji, nga aktet e depozituara, konstaton se sipas vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. {***}, datë 20.7.2016, me të cilin është bërë njohja e vendimit penal të huaj nr. {***}, datë 14.10.2008, të Gjykatës së Kurorës Snaresbook Angli, rezulton se i dënuari H. B. është dënuar për veprën penale të vrasjes, të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, për

veprën penale të vrasjes së mbetur në tentativë, parashikuar në nenet 76 e 23 të Kodit Penal dhe për veprën penale të plagosjes së rëndë me dashje, të parashikuar nga neni 88/1 i Kodit Penal.

36.3.5 Ligji nr. 141/2016, “Për amnistinë”, sipas të cilit ka disponuar në vendim magjistratja, parashikonte:

“Neni 4

Kriteri ndalues për përfitim të amnistisë

1. *Pavarësisht nga parashikimet e nenit 3, nuk përfitojnë nga kjo amnisti personat e dënuar për:*

a) *krime kundër njerëzimit, të parashikuara në nenet 73, 74, 74/a e 75, të Kodit Penal;*

b) *krime kundër jetës, të kryera me dashje, të parashikuara në nenet 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c, 81, 82, 83/a, 83/b e 84/a, të Kodit Penal, si dhe në nenin 77 të Kodit Penal Ushtarak;*

c) *vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit, të parashikuara në nenet 86, 87, 88, 89/a e 99, të Kodit Penal [...]”.*

36.3.6 Nga dispozita e mësipërme, si dhe referuar vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. {***}, datë 20.7.2016, rezulton se ankuesi H. B. nuk mund të ishte përfitues nga amnistia, pasi ai ishte i dënuar për veprat penale të “vrasjes me dashje”, “vrasjes me dashje të mbetur në tentativë” dhe “plagosjes së rëndë me dashje”, të parashikuara në nenet 76, 76–23, si dhe 88 të Kodit Penal, dhe që përbëjnë kriter ndalues për përfitim nga amnistia.

36.3.7 Ligji për amnistinë 141/2016, në nenin 5 ka parashikuar lehtësi edhe për personat e dënuar të cilët hyjnë në kategoritë e përcaktuara në nenin 4, por këtë përfitim e ka lidhur me kohën e mbetur të dënimit, duke përcaktuar se: “1. *Të gjithë personat e dënuar, të cilët nuk përfitojnë nga parashikimi i nenit 3 të këtij ligji, pavarësisht nga kriteret ndaluese të nenit 4, lirohen nëse u kanë mbetur pa vuajtur nga dënimi i dhënë:*

a) *deri në 2 vjet për të dënuarat gra apo personat që në kohën e kryerjes së veprës penale kanë qenë të mitur;*

b) *deri në 1 vit për personat e dënuar burra.”.*

36.3.8 Në analizë të dispozitave të mësipërme, të rrethanave konkrete të vendimit të formës së prerë për njohjen e dënimit të H. B., si dhe të periudhës që atij i mbetej për të vuajtur dënimin, sipas raportit për dinamikën e vuajtjes së dënimit të IEVP Fushë-Krujë, Kolegji vlerëson se magjistratja ka vendosur në kundërshtim me parashikimet e nenit 5, të ligjit nr. 141/2016, “Për amnistinë”.



36.3.9 Nga vendimi nr. {***} akti, datë 21.11.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, sipas dinamikës së vuajtjes së dënimit të datës 23.7.2018, rezulton se në kohën e paraqitjes së kërkesës për njohje amnistie, ankuesit i kishin mbetur 7 vjet, 7 muaj dhe 6 ditë burgim, pra më shumë se 1 vit që parashikon neni 5, i ligjit nr. 141/2016, “Për amnistinë”, për të përfutur personat që i nënshtrohen kriterit ndalues sipas nenit 4 të ligjit.

36.3.10 Kolegji tërheq vëmendjen në faktin se magjistratja ka kryer shkelje të dy dispozitave të ligjit nr. 141/2016, të nenit 4, lidhur me kriteret ndaluese për të përfutur nga amnistia, dhe të nenit 5, për përfutimin në varësi të kohës së mbetur të dënimit. Pavarësisht se me parashikimet në nenin 5, zbutet efekti ndalues i nenit 4, të ligjit nr. 141/2016, magjistratja ka vazhduar edhe me moszbatimin korrekt të nenit 5, duke i dhënë një përfutim të padrejtë të dënuarit, i cili nuk përfshihej në kategoritë përfutuese sipas këtij neni. Ky qëndrim i mbajtur nga magjistratja, përbën një shkelje të rëndë të ligjit nga ana e saj, dhe vlerësimi i KLGj-së për një ulje të rëndësishme të shkeljes disiplinore, në këtë rast nuk qëndron.

36.4 Me vendimin nr. {*}, datë 18.1.2019,** magjistratja Enkeleida Hoxha, pas kërkesës së të dënuarit H. B. të datës 8.1.2019, me objekt “Ulje e dënimit për 90 ditë”, ka vendosur:

“Pranimin e kërkesës së kërkuarit H. B.;

- Uljen e dënimit për kërkuarin H. B. në masën 90 (nëntëdhjetë) ditë, për periudhën kohore, vitin 2007.”.

36.4.1 Për këtë vendim të magjistrates, KLGj-ja, në vendimin nr. 92, datë 17.3.2021, ka mbajtur qëndrimin se: “60. Ky disponim i magjistrates jo vetëm është në kundërshtim me parashikimet e ligjit që cituam më sipër, por edhe me parashikimet e nenit 57 të Kodit Penal, neneve 438, 518, pika 1, dhe nenit 3, të Kodit të Procedurës Penale; nenit 9, pika 3, e ligjit nr. 8499, datë 10.6.1999, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për transferimin e personave të dënuar”, nenit 52, paragrafi 2, i ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale” dhe vendimit unifikues 154/2000, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë [...]. 61. Ulja e dënimit është bërë për një periudhë kur ai nuk ka qenë i paraburgosur, ose nuk ka pasur cilësinë e të dënuarit, por atë të të pandehurit, çka do ta bënte këtë veprim të magjistrates një veprim në kundërshtim të hapur me kërkesat e ligjit nr. 8328, “Për të drejtat dhe trajtimin e

të dënuarve”, duke sjellë për rrjedhojë përfutime të padrejta për të dënuarin H. B.”.

36.4.2 Nga aktet e depozituara, Kolegji konstaton se, sipas vendimit të mësipërm të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, kërkuari H. B. ka kërkuar ulje dënimi për periudhën kohore nga data e arrestimit nga autoritetet daneze, 4.9.2007 deri në datën 14.11.2007, datë kur është transferuar në shtetin anglez, që i është njohur si kohë paraburgimi⁶⁷ para dënimit të tij, me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Mbretërisë së Bashkuar, të datës 14.10.2008.

36.4.3 Magjistratja ka vendosur pranimin e kërkesës me argumentimin se i dënuari H. B. plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 63 e vijues, të ligjit nr. 8328/1998, në të cilin është parashikuar se:

“Të dënuarit që zbatojnë rregullat dhe kanë një pjesëmarrje shembullore në veprimtaritë trajtuese, duke dhënë prova për riintegrim në shoqëri, mund të përfutojnë një ose disa ulje, deri 90 ditë në çdo vit të vuajtjes së dënimit. Në burgjet e sigurisë së lartë, ulja e dënimit bëhet deri 45 ditë në vit. Për dhënien e këtij shpërblimi të veçantë, vlerësohet qëndrimi i të dënuarit nga ulja e mëparshme ose gjatë 12 muajve të fundit [...]”.

Në arsyetimin e vendimit, magjistratja shprehet se në bazë të vlerësimit të sjelljes, dërguar nga IEVP Fushë-Krujë, rezulton se kërkuari H. B. ka respektuar me korrektësi rregulloren dhe nuk ka asnjë masë disiplinore.

36.4.4 Kolegji vlerëson se magjistratja në dhënien e vendimit nr. {***}, datë 18.1.2019, ka zbatuar gabim dispozitën ligjore së cilës i është referuar. Neni 63, i ligjit nr. 8328/1998, flet për të dënuarit që mund të përfutojnë ulje dënimi, ndërkohë që ankuesi H. B., për periudhën nga data 4.9.2007 deri në datën 14.11.2007, për të cilën ka kërkuar ulje dënimi, nuk ka qenë i dënuar dhe statusin e të dënuarit e ka marrë me vendimin e formës së prerë të Gjykatës së Mbretërisë së Bashkuar të datës 14.10.2008. Gjithashtu, për periudhën për të cilën ka disponuar dhe ka konsideruar gjyqtarja si periudhë dënimi, rezulton se nuk ka asnjë dokument që, sipas kërkesave të nenit 63, të ligjit nr. 8328/1998, të vërtetojë se i dënuari ka zbatuar rregullat, ka pasur pjesëmarrje në veprimtaritë trajnuese apo të ketë dhënë prova

⁶⁷ Me vendimin nr. {***} akti, datë 3.5.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.



për riintegrim në shoqëri, mbi bazën e të cilave mund të përfitonte ulje dënimi.

36.4.5 Kolegji konstaton se në këtë vendim, magjistratja nuk ka respektuar parashikimet e nenit 57 të Kodit Penal; neneve 438 dhe 518, pikat 1 dhe 3, të Kodit të Procedurës Penale; nenit 9, pika 3, të ligjit nr. 8499, datë 10.6.1999, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës ‘Për transferimin e personave të dënuar’”; nenit 52, paragrafi 2, i ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, si dhe vendimit unifikues nr. 154/2000, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilat janë të detyrueshme për zbatim në rastet e ekzekutimit të një vendimi penal të huaj që është njohur nga gjykatat shqiptare.

36.5 Me vendimin nr. {*}, datë 22.2.2019,** magjistratja Enkeleida Hoxha, pas kërkesës së të dënuarit H. B., me objekt “Lirim me kusht”, ka vendosur:

– *Pranimin e kërkesës së kërkuarit (të dënuarit) H. B.*

– *Lirimin me kusht të kërkuarit (të dënuarit) H. B., për dënimin e mbetur të pavuajtur prej pesë vjet, dy muaj e njëmbëdhjetë ditë, për një kohë prove prej pesë vjetësh [...].”*

36.5.1 Në vendimin nr. 92, lidhur me këtë vendim të ankueses, KLGj-ja shprehet se: “73. Në vendimin nr. {***} akti, datë 22.2.2019, me objekt lirim para kohe me kusht, magjistratja nuk ka mbajtur parasysh asnjë kërkesë të parashikuar nga neni 64 i Kodit Penal, i cili në mënyrë urdhërore ndalon përfshirjen e kohës së përfutur me amnisti në përllogaritjen e dënimit për të përfutur nga instituti i lirit me kusht. Gjithashtu, ajo ka injoruar edhe vendimin unifikues nr. 2/2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në lidhje me arsyen e veçantë, që në këtë rast nuk ekziston. Rehabilitimi i të dënuarit nuk lidhet vetëm me mungesën e masave disiplinore për një periudhë kaq të shkurtër kohe, por sjellja e tij duhet të jetë shembullore që nga dita kur vendimi penal ka marrë formë të prerë dhe deri në kohën kur gjykata disponon me vendim për kërkesën me objekt lirim para kohe me kusht [...].”

36.5.2 Ky qëndrim i KLGj-së vjen pas konstatimit se magjistratja, në vendimin nr. {***}, datë 22.2.2019, në pranimin e kërkesës për lirim me kusht të të dënuarit H. B., është bazuar në raportin e vlerësimit të IEVP Fushë-Krujë, për periudhën nga data 26.1.2016, kur është vendosur në këtë institucion pas transferimit nga Mbretëria e Bashkuar, deri në datën 16.1.2019, pra për një periudhë shumë të shkurtër në raport me kohën e vuajtur në dënim nga ankuesi.

36.5.3 Sipas vlerësimit të KLGj-së, në këtë vendim, magjistratja nuk ka marrë në konsideratë vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 2/2015, lidhur me çështjet e nevojshme që gjykatat duhet të vlerësojnë në shqyrtimet e kërkesave me objekt lirim me kusht.

36.5.4 Kolegji konstaton se magjistratja e ka bazuar vendimin për lirimin e të dënuarit H. B. në nenin 64 të Kodit Penal, i cili parashikon: “I dënuari me burgim mund të lirohet me kusht, nga vuajtja e dënimit vetëm për arsye të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij, si dhe të ketë vuajtur:

– jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale;

– jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim;

– jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji, me përjashtim të parashikimeve në paragrafin 3 të këtij neni.

Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfutur me amnisti ose falje.”

36.5.5 Nga vendimi i mëparshëm i magjistrates nr. {***} akti, datë 21.11.2018, rezulton se ankuesi H. B., sipas dinamikës së vuajtjes së dënimit datë 23.7.2018 të paraqitur nga IEVP Fushë-Krujë, ka vuajtur gjithsej nga dënimin i dhënë 17 vjet, 4 muaj e 24 ditë burgim.

Në arsyetimin e vendimit nr. {***}, datë 22.2.2019, magjistratja ka argumentuar se, sipas dinamikës së vuajtjes së dënimit datë 24.1.2019, ankuesi H. B. ka vuajtur gjithsej 19 vjet, 5 muaj e 19 ditë burgim. Nga kjo llogaritje, rezulton se magjistratja ka llogaritur në kohën e vuajtjes së dënimit edhe një vit dënim që i dënuari ka përfutur me amnisti, me vendimin nr. {***}, datë 21.11.2018, në kundërshtim me parashikimin e paragrafit të dytë, të nenit 64 të Kodit Penal, sipas të cilit në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfutur me amnisti ose falje. Këtë periudhë të vuajtur dënim, magjistratja e ka konsideruar në plotësim të kriterit “jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë”, parashikuar në paragrafin e parë të nenit 64 të Kodit Penal.

36.5.6 Kolegji konstaton se në argumentimin e vendimit, magjistratja i ka dhënë rëndësi dhe ka konsideruar si “arsye të veçanta” gjendjen ekonomike dhe shëndetësore të prindërve të të dënuarit, në kundërshtim me përcaktimin e vendimit unifikues



nr. 2/2015, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit: “Në shumë çështje gjyqësore me objekt lirim me kusht, janë pretenduar si “arsye të veçanta” rrethana të tilla si për shembull: gjendja familjare e rënduar e të dënuarit, sëmundja e rëndë e prindërve apo e të afërmeve të tjerë, apo qenia me fëmijë të mitur dhe me bashkëshortë në ngarkesë të të dënuarit. Në vlerësimin e Kolegjeve të Bashkuara, kjo qasje është e papranueshme dhe e gabuar. Kjo pasi në interpretimin që i kanë bërë shprehjes “arsye të veçanta”, gjykatat më të ulëta efektivisht kanë shtuar me pa të drejtë një kriter të jashtëm të paparashikuar nga ligji si kusht ndalues për efekt të pranimit të kërkesës për lirim me kusht. Megjithatë, siç edhe do të sqarohet më poshtë, Kolegjet vlerësojnë se rrethanat që kanë të bëjnë me familjarët e të dënuarit, mund të merren parasysh nga ana e gjykatave, jo si kusht thelbësor, por si rrethanë që shkon në favor të kërkesës për lirim me kusht, në drejtim të analizës së gjykatës për riintegrimin e plotë të të dënuarit pas lirimit.”.

36.5.7 Gjithashtu, Kolegji vëren se magjistratja, në vlerësimin dhe pranimin e kërkesës për lirim me kusht, nuk ka mbajtur në konsideratë natyrën e veprës penale të kryer, si dhe qëndrimin e personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës. Këto elemente janë konsideruar në vendimin unifikues nr. 2/2015, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë si thelbësore në vlerësimin që gjykatat duhet të bëjnë në shqyrtimet e kërkesave me objekt lirim me kusht.

36.5.8 Për sa më sipër, Kolegji duke konstatuar shkeljen nga magjistratja të legjislacionit në fuqi, konkretisht nenit 64 të Kodit Penal dhe vendimit unifikues nr. 2/2015, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në dhënien e vendimit nr. {***}, datë 22.2.2019, vlerëson të drejtë qëndrimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili ka konkluduar se në dhënien e vendimit nr. {***} akti, datë 22.2.2019, me objekt lirim para kohe me kusht të të dënuarit H. B. nga ana e magjistrates Enkeleida Hoxha, konstatohen shkelje shumë të rënda të ligjit material penal.

37. Në vlerësim të pretendimit të ankueses se KLGj-ja ka bërë një analizë të mirëfilltë të një gjykate më të lartë, Kolegji çmon se gjatë procedimit disiplinor ndaj magjistrates dhe në vendimin nr. 92, datë 17.3.2021, KLGj-ja ka trajtuar vetëm mënyrën e zbatimit të ligjit nga ana e gjyqtare, e konkretisht: zbatimin e nenit 63, të ligjit nr. 8328/1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të

dënuarve me burgim”, neneve 57, 64 të Kodit Penal, neneve 438, 518, pika 1, dhe nenit 3, të Kodit të Procedurës Penale, nenit 9, pika 3, të ligjit nr. 8499, datë 10.6.1999, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës ‘Për transferimin e personave të dënuar’”, nenit 52, paragrafi 2, të ligjit nr. 83331, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, si dhe të vendimeve unifikuese nr. 154/2000 dhe nr. 2/2015, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

37.1 Kolegji, në analizë të këtij pretendimi të ankueses, referuar përmbajtjes së vendimit nr. 92, datë 17.3.2021, të KLGj-së dhe të vendimeve objekt shqyrtimi, në lidhje me të dënuarin H. B., vlerëson se KLGj-ja, në përmbushje të funksioneve sipas legjislacionit në fuqi, është fokusuar vetëm në evidentimin dhe vlerësimin e shkeljeve profesionale të kryera nga magjistratja Enkeleida Hoxha në disa vendime të saj si gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

37.2 Këtë diskrecion të organit procedues disiplinor e ka njohur dhe Gjykata Kushtetuese, e cila në vendimin nr. 29/2001, është shprehur: “Vendimet gjyqësore të formës së prerë, për çështjen konkrete që zgjidhin, kanë fuqinë e ligjit. Kjo do të thotë se për sa kohë ato nuk janë prishur ose ndryshuar nga një gjykatë më e lartë, asnjë organ tjetër shtetëror nuk mund të mos përfillojë përmbajtjen e tyre dhe të ngarkojë me përgjegjësi gjyqtarin e çështjes. Megjithatë, problemi ndryshon në rastet kur këto vendime janë shoqëruar me shkelje që diskreditojnë rëndë pozitën ose figurën e gjyqtarit dhe që cenojnë në përgjithësi prestigjin dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor. Në raste të tilla, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka kompetenca të plota të marrë çdo lloj mase disiplinore ndaj gjyqtarëve, pa e kondicionuar atë, me faktin nëse kjo kategori vendimesh kanë marrë formë të prerë dhe kanë fituar kështu autoritetin e gjësë së gjykuar.”.

37.3 Kolegji vlerëson se KLGj-ja, në dhënien e vendimit nr. 92, datë 17.3.2021, nuk ka zëvendësuar vlerësimin dhe bindjen e gjyqtarit për zgjidhjen e çështjes. Vendimet të cilat kanë qenë objekt shqyrtimi në KLGj, rezultojnë se janë marrë haptazi në kundërshtim të ligjit, si dhe në të paktën dy raste në kundërshtim me vendimet unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Shkeljet e ankueses janë të dukshme, dhe për koncepte dhe institute të së drejtës që nuk mund të keqinterpretoheshin nga një gjyqtare me eksperiencën e saj. Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 17/2004, thekson se gjyqtari nuk



mund të shkarkohet nga detyra për mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, por këtë pavarësi të bindjes së brendshme të gjyqtarit e kushtëzon për sa kohë që nga rrethanat objektive dhe subjektive, nuk rezulton se veprimet e tij mund të kenë qenë të qëllimshme dhe në kundërshtim të hapur dhe flagrant me ligjin apo me praktikatat unifikuese të gjykatave më të larta.

38. Ankuesja pretendon se KLGj-ja ka mbajtur qëndrime të ndryshme për dy rastet e gjykuara nga magjistratja. Këshilli, në rastin e të dënuarit H. B., ka shqyrtuar mënyrën e zbatimit të ligjit procedural dhe material nga ana e magjistrates, edhe pse këtë tagër ia përjashtoi vetes në rastin e të dënuarit I. P. Sipas ankueses, arsyetimi i bërë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për rastin e të dënuarit I. P. duhet të jetë i njëjtë edhe për rastin e të dënuarit H. B., pasi statusi i të dyja dosjeve është formë e prerë me vendimin e shkallës së parë dhe pa ankim.

38.1 Lidhur me këtë pretendim të ankueses, nga vendimi nr. 92 i KLGj-së, rezulton se:

“45. Këshilli vlerëson se shqyrtimi i faktit se, nëse një gjykatë nuk ka marrë një provë vendimtare ka të bëjë me mënyrën e zgjidhjes së çështjes, e cila është vetëm në kompetencën e një gjykate më të lartë, së cilës ligji i jep të drejtën që të shqyrtojë ankimin e bërë kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Neni 178/1 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: “Eksperimentimi lejohet kur është i nevojshëm zhvillimi i kërkimeve ose marrja e të dhënave ose e vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, shkencore ose kulturore [...], pra sipas ligjit del e qartë që gjykata lejohet që të vendosë kryerjen e tij, konkluzionet e të cilat mund të mos merren parasysh nga gjykata, me kusht që kjo e fundit të argumentojë qëndrimin e saj.”.

38.2 Kolegji vëren se KLGj-ja, lidhur me këtë pretendim të ankueses, ka prapësuar, ashtu si dhe është shprehur në vendimin nr. 92, se shqyrtimi i faktit nëse një gjykatë nuk ka marrë një provë vendimtare, ka të bëjë me mënyrën e zgjidhjes së çështjes e cila është vetëm në kompetencën e një gjykate më të lartë, së cilës ligji i jep të drejtën që të shqyrtojë ankimin e bërë kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Kjo situatë nuk është në rastin tjetër, rastin e të dënuarit H. B., që do të detyronte KLGj-në të mbante të njëjtin qëndrim. Sipas KLGj-së, shkeljet e magjistrates në vendimet e mësipërme, lidhen me shpërfilljen haptazi prej saj të normave urdhëruese të ligjit material e procedural, shkelje të cilat janë të dukshme, që

lidhen me koncepte e institute të së drejtës penale e procedurale, dhe që rezultojnë si të tilla pa qenë e nevojshme të konstatohen nga vendimarrja e një gjykate më të lartë.

39. Lidhur me pretendimin se vendimarrja për lirimin e të dënuarit H. B. nuk është ankimuar dhe nuk ka një vendim të një shkalle më të lartë që të jetë shprehur nëse është shkelur ligji material apo procedural i saj, Kolegji vlerëson se në procedimin disiplinor ndaj magjistrates, të kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, janë marrë në shqyrtim dhe janë evidentuar shkeljet profesionale të kryera nga magjistratja në disa vendime të saj, lidhur me të dënuarin H. B. Mungesa e ankimit për këto vendime, nuk e përjashton apo e lehtëson përgjegjësinë e magjistrates për shkeljet e kryera, por mbetet një vlerësim që duhet bërë për veprimtarinë e pjesëmarrësve të tjerë në proceset gjyqësore, që nuk është objekt shqyrtimi nga KLGj-ja.

40. Ankuesja Enkeleida Hoxha ka parashtuar në ankim se vendimi për lirimin me kusht të të dënuarit H. B., nuk është shoqëruar me asnjë veprimtari të paligjshme të tij, dhe vrasja e tij nuk mund të konsiderohet si pasojë e vendimit për lirimin para kohe të tij.

40.1 Lidhur me këtë pretendim të ankueses, konstatohet se në vendimin nr. 92, në analizën e pasojës së ardhur si rezultat i shkeljeve të magjistrates, KLGj-ja është shprehur se: “79 [...] lirimet e pamërituara me kusht të personave që kanë kryer vepra shumë të rënda penale dhe që kanë rrezikshmëri të lartë shoqërore, ndikojnë shumë në ndjeshmërinë e publikut, duke u bërë shtrat edhe për kultivimin e ndjenjës së hakmarrjes dhe vetëgjyqësisë, sipas parimit të talonit [...]”. Qëndrimi i Këshillit është si pasojë direkte e vendimeve të magjistrates, ka qenë edhe rënia e besimit në sistemin e drejtësisë, që ka sjellë “kultivimin e ndjenjës së hakmarrjes dhe vetëgjyqësisë”.

40.2 KLGj-ja ka mbajtur të njëjtin qëndrim gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, duke parashtuar se ushtrimi i parregullt i detyrës nga magjistratja Enkeleida Hoxha ka sjellë pasojë për dhënien e drejtësisë, në një moment kur çdo gjyqtar i sistemit të drejtësisë duhet të bëjë të kundërtën. Referuar “teorisë së dukjes”, sjellje të caktuara të gjyqtarit konsiderohen si cenim i besimit të publikut te drejtësia.



40.3 Sipas prapësimeve të ILD-së drejtuar Kolegjit, shkeljet disiplinore të kryera nga ankuesja kanë sjellë pasoja, jo vetëm në cenimin e imazhit të gjyqtarit dhe humbjen e besimit ndaj tij, por kanë cenuar edhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Besimi i publikut nuk është nocion i papërkufizuar, pasi gjen mbështetje te vlerat themelore dhe standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së magistratëve, sipas përcaktimeve të neneve 3 dhe 4, të ligjit 96/2016. Në nenin 3, pika 5 e këtij ligji është parashikuar se sjellja e magistratit është e lidhur me garantimin e ruajtjes e forcimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Sipas ILD-së, vendimmarrja e gjyqtarës në rastin e të dënuarit H. B., solli një pasojë të rëndë, shmangien e të dënuarit me burgim të përjetshëm të caktuar nga autoritetet e huaja, i njohur nga autoriteti gjyqësor vendas me konvertimin e tij në 25 vite burgim, e që në vijim u pasua me vuajtjen e vetëm 3 viteve burgim, ka sjellë si pasojë diskreditimin e figurës së gjyqtarit shqiptar edhe në raport me autoritetet gjyqësore homologe të shtetit anglez.

40.4 Kolegji, lidhur me sa më sipër, vlerëson se është i pabazuar pretendimi i ankuses se vendimmarrja e saj nuk ka sjellë pasoja. Sipas parimit të integritetit, një prej Primeve të Bangalores mbi sjelljen gjyqësore të vitit 2002, gjyqtari duhet të sigurojë që sjellja e tij të jetë e paqortueshme nga këndvështrimi i një vëzhguesi të arsyeshëm dhe mënyra e sjelljes duhet të ripohojë besimin e njerëzve tek integriteti i gjyqësorit. Drejtësia, theksohet në Parimet e Bangalores, duhet *jo vetëm të jepet, por edhe të shihet se jepet*. Funkcioni i gjyqtarit është mjaft i rëndësishëm në dhënien e një drejtësie të paanshme dhe të pavarur dhe, si i tillë, mund të ushtrohet vetëm në kushtet e besimit që ai reflekton te publiku. Sipas vendimmarrjes së gjyqtarit, publiku i gjerë njihet me mënyrën e administrimit të drejtësisë nga gjykatat, duke ushtruar kontrollin e tij mbi respektimin e parimit të shtetit të së drejtës. Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit dhe besimi i publikut në të janë të lidhura ngushtë në çdo shoqëri demokratike. Dhënia e vendimeve haptazi në kundërshtim me ligjin, që sjellin perceptimin e publikut se drejtësia nuk po bëhet, ndikojnë në sistemin gjyqësor në tërësi dhe, rrjedhimisht, edhe në vetë besimin që publiku vendos në të. Në këtë rast, sillen në vëmendje dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, e cila në

vendimin nr. 11/2008, është shprehur se: “*Rrjedhoja më e rëndësishme e parimit të pavarësisë së gjyqtarëve është mospërgjegjësia për vendimet që japin sipas bindjes së tyre, mbështetur në Kushtetutë dhe në ligje. Megjithatë, pasoja e pushtetit dhe besimi që shoqëria u jep gjyqtarëve, është e tillë që duhet të ketë disa mënyra për t’i mbajtur gjyqtarët përgjegjës, përfshi edhe largimin nga detyra, në rast të shkeljeve që justifikojnë këtë veprim.*”.

41. Në përfundim, në përmbledhje të të gjitha argumenteve të mësipërme, Kolegji konstaton se ankuesja Enkeleida Hoxha, në vendimet objekt procedimi disiplinor:

- ka shkelur parashikimet e paragrafit të parë dhe të dytë, të nenit 64 të Kodit Penal, sipas të cilëve i dënuari mund të lirohet me kusht, nga vuajtja e dënimit vetëm për arsye të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij, të ketë vuajtur jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet dhe që në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose falje;

- nuk ka respektuar parashikimet e nenit 57 të Kodit Penal, për llogaritjen e paraburgimit;

- nuk ka respektuar kërkesat e neneve 4 dhe 5, të ligjit nr. 141/2016, “Për amnistinë”, për kriteret ndaluese për përfitimin e amnistisë;

- nuk ka zbatuar drejt parashikimet e nenit 63 e vijues, të ligjit nr. 8328/1998, sipas të cilit vetëm të dënuarit që zbatojnë rregullat dhe kanë një pjesëmarrje shembullore në veprimtaritë trajtuese, duke dhënë prova për riintegrim në shoqëri, mund të përfitojnë një ose disa ulje, deri 90 ditë në çdo vit të vuajtjes së dënimit;

- nuk ka zbatuar drejt parashikimet e nenit 9, pika 3, të ligjit nr. 8499, datë 10.6.1999, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës ‘Për transferimin e personave të dënuar’”, sipas të cilit ekzekutimi i dënimit rregullohet nga ligji i shtetit zbatues dhe vetëm ai shtet është kompetent për të marrë të gjitha vendimet përkatëse;

- nuk ka respektuar parashikimet e nenit 61, të ligjit nr. 10193, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, sipas të cilit, gjatë ekzekutimit, dënimi i dhënë me vendimin gjyqësor të huaj mund të ulet, falet ose amnistohet, sipas rregullave të legjislacionit shqiptar;

- nuk ka respektuar kërkesat e nenit 438 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit vendimet



e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë të detyrueshme për gjykatat në gjykimin e çështjeve;

- nuk ka respektuar kërkesat e nenit 518, të Kodit të Procedurës Penale, për ekzekutimin e vendimit të huaj;

- nuk ka zbatuar vendimin unifikues nr. 2/2015, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, lidhur me kuptimin dhe zbatimin në praktikë të shprehjes “arsye të veçanta”, të parashikuar në nenin 64 të Kodit Penal;

- nuk ka zbatuar vendimin unifikues nr. 154/2000, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për njohjen e vendimeve të huaja nga gjykatat shqiptare.

42. Kolegji vëren se shkeljet e mësipërme të magjistrates, për vetë natyrën dhe pasojat që kanë sjellë, janë konsideruar shkelje të rënda, në analizën që KLGj-ja ka bërë mbështetur në kriteret e nenit 115, pika 1, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ku përcaktohen si kriteret për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore, midis të tjerave:

a) lloji dhe rrethanat e shkeljes;

b) shkalla e fajësisë dhe motivi;

c) pasojat e shkeljes;

ç) të dhënat profesionale, të çështjeve disiplinore dhe të dhëna kriminale të magjistratit;

d) masën e ndonjë rreziku të shkaktuar nga shkelja disiplinore;

dh) çdo rrethanë e rëndësishme që ka lidhje me shkeljen;

e) rrethana të lidhura me gjendjen shëndetësore të magjistratit;

ë) sjellja e magjistratit pas kryerjes së shkeljes dhe pas fillimit të hetimit;

f) sjellja e magjistratit gjatë procedimit disiplinor dhe qëndrimin që mban ndaj tij;

g) çdo çështje tjetër që konsiderohet e rëndësishme.

43. Në analizë të kriterit “lloji dhe rrethanat e shkeljes”, konstatohet se KLGj-ja ka konkluduar se:

“77. Duke analizuar rrethanat e shkeljeve disiplinore, rezultojnë se: nga ana e magjistrates Enkeleida Hoxha janë ndërmarrë veprime/mosveprime të cilat kanë të bëjnë me mosrespektim të rëndë dhe të vazhduar të legjislacionit material dhe procedural penal, duke mos respektuar parashikimet e nenit 57 të Kodit Penal, neneve 438, 518, pika 1, dhe nenit 3 të Kodit të Procedurës Penale; nenit 9,

pika 3, të ligjit nr. 8499, datë 10.6.1999, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës Për transferimin e personave të dënuar”, nenit 52, paragrafi 2, i ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, vendimet unifikuese nr. 154/2000 dhe nr. 2/2015, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë; ligjit nr. 141/2016 “Për amnistinë” dhe nenet 64 e 65 të Kodit Penal, pra nuk janë respektuar dispozitat penale me karakter urdhërues, të cilat parashikojnë kriteret me karakter objektiv, ndalues dhe me një përmbajtje të drejtpërdrejtë dhe lehtësisht të kuptueshme, ku përvoja e gjatë profesionale në detyrë e magjistrates, e lejon të interpretojë dhe zhatojë drejt këto dispozita ligjore. Këto veprime/mosveprime nga magjistratja Enkeleida Hoxha janë kryer në mënyrë të drejtpërdrejtë, të vazhduar, të vullnetshme dhe të pajustificuar në disa procese gjyqësore të zhvilluara ndaj të dënuarit H. B., brenda një harku kohor të shkurtër, për t’i krijuar atij mundësinë që të lirohet sa më shpejt nga burgu, megjithëse ka qenë i dënuar për vepra shumë të rënda penale.”.

44. Në analizë të kriterit “pasojat e shkeljes”, KLGj-ja ka konkluduar se: “78. Ushtrimi i parregullt i detyrës nga ana e magjistrates Enkeleida Hoxha, ka sjellë pasojat për dhënien e drejtësisë, cenimin e besimit ndaj saj dhe të drejtësisë në përgjithësi, në një moment kur çdo gjyqtar i sistemit të drejtësisë duhet të bëjë të kundërtën, duke përmbushur në mënyrë sa më të rregullt detyrën e ngarkuar, në mënyrë që t’i kthejmë publikut besimin e humbur të drejtësisë, e cila është në proces reformimi [...]. 79. Dubet thënë që lirimet e pamerituara me kusht të personave që kanë kryer vepra shumë të rënda penale dhe që kanë rrejtshmëri të lartë shoqërore, ndikojnë shumë në ndjeshmërinë e publikut, duke u bërë shtrat edhe për kultivimin e ndjenjës së hakmarrjes dhe vetëgjyqësisë [...]. Transferimi nuk ka për qëllim që të dënuarit t’i krijohet terreni i dubur që ai të lirohet para kohe me kusht, pa përmbushur asnjë kriter ligjor. Vendimmarrjet e magjistrates në procedim janë të tilla që cenojnë rëndë figurën e një magjistrati si brenda vendit, ashtu edhe tek autoritetet gjyqësore të Mbretërisë së Bashkuar e më gjerë.”.

45. Nga sa më sipër, KLGj-ja, në analizë të kriterëve të dispozitës së mësipërme, të marra në harmoni me njëra-tjetrën, ka arritur në përfundimin se veprimet/mosveprimet e kryera nga ana e magjistrates Enkeleida Hoxha në ushtrimin e detyrës, janë shkelje shumë të rënda disiplinore.

46. Në vazhdim, konstatohet se KLGj-ja ka bërë dhe analizën nëse shkeljet shumë të rënda disiplinore të magjistrates përbëjnë akte që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, dhe se



përmbushen të gjithë elementet e vlerësuara në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, e cila në vendimin nr. 75/2002, ka vënë në dukje: “[...] *kjo shprehje përmbledh në vetvete një sërë elementesh, të cilat mund të identifikohen rast pas rasti nga organi përkatës që merr vendimin për shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm. Më tej, Gjykata Kushtetuese vazhdon me arsyetimin se ato janë të lidhura me akte e sjellje të parregullta e të padenja që këta funksionarë të lartë kryejnë gjatë ushtrimit të detyrës, për shkak të saj si dhe jashtë detyrës. Këto veprime apo mosveprime që analizohen në bazë të rrethanave të kryerjes së tyre, momenti subjektiv, si dhe dëmet që i sjellin shoqërisë dhe shtetit, duhet të jenë të asaj natyre që e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese nga këto subjekte.*”.

47. KLGj-ja, referuar parashikimeve të trajtuara më sipër në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, ka vlerësuar se shkeljet e pajustificuara dhe të vazhduara të normave ligjore nga ana e gjyqtarëve gjatë ushtrimit të detyrës, që kanë sjellë pasoja për dhënien e drejtësisë, konsiderohen si akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë figurën e magjistratit, duke e bërë të padenjë për të vazhduar funksionin e saj si magjistrate.

48. Në përfundim, KLGj-ja, duke vlerësuar se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistrates Enkeleida Hoxha, përbëjnë “shkelje shumë të rëndë disiplinore” dhe që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës, ka vendosur dhënien e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, e parashikuar në nenin 140, pika 2, germa “a”, të Kushtetutës, si dhe në nenin 111, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

49. Kolegji çmon se KLGj-ja, si organi i ngarkuar nga Kushtetuta për të vendosur për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve, bazuar në rrethanat konkrete, aktet, si dhe pretendimet dhe provat e paraqitura nga palët gjatë procesit, ka analizuar veprimet e kryera nga ankuesja në dhënien e vendimeve objekt procedimi disiplinor, dhe ka arritur në konkluzionin e drejtë dhe të bazuar se mosrespektimi i pajustificuar dhe i vazhdueshëm i legjislacionit përbën shkelje të rëndë profesionale në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, që diskrediton

pozitën dhe figurën e gjyqtarit, dhe që ka sjellë pasoja të rënda për autoritetin e organeve të drejtësisë, pasi i dënuari ka përfituar padrejtësisht lirin para kohe për shkak të vendimeve të magjistrates.

50. Kolegji konkludon se shkeljet e rënda profesionale të evidentuara në vendimet e magjistrates Enkeleida Hoxha, të cilat, si u analizuan më sipër, konsistojnë në shkeljen haptazi në mënyrë të përsëritur, të legjislacionit në fuqi, në dhënien e vendimeve gjyqësore të njëpasnjëshme për të dënuarin H. B., kanë mundësuar ndërprerjen e vuajtjes së dënimit të tij në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Këto vendime, të marra me gabime për koncepte bazike të drejtësisë penale, si “paraburgim” dhe “dënim”, apo institute të tjera të rëndësishme të kësaj drejtësie, nuk mund të justifikohen në rastin e një gjyqtari me eksperiencë të gjatë në sistemin e drejtësisë, i cili ka njohuri të plota për zbatimin e legjislacionit penal.

51. Kolegji i gjen të drejta konkluzionet e Këshillit se shkeljet e kryera nga magjistratja, janë rezultat i veprimeve të kryera me dashje, që kanë diskredituar rëndë pozitën e saj si gjyqtare dhe që kanë cenuar prestigjin dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor, ashtu siç kërkon dhe Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 29/2001: “[...] *shkarkimi nga detyra i gjyqtarit vendoset vetëm në raste të caktuara, midis të tjerash edhe për shkelje të ndryshme të disiplinës në punë, të kryera këto në ndonjë nga format e parashikuara në ligjin nr. 8436, datë 28.12.1998, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”. Megjithatë, jo çdo shkelje, qoftë kjo e kryer edhe në formën e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, përligj marrjen e kësaj mase ekstreme. Zbatimi i saj, në vështirim të dispozitës kushtetuese të lartpërmendur, është i lidhur vetëm me kryerjen e akteve që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit [...].*”.

52. Kolegji konsideron se vlerësimi i veprimeve të gjyqtarit, i pasojës së ardhur dhe i masës disiplinore që duhet marrë ndaj tij janë në kompetencën e vetë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kolegji, në vlerësimin e tij për masën disiplinore të shkarkimit nga detyra për magjistraten Enkeleida Hoxha, sjell në vëmendje qëndrimin e mbajtur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 11/2003, në të cilin shprehet se: “*Sipas nenit 135 të Kushtetutës, pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, nga gjykata e apelit dhe gjykata e*



shkallës së parë. Ky pushtet ushtrohet i shkallëzuar sipas parimit të kontrollit të vendimeve të gjykatave më të ulëta nga gjykatat më të larta. Kjo do të thotë se përderisa vendimet nuk janë prishur ose ndryshuar nga një gjykatë më e lartë, asnjë organ tjetër shtetëror, qoftë edhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nuk ka të drejtë t'i prekë ato dhe as të ngarkojë me përgjegjësi disiplinore gjyqtarin e çështjes për këto vendime. Përgjatë nga rregulli i mësipërm, bëhet vetëm për rastet kur vendimet janë rrjedhojë e shkeljeve që diskreditojnë rëndë pozitën ose figurën e gjyqtarit. Në këto raste, shkeljet duhet të evidentohen dhe argumentohen para se të merret masa disiplinore e largimit të gjyqtarit nga detyra. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, kur vërtetohen shkelje të natyrës së mësipërme, mund të veprojë në çdo kohë për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit, pavarësisht nëse çështja ka përfunduar ose jo [...].”.

53. Në analizë të sa më sipër, Kolegji arrin në përfundimin se shkeljet e magjistrates gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj gjyqësore, në dhënien e vendimeve objekt procedimi, të konstatuara nga ILD-ja, të shqyrtuara dhe konkluduara nga KLGj-ja në procedimin disiplinor ndaj saj, janë të tilla që e ngarkojnë atë me përgjegjësi disiplinore dhe se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, e dhënë ndaj magjistrates, prej KLGj-së, është proporcionale me rëndësinë e shkeljeve të kryera prej saj.

54. Për sa më sipër, Kolegji, bazuar në analizën në tërësi të pretendimeve të kërkuases, çmon se vendimi nr. 92, datë 17.3.2021, i Këshillit të Lartë Gjyqësor, është i drejtë dhe i bazuar në ligj, dhe kërkesa e magjistrates Enkeleida Hoxha nuk duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Posaçëm i Apelit, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P”, dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

Mospranimin e ankimit të magjistrates Enkeleida Hoxha, kundër vendimit nr. 92, datë 17.3.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për

caktimin e masës disiplinore ndaj gjyqtarës Enkeleida Hoxha”.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë, dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 31.5.2022.

Shpallur më 30.6.2022.

Kryetare Albana Shtylla

Anëtarë: Ina Rama, Mimoza Tasi, Natasha Mulaj, Rezarta Schuetz, Sokol Çomo

URDHËR

Nr. 311, datë 29.6.2022

PËR SHFUQIZIM TË URDHËRIT NR. 2, DATË 21.1.2021 “PËR DELEGIM KOMPETENCASH”

Në mbështetje të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 2, datë 21.1.2021 “Për delegim kompetencash”.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Jonaid Myzyri

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR “SEKRET SHTETËROR” NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE Nr. 6598/8, datë 30.6.2022

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, i ndryshuar, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e



informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, i mbledhur më datë 28.6.2022, vendosi të deklasifikojë informacionet e klasifikuara “Sekret shtetëror”, si më poshtë:

1. Deklasifikohen plotësisht informacionet (dosjet) e klasifikuara “Sekret shtetëror”, si më poshtë:

Fondi 14/APOU, viti 1971

Dosjet 42, 50. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Dosja 65. Niveli i klasifikimit “T sekret”.

Viti 1972

Dosja 28. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1973

Dosja 8. Niveli i klasifikimit “T sekret”. Dosjet 14, 28, 30. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1974

Dosja 10, 32. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1975

Dosja 4. 10. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1977

Dosja 7. Niveli i klasifikimit “T sekret”. Dosja 27. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

2. Një kopje e bibliografisë t’i dërgohet DSIK-së, si dhe për botim në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ardit Bido

VENDIM

Nr. 116, datë 24.5.2022

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SPV BLUE 1” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK “BLUE 1” ME VENDNDODHJE NË ZONËN E SHEQ MARINAS, BASHKIA FIER, ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 mw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e

licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.5.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 771/7 prot., datë 20.5.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘SPV Blue 1’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik ‘Blue 1’, me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 mw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 2, datë 13.1.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik “Blue 1” me kapacitet të instaluar 50 mw, për një afat 30-vjeçar, me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier.

- ERE, me shkresën nr. 70/1 prot., datë 14.1.2022, njoftoi në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve nga të tretët (data 24.2.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla.

- Në vijim, shoqëria është njoftuar për vendimin dhe i është kërkuar plotësimi i dokumentacionit. Po ashtu në analizë të këtij aplikimi janë zhvilluar disa seanca dëgjimore. Shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k. ka dërguar dokumentacion në kuadër të plotësimeve të kërkuara.

- Nga shqyrtimi që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k., rezulton se janë plotësuar kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si më poshtë:

- formatin dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germa: “a”, “b”, “c”;

- dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germa: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”;

- dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa: “a”, “b”, “d”;



- dokumentacionin teknik për centralin fotovoltaiik, neni 9, pikat 4.4.1; 4.4.2, 4.4.3, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, pika 4.4.4 germat: “a”, “b”, “c”, “d”;

- leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.4.5, germat “a” dhe “b”.

- I vetmi dokument që mbetet pa plotësuar është dokumenti që vërteton pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (certifikata pronësie, kontrata shitblerje, kontrata qiramarrje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjekte private ose shtetërore që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete të paluajtshme, etj.). Shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE certifikatat e regjistrimit të pronësisë për pasuritë me nr. 535/3, nr. 622 dhe nr. 537, përpara vënies në operim të veprës.

- Kontratat nr. 2720 rep. dhe nr. 2066 kol., të datës 9.7.2021, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaiik gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike ‘Blue 1’ me kapacitet të instaluar 50 mw dhe veprave ndihmëse, i cili nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën Sheq Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria ‘SPV Blue 1’ sh.p.k.”, të nënshkruara ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), në cilësinë e autoritetit kontraktues dhe shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k. në cilësinë e mbajtësit të miratimit përfundimtar, ka një afat 49-vjeçar, por ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

- Në rastin konkret, duke qenë se nga studimi i fizibilitetit të centralit fotovoltaiik “Blue 1” rezulton se jetëgjatësia e moduleve fotovoltaike shkon 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “SPV Blue 1” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike

nga centrali fotovoltaiik “Blue 1”, me kapacitet të instaluar 50 mw, për një afat 25-vjeçar duke filluar nga data e operimit, por jo më vonë se data 1.7.2023.

2. Shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k. të depozitojë në ERE certifikatat e regjistrimit të pronësisë për pasuritë me nr. 535/3, nr. 622 dhe nr. 537, përpara vënies në operim të veprës.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

4. Ky vendim është objekt rishikimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 117, datë 24.5.2022

MBI NJOHJEN E LICENCËS PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE, LËSHUAR NGA ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR SUBJEKTIN “FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS” SHPK

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë



29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; “Memorandumin e mirëkuptimit për njohjen reciproke të licencave për veprimtarinë e tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike ndërmjet autoriteteve kombëtare rregullatore të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 245, datë 6.12.2021; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.5.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 562/3-1 prot., datë 17.5.2022, “Mbi njohjen e licencës për furnizimin me energji elektrike nr. ZRRE/LI_55/21, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, me vendimin V_968_2018, datë 13.4.2018, për subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k., që ka regjistruar në Shqipëri subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k., dega në Tiranë,

konstatoi se:

- Subjekti “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k., dega Tiranë, me shkresën e datës 24.3.2022, protokolluar në ERE me nr. 405, datë 24.3.2022, ka paraqitur kërkesën për njohjen e licencës për furnizimin me energji elektrike, të lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji në Republikën e Kosovës, V_968_2018, datë 13.4.2018.

- Duke qenë se dokumentacioni i depozituar fillimisht nga shoqëria nuk ishte i plotë, ERE i evidentoi shoqërisë këtë fakt me shkresën nr. 405/1, datë 6.4.2022. Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 405/2 prot., datë 8.4.2022, shoqëria depozitoi të gjithë dokumentacionin e munguar.

- ERE, me shkresën me nr. 405/3 prot., datë 27.4.2022, i paraqiti Zyrës së Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, kërkesën për informacion në lidhje me vlefshmërinë e kësaj licence dhe në rast se kjo zyrë ka ndërmarrë ndonjë veprim për heqjen apo pezullimin e kësaj licence. Kjo shkresë u dërgua dhe e skanuar në adresën elektronike zyrtare të ZRRE-së, info@ero-ks.org, më datë 29.4.2022.

- Me shkresën nr. 237/22 prot., datë 11.5.2022, protokolluar në ERE me nr. 405/4 prot., datë

16.5.2022, ZRRE Kosovë ka informuar ERE-n se ka lëshuar licencën për furnizimin me energji elektrike me numër ZRRE/LI_55/16 për subjektin juridik “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k., me afat vlefshmërie nga 13 prill 2018 deri më 12 prill 2023. Gjithashtu, ZRRE ka njoftuar se nuk ka filluar dhe as ka ndërmarrë ndonjë veprim apo vendim për heqjen apo pezullimin e kësaj licence.

- Në kuptim të nenit 4, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, është pranuar njohja reciproke e licencave për furnizimin me energji elektrike, me kusht që subjekti që aplikon për njohjen e licencës të dorëzojë në ERE licencën e përkthyer dhe noterizuar, si dhe informacionin e përcaktuar në nenin 9/1 dhe 9/2, germa “c”, të kësaj rregulloreje.

- Subjekti ka depozituar në ERE të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 3, të rregullores së sipërcituar, si dhe ka kryer pagesën e aplikimit për njohjen e licencës për furnizimin me energji elektrike.

- Afati i njohjes së licencës do të jetë i njëjtë me afatin e licencës së lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, për shoqërinë “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k. deri më 12.4.2023.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë njohjen e licencës për furnizimin me energji elektrike nr. ZRRE/LI_55/16, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, me vendimin V_968_2018, datë 13.4.2018, për subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k., që ka regjistruar në Shqipëri subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k., dega në Tiranë.

2. Njohja e licencës sipas përcaktimeve të pikës 1 do të jetë e vlefshme deri më 12.4.2023.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Zyrën e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga



data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 118, datë 24.5.2022

**MBI NJOHJEN E LICENCËS PËR
TREGTIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE, LËSHUAR NGA ZYRA E
RREGULLATORIT PËR ENERGJI E
REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR
SUBJEKTIN “FUTURE ENERGY
TRADING AND EXCHANGE
DYNAMICS” SHPK (FUENTE
DYNAMICS)**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; “Memorandumin e mirëkuptimit për njohjen reciproke të licencave për veprimtarinë e tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike ndërmjet autoriteteve kombëtare rregullatore të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 245, datë 6.12.2021; Bordin i ERE, në mbledhjen e tij të datës 24.5.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 562/4-1

prot., datë 17.5.2022, “Mbi njohjen e licencës për tregtimin e energjisë elektrike nr. ZRRE/LI_72/21, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, me vendimin V_1400_2021, datë 2.9.2021, për subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k. (Fuente Dynamics), që ka regjistruar në Shqipëri subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k., dega në Tiranë,

konstatoi se:

- Subjekti “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k., dega Tiranë, me shkresën e datës 24.3.2022, protokolluar në ERE me nr. 405, datë 24.3.2022, ka paraqitur kërkesën për njohje të licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike (licenca për furnizim me shumicë (tregtim), të lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji në Republikën e Kosovës, me vendimin V_1400_2021, datë 2.9.2021.

- Duke qenë se dokumentacioni i depozituar fillimisht nga shoqëria nuk ishte i plotë, ERE i evidentoi shoqërisë këtë fakt me shkresën nr. 405/1 prot., datë 6.4.2022. Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 4005/2 prot., datë 8.4.2022, shoqëria depozitoi të gjithë dokumentacionin e munguar.

- ERE, me shkresën nr. 405/3 prot., datë 27.4.2022, i paraqiti Zyrës së Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, kërkesën për informacion në lidhje me vlefshmërinë e kësaj licence dhe në rast se kjo zyrrë ka ndërmarrë ndonjë veprim për heqjen apo pezullimin e kësaj licence. Kjo shkresë u dërgua dhe e skanuar në adresën elektronike zyrtare të ZRRE-së, info@ero-ks.org, në datën 29.4.2022. ZRRE ka njoftuar se nuk ka filluar dhe as ka ndërmarrë ndonjë veprim apo vendim për heqjen apo pezullimin e kësaj licence.

- Me shkresën nr. 237/22 prot., datë 11.5.2022, protokolluar në ERE me nr. 405/4 prot., datë 16.5.2022, ZRRE Kosovë ka informuar ERE-n se ka lëshuar licencën për tregtimin e energjisë elektrike me numër ZRRE/LI_72/21, për subjektin juridik “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k. (Fuente Dynamics), me afat vlefshmërie nga 2.9.2021 deri më 1 shtator 2026.

- Në kuptim të nenit 4, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të



ndryshuar, është pranuar njohja reciproke e licencave për tregtimin e energjisë elektrike, me kusht që subjekti që aplikon për njohjen e licencës të dorëzojnë në ERE licencën e përkthyer dhe noterizuar, si dhe informacionin e përcaktuar në nenin 9/1 dhe 9/2, germa “c”, të kësaj rregulloreje.

Subjekti ka depozituar në ERE të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 3, të rregullores së sipërcituar, si dhe ka kryer pagesën e aplikimit për njohje të licencës për tregtimin e energjisë elektrike.

- Afati i njohjes së licencës do të jetë i njëjtë me afatin e licencës së lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës, për shoqërinë “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k. (Fuente Dynamics), deri më 1.9.2026.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë njohjen e licencës për tregtimin e energjisë elektrike nr. ZRRE/LI_72/21, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, me vendimin V_1400_2021, datë 2.9.2021, për subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k. (Fuente Dynamics), që ka regjistruar në Shqipëri subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k., dega në Tiranë.

2. Njohja e licencës sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi do të jetë e vlefshme deri më 1.9.2026.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Zyrën e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 119, datë 24.5.2022

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “IRARBA ENERGJI” SHPK PËR TRANSFERIMIN E ASETVEVE TË PALUAJTSHME NË FAVOR TË BANKËS SË BASHKUAR TË SHQIPËRISË SHA

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa “a”, dhe nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të pikës 1.3 dhe pikës 1.6, të “Kushteve të licencës së veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 99, datë 17.6.2016; të nenit 11 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016; si dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.5.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 771 prot., datë 17.5.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Irarba Energji’ sh.p.k. për transferimin e aseteve në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 225, datë 9.11.2021, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Irarba Energji” sh.p.k. për transferimin e aseteve të paluajtshme në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë (*United Banka of Albania*) sh.a.

- ERE njoftoi shoqërinë për vendimarrjen e mësipërme me shkresën nr. 1012/2 prot., datë 10.12.2021, duke evidentuar dhe dokumentacionin e munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE në zbatim të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, rezulton se ai është plotësuar si vijon:

Neni 7, pika 1, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “i”, “j”, pika 3, pika 4 dhe pika 6.

- Në lidhje me dokumentacionin e plotësuar pjesërisht, i cili është si vijon:

Neni 7, pika 1, germa “h” (marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga



format e parashikuara nga ligji, për transferimin e aseteve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të aseteve që kërkohet të transferohen). Shoqëria nuk ka depozituar marrëveshje të nënshkruar me bankën, por janë depozituar shkresa të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a., ku deklarohet se Banka ka miratuar financimin përkatës, por marrëveshja me shoqërinë për vendosjen e barrës siguruese do të nënshkruhet pas marrjes së autorizimit nga ERE, ndaj në këto rrethana vlerësohet që të miratohet kërkesa e shoqërisë “Irraba Energji” sh.p.k. për transferimin e aseteve në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a., me kusht që brenda 3 muajve nga ky miratim, të depozitojë në ERE marrëveshjen e nënshkruar me Bankën për këtë transferim të aseteve, ku të jetë përfshirë dhe lista e aseteve të paluajtshme, së bashku me vlerën përkatëse të secilit prej tyre, përndryshe autorizimi i ERE-s do të bëhet i pavlefshëm.

- Dhënia e miratimit nga ERE për transferimin e aseteve nuk e çliron shoqërinë “Irraba Energji” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet e organeve të tjera, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

- Shoqëria “Irraba Energji” sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s, për sa i përket pagesave të rregullimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Irraba Energji” sh.p.k. për transferimin e aseteve të paluajtshme në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a., me kusht që, brenda 3 muajve nga ky miratim, të depozitojë në ERE marrëveshjen e nënshkruar me bankën për këtë transferim të aseteve, përfshirë dhe lista e aseteve të paluajtshme, së bashku me vlerën përkatëse të secilit prej tyre.

2. Mosdepozitimi i dokumentacionit sipas përcaktimeve të pikës 1, e bën këtë miratim të pavlefshëm.

3. Dhënia e miratimit nga ERE për transferimin e aseteve nuk e çliron shoqërinë “Irraba Energji” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet e organeve të tjera, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

4. Ky vendim është objekt rishikimi në çdo kohë nga ERE.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 120, datë 24.5.2022

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “EGNATIA
HYDROPOWER” SHPK NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA HEC
“GOSTIMA 1”, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 3047 kw, “GOSTIMA 2”, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 5586 kw,
“GOSTIMA 3”, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 5335 kw, “GOSTIMA 4”, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 7396 kw,
“GOSTIMA 5”, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 10321 kw, “GOSTIMA 5/1”,
ME KAPACITET TË INSTALUAR 450 kw,
DHE “GOSTIMA 6”, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 16819 kw, ME KAPACITET
TOTAL TË INSTALUAR 48 864 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pika 3 dhe 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e



Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.5.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 771/3 prot., datë 18.5.2022, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Egnatia Hydropower’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Gostima 1’, me kapacitet të instaluar 3047 kw, ‘Gostima 2’, me kapacitet të instaluar 5586 kw, ‘Gostima 3’, me kapacitet të instaluar 5335 kw, ‘Gostima 4’, me kapacitet të instaluar 7396 kw, ‘Gostima 5’, me kapacitet të instaluar 10321 kw, ‘Gostima 5/1’, me kapacitet të instaluar 450 kw, dhe ‘Gostima 6’, me kapacitet të instaluar 16819 kw, me kapacitet total të instaluar 48 864 kw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Egnatia Hydropower” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 636 prot., datë 9.5.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Gostima 1”, “Gostima 2”, “Gostima 3”, “Gostima 4”, “Gostima 5”, “Gostima 5/1” dhe “Gostima 6”, me vendndodhje në rrjedhën e lumit Gostimë, përfshirë dhe degët e tij, rrethi Elbasan, Librazhd.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores së sipërcituar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim, shoqëria ka plotësuar dokumentacionin, në lidhje me:

- Formatin dhe dokumentacionin për aplikim, neni 9, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”;

- dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”;

- dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa “d”;

- dokumentacionin teknik për HEC, neni 9, pika 4.1.3, germat: a”, “b”, “c”, “d”;

- lejet nga institucionet e tjera, neni 9, pika 4.1.5, germat “b” dhe “c”;

- dokumentacionin tekniko-ekonomik, neni 9, pika 4.1.4, germat “c” dhe “e”.

Dokumentacionin e munguar si më poshtë:

- Nenin 7, “Delegimi i të drejtave të aplikuesit”, pika 2, germa “a”, shoqëria duhet të përcjellë në ERE prokurën ose autorizimin e aplikuesit për përfaqësimin e tij.

Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa “d” (vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj, në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata)). Duke qenë se selia e shoqërisë është në Tiranë, në vijim shoqëria duhet të përcjellë në ERE vërtetimet e Prokurorisë dhe Gjykatës së Tiranës për administratorin e shoqërisë dhe përfaqësuesin e saj ligjor, në zbatim të nenit 7, pika 2, germa “b”, të rregullores;

- germa “e” (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse. Në rastin e aplikimeve për licencë prodhimi të energjisë elektrike kërkohet paraqitja e licencës për drejtues teknik elektrik). Shoqëria të përcjellë në ERE licencën për drejtuesin teknik;

- germa “P” (marrëveshje koncesioni apo çdo formë tjetër e marrëveshjes në rastet e aplikueshme të lidhura me institucionet përgjegjëse të ngarkuara me ligj, në përputhje me kuadrin ligjor përkatës si dhe ndryshimet në këto akte). Në vijim do t’i kërkohet shoqërisë të përcjellë në ERE edhe kontratën bazë të koncesionit të nënshkruar me autoritetin kontraktor dhe kontratën shtesë të koncesionit të nënshkruar pas kryerjes së projektit të zbatimit të vitit 2019 dhe oponencën teknike respektive.

Po ashtu, në lidhje me rivendosjen në afat të ndërtimit të veprës, shoqëria duhet të bëjë me dije nëse është pajisur me leje ndërtimi.

Dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3:

- germa “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj institucionit të



sigurimeve shoqërore). Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimet respektive me afat të përditësuar (të jenë lëshuar jo më parë se 1 muaj nga momenti i depozitimit në ERE) në zbatim të nenit 8, pika 3 të rregullores;

- germa “b” (bilanci financiar i tri viteve të fundit/ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë, shoqëri të tjera paraqitja e bilancit të këtyre të fundit)). Në zbatim të kërkesave të kësaj pike të rregullores, shoqëria duhet të depozitojë në ERE pasqyrat financiare për vitin 2021;

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financim dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacione, të tjera, etj.)). Shoqëria nuk ka përcjellë dokument në lidhje me sa kërkon kjo pikë e rregullores dhe do t’i kërkohej t’i depozitojë këto dokumente në ERE.

Dokumentacionin teknik për HEC:

Të dhënat teknike për HEC, neni 9, pika 4.1.1:

- Për HEC “Gostima 1”, “Gostima 2”, “Gostima 3”, “Gostima 4”, “Gostima 5”, dhe “Gostima 6” shoqëria duhet të plotësojë të dhënat që lidhen me: kapacitetin ujëmbledhës, tensionin në dalje të gjeneratorit, nën/stacionin ku lidhet, tensionin e rrjetit të shpërndarjes/transmetimit ku lidhet HEC, rendimentin dhe jetëgjatësinë e pritshme të centralit, sipas kërkesave të formatit në zbatim të rregullores.

Të dhënat teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin, neni 9, pika 4.1.2, shoqëria duhet të plotësojë të dhënat që lidhen me prodhuesin e transformatorit, kapacitetin mVa, tensionin e përshtjellave kV, Skemën e lidhjes së përshtjellave, gjatësinë e linjës km, kapacitetin transmetues mw, nivelin e tensionit të linjës kV, llojin e përcjellësve dhe seksionin e përcjellësve m², për të 7 HEC.

Leje nga institucione të tjera:

Neni 9, pika 4.1.5.

- germa “a” (miratimi i pikës së lidhjes me sistemin). Shoqëria duhet të depozitojë në ERE, miratimin e pikës së lidhjes dhe/ose marrëveshjen e pikës së lidhjes me sistemin e transmetimit.

- Në përfundim të afatit të dy prej kontratave të qirasë (datë 25.3.2031 dhe 7.1.2031), shoqërisë do t’i kërkohej t’i depozitojë ato me afate të rinovuara, apo çdo dokument tjetër që do të rregullojë

pronësinë në vijim. Ndërsa për kontratën e tretë, e cila përcakton se afati i saj është 9 vjet duke filluar nga e nesërmja e marrjes së lejes së ndërtimit nga organet përkatëse, do t’i kërkohej shoqërisë informacion në lidhje me pajisjen me leje ndërtimi në mënyrë që të llogariten afatet e përfundimit të saj.

- Shoqëria duhet të përcjellë në ERE informacion në lidhje me fazën e zbatimit të projektit, dhe me depozitimin e tij do të bëhen edhe llogaritjet përkatëse në lidhje me fillimin ose jo të punimeve brenda afateve që përcakton deklarata mjedisore.

- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit të sipërcituar, do të njoftohet subjekti që në zbatim të neneve 10, pika 10, dhe 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, t’i depozitojë ato në ERE brenda afateve.

- Shoqëria duhet të depozitojë kontratën e koncesionit të formës BOT (ndërtim-operim-transferim), për ndërtimin e hidrocentraleve mbi lumin Gostimë (Egnatia–Shushicë), me nr. 4 rep., nr. 1 kol., të nënshkruar më datë 20.2.2013.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Gostima 1”, me kapacitet të instaluar 3047 kw, “Gostima 2”, me kapacitet të instaluar 5586 kw, “Gostima 3”, me kapacitet të instaluar 5335 kw, “Gostima 4”, me kapacitet të instaluar 7396 kw, “Gostima 5”, me kapacitet të instaluar 10321 kw, “Gostima 5/1”, me kapacitet të instaluar 450 kw, dhe “Gostima 6”, me kapacitet të instaluar 16819 kw, me kapacitet total të instaluar 48 864 kw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të



ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 121, datë 24.5.2022

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “EGNATIA
HYDROPOWER” SHPK NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “e”; nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.5.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 771/2 prot., datë 18.5.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Egnatia Hydropower’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Egnatia Hydropower” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 636 prot., datë 9.5.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe

heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal, si dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim, shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

- formatin dhe dokumentacionin për aplikim, neni 9, pika 1, germa: “a”, “b”, “c”;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germa: “a”, “b”, “c”;

- dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa “d”;

- dokumentacionin teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, germa “c”.

Rezulton se shoqëria nuk ka plotësuar një pjesë të konsiderueshme të dokumentacionit si vijon:

Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa “d” (vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj, në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata)). Shoqëria nuk ka përcjellë në ERE, vërtetimet e Prokurorisë dhe Gjykatës së Tiranës për administratorin, vetë shoqërinë dhe përfaqësuesin e saj ligjor, në zbatim të nenit 7, pika 2, germa “b” të rregullores;

- germa “e” (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse). Shoqëria nuk ka përcjellë strukturën e organizimit të saj.

Dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3:

- germa “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj institucionit të sigurimeve shoqërore). Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimet respektive me data të rifreskuara në zbatim të nenit 8, pika 3, të rregullores;

- germa “b” (bilanci financiar i tre viteve të fundit/ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë shoqëri të tjera paraqitja e



bilancit të këtyre të fundit). Shoqëria nuk ka depozituar në ERE pasqyrat financiare për vitin 2021;

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financim dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacione, të tjera, etj.)). Shoqëria nuk ka depozituar dokumentacion për sa kërkon kjo pikë e rregullores.

Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8:

- germa “a” (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar në gwh/sipas viteve);

Shoqëria nuk ka depozituar informacion mbi sasitë e parashikuara për t’u tregtuar për pesë vitet e licencës;

- germa “b” (kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj). Shoqëria nuk ka depozituar një dokument ku të specifikohet kapitali financiar që vë në dispozicion të ushtrimit të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

- Duke qenë se nuk është plotësuar një pjesë e konsiderueshme e dokumentacionit juridiko-administrativ dhe fiskal, dhe dokumentacionit teknik për ushtrimin e veprimtarisë për të cilën kërkon të licencohet subjekti është i paplotësuar, vlerësohet të mosfillojë procedura për licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit energjisë elektrike.

- Në mbështetje të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, shoqëria mund të paraqesë një aplikim të ri për licencim brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit të ERE-s për mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit dhe dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm edhe për aplikimin e ri.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mosfillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Në rast se shoqëria do të paraqesë një aplikim të ri, brenda 1 (një) muaji nga marrja e këtij vendimi, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria për qëllime të rinovimit të licencës do të konsiderohet i vlefshëm.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 122, datë 24.5.2022

MBI SHTYRJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s NË LIDHJE ME RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “KURUM INTERNATIONAL” SHA, ME NR. 372, SERIA F12/17, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 106, DATË 20.7.2012, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 13, pikat 1 dhe 3, dhe nenit 14, pika 3, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96,



datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.5.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 771/2 prot., datë 18.5.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Kurum International’ sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 20.7.2012, i ndryshuar”,

konstatoi se:

- Në vijim të relatimit të relacionit nr. 771/2 prot., datë 28.5.2022, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Kurum International’ sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, lindi nevoja për sqarime që lidhen me dokumentacionin financiar dhe atë teknik të aplikimit të shoqërisë dhe si e tillë vlerësohet shtyrja e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s me 20 (njëzet) ditë pune, për t’iu drejtuar shoqërisë me shkresën respektive në lidhje me dhënien e sqarimeve për këto çështje.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 20 (njëzet) ditë pune nga marrja dijeni, afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për rinovimin e licencës nr. 372, seria F12/17, të shoqërisë “Kurum International” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 20.7.2012.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në urdhrin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 115, datë 6.6.2022, “Për miratimin e rregullores për kërkesat, përmbajtjen e regjistrit dhe procedurat e regjistrimit, çregjistrimit ose ndryshimit të të dhënave në regjistrin e avionëve civil të Republikës së Shqipërisë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 93, datë 20.6.2022, faqe 11889–11899, bëhen korrigjimet si më poshtë:

Në faqen 11889, në pikën 2 të urdhrin, togfjalëshi “zbatimin e këtij urdhri”, i përsëritur dy herë, **hiqet dhe lihet një herë**, si dhe në faqen 11890, në pikën 18 (neni 2 i rregullores), fjala e fundit “qiramarrësit” bëhet **“qiradhënësit”**.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 560 lekë